

**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
DEPARTAMENTI I URBANISTIKËS**

Dizertacion për marrjen e gradës “Doktor”

TEMA:

**NDIKIMI I PËRQASJES SË METABOLIZMIT NË
PLANIFIKIMIN HAPËSINOR NË SHQIPËRI
NGA PLANI KOMBËTAR I TERRITORIT NË NIVELIN LOKAL TË
PLANIFIKIMIT**

Paraqitur nga:

Anisa FAGU (QORRI)

Udhëheqës shkencor:

**Prof.Asoc. Armand VOKSHI
Prof. Giuseppe De LUCA**

Mbrohet në datën 17/ 06/ 2021

Tiranë

Copyright

©Anisa Fagu (Qorri)

2021

**Udhëheqësi i studentes
Anisa Fagu(Qorri)**
vërteton se ky është versioni i miratuar i disertacionit të mëposhtëm:

**NDIKIMI I PËRQASJES SË METABOLIZMIT NË
PLANIFIKIMIN HAPËSINOR NË SHQIPËRI
NGA PLANI KOMBËTAR I TERRITORIT NË NIVELIN
LOKAL TË PLANIFIKIMIT**

Udhëheqës shkencor:

Prof.Asoc. Armand VOKSHI

Prof. Giuseppe De LUCA

**NDIKIMI I PËRQASJES SË METABOLIZMIT NË
PLANIFIKIMIN HAPËSINOR NË SHQIPËRI
NGA PLANI KOMBËTAR I TERRITORIT NË NIVELIN
LOKAL TË PLANIFIKIMIT**

Përgatitur nga:
MSc. Anisa Fagu (Qorri)

**Dizertacion i paraqitur në
Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
Universiteti Politeknik i Tiranës**

**Në përputhje të plotë
Me kërkesat
Për gradën Doktor**

**Universiteti Politeknik i Tiranës
Qershor, 2021**

DEDIKIM

Prindërve të mi

FALENDERIME

Faleminderit udhëheqësve të temës, Prof. Dr. Giuseppe De Luca, për udhëzimet, pozitivitetin dhe frymëzimin përgjatë këtij projekti, Prof. Dr. Amand Vokshin për përkrahjen dhe inkurajimin e vazhdueshëm.

Një falenderim për të gjithë pedagogët e shkollës së Doktoraturës në FAU, për mundësinë e dhënë. Familjarëve dhe miqve për mirëkuptimin, kolegëve të AKPT, dhe bashkëshortit tim Eledit, për mbështetjen.

DEKLARATA E ORIGJINALITETIT

Përmbajtja e këtij punimi është krejtësisht autentike.

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të evidentuara nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë edhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Jam i vetëdijshëm se në rast të mospërputhjes, Senati i UPT-së është i ngarkuar të më revokojë gradën “Doktor”, që më është dhënë mbi bazën e kësaj teze, në përputhje me “Rregulloren e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë (Doktorate) në UPT”

Anisa Fagu (Qorri)

Tiranë, më: ___/___/___

TABELA E PËRMBAJTJES

<u>KAPITULLI I</u>	13
<u>1. HYRJE</u>	13
1.1 PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT	15
1.2. METODOLOGJIA.....	18
1.3. PËRMBAJTJA E KAPITUJVE NË VIJIM	23
<u>KAPITULLI II</u>	25
<u>KONCEPTI I METABOLIZMIT NË LITERATURËN NDËRKOMBËTARE</u>	25
2.1. KONTEKSTI TEORIK DHE HISTORIK I LINDJES SË METABOLIZMIT URBAN DHE QASJET E TIJ KRYESORE - METABOLIZMI URBAN DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM.....	26
2.2. METODAT BAZË NË APLIKIMIN E METABOLIZMIT URBAN	36
2.3. PËRAFRIMI NË SISTEME	41
2.4. RASTET E ZBATIMIT TË METABOLIZMIT URBAN NË EUROPE	44
<u>KAPITULLI III</u>	55
<u>PLANIFIKIMI HAPËSINOR NË SHQIPËRI</u>	55
3.1. NDIKIMI I DIMENSIONIT EVROPIAN.....	56
3.2. PLANIFIKIMI NË NIVEL KOMBËTAR NË SHQIPËRI - VËSHTRIMI HISTORIK	59
3.3. RËNDËSIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT NË NIVELIN KOMBËTAR	71
3.4. PLANI I PARË KOMBËTAR ‘SHQIPËRIA 2030’	74
<u>KAPITULLI IV</u>	91
<u>4. METABOLIZMI I SHQIPËRISË</u>	91
4.1. ZBATIMI I METABOLIZMIT, NIVELI KOMBËTAR	91
4.2. ZBATIMI I METABOLIZMIT, NIVELI LOKAL	100
4.3. KRAHASIMI, ANALIZA E REZULTATEVE.....	101
4.4. KUFIZIMET DHE MUNDËSITË NË ZBATIMIN E METABOLIZMIT URBAN.....	109
<u>KAPITULLI V</u>	114
<u>5. PROPOZIMI I NJË KORNIZE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR ZHVILLIMIN E ANALIZËS METABOLIKE</u>	114
5.3.2. SHKALLA TERRITORIALE DHE KUFIJTË E SISTEMIT.....	116
5.3.3. TREGUESIT PËR NDËRTIMIN E PROFILIT URBAN.....	119
5.4.2. TREGUESIT PËR NDËRTIMIN E PROFILIT METABOLIK	125
5.4.3. FLUKSET METABOLIKE DHE METODAT E VIZUALIZIMIT	128
5.5. NDIKIMI I QASJES METABOLIKE NË INSTRUMENTET KRYESORE TË PLANIT.....	139
<u>KAPITULLI VI</u>	149
<u>6. PËRFUNDIME</u>	149
6.1. MBI METABOLIZMIN URBAN.....	151
6.2. KËRKIME TË MËTEJSHME.....	153
<u>BIBLIOGRAFIA</u>	161

LISTA E TABELAVE

Tabela 2.1-1: Përmbledhje mbi Metabolizmin Urban (Faraud, 2017, fq. 9).....	34
Tabela 2.3-1 Krahasim midis këndvështrimeve mbi Botën nga pikëpamja klasike dhe asaj të Sistemeve (Përpunim i Autorit)	44
Tabela 2.4-1: Analiza metabolike e modeleve urbane (Burimi: SUME, WP 3.3 (2011) f.7274) ...	49
Tabela 3.2-1 Lidhja midis planifikimit kombëtar dhe regjimeve politike në Shqipëri	62
Tabela 3.2-2: Përmbledhje e ndikimeve politike ekonomike dhe urbane në Shqipërinë e viteve 1945-1990.	64
Tabela 3.4-1 Deklarata e Vizionit PPK 2030.....	80
Tabela 3.4-2: Rankimi i shkallës së urbanizmit sipas modelit gjerman	90
Tabela 4.1-1 Shtresat për ndërtimin e hartës të fluksit të energjisë, PPK 2030. Burimi: Autori.....	97
Tabela 4.3-1 Kkrahassimi në strukturën kryesore të përmbajtjes së analizës metabolike në nivel lokal për 4 bashkitë në studim. Përpunim i Autorit.....	103
Tabela 4.4-1 Struktura e mbledhjes së të dhënave, niveli, rëndësia dhe detaji. Përpunoi: Autori	116
Tabela 4.4-2 Lidhja midis nivelit të mbledhjes së të dhënave, kohës, kufijve të një sistemi , planeve hapësinore dhe nivelit të vendimarrjes politike. <i>Burimi: Autori</i>	118
Tabela 4.4-3 Indiktorët për ndërtimin e profilit urban Burimi: Autori.....	121
Tabela 4.4-4 Të dhënat kornizë për flukset e profilit metabolik	127
Tabela 4.4-5 Të dhënat për ndërtimin e diagramës Sankey të Ujit, tregon bilancin ujqor të Shqipërisë. Përpunoi Autori, si pjesë e grupit të punës për hartimin e studimit “Metabolism of Albania” (MZHU, AKPT 2015).	130
Tabela 4.4-6 Të dhënat bruto për ndërtimin e diagramës Sankey të Energjisë.	132
Tabela 4.4-7 Struktura e të dhënave për ndërtimin e diagramës Sankey të Ushqimit . Përpunoi Autori, si pjesë e grupit të punës për hartimin e studimit “Metabolism of Albania” (MZHU, AKPT 2015).	134
Tabela 4.4-8 Burimet e brendshme natyrore . Burimi: INSTAT, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	135
Tabela 4.4-9 Lidhja midis niveleve të Analizës së Flukseve të Materialeve me Instrumentat e Planifikimit në Shqipëri. <i>Burimi: Raporti OECD 2008. Përpunoi: Autori</i>	139
Tabela 5.5-1 Ndikimet e disa Indiktorëve urban në dimensionet e metabolizmit urban.	140
Tabela 5.5-2 Matrica e Energjisë për t’u përdorur në Fazën 2 dhe 4	146
Tabela 5.5-3 Matrica e Materialeve për t’u përdorur në Fazën 2 dhe 3	146
Tabela 5.5-4 Matrica e Ujit për t’u përdorur në Fazën 2 dhe 3	147

LISTA E FIGURAVE

Figura 1-1 Hexahedroni i zhvillimi të qëndrueshëm. Propozim për një konceptim të ri të zhvillimit të qëndrueshëm. (Përpunim i autorit).....	19
Figura 2-1 Lidhja e metabolizmit urban me praktikën e planifikimit dhe sistemet natyrore, sociale dhe urbane (Burimi: Autori, përshtatur nga UN Environment (2017), Bai & Schandl (2011)).....	26
Figura 2-2 Transaksionet midis inputeve dhe outputeve t/dite per nje qytet hipotetik në Amerikë sipas Wolman (1965)	30
Figura 2-3 Metabolizmi Urban i Brukselit, Belgjikë 1970 (Duvigneaudand Denayeyer-De Smet, 1977)(Kennedy, C., Pincetl, S. & Bunje, P. , 2010).....	30
Figura 2-4 Metabolizmi linear dhe metabolizmi circular i qyteteve (Faraud, 2017)	37
Figura 2-5 Numri i studimeve të metabolizmit ndër vite, tregon rritjen e diversitetit të përqaesjes ku metoda përlllogaritëse MFA është dominuese (Musango, 2017).....	39
Figura 2-6 Parisi (2.2 milion banorë), Parisi dhe rrethinat e tij (6.3 milion banorë), dhe rajoni më i madh i Parisit (11.3 milion banorë) Përshtati në shqip, autori.	46
Figura 2-7 Skema e thjeshtuar e përgjithshme e bilancit të materialit (përfshirë ajrin dhe ujin) (OECD, 2011) si dhe skema e bilancit material të gjerë ekonomik (duke përjashtuar rrjedhat e ajrit dhe ujit) (OECD, 2011) Përshtati në shqip, autori.	46
Figura 2-8 Hartëzimi i flukseve të Roterdarmit. Burimi: Urban metabolism, sustainable development of Rotterdam (2014).....	54
Figura 2-9 Vizualizimi i katër strategjive si për shembull ri-industrializimi i bulevardeve përmes korridoreve të infrastrukturës, infrastruktura e mbetjeve organike etj. Burimi: Urban metabolism, sustainable development of Rotterdam(2014).....	54
Figura 3-1 Atlasi me 10 harta “ALBANIA” nga puna kërkimore e ing. Francesco Pollastri, Drejtor i “Ufficio Geografico dell’Istituto Centrale di Statistica del Regno d’Italia” Gusht 1939.....	63
Figura 3-2 Tipologjia e komunave dhe bashkive sipas Census2011, INSTAT	77
Figura 3-3 Rrjeti i qendrave urbane sipas hierarkisë dhe mënyrat e ndërhyrjes në territor, PPK2030,MZHU,AKPT 2014	77
Figura 3-4 Vendosi e Shqipërisë në raport me korridoret ekonomike me rëndësi europiane.....	80
Figura 3-5 Diagrama e Vizionit PPK 2030, përcaktimi i drejtimeve kryesore të lidhjeve me korridoret ekonomike me rëndësi europiane dhe detajimi i infrastrukturës kombëtare për të arritur këtë qëllim.....	80
Figura 3-6 Hierarkia e Instrumentave te planifikimit te territorit sipas igji 107/2014. Përpunoi autori, AKPT(2016).	81
Figura 3-7 Sistemi i vendeve qendrore sipas principit të tregut me tre renditje qendrash (PKK 2030)	85
Figura 3-8 Modeli hipotetik i një qyteti multinyjor (MZHU&AKPT, 2016).....	85
Figura 3-9 Klasifikimi i qendrave urbane sipas periferialitetit. Burimi:INSTAT, PPK2030.....	87
Figura 3-10: Modeli i zhvillimit hapësinor, AKPT	
Figura 21 harta e hierarkisë së qendrave urbane	89
Figura 3-11 Polet e zhvillimit dhe ndërhyrjet ne territor Gjirokastër –Sarandë dhe Vlorë Fier Berat, AKPT, PPK 2030.....	89
Figura 4-1 Harta e Fluksit të Ujit. “Metabolism of Albania”, IABR, AKPT et.al, 2014	92
Figura 4-2 Harta e ASistemit ujor. Burimi: AKPT, PPK 2030, 2016.f.120.....	92
Figura 4-3 Shtresat e hartës së Sistemit Natyror. Burimi: AKPT, PPK 2030, 2016.....	95
Figura 4-4 Shtresat e hartës së Sistemit Infrastrukturor Energjetik. Burimi: AKPT, PPK 2030 ...	97
Figura 4-5 Harta e Fluksit të Energjisë. Burimi: Metabolism of Albania , 2014	98
Figura 4-6 Harta e Energjisë. Burimi: AKPT, PPK 2030, 2016.f.120	98
Figura 4-7 Fluksi i transportit rrugor në akset kryesore kombëtare (majtas) analizat nga Instituti i Transportit.....	98

Figura 4-8 Lokacionet e pikave turistike me kërkesë më të lartë për të vizituar.....	98
Figura 4-9 Harta e Fluksit të Turizmit. Burimi: Metabolism of Albania, 2014	99
Figura 4-10 Harta Sistemit Infrastrukturor. Burimi: AKPT, PPK 2030, 2016.f.132	99
Figura 4-11 Fluksi i energjisë, PPV Lezhë	
Figura 4-12 potenciali energjisë, PPV Lezhë.....	104
Figura 4-13 Potenciali i Ujit, PPV Lezhë	
Figura 4-14 Konsumi i Ujit, PPV Lezhë	104
Figura 4-15 harta e potencialeve turistike, PPV Lezhë	
Figura 4-16 Fluksi i Ushqimit, PPV Lezhë	105
Figura 4-17 Harta e fluksit të energjisë në rajon, PPV Elbasan	
Figura 4-18 Harta e fluksit të ujit në rajon (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore).....	105
Figura 4-19 Harta e fluksit të energjisë në bashki, PPV Elbasan	
Figura 4-20 Fluksi i ujit në Bashkinë Elbasan, PPV Elbasan	106
Figura 4-21 Fluksi i ushqimit në Bashkinë Elbasan	
Figura 4-22 Fluksi i mbetjeve në Bashkinë Elbasan	106
Figura 4-23 Fluksi i ushqimit PPV Vlorë	
Figura 4-24 Fluksi i Ujit, PPV Vlorë	106
Figura 4-25 Fluksi i Energjisë PPV Vlorë Figura 4-26 Fluksi i mbetjeve. PPV Vlorë.....	107
Figura 4-27 Diagrama sankey e mbetjeve. Burimi: PPV VHSK	107
Figura 4-28 Bilanci ushqimor i paraqitur per bashkite Vlore, Himare, Sarande dhe Konsipol. Burimi: PPV VHSK	107
Figura 4-29 Bilanci ujqor në të katër bashkitë. PPV VHSK	
Figura 4-30 Fluksi i turistëve për rajonin.....	108
Figura 4-31 Bilanci energjetik për bashkitë Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konsipol. Burimi: PPV VHSK.....	108
Figura 5-1 Skema e Profilit metabolik e paraqitur për fluksin e Ujit sipas klasifikimeve të tabelës 13. Përshtatur nga: Water Research (Farooqui, T.A., Renouf, M.A., Kenway, S.J. , 2016).....	128
Figura 5-2 Flukset mesatare në Hollandë në milion/m ³ në vit . Burimi:pbl.nl(2014).....	129
Figura 5-3 Diagrama Sankey per fluksin e Energjisë në (PJ), burimi Metabolism of Albania, IABR, AKPT et.al, 2014	131
Figura 5-4 Diagrama Sankey e Fluksit Ushqimit(kton), AKPT et.al, 2014.....	134
Figura 5-5 Metabolizmi Urban Seoul, viti 2000.	134
Figura 5-6 Metabolizmi Urban Shanghai, viti 2000. Burimi: (ADB, 2014, p. 53)	134
Figura 5-7 Struktura e përdorimit të brendshëm të materialeve mjedisore Shqipëri, për vitet 2015 dhe 2019. Burimi INSTAT, përpunoi autori.....	135
Figura 5-8 Përdorimet sipas aktiviteve, viti 2017, përpunoi Autori.....	136
Figura 5-9 Kontributi i Burimeve dhe importi i tyre sipas sipas aktiviteve, viti 2017, Autori..	136
Figura 5-10 Përdorimet sipas aktiviteve, viti 2015, përpunoi Autori.....	137
Figura 5-11 Lidhja e elementëve të përbajtjes të një plani me fazat e hartimit të analizës metabolike.....	148

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BRSS	Bashkimi i Republikave Popullore Socialiste
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
KT	Kohezioni Territorial
INSTAT	Instituti i Statistikave
MFA	Analiza e Flukseve të Materialeve
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
MU	Metabolizmi Urban
MT	Metabolizmi Territorial
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PHU	Planifikimi Hapësinor dhe Urban
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
TA 2020	Axhenda Territoriale e BE 2020

Për të parandaluar pandeminë e ardhshme, duhet të ndryshojmë marrëdhënien tonë me natyrën.

OKB, 2020

1 KAPITULLI I_HYRJE

‘Qytetet janë mbase një nga krijimet më komplekse të njerëzimit, akoma të pambaruar, akoma të papërcaktuar. Ata janë si një udhëtim që nuk mbaron kurrë. Evolucionin e tyre përcaktohet nga ngritja e tyre në madhësi ose zbritja e tyre në rrënim. Ata janë e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja’ (UN-Habitat, 2009). Gjithmonë e më shumë po jetojmë në një botë të ndërlikuar, në qytete që shndërrohen në mënyrë dinamike dhe komplekse, ku nevoja për planifikim hapësinor, është kthyer në një domosdoshmëri nëse duam të sigurojmë zhvillimin e qëndrueshëm. Dikur e zhvilluar me qëllimin për të ndërtuar ‘një shoqëri të mirë’ e më pas të paktën ‘nje shoqëri të drejtë’, urbanistika, e zgjeruar si koncept në planifikimi hapësinor, ka marrë në ditët e sotme, gjithmonë e më tepër trajtat e një shkence komplekse. E kontestuar midis një përfaqse drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe një përfaqse tjetër, që e vendos më shumë theksin te tregu, dhe jo shteti, planifikimi hapësinor po zhvillon instrumenta të reja, gama e të cilave po zgjerohet çdo ditë e më shumë. Megjithatë, duhet të kemi në vëmendje se planifikimi, konsiderohet një profesion relativisht i ri, jo vetëm në kontekstin e Shqipërisë, ndaj vështirësitë që paraqet janë të shumta dhe komplekse, aq sa vetë qyteti, shoqëria dhe mjedisi, marrëdhënien e të cilave studion. Sisteme të shumta planifikimi ekzistojnë në të gjithë botën, forma e të cilit ndryshon dhe bashkë-evoluon kryesisht me shoqëritë dhe sistemet e tyre të qeverisjes (Allmendinger, 2009).

Qytetet dhe rajonet përreth tyre, janë qendrat më të rëndësishme të jetës sociale, kulturore dhe të inovacionit të çdo vendi, dhe shërbejnë si motorët e zhvillimit ekonomik të tyre. ‘Zhvillimi i qyteteve sfidohej në mënyrë të vazhdueshme nga faktorët e brendshëm të tilla si: proceset e përjashtimit social apo segregimit hapësinor, shkallët e larta të papunësisë, shkalla e lartë e kriminalitetit apo trafiku i rënduar) si dhe faktorët e jashtëm të tilla si: globalizimi, zhvendosja drejt ‘ekonomisë së dijes’ dhe teknologjisë së informacionit, mobiliteti në rritje i faktorëve të prodhimit, ndryshimet demografike, integrimi i vazhdueshëm në BE dhe presioni në rritje ndaj cilësisë mjedisore. Pabarazitë në kushtet socio-ekonomike midis vendeve fqinje, brenda rajoneve të qyteteve, duken relativisht më të larta sesa pabarazitë ndërmjet qyteteve dhe rajoneve brenda një vendi’ (Van Der Meer, Jan. & Braun, Erik., 2008, p. 179). ‘Megjithëse disa qytete po zhduken, (për shembull qytetet e bllokut ish-sovjetik), shumë qytete të reja moderne po rriten, madje disa prej tyre po rriten në mënyrë dramatike’ (UN-Habitat, 2009). Ato po rriten në numra, në popullsi, në përdorimin e materialeve dhe të energjisë, dhe në akumulimin e materialeve stok. Ky zgjerim i shpejtë është shoqëruar me rritjen e flukseve hyrëse të energjisë dhe përdorimeve të tilla si karburant, ushqim, mbeturina dhe energji elektrike që hyjnë, dalin dhe/ose grumbullohen brenda dhe jashtë kufijve të qytetit (Kennedy, C., Cuddihy, J., & Engel-Yan, J., 2007). Ditët e sotme, bilanci i përdorimit të materialeve për një qytet modern është disa rend më i lartë sesa ai i një qyteti antik me të njëjta përmasa; në të kundërt nga qytetet e vjetra, ky material përbëhet më së shumti nga ‘ujë’ dhe ‘ajri’ për të zhvilluar aktivitetet njerëzore të tilla si ‘banimi’, ‘transporti’ etj. Më pas vijnë lëndët djegëse dhe materialet e ndërtimit, ushqimi dhe të mirat e tjera materiale të konsumit. Teknologjitë e zhvilluara në shekujt e 18-të dhe 19-të tilla si motorët me lëndë djegëse dhe elektriciteti, qarqet elektrike, sintezat kimike të polimerëve, farmaceutika, dhe fertilizuesit formuan bazën për historinë e suksesshme të zhvillimit të qyteteve. Por nga gjithë ky përdorim i madh materialeve dhe burimesh energjetike, sipas Paul Dijst (2007) lindin tre probleme të mëdha: (1) disponueshmëria e burimeve; (2) ndarja e burimeve në mënyrë të drejtë; (3) (menaxhimi) mbetjet mjedisore’ (Brunner, 2007). Këto problematika padyshim kanë në zemër shkallën e

urbanizimit si një trend global ku sipas OKB-së ‘përcakton shpërndarjen hapësinore të popullsisë botërore dhe është një nga trendet demografike të shek XX-XI sëbashku me rritjen e popullsisë globale, mblakjen dhe emigracionin ndërkombëtar’ dhe në vitin 2050 rreth dy të tretat (68 përqind) e popullsisë botërore do të jetojë në zona urbane (UN, World Urbanization Prospects: The 2018 Revision, 2018). Këto fenomene globale përshkallëzohen në mënyra të ndryshme dhe kanë impakt në zhvillimin hapësinor edhe brenda kufijve territorialë të një vendi si Shqipëria.

Nën dritën e këtij kompleksiteti, që ofron fenomeni në rritje i urbanizimit dhe pasojat e tij në cilësinë e jetës së individit dhe shoqërive ku ai jeton, lind nevoja të rimendojmë mënyrën se si ne projektojmë qytetet tona. Shkenca e planifikimit hapësinor kërkon t’i japë zgjidhje disa prej këtyre problemeve dhe kjo kërkesë është më shumë se kudo tjetër aktuale për Shqipërinë. Të dhënat nga Census 2011, treguan se për herë të parë, popullsia që jeton në zonën urbane e tejkaloi numrin e popullsisë që jeton në zonën rurale përkatësisht me vlerat 53,5% : 46,5%. (INSTAT, Censusi i Popullsisë dhe i Banesave, 2012, p. 10) Ndërsa Studimet e Bankës Botërore tregojnë për dy modele të kundërta të urbanizimit në vendet në zhvillim ku disa qytete po rriten në popullsi dhe zhvillohen si qendra të aktivitetit ekonomik, ndërsa pjesa tjetër po tkurret, në vendin tonë ky fenomen vërehet edhe brenda përbrenda territorit. Së pari, për shkak të stadiut evolutiv ku ndodhet Shqipëria si vend në zhvillim, me ekonomi jo të konsoliduar në një treg të kufizuar dhe lëvizje dinamike të popullsisë kryesisht migruese dhe së dyti, për shkak të mungesës së konsolidimit të kuadrit politik dhe ligjor në vend, shfaqjet e pabarazive të zhvillimit hapësinor rajonal janë të thella.

Megjithatë, Shqipëria ka bërë një kapërcim galopant nga mendimi tradicional i urbanistikës racionale në koncepte të reja mbi organizimin e qyteteve, territorin përreth tyre, planifikimin dhe zhvillimin e urban, sidomos gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Faktori ‘kohë’ shpesh duke u zgjeruar e në raste të tjera duke u tkurrur, mund të themi se nuk ka rrjedhur në mënyre lineare gjatë zhvillimit të sistemit tonë politik, social e ekonomik gjatë tre dekadave të fundit. Presioni për kapjen e ritmit të zhvillimit të vendeve të kontinentit, ka shkaktuar deformime në produktet finale të planeve territoriale, të reflektuara në sistemin urban, duke shkaktuar fenomene sa të ngjashme me vendet në zhvillim aq edhe unike.

Nevoja për zgjerim të konceptit nga urbanistika deri në planifikim hapësinor në vendin tonë, lidhet së pari, me pamundësinë për të zgjidhur praktikisht problemet komplekse të zhvillimit urban të shfaqura këto tre dekada brenda një kornize të ngushtë të disiplinës urbane, dhe së dyti me nevojën e sigurimit të një zhvillimi sa më koheziv territorial, social dhe ekonomik të vendit.

Vendimet politike, bazuar mbi planet hapësinore, për zhvillimet në territor plazmojnë mënyrën e konsumit dhe të shpërndarjes së burimeve primare si toka, uji, energjia dhe ushqimi. Metabolizmi Urban (MU) është një platformë multi-disiplinore dhe e integruar që shqyrton rrjedhat e materialeve dhe të energjisë në qytete si sisteme komplekse, pasi ato formohen nga forca të ndryshme sociale, ekonomike dhe mjedisore (Pincetl, S., Bunjeb, P. Holmes, T., 2012). Ngjashëm me organizmat biologjikë dhe ekosistemet, qytetet ciklojnë dhe transformojnë lëndët e para hyrëse, ushqimin, ujin dhe karburantin në struktura fizike, biomasë dhe mbetje (Decker, E. H., Elliott, S., Smith, F. A., Blake, D. R., & Rowland, F. S., 2000).

Ka shumë faktorë që ndikojnë në shkallën e metabolizmit të një qyteti, si struktura urbane, forma, klima, cilësia dhe mosha e stokut të ndërtesave, gjelbërimi dhe infrastruktura e transportit, faktorë që janë studiuar në projektimin e qyteteve qysh në fillimet e tyre, por kërkesat për hyrje të materialeve dhe energjisë për të mbështetur rritjen e vazhdueshme urbane janë gjithmonë e më të larta, dhe të kuptuarit e metabolizmit të qyteteve bëhet jashtëzakonisht i rëndësishëm sidomos për vendimmarrjen politike që menaxhon këto flukse. Kuadri MU ofron një mjet rigoroz për të analizuar këto flukse dhe mund të çojë në zhvillimin e sistemeve të menaxhimit që rrisin efikasitetin e përdorimit të burimeve, riciklimin e mbetjeve dhe ruajtjen e energjisë. Studimi i kësaj qasjeje dhe përdorimi eficient në hartimin e planeve territoriale të vendit tonë, brenda kuadrit të ri ligjor të vendit, dhe kontekstit teorik ndërkombëtar të zhvilluar, do të na mundësojë planifikim dhe zhvillim cilësor dhe afatgjatë të territorit.

1.1 Përkufizimi i problemit, qëllimi dhe objektivat

Në planifikimin hapësinor dhe të sektorëve ekonomikë të zhvillimit, përjasje të ngjashme me metabolizmin urban nuk janë të reja. Ky koncept u prezantua në planifikimin hapësinor në fillim të viteve 1970 me programin UNESCO ‘Njeriu dhe Biosfera’, duke u kombinuar mirë me ato plane që menaxhojnë rrjedhat e burimeve, të tilla si energjia dhe eficientia e ujit, për zvogëlimin e rrezikut hidro-geologjik, për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, për zvogëlimin e konsumit të tokës dhe rritjen e shërbimeve të ekosistemit, për zhvillimin e lëvizshmërisë së qëndrueshme. Metabolizmi urban mund të përcaktohet si "shuma totale e proceseve teknike dhe socio-ekonomike që ndodhin në qytete, duke rezultuar në rritje, prodhim të energjisë dhe eliminimin e mbeturinave" (Kennedy, C., Pincetl, S. & Bunje, P. , 2010). Edhe pse koncepti ka më shumë se 60 vite që hulumtohet, popullariteti i tij është rritur vitet e fundit, dëshmuar kjo edhe nga aplikimi i tij në raste të ndryshme. Në vendin tonë, Metabolizmi i Territorit, është një koncept novator, i prezantuar për herë të parë me botimin kërkimor "Metabolism of Albania" e më pas i përkufizuar në Rregulloren për Planifikimin e Territorit, e miratuar me VKM Nr.686, datë 22.11.2017 ku edhe sanksionohet përfshirja e analizës metabolike në planet territoriale.

Gjithashtu, Planifikimi Hapësinor është një koncept i prezantuar rishtazi, jo vetëm në dialogun ndërkombëtar teknik, kryesisht europian por edhe në vendin tonë si praktikë për hartimin e dokumentave të reja të planifikimit në sistemin tonë ligjor të pas 2013. Edhe pse, në pamje të përgjithshme, problematikat e organizimit dhe të planifikimit të territorit mbeten të njëjta me qytetet e tjera moderne evropiane, Shqipëria shfaq veçoritë e saj lokale dhe rajonale. Së pari, vetë koncepti ligjor dhe teknik i ‘planifikimit’ ka evoluar nga një koncept statik, i përgjithshëm dhe i centralizuar në një koncept dinamik, lokal & rajonal dhe të decentralizuar. Kjo shfaqet më së miri në ndryshimet që ka pësuar legjislacioni shqiptar pas vitit 2009, kur problemet ekonomike e sociale, që marrin shprehjet e tyre në transformimet territoriale nuk mund të injoroheshin më tej. Sot, vërehet një pabarazi e theksuar e zhvillimit hapësinor në vend, ku qytetet e rajone të tëra janë në tkurrje e gati në "zhdukje", e të tjera rriten vazhdimisht si demografikisht, gjeografikisht dhe ekonomikisht. Për këtë është e nevojshme hulumtimi i metodave të reja në fushën e planifikimit e të zhvillimit të territorit, të cilat të bazohen në praktikat evropiane më të zhvilluara, por që reflektojnë karakteristikat e veçanta të vendit, që mund të kapin dinamizmin e kontekstit lokal. Për këtë arsye është e rëndësishme që të zhvillohet një analizë e detajuar e metodave dhe instrumentave të rinj për planifikimin e territorit në nivel kombëtar dhe vendor. Po aq e rëndësishme është dhe analizimi i

lidhjeve dhe i shkëputjeve të tyre në kohë dhe hapësirë nga konceptimi teorik në zbatimin praktik, në mënyrë që të bëhet një reflektim mbi cilësinë e hartimit dhe të zbatimit të tyre.

Pyetjet kërkimore

'Metabolizmi Urban' është një kornizë e re përmes së cilës mund të kuptojmë urbanizimin dhe pasojat e tij. Përdoret për të eksploruar lidhjen midis flukseve të burimeve natyrore, morfologjisë urbane dhe karakteristikave socio-ekonomike të qyteteve bazuar në analogjinë me metabolizmin e organizmave të gjallë. Modele të ndryshme studiojnë hyrjen dhe daljen e flukseve të materialeve (rrjedhat dhe rezervat) midis qytetit dhe mjedisit përreth tij, dhe një përpjekje për të zbatuar këtë kornizë është realizuar në hartimin e planeve territoriale.

Si ka ndikuar kjo qasje në cilësinë e planeve të reja territoriale, dhe si është zbatuar? Meqenëse Metabolizmi i Territorit ofron baza të reja për zhvillimin e mëtejshëm të planifikimit urban në vendin tonë dhe nxit hartimin e politikave për zhvillim të qëndrueshëm pritet që zbatimi i tij mund të sjellë rritjen e cilësisë së planeve dhe të performancës së vetë qyteteve të planifikuara nën këtë qasje.

Në një kontekst më të gjerë, ky studim tenton të avancojë në ndërtimin e trupit teorik që do të ndihmojë disiplinën e planifikimit të territorit në avancimin e saj nga një praktikë administrative, në një shkencë komplekse për territorin.

Vështrimi analitik mbi përdorimin e metabolizmit të territorit në hartimin e planeve në vendin tonë në nivel vendor dhe kombëtar do të mund të na tregojë shtrirjen dhe mënyrat e përdorimit të tij.

A është aplikimi i kësaj metode më shumë se një ushtrim matematikor që peshon flukset hyrëse dhe dalëse të burimeve, apo mund të përdoret edhe për hartimin e politikave urbane dhe projektimit urban?

Cili është roli i metabolizmit në realizimin e Planit të parë Kombëtar të Territorit, dhe si u zbatua kjo kornizë në hartimin e planeve të përgjithshme vendore 2013-2020?

Për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të mësipërme kërkimi adreson paraprakisht edhe disa nënçështje si:

- Cili është konteksti që ndikoi në zbatimin e një reforme në planifikimin hapësinor në vend?
- Cili është roli i planit kombëtar të territorit në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe në integrimin me politikën e kohezionit territorial në nivel evropian?
- Si ndryshoi përmbajtja e planeve të përgjithshme vendore dhe me çfarë kompleksiteti të ri përballen ato në çështjet e planifikimit të territorit në nivel vendor?

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Fokusi kryesor i studimit do të jetë analiza e ndikimit të metabolizmit urban në Planin e Përgjithshëm Kombëtar (PPK) 'Shqipëria 2030', si 'instrumenti më i lartë i planifikimit territorial në Shqipëri' [dhe] 'i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke e parë territorin shqiptar si një të tërë' (MZHU&AKPT, 2016, p. 18) si edhe të disa Planeve të përgjithshme Vendore për bashkitë (shih aneksin 1) ku si përfaqësuese të grupimeve të analizuara do të jenë bashkitë Lezhë, Vlorë, Elbasan dhe Gjirokastrë. Ashtu siç shkruajnë dhe (Van Der Meer, Jan.& Braun, Erik., 2008, p. 179) 'për të kuptuar politikëbërjen urbane kombëtare apo shtetërore është e nevojshme që ajo të mos shkëputet nga konteksti i saj kombëtar. Ky kontekst është i përbërë nga modelet e zhvillimit ekonomik dhe hapësinor, korniza institucionale dhe prioritetet politike [... Po ashtu] ndërveprimi midis niveleve të politikëbërjes është një çështje

tjetër që duhet marrë në konsideratë'. Për këtë arsye, platforma mbi të cilën do të zhvillohet analiza e ndikimit të MU në planet e mësipërme do të ngrihet mbi interpretimin dhe evidentimin e evolimit të kuadrit rregullator të planifikimit në Shqipëri.

Qëllimi është të zhvillohet një kornizë të fortë konceptuale që përshkruan karakteristikat e metabolizmit urban dhe ndikimit të tij në planet e territorit të hartuara në vendin tonë në nivel vendor dhe kombëtar.

Fillimisht kërkimi do të rishikojë zhvillimin e konceptit të metabolizmit urban kryesisht përmes kërkimit akademik në sfondin teorik ndërkombëtar.

Gjithashtu, tema ka për qëllim zbërthimin e metabolizmit urban në funksion të analizimit dhe planifikimit hapësinor të vendit përkundrejt tre kushteve themelore që karakterizojnë kontekstin shqipëtar: vend në zhvillim apo në tranzicion (si nga ana politike ashtu dhe nga ana ekonomike), gjë e cila reflektohet në konfliktin midis nevojës për zhvillim të menjëhershëm dhe nevojës për mbrojtjen e mjedisit, nivel i lartë i pabarazive hapësinore (nevoja për kohezion territorial, modeli policentrik vs monocentrik), kërkesa për integrim europian (modelet e përafrimit dhe nevoja për bashkëpunim ndërkufitar). Ashtu siç shkruajnë (Davoudi, S. & Cowie, P., 2016, p. 48) 'qëllimi kryesor nuk është që të zhvillojmë 'modelin ideal' apo standartin e dëshiruar të praktikës nga e cila duhet të identifikohen vlerat apo normat të cilat ia vlen që të zbatohen, por të sugjerohen një numër principesh udhëzuese të cilat të informojnë mbi gjykimin e praktikave qeverisëse të veçanta në një kohë dhe vend specifik' dhe këtë synojmë ta arrijmë përmes analizës krahasimore të planeve territoriale të hartuara në Shqipëri midis 2013-2020.

Në këtë mënyrë synohet që të ndërtohet një model praktik bazuar në kornizën teorike, që mundëson planifikuesit dhe politikbërësit të marrin një informacion të plotë mbi gjendjen e dhënë metabolike të territorit në studim, dhe të kuptojnë nëse zbatimi i propozimeve të planit për këtë territor, siguron arritjen e modelit metabolik të propozuar. Ndër objektivat kryesore të studimit janë:

- Identifikimi i faktorëve ekonomikë, socialë e politikë ndër vite që kanë ndikuar në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në vendin tonë. Çfarë mund të mësojmë nga e kaluara?
- Vlerësimi për një përafrim të ri në metodat për analizën e territorit, nga sistemet territoriale në metabolizmin e territorit për Shqipërinë, planet e hartuara nga 2013-2020.
- Zbërthimi i konceptit të metabolizmit të territorit si instrument praktik për planifikim kombëtar e vendor, me qëllim arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Identifikimi i mundësive dhe mangësive që paraqiti aplikimi i metabolizmit urban në planet e hartuara vendore dhe në planin Kombëtar Shqipëria 2030.
- Roli i metabolizmit urban në përforcimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, si instrument i rëndësishëm që promovon kohezionin territorial dhe zhvillimin e balancuar.
- Refleksione mbi konsolidimin e planifikimit hapësinor si shkencë bazë për orientimin e zhvillimit afatgjatë e të qëndrueshëm të Shqipërisë. Adresimi i rëndësishëm të kontributit të institucioneve kërkimore, akademike në këtë fushë.

Në përfundim theksojmë se, ky studim nuk tenton të elaborojë një model matematikor për matjen e flukseve, por të ofrojë një kornizë referuese ku do të mund të bazohet zhvillimi i mëtejshëm praktik i tij në kontekstin shqiptar. Edhe pse, ende nuk kemi një studim që vlerëson cilësinë dhe shkallën e zbatimit të planeve territoriale në vendin

tonë, gjatë analizës së tyre në këtë tezë, shtrohet hipoteza, se duke implementuar metoda te reja si ajo e metabolizmit urban, që ofron mundësi për përfshirjen e komponenteve komplekse të qytetit dhe ndërton një marrëdhënie të re mes tij dhe territorit më të gjerë përreth, atëherë do të mund të kemi plane më cilësore.

1.2 Metodologjia

Kjo tezë bazohet në kërkimin teorik të literaturës bashkëkohore vendase dhe të huaj, në vëzhgimin analitik dhe metodën krahasuese të aplikimeve praktike. Autori duke qenë kontribues dhe pjesëmarrës në proceset e reformimit të kuadrit të ri ligjor të planifikimit të territorit, nga viti 2009 e në vazhdim si edhe kontribuese e drejtpërdrejtë në disa praktika të implementimit të tij si psh.: në hartimin e dokumentit “Metabolizmi i Shqipërisë”, Plani i Përgjithshëm Kombëtar “Shqipëria 2030”, koordinimi dhe monitorimi i procesit për hartimin e planeve të përgjithshme vendore në nivel bashkie viti 2009 e në vazhdim, si dhe në zhvillimin e praktikave administrative që pasuan si : monitorimi dhe zbatimi i planeve territoriale përmes ‘Platforma e Monitorimit’¹ dhe kërkimet mbi përcaktimin e një metode për unifikimin e përcaktimeve të ‘Urban Rurales’², reflekton dhe argumenton nga pikëpamja akademike këtë eksperiencë.

Një ndër makro temat e tezës është Planifikimit Hapësinor si stad i ri i evolimit të shkencës urbane në vendin tonë, sfidat dhe mundësitë që paraqiten në implementimin e suksesshëm të tij. Fokusi i kërkimit është ndikimi i zbatimit të Analizës Metabolike të Territorit në dokumentat e planifikimit në nivel kombëtar dhe vendor të cilat hartohen, në zbatim të kuadri të ri ligjor në Shqipëri, në përputhje me parimet e Planifikimit Hapësinor. Arritja e objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm si paradigëm e planifikimit cilësor territorial/hapësinor është nëntema e dytë, e cila përbën dhe sfondin ku zhvillohet qasja e Metabolizmit Urban. Në këtë kontekst, teza eksperimenton dhe propozon një marrëdhënie të re që vizualizon lidhjen më komplekse që ekziston midis territorit, planifikimit dhe qeverisjes për një zhvillim të qëndrueshëm. Nga trekëndëshi i njohur propozuar për herë të parë nga Rene Passet (1979) (Purvis, B., Mao, Y. & Robinson, D., 2019) për zhvillim të qëndrueshëm: Mjedis Ekonomi, Shoqëri, në një hexahedron që zgjeron lidhjen komplekse midis faktorëve të mësipërm. Duke vizualizuar në këtë mënyrë, marrëdhënien hapësinore të Mjedisit, Shoqërisë, Ekonomisë si dhe Planifikimit, Qeverisjes dhe Territorit, mund të inkuadrojmë më mirë rolin e Metabolizmit Urban në këtë sistem kompleks të politikave për zhvillim të qëndrueshëm.

¹ Shënim i autorit: Platforma e Monitorimit, bazohet në kapitullin e fundit të PPK ‘Shqipëria 2030’, si hapi tjetër i nevojshëm që duhet përbushur me qëllim zbatimin dhe monitorimin e PPK, por jo vetëm. Ky kërkim është një produkt ende i papublikuar i hartuar nga grupi i punës në Drejtorinë e Planifikimit Kombëtar AKPT, ku autori ka kontribuar duke konceptuar dhe udhëhequr procesin. Platforma konsiston në selektimin e një seti Indikatorësh, mbledhja e të dhënave dhe matja e të cilave në mënyrë periodike do të mund të tregojë shkallën e zbatimit të planeve territoriale.

² Përkufizimi Urban-Rurale në vendin tonë, aktualisht realizohet nga INSTAT duke ndjekur metodologjinë statistikore të miratuar nga OECD. Në këtë studim, ende i papublikuar, i hartuar nga grupi i punës në Drejtorinë e Planifikimit Kombëtar AKPT, ku autori ka kontribuar duke dizenuar dhe udhëhequr procesin argumentohet se metoda statistikore paraqet mungesa të theksuara në identifikimin real të Urban-Rurales në vendin tonë, dhe se një përjasje me karakter hapësinor, që të reflektojë shkallën dhe ndarjen dhe marrëdhëniet reale të këtij fenomeni, duhet ndërmarrë.




Figura 1-1 Hexahedroni i zhvillimit të qëndrueshëm. Propozim për një konceptim të ri të zhvillimit të qëndrueshëm. (Përpunim i autorit)

Nëse pranojmë se baza e përbashkët e planifikimit hapësinor dhe politikave qeverisëse për zhvillim të qëndrueshëm është territori, atëherë është e nevojshme hulumtimi i instrumentave dhe metodave të planifikimit hapësinor. Për të hulumtuar këtë lidhje komplekse, teza i referohet në disa rate Teorisë së Sistemeve dhe Teorisë së Kompleksitetit dhe materializimin e tyre në analizat territoriale në bazë sistemesh. Këto sisteme janë të organizuar në marrëdhënie mes qendrave, korridoreve dhe zonave mbi bazën e të cilave rrjedhin dhe zhvillohen flukset kryesore të zhvillimit hapësinor, ku në rastin e Shqipërisë dhe studimit të metabolizmit urban të saj janë studjuar: uji, natyra, ushqimi, energjia dhe urbanizimi. Në vijim do të analizohen më në detaje këto flukse dhe sistemet që këto krijojnë nëpërmjet Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Metabolizmit të Shqipërisë. E njëjta analizë do të zhvillohet edhe për zbatimin e Metabolizmit Urban në planet e nivelit vendor. Siç shkruajne Caputo et al. (2016) ‘për të kuptuar efikasitetin e metabolizmit urban, është i nevojshëm një krahasim ndërmjet qyteteve të ngjashme’ (Caputo, Paola., Pasetti, Giulia. & Bonomi, Marco, 2016, p. 1589). ‘Problemi kryesor me studimet kërkimore krahasimore shkaktohen nga vështirësitë për të krahasuar vende apo shtete të cilat kanë prejardhje të ndryshme historike, kushte të ndryshme sociale dhe ekonomike dhe veçanërisht forma të ndryshme qeverisjeje, të cilat iu caktojnë funksione dhe përgjegjësi të ndryshme niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe llojeve të ndryshme të qeverisjes brenda çdo niveli’ (Aiken, Michael., Newton, Kenneth., Friedland, Roger & Martinotti, Guido., 1987, p. 341). Zakonisht eksperiencat e ndryshme të vendeve në lidhje me planifikimin hapësinor dhe urban grupohen në tipologji të caktuara dhe në nivele të ndryshme përgjithësimi. Për këtë arsye, modelet krahasimore janë përzgjedhur në bazë të disa karakteristikave. Përzgjedhja e shembujve krahasues për dokumentat e nivelit kombëtar ka përmbushur këto kritere:

- Vende që kanë arritur të zbatojnë me sukses qasjen e metabolizmit urban në disa dokumente planifikimi;
- Vende të cilat kanë zhvilluar një model planifikimi hapësinor nga janë frymëzuar edhe ndryshimet në kuadrin tonë ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
- Disa kritere të përgjithshme si shtrirja territoriale dhe të dhënat demografike të hapësirës së studiuar në dokumentet e planifikimit të tyre, të përzgjedhur për analizën krahasuese, përputhen me shtrirjen territoriale dhe të dhënat demografike për Shqipërinë.

- Sa më lart janë përzgjedhur modelet e Roterdamit, Rajoni i Parisit dhe studimi në nivel evropian që SUME (Sustainable Urban Metabolism of Europe) i cili në vetvete krahason disa kryeqytete evropiane nën prizmin e faktorëve të zhvillimit urban me ndikim në metabolizmin e këtyre qyteteve.

Përzgjedhja e shembujve krahasues për dokumentat e nivelit vendor ka përmbushur këto kritere:

- Bashkitë e përzgjedhura janë qendra urbane primare në lidhje me polet e zhvillimit të përcaktuara nga PPK2030.
- Planet vendore për bashkitë reflektojnë katër qasje të ndryshme në hartimin e planeve lokale si pasojë e katër grupeve teknike të ndryshme të ngarkuar për hartimin e tyre.

Ashtu siç shpjegon dhe (Dijst, M. et al., 2018, p. 199) studimet mbi metabolizmin urban janë më së shumti përshkruese përveç sistemeve dinamike që janë të bazuara në klimën urbane dhe të shpërhapjes, dhe nuk përfshijnë më shumë se dy dimensione të metabolizmit urban. Sipas tij përpara se të ndërtohen dhe përpunohen modele shumë dimensionale dhe të përgjithshme të planifikimit urban, na duhet një kuptueshmëri për ndërveprimin midis entiteteve kryesore të tij si : përdorimin e tokës, shërbimet e ekosistemit, flukset e materialeve, popullsia dhe mobiliteti, punësimi dhe prodhimtaria, ndërveprimi me tokën si edhe kriteret kryesore për nënësishtet e tjera (Dijst, M. et al., 2018). Duke qenë se korniza për analizën e MU është komplekse dhe ka nevojë për një numër të dhënash të shumta dhe të detajuara, teza do të bazohet tek konstatimet e rasteve të aplikuara për flukset e ujit, energjisë dhe ushqimit edhe pse disa bashki bregdetar kanë tentuar të modelojnë edhe fluksin e turistëve.

Disertacioni është pasuruar me materiale dhe literaturë parësore dhe dytësore. Analiza krahasimore është ndalur më shumë në vendet e Europës perëndimore të cilat kanë realizuar edhe kërkimet më domethënëse në këtë drejtim duke e zbatuar këtë qasje edhe në dokumentat e planifikimit urban.

Përkufizimi i koncepteve kryesore

Tema përmban koncepte dhe terma të reja, të cilat mbartin kompleksitet dhe marrin kuptime dhe nuanca të ndryshme në varësi të kontekstit ku përdoren, prandaj për të bërë më të qartë përmbajtjen, këtu do të japim përkufizimin e disa prej termave kryesore në lidhje me kontekstin që janë përdorur në këtë punim.

Planifikimit Hapësinor/Territorial/Urban – Planifikimi hapësinor i referohet metodave të përdorura nga sektori publik për të ndikuar në shpërndarjen e njerëzve dhe aktiviteteve në hapësira të shkallëve të ndryshme. Planifikimi hapësinor përfshin të gjitha nivelet e planifikimit të përdorimit të tokës si planifikimin urban, planifikimin rajonal, planet hapësinore kombëtare dhe në nivelet ndërkombëtare të Bashkimit Evropian. Sipas Kombeve të Bashkuara (UN, 2008) planifikimi hapësinor ka të bëjë me ‘problemin e koordinimit ose integritetit të dimensionit hapësinor të politikave sektoriale përmes një strategjie të bazuar në territor’ (Cullingworth dhe Nadin, 2006: 91). Më komplekse sesa rregullat e thjeshta për përdorimin e tokës, ajo adreson tensionet dhe kontradiktat midis politikave sektoriale, për shembull për konfliktet midis zhvillimit ekonomik, politikave mjedisore dhe kohezionit social. Roli kryesor i planifikimit hapësinor është të promovojë një rregullim më racional të aktiviteteve dhe të pajtojë qëllimet e politikave konkurruese. Ka shumë përkufizime të planifikimit

hapësinor, por një nga përkufizimet më të hershme vjen nga Karta Evropiane e Planifikimit Hapësinor/Rajonal³:

'Planifikimi rajonal/ hapësinor i jep shprehje gjeografike politikave ekonomike, shoqërore, kulturore dhe ekologjike të shoqërisë. Është në të njëjtën kohë një disiplinë shkencore, një teknikë administrative dhe një politikë e zhvilluar si një qasje ndërdisiplinore dhe gjithëpërfshirëse e drejtuar drejt një zhvillimi rajonal të ekuilibruar dhe organizimit fizik të hapësirës sipas një strategji e përgjithshme'. (UN, Spatial Planning, Key Instrument for Development and Effective Governance with Special Reference to Countries in Transition, 2008, p. 11).

Megjithëse sipas Haughton, (Graham, H., Allmendinger, P. & Vigar, G., 2010, p. 5) **'planifikimi hapësinor'** është një koncept shumë i kontestuar dhe domethënia e tij ndryshon me kalimin e kohës, duke qenë subjekt i interpretimeve të ndryshme që bien në kundërshtim me njëra -tjetrën, në secilin prej këtyre përkufizimeve theksohen *katër karakteristika* themelore të tij. *Së pari*, ka një theks në të menduarit strategjik afatgjatë dhe krijimit të një vizioni të ardhshëm në formën e strategjive hapësinore për të cilat është darkordësuar më parë. *Së dyti*, planifikimi hapësinor shihet nga zyrtarët qeveritarë si një nga mjetet e politikë-bërjes për të krijuar koherencë në një sistem qeverisje gjithnjë e më shumë të fragmentarizuar. Në këtë këndvështrim, strategjitë hapësinore veprojnë si një mekanizëm përbashkues në politikë-bërje, ku planifikimi shikohet si siguresi i një forumi të besueshëm në të cilin sektorë të tjerë të politikave mund të përfshihen për të rënë dakort mbi të ardhmen e politikave të tyre dhe për tu informuar për strategjitë e ardhshme. *Së treti*, planifikimi hapësinor luan një rol të rëndësishëm në avancimin e shoqërisë drejt *zhvillimit të qëndrueshëm* (në Angli për shembull, legjisllacion i ri i miratuar në vitin 2004 e ka shëndërruar zhvillimin e qëndrueshëm në një detyrim statutor për planifikimin). *Së fundi*, planifikimi i ri hapësinor thekson *përfshirjen*, gjë e cila pasqyrohet në proceset e konsultimit publik me grupet e gjera të shoqërisë, dhe mbi të gjitha për të adresuar çështje të përfshirjes sociale brenda strategjive hapësinore. Sidoqoftë, duhet theksuar që në shkallë evropiane, nuk ka një model të vetëm të planifikimit hapësinor, megjithëse koncepti i kohezionit territorial është tashmë dominues në diskurin e planifikimit hapësinor evropian (Nadin & Stead, 2008, p. 35). Pra, për të përgjithësuar, dhe duke u bazuar dhe në disa konkludime të (Haughton, G., Allmendinger, P, Counsell, D. & Vigar, G., 2010, p. 6)., mbi të gjitha planifikimi hapësinor shihet si një projekt i vazhdueshëm, i cili nuk operon vetëm mbi një draft të vetëm. Të gjitha këto konkludime mbi evolucionin e konceptit të 'planifikimit hapësinor' na tregojnë rëndësinë e madhe që ka marrë termi dhe ndikimin e tij të rëndësishëm në politikat qeveritare lokale apo të qeverisjes qendrore dhe asaj rajonale.

Ndaj mund të themi se, planifikimi hapësinor është thelbësor për ofrimin e përfitimeve ekonomike, sociale dhe mjedisore duke krijuar kushte më të qëndrueshme dhe të parashikueshme për investime dhe zhvillime, duke siguruar përfitime për komunitetin nga zhvillimi, dhe duke promovuar përdorimin e kujdesshëm të tokës dhe burimeve natyrore për zhvillim. Si edhe, është një mjet i rëndësishëm për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Metabolizëm i Territorit/Urban – është një model që lehtëson përshtatjen dhe analizën e flukseve të materialeve dhe energjisë brenda qyteteve. Ai u siguron studiuesve një kornizë metaforike për të studiuar ndërveprimet e sistemeve natyrore

³ Shënim i autorit: Shpesh e quajtur 'Karta e Torremolinos', miratuar në 1983 nga Konferenca Evropiane e Ministrave përgjegjës për Planifikimin Rajonal (CEMAT).

dhe njerëzore në rajone specifike. (Pincetl, S., Bunjeb, P. Holmes, T., 2012) (Kennedy, C., Cuddihy, J., & Engel-Yan, J., 2007) kanë prodhuar një përkufizim të qartë në shkrimin 'Ndryshimi i Metabolizmit të Qyteteve' duke shprehur se metabolizmi urban është 'shuma totale e proceseve teknike dhe socio-ekonomike që ndodh në qytete, duke rezultuar në rritje, prodhim të energjisë dhe eliminimin e mbetjeve.' Me shqetësimin në rritje të ndryshimit të klimës dhe degradimit atmosferik, përdorimi i modelit të metabolizmit urban është bërë një element kryesor në përcaktimin dhe ruajtjen e qyteteve të shëndetshme dhe të qëndrueshme. Metabolizmi urban ofron një këndvështrim të unifikuar-holistik që përfshin të gjitha aktivitetet e një qyteti në një model të vetëm. Koncepti i metabolizmit urban – në këtë studim do të trajtohet si pjesë e rëndësishme e planifikimit hapësinor, sepse ashtu siç u prezantua në fillim të viteve 1970-të me programin e UNESCO - Njeriu dhe Biosfera, metabolizmi urban 'ndërlidhet mirë me të gjitha ato plane që menaxhojnë burimet, të tilla si planet për eficientë e energjisë dhe të ujit, për reduktimin e risqeve hidro-geologjike, për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, për reduktimin e konsumimit të tokës dhe rritjen e shërbimeve të ekosistemeve, për zhvillimin e mobilitetit të qëndrueshëm. Integrimi i konceptit të metabolizmit urban në planifikimin hapësinor jep një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të qëndrueshëm (Magoni, 2017).

Shumë autorë bëjnë një përkufizim të konceptit të '**politikës urbane**' dhe më pas të koncepteve të tjera të lidhura me metodat dhe instrumentat e planifikimit hapësinor. Kështu, 'në terma të përgjithshëm, politika urbane mund të përshkruhet si një aktivitet konceptual apo një sërë masash sistematike të ndërmarra nga një autoritet publik, pavarësisht nivelit administrativ të tij – evropian, kombëtar, rajonal dhe/apo lokal – që ka në qendër të saj zhvillimin e qyteteve si hapësira përfaqësuese dhe ku zhvillimi urban merr trajtën më të plotë.

Nga ana teorike, të gjitha nivelet e qeverisjes mund të ndjekin politika urbane. Megjithatë, nivelet më të larta të qeverisjes gjithashtu formulojnë politika që nuk janë të dizenuara në mënyrë specifike për qytetet, por mund të kenë një ndikim të madh tek to' (Van Der Meer, Jan.& Braun, Erik., 2008). PPK në rastin shqiptar përbën një instrument të rëndësishëm politik dhe ashtu siç shkruhet dhe në dokumentin e miratuar në vitin 2016 ky plan është 'dokumenti referues i detyrueshëm për të gjitha planet që hartohen në Republikën e Shqipërisë' (MZHU&AKPT, 2016, p. 25). Van Der Berg, Braun dhe Van Der Meer (2007) bëjnë dallimin midis politikës urbane dhe politikave që mund të jenë 'urbane', edhe pse nuk kanë në qendër të tyre qytetet, por që kanë një ndikim thelbësor te qytetet, të tilla si politikën e strehimit, të transportit dhe politikën e planifikimit hapësinor etj. Një ndryshim tjetër që ata bëjnë është edhe midis politikave të pjesshme dhe politikave të integruara (ndërmjet sektorëve). Çështje të tilla urbane janë aksesueshmëria, cilësia e jetesës dhe rigjallërimi ekonomik që kërkojnë një përafrim të përgjithshëm. Në këtë kuptim edhe PPK e cila ka në vizionin e tij përgjigjet ndaj nevojave dhe kërkesave gjithnjë në rritje të zhvillimit të sektorëve ekonomikë 'drejt një ekonomie, e cila nuk konsumon apo degradon territorin', sugjeron një qasje të politikave integruese që nxisin bashkëpunimin mes sektorit të shërbimeve, atij bujqësor, turistik e energjetik, si edhe nxitjen për risi dhe kooperim e specializim të tyre. (MZHU&AKPT, 2016, p. 57).

Zhvillim i Qëndrueshëm – mund të përkufizohet si zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes pa cënuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre. Ndërsa UN e përshkruan si një proces global të zhvillimit që minimizon resurset natyrore dhe zvogëlon ndikimet në mjedis duke përdorur procese që njëkohësisht

përmirësojnë ekonominë dhe cilësinë të jetës (Komisioni Botëror i KB për Mjedisin dhe Zhvillimi, 1987).

Kohezion Territorial – është një term i trajtuar gjerësisht në dokumentet kryesore të Bashkimit Evropian, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me planifikimin hapësinor rajonal dhe me politikat urbane të territorit. Edhe në këto dokumenta jo vetëm ‘kohezioni territorial’ por edhe ‘qeverisja e territorit’ përshkruhet si një koncept i ri dhe shumë kompleks. Në një dokument të Parlamentit Evropian (Böhme, K., Zillmer, S., Toptsidou, M. & Holstein, F., 2015, p. 15) mbi qeverisjen e territorit dhe politikat e kohezionit theksohet që qeverisja e territorit përdoret për të përshkruar rëndësinë e lokacionit apo të territorit në proceset vendim-marrëse dhe tregon gjithashtu për zhvendosjen që ka ndodhur brenda natyrës së qeverisjes – nga ‘shteti’ në ‘qeverisje’ – dhe në shumë raste dhe në ‘qeverisje në disa nivele’. Sipas këtij dokumenti termi i ‘qeverisjes së territorit’ kuptohet si një zgjerim i një koncepti të qeverisjes në shumë nivele duke i lidhur politikat me një territor të caktuar, dhe duke bërë që kjo përfaqëse të jetë e ndjeshme dhe në brendësi të problemeve të atij territori.

‘Mënyra sesi perceptohet dhe mënyra sesi implementohet mund të sjellë shumë keqkuptime, duke bërë që shpesh të konsiderohet në shumë dokumenta të politikave evropiane si sinonim i ‘qeverisjes’ ose i ‘qeverisjes në shumë nivele’ (Böhme, K., Zillmer, S., Toptsidou, M. & Holstein, F., 2015, p. 13). Kjo vjen si pasojë e rritjes së rëndësisë së termit, që pas prezantimit të tij në Traktatin e Lisbonës në vitin 2007, vetë traktati do të hynte në fuqi në vitin 2009 ndërsa politikat për kohezionin territorial gjatë vitit 2013. Më herët në Dokumentin e Gjelbër të Komisionit Evropian, kohezioni territorial, ishte përkufizuar si një mjet që siguron zhvillimin në harmoni të të gjitha vendeve dhe që siguron që të gjithë qytetarët e tyre të jenë në gjendje që të shfrytëzojnë sa më shumë tiparet më të qenësishme të këtyre territoreve. Si pasojë, përkufizimi i termit konkludon se kohezioni territorial është një mjet që mundëson transformimin e diversitetit në një aset që kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha vendeve të BE-së (KE, 2008, p. 3). Më pas termi është pasqyruar dhe ka marrë formën e një diskursi edhe në dokumentet e tjera për territorin të cilat kanë të bëjnë me një përfaqëse sensitive dhe të integruar të politikave territoriale, për përmirësimin e performancës të veprimeve në të gjitha nivelet dhe për të krijuar sinergjitë midis llojeve të ndryshme të politikave të ndërhyrjes.

Në këtë mënyrë, ‘qeverisja e territorit’, ashtu si qeverisja në përgjithësi shndërrohet në një koncept të nevojshëm vetëm në kontekstin e procesit të zhvillimit të politikave të tilla si Europa 2020, TA 2020 (Akhenda Territoriale e BE-së 2020), Akhenda Urbane, Politikat e Kohezionit dhe politikat e ndryshme sektoriale. Këto procese operojnë në një nivel të ndryshme të qeverisjes evropiane dhe është për këtë arsye që duhet theksuar karakteri shumë dimensional i qeverisjes së territorit. Edhe pse, para së gjithash, kohezioni territorial kuptohet si pjesë e përgjithshme e politikave të kohezionit të BE-së, të cilat përbëjnë dhe një ndër politikat më të financuara të saj, PPK 2030 është një shembull i shkëlqyeshëm që tregon se politikat e kohezionit territorial mund të përshtaten dhe zbatohen me sukses edhe kur përshkallëzohen nga niveli evropian në nivel kombëtar.

1.3 Përmbajtja e kapitujve në vijim

Kapitulli i parë, parashtron strukturën e kërkimit përmes, përkufizimit të problematikës të zbrërthyer në kontekstin ndërkombëtar dhe atë lokal. Përcakton qëllimin dhe objektivat e studimit si edhe pyetjet kyçe kërkimore, sipas të cilave do të strukturohen edhe kapitujt në vijim. Këtu, përshkruhet metodologjia e ndjekur për realizimin e kërkimit, e bazuar kryesisht në hulumtim teorik dhe analiza krahasuese të

planeve territoriale kombëtare dhe të hartuara në vendin tonë dhjetëvjeçarin e fundit. Në këtë kapitull do të paraqiten edhe përkufizimet e disa prej koncepteve kryesore rreth të cilëve do të zhvillohen argumentat kryesore të temës.

Në kapitullin e dytë trajtohet konteksti teorik i konceptit të metabolizmit urban. Këtu përshkruhen metodat bazë të aplikimit të tij, ndikimi i disa teorive të ndryshme dhe zbatimi nga disa studime të vendeve europiane.

Kapitulli i tretë paraqet panoramën e kontekstit të ri të planifikimit në Shqipëri përmes ndryshimeve të kuadrit ligjor dhe instrumentave të planifikimit në vend. Ky kontekst i nevojshëm na njeh me veçoritë dhe ndikimin e qasjes metabolike ndaj planifikimit të territorit në vendin tonë.

Kapitulli i katërt analizon më nga afër ndikimin e qasjes metabolike në nivelin kombëtar dhe vendor, në planet territoriale të hartuara në 2013-2020 në Shqipëri. Këtu identifikohen faktorët pozitivë, limitet dhe mundësitë për avancimin e mëtejshëm në studimin e metabolizmit urban, përmes një analize krahasimore dhe interpretimit cilësor të planit të përgjithshëm kombëtar dhe planeve të përgjithshme vendore, të marra si raste studimore.

Kapitulli i pestë propozon një metodë të konsoliduar për zhvillimin e analizës metabolike me qëllim zbatimin e saj cilësor në dokumentat e planifikimit të territorit Shqipëri. Këtu evidentohet rëndësia e lidhjes midis shkallës territoriale, qëllimit të studimit dhe tipit të planit. Metoda përcakton: indikatorët për ndërtimin e një profili urban të territorit, indikatorët për ndërtimin e profilit metabolik, matricat për mbledhjen e të dhënave dhe metodat e vizualizimit të analizës.

Në Kapitullin e gjashtë formulohen përfundimet në lidhje me metodën e propozuar, sjell diskutime dhe rekomandime për kërkime të mëtejshme në drejtim të zbatimit të metabolizmit urban në planifikim.

2 KAPITULLI II_KONCEPTI I METABOLIZMIT NË LITERATURËN NDËRKOMBËTARE

Në dekadat e fundit, koncepti i metabolizmit urban ka qenë një temë themelore e debatit për qytetet. Nga përkufizimi i përgjithshëm i konceptit të matja specifike e përbërësve të tij të ndryshëm, metabolizmi urban është diskutuar nga shumë punime shkencore dhe libra, veçanërisht pas viteve 2000. (Vitor Oliveira & Rita Vaz, 2021) Kërkime të ndryshme sugjerojnë se shkenca e planifikimit të territorit do të përfitonte nga përfshirja e konceptit dhe zbatimet e ndryshme të tij në praktikë, duke paraqitur rezultate shkencore që provojnë dobinë e integritit të metabolizmit me planifikimin urban. Ky kapitull përpiqet fillimisht të përshkruajë sfondin e zhvillimit teorik të konceptit, të nevojshëm për të kuptuar lidhjen sistematike dhe kompleksitetin midis teorisë dhe praktikës. Ky sfond do të na lejojë të analizojmë më pas se si instrumentat e reja të planifikimit në Shqipëri janë munduar të zbatojnë këtë qasje.

Pas diskursit teorik, përbërësve kryesorë dhe zbatueshmërisë së konceptit në praktikë, e gjithë teza ofron një propozim për rishikim e metodës së Analizës Metabolike (AM) të integruar në dokumentat e planifikimit në nivel kombëtar dhe vendor në Shqipëri. Bazuar në këtë pasqyrë mbi kërkimin dhe praktikën, përshkruhen një numër parimesh për vlerësimin e metabolizmit urban. Argumentohet që metabolizmi urban duhet të vlerësohet brenda praktikës së planifikimit, përbërës të ndryshëm metabolikë duhet të vlerësohen në shkallë të ndryshme territoriale, matja e tyre duhet të jetë selektive dhe të ekuilibrojë kompleksitetin dhe pragmatizmin. Gjithashtu territori duhet të analizohet brenda kornizës metabolike dhe të pranohet si një element kryesor në lidhjen midis teorisë dhe praktikës. Lidhja e Metabolizmit Urban me Zhvillimin e Qëndrueshëm, i cili është në themel të vizionit për hartimin e çdo plani, është organike, ndaj implemetimi i sukseshëm në praktikë i AM duket i lidhur drejtpërdrejt me arritjen e këtij qëllimi.

Metoda e metabolizmit urban ripërcakton mënyrën sesi merremi me sfidat hapësinore në epokën tonë urbane duke analizuar marrëdhëniet midis shoqërisë dhe natyrës dhe midis qytetit dhe peizazhit. Tani më shumë se kurrë ne në fakt jetojmë në peisazhe të mëdha urbane, sisteme komplekse dhe aktive që janë bërë mjedisi ynë natyror (Brugmans G., Francke M., Persyn F. (ed), 2015)

Sfidat ambjentale që po përjetojmë në këtë mijëvjeçar lidhen drejtpërdrejt me rritjen e fenomenit të urbanizimit dhe me jetën e qyteteve tona ndaj duket me vend qasja se “ne mund të zgjidhim problemet mjedisore në botë vetëm nëse zgjidhim problemet e qytetit” (Brugmans,G., Strein J., (ed), 2014). Ka më shumë mënyra sesa një për të definuar një qytet. Në Metabolizmin Urban, peizazhi urban konsiderohet si një sistem kompleks, i gjerë dhe ndërveprues që punon vazhdimisht për të përmbushur nevojat e banorëve të tij. ‘Metafora e qytetit si një ekosistem dhe në veçanti ajo e metabolizmit urban janë të vlefshme për arkitektët, planifikuesit urbanë dhe projektuesit, për të kuptuar dhe adresuar problemet e qytetit si një sistem të lidhur me flukset e burimeve. Atëherë kur planifikuesit dhe projektuesit urbanë inkorporojnë të menduarin metabolik përgjatë dizenjimit të formave dhe proceseve urbane, menaxhimi i burimeve arrin që të integrohet në projektet urbane’ (Voskamp, Ilse.& Stremke, 2014, p. 4). Pavarësisht rrymave dhe përqsasjeve të ndryshme teorike dhe praktike që debatojnë mbi formën, strukturën dhe anën metodologjike të metabolizmit urban, sipas studiuësve të ndryshëm, ai shquhet për ‘gjerësinë e zbatueshmërisë së tij dhe njëkohësisht praktikimin e pjesshëm’ (Schalk, 2014, p. 279) . Ky kompleksitet në përqsasje është njëkohësisht pika e fortë dhe e dobët e metodës. Zbërthimi metodik i konceptit do të na

ndihmojë për ta kuptuar dhe për ta implementuar atë më me vërtetësi në lidhje me kontekstin Shqipëtar.

2.1 Konteksti teorik dhe historik i lindjes së metabolizmit urban dhe qasjet e tij kryesore - Metabolizmi Urban dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm

Ky kapitull zbërthen nënshtresat që formësojnë trekëndëshin e famshëm të zhvillimit të qëndrueshëm: Ekonomi, Shoqëri dhe Mjedis dhe përputhjen e këtij koncepti holistik me metabolizmin e territorit. Fusha e Ekonomisë dhe e Shoqërisë shpjegohet me ndikimin dhe argumentimin e teorisë marksiste, ndërsa Mjedisin nëpërmjet teorisë së sistemeve dhe ekologjisë urbane. Ky përfrim mbështet tezën kryesore të temës e cila pohon se: për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm, planifikimi i territorit duhet të trupëzojë në tërësinë e tij qasjen metabolike. ‘Të menduarit mbi metabolizmin urban ka tre degë të rëndësishme: ekologjinë humane, ekologjinë industriale dhe ekologjinë politike urbane. E para e konceptualizon metabolizmin nga këndvështrimi social ndërsa e dyta mbart gjithashtu anën sociale por nga këndvështrimi material dhe nga ana e flukseve natyrore. Literatura mbi ekologjinë e politikave urbane argumenton që metabolizmi urban është një përmbledhje e proceseve socio-natyrore që janë të ndikuara nga strukturat e pushtetit politik’ (Giezen & Roemers, 2015). Perspektiva e fundit është dhe perspektiva më e rëndësishme dhe më e plotë e planifikimit urban, që e përshkruan atë si një fushë që luhet midis fushës fizike dhe domenit të diskutit. Në figurën e mëposhtme paraqitet lidhja konceptuale që kërkojmë të hulumtojmë, midis sistemeve të ndryshme dhe metabolizmit urban.




Figura 2-1: Lidhja e metabolizmit urban me praktikën e planifikimit dhe sistemet natyrore, sociale dhe urbane (Burimi: Autori, përshtatur nga UN Environment (2017), Bai & Schandl (2011))

Kërkimi mbi origjinën e konceptit të metabolizmit urban do të na orientojë natyrshëm në lidhjen organike midis tij dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Teza që përkrah tema është vendosja e konceptit të metabolizmit urban në qendër të çdo procesi planifikimi apo të projektimit urban, si metoda më efikase për zhvillimin e modeleve të qyteteve të qëndrueshme. Përjasjet më të fundit dialektike marrin në shqyrtim produktin hapësinor të qyteteve duke u bazuar në aspektet e tij socio-politike dhe historike, duke vendosur në qendër të entitetit urban një element social relational (Faraud, 2017).

Ky përafrim është i drejtë, nëse i referohemi lidhjes së MU me *sociologjinë urbane*, dhe më konkretisht në dialektikën e Karl Marksit (1818-1883) dhe të bashkohësve të tij. Në veprën e tij “Kapitali”, Marks integroi plotësisht konceptimin materialist për natyrën me konceptimin e tij materialist të historisë. Në zhvillimin e tij të *ekonomisë politike*, siç u paraqit në veprën “Kapitali”, Marks përdori konceptin e "metabolizmit" (Stoffwechsl) për të përcaktuar punën si ‘një proces midis njeriut dhe natyrës, me të cilin njeriu përmes veprimeve të tij, ndërmjetëson, rregullon dhe kontrollon metabolizmin midis tij dhe natyrës’. Megjithatë një ‘shkëputjen e pariparueshme’ e quajtur *metabolism rift*, ishte shfaqur në këtë metabolizëm si rezultat i marrëdhënieve kapitaliste të prodhimit dhe ndarjes antagonistike të qytetit dhe fshatit. Prandaj, nën shoqërinë e prodhuesve të ndërlidhur do të ishte e nevojshme të "qeveriset metabolizmi i njeriut me natyrën në një mënyrë racionale", plotësisht përtej aftësive të shoqërisë borgjeze (Foster, Marx's Ecology Materialism and Nature, 2000, p. 141). Kjo kornizë konceptuale ishte e rëndësishme sepse i lejoi Marksit të bashkonte kritikën e tij ndaj tre tipareve kryesore të ekonomisë politike *borgjeze*: analiza e nxjerrjes së "tepricës" së produktit direkt nga prodhuesi ; teoria kapitaliste e lidhur me qiranë e tokës ; dhe teoria Maltusiane e popullsisë, e cila i lidhi këto të dyja me njëri-tjetrin. Për më tepër, koncepti i Marksit për "shkëputjen" metabolike në marrëdhëniet midis qytetit dhe fshatit, qenieve njerëzore dhe tokës, e lejoi atë të depërtonte në rrënjët e asaj që historianët ndonjëherë e kanë quajtur "revolucionin e dytë bujqësor", që ndodhi në kapitalizmin e kohës së tij, dhe kriza në bujqësi me të cilën u shoqërua kjo, duke i mundësuar atij zhvillimin e një kritike të degradimit të mjedisit duke parashikuar shumë nga mendimi i sotëm ekologjik. Qysh në shekullin e 19-të u përdor ky term për të përshkruar se si njerëzit po nxirrnin materiale dhe ndryshonin peizazhet natyrore në mënyra të paprecedentë. Marks vuri re se njerëzit ishin në proces të kolonizimit të natyrës dhe "metabolizimit" të shpejtë të burimeve të saj.

"Metabolizmi urban nuk është vetëm një metaforë e fuqishme për të kuptuar më mirë sistemet tona urbane, por edhe korniza themelore që na duhet për përshpejtimin e tranzicionit në qytete të qëndrueshme." Vetë Marks pohon se nuk ishte i pari që zhvilloi këtë koncept, dhe se idetë e tij u influencuan gjerësisht nga Justus von Liebig, një kimist gjerman i dherave i cili e përdori konceptin e metabolizmit për të përshkruar shkëmbimin material dhe marrëdhëniet e pavarura midis shoqërisë njerëzore dhe natyrës. Ishte në këtë kuptim që Marks përdori shprehjen e ‘metabolizmit midis njeriut dhe natyrës’ duke iu referuar në mënyrë specifike cikleve të ushqimit të bimëve në termat e kushteve të fertilitetit, prodhimit bujqësor dhe urbanizimit. Duke aplikuar nocionin e Metabolizmit, Marks përshkroi karakterin transformues të natyrës nëpërmjet proceseve të punës, dhe së dyti përshkroi dhe shkëmbimin e të mirave në sistemin kapitalist (Dinares, 2014).

Si përmbledhje, mjedisi i qytetit (si social dhe ai fizik) është rezultat i proceseve historike dhe gjeografike të urbanizimit të natyrës (Heynen, N., Kaika, M. & Swyngedouw, E., 2006, p. 5). (Foster, 2013) në artikullin e tij për Marks dhe metabolizmin universal të natyrës shkëput nga Kapitali konceptin e "hendek-ut" në marrëdhëniet metabolike midis qenieve njerëzore dhe natyrës si ndërprerja e ciklit të tokës në bujqësinë e industrializuar. Duke propozuar se, duke shkatërruar rrethanat që shkaktonin këtë metabolizëm, do të ndodhte dhe restaurimi i ligjeve të rregullta të prodhimit social, dhe në njëfarë mënyre të zhvillimit të plotë të qenies njerëzore. Gjatë dekadave të fundit, studiuesit e ekologjisë i kanë përdorur perspektivat teorike të Marksit mbi metabolizmin për të analizuar zhvillimin e kontradiktave të kapitalizmit

në një sërë fushash të tilla si: kufijtë e planetit, metabolizmi i karbonit, shkatërrimi i tokës, prodhimi i pesticideve, metabolizmi i oqeanit, pastrimi i pyjeve, ri-përtëritja e pyjeve, ciklet hidrogjike, menaxhimi i bagëtimeve, agro-karburantet, zaptuesit e tokës globale dhe kontradiktat midis qytetit dhe fshatit (Foster, 2013) duke vënë në këtë mënyrë një pikëpyetje për vetë sistemin ekonomik ku jetojmë. Megjithatë, në vend që të synojmë kontrollin, ne duhet të përqafojmë pasigurinë dhe të ripërcaktojmë parimet e projektimit për të njohur kompleksitetin e ekosistemeve hibride – duke zgjeruar heterogjenitetin e formave dhe funksioneve në qytete për të mbështetur si funksionet njerëzore ashtu edhe ato ekologjike.

Referenca e drejtpërdrejtë e metabolizmit me proceset natyrore është zhvilluar me të njëjtin ritëm me evoluimin e ekologjisë si një fushë shkencore dhe me *'sistemet e të menduarit'* të organizmave biologjike që u zhvilluan shumë gjatë gjysmës së parë të shekullit 20-të. Sipas de Oliveira (2011) vetë përkufizimi i ekologjisë nga **Ernst Haeckel** – si shkenca e marrëdhënieve midis organizmave dhe botës të jashtme përreth, lexohej si një referencë për marrëdhëniet e ndërsjellta dhe ndërlidhjet e gjërave. 'Hapësira' dhe 'koha' nuk perceptohen më si koncepte absolute por si entite relative dhe të pavarura. Për të kundërshtuar idenë e 'hapësirës' – si një koncept abstrakt dhe i distancuar nga forma materiale dhe interpretimi kulturor – ata që përkrahnin metabolizmin preferuan që të përdorinin termin *'mjedis'* (Oliveira, 2011, p. 79). 'Metabolizmi' u prezantua si term në fillim nga sociologu urbanist **Ernest Burgess** (1886-1966) në artikullin e tij 'Rritja e Qyteteve', i publikuar në vitin 1925, edhe pse ai nuk përdori termin metabolizëm urban por *'metabolizëm social'* për të përshkruar procesin e rritjes dhe transformimit të qyteteve. E reja në konceptimin e Burgess-it ishte fakti se rritja e qyteteve shihej si diçka 'normale' dhe nuk përbënte një arsye për prishje sociale, ashtu siç ishte retorika e promotorëve të *Garden City*. Për shkak se qyteti shqyrtohej si një organizëm i gjallë, atëherë ai rritet dhe ndryshon, dhe në këtë mënyrë kalonte periudha natyrore të dizintegritimit dhe ri-integritimit (Schalk, 2014, p. 284). Organizimi shoqëror dhe dizorganizimi trajtohen nga Burgess si proceset e metabolizmit. Ndërkohë që proceset dhe shkalla e zgjerimit urban, mund të studiohen jo vetëm si rritjen fizike, por edhe përmes ndryshimeve pasuese në organizimin shoqëror dhe në llojet e personaliteteve. 'Sa përputhet rritja e qytetit, në aspektet e tij fizike dhe teknike, me një rregullim të natyrshëm, por adekuat të organizimit shoqëror? Cila është norma normale e zgjerimit, për një qytet, me të cilën ndryshime të kontrolluara në organizimin shoqëror mund të ecin me një ritëm të suksesshëm? Këto pyetje mund të përgjigjen më së miri, ndoshta, duke e menduar rritjen urbane si rezultat i organizimit dhe çorganizimit, analoge me proceset anabolike dhe katabolike të metabolizmit në trup' (Robert E. Park & Ernest W. Burgess, 1925, p. 53).

Nëse ndalemi tek përkufizimi i termit, përveç *konceptimit biologjik*, procesi i metabolizmit në fjalorin e Oksfordit trajtohet edhe si një proces kimik, i cili ndodh brenda një organizmi në mënyrë që ai të vazhdojë të jetojë. (Faraud, 2017) heton mbi etimologjinë e fjalës 'metabolizëm' e cila rrjedh nga fjala greke 'metabol' që do të thotë 'ndryshim', dhe në këtë mënyrë, nocioni i metabolizmit i referohet procesit të ndryshimeve që e mbajnë një sistem të gjallë, gjë e cila shpjegon përdorimin e tij të parë në shkencat ekologjike dhe biofizike (Faraud, 2017). Filledat e metabolizmit urban nga këta studjues burojnë nga koncepti biologjik (Schalk, 2014; Faraud, 2017), madje i tillë konsiderohet edhe modeli i parë urban i metabolizmit që na ofrohet nga Wolman i cili do të trajtohet më gjerësisht në vazhdimësi. Edhe në vendin tonë, si një term i huazuar nga biologjia, 'metabolizmi' fillimisht ndeshet vetëm në fjalorin e gjuhës shqipe në të cilin përshkruhet si 'tërësia e shndërrimeve që kryhen në organizëm gjatë

shkëmbimit të lëndëve' (Elezi, 2006) dhe iu referohet kryesisht metabolizmit të organizmave të gjalla dhe bimëve.

Megjithatë, antropologët vazhdimisht kanë shtyrë kufijt e këtij koncepti përtej fushës së biologjisë. Kështu **Levi-Straus** në përshkrimin e tij për qytetet nuk theksonte vetëm *krijimin biologjik të qyteteve por edhe evolucionin e tyre organik dhe gjithashtu dhe anën estetike*. Për të qytetet janë njëkohësisht objekt i natyrës dhe një subjekt i kulturës; njëkohësisht edhe një individ edhe një grup; është diçka e jetuar dhe diçka e ëndërruar; arritja më e lartë e zhvillimit njerëzor (Weinstock, 2011, p. 102). Kjo marrëdhënie investigohet më tej nga **Edward Hall**, nëpërmjet teorisë së tij *proxemics*⁴ (Caves, 2004, p. 328) dhe eksplorimit të kohezionit kulturor dhe shoqëror në lloje të ndryshme të hapësirës personale të përcaktuar nga ana kulturore. Sipas tij ka katër forma të territorit njerëzor:

- Territori publik: një vend ku mund të hyjë lirisht. Ky lloj territori rrallë është në kontrollin e vazhdueshëm të vetëm një personi. Sidoqoftë, njerëzit mund të kenë në pronësi të përkohshme të territorit publik.
- Territori ndërveprues: një vend ku njerëzit grumbullohen jozyrtarisht;
- Territori i shtëpisë: një vend ku njerëzit vazhdimisht kanë kontroll mbi territorin e tyre individual
- Territori i trupit: hapësira imediate që na rrethon.

Këto nivele të ndryshme të territorit, përveç tipareve të hapësirës personale, sugjerojnë mënyra komunikimi që prodhojnë pritshmëri të sjelljes së përshtatshme.

Në këtë mënyrë, modelet e ndryshme të sistemeve kulturore ishin të rrënjosura thellë në fushën e biologjisë dhe të fiziologjisë që në fillim të shek.19. Kështu ndërmjet shkencave të ndryshme pasurohet koncepti i metabolizmit si shkëmbim jo vetëm kimiko-biologjik por edhe social-kulturor e antropologjik, ku hapësira dhe koha janë gjithashtu determinantët kryesor të tij.

Zbatimi i mendimit metabolik për adresimin e problemeve urbane nis me asocimin e urbanizimit dhe zhvillimit të qyteteve moderne gjithmone e më të varura nga konsumi i burimeve të parinovueshme. Përdorimi i tij njohu popullaritet, gjerësisht pas Luftës së Dytë Botërore me qëllim për të zgjidhur problemet që kishte shkaktuar njeriu. 'Qëllimi kryesor i tij ishte që të ri-lidhte njeriun me mjedisin e konstruktuar, aspiratat e individit me nevojat kolektive, [...] njohuritë me ndienjat' (Oliveira, 2011). Modeli i parë i metabolizmit urban, prezantohet nga **Abel Wolman (1965)**. *Për herë të parë si metabolizëm urban u përcaktua "totali i të mirave materiale që nevojiten për mbajtjen e banorëve të një qyteti në shtëpi, në punë dhe në argëtim"* (Wolman, 1965). Më vonë këto kërkesa përfshinë dhe materialet e ndërtimit të cilat nevojiten për të ndërtuar dhe ri-ndërtuar vetë qytetin. Wolman thekson se cikli i metabolizmit nuk ka përfunduar derisa mbetjet e ngurta të jetës së përditshme të eliminohen dhe sistemohen me minimumin e zhurmës dhe të dëmit. Wolman e shikonte tokën si një sistem ekologjik të mbyllur dhe që nuk mund të pranonte më metodat e vjetra të transportimit dhe të sistemimit të mbetjeve (Wolman, 1965, p. 179). Me zgjerimin e qytetit problemet e këtij të fundit u rritën dhe zgjidhja e tyre qëndronte vetëm në duart e një administratori. Për të paraqitur propozimin e tij, Wolman në eksperimentin për një qytet amerikan imagjinari, thekson se qytetet në rritje nga pikpamja administrative kishin tre probleme kryesore metabolike: sigurimin e furnizimit me ujë, largimin e ujërave të ndotura

⁴Shënim: Proxemika është studimi i përdorimit njerëzor të hapësirës dhe efektet që ka dendësia e popullsisë në sjelljen, komunikimin dhe ndërveprimin shoqëror (Dictionary.com. Retrieved November 14, 2015.)

(kanalizimet) dhe kontrollin e ndotjes së ajrit. Duke përcaktuar në këtë mënyrë edhe flukset më kryesore që shënojnë transformimin dhe cilësinë e zhvillimit të qytetit. Është e qartë që kompleksiteti i problemeve që ofron hapësira urbane sot është më e gjerë dhe dizenjimi, përdorimi dhe kuptimi i sistemit urban përfshin transformimin e natyrës në një sintezë të re. Sic thekson dhe Heynen, Kaika & Swyngedouw (2006) detyra kryesore e studiuesve në ditët tona duhet të jetë gjetja e kuptimit të kësaj natyre urbane të sintetizuar dhe njëkohësisht të politizuar (Heynen, N., Kaika, M. & Swyngedouw, E., 2006, p. 5). Kjo sepse koncepti i metabolizmit urban është shumë i lidhur njëkohësisht me politika të sektorëve të ndryshëm të tillë si ekonomia politike, gjeografia politike etj., por edhe ndërthurja e tyre me njëra – tjerën, gjë që bën metabolizmin urban të jetë një koncept multi-disiplinor. Përkufizimi i mëvonshëm mbi metabolizmin urban e detajon atë si "shuma totale e proceseve teknike dhe socio-ekonomike që realizohen në qytete dhe janë përgjegjës për zhvillimin, prodhimin e energjisë dhe hedhjen e mbetjeve" (Kennedy, C., Cuddihy, J., & Engel-Yan, J., 2007, pp. 43-59).




Figura 2-2: Transaksionet midis inputeve dhe outputeve t/dite per nje qytet hipotetik në Amerikë sipas Wolman (1965)

Figura 2-3: Metabolizmi Urban i Brukselit, Belgjikë 1970 (Duvigneaudand Denayer-De Smet, 1977) (Kennedy, C., Pincetl, S. & Bunje, P. , 2010)

Puna formuese për aplikimin e MU arriti majat në vitet 1970-të, ku u hartuan studimet e para të metabolizmit të qyteteve, dhe inxhinierët e ekologjistët u përqendruan në kuptimin e zonave të para metropolitane. Më pas, rreth viteve 1980 pati një zbehje, për të rilindur në vitet 1990-të. Vështrimi i mëtejshëm kronologjik tregon se në dekadat e fundit interesi për të studjuar metabolizmin urban është rritur ndjeshëm. Rishikimi zbulon se ka dy shkolla të lidhura, jokonfliktuale, të metabolizmit urban: një sipas *Odum* përshkruan metabolizmin në terma të ekuivalentëve të energjisë; ndërsa e dyta shpreh më gjerësisht flukset e ujit, materialeve dhe lëndëve ushqyese të një qyteti në lidhje me flukset masive *MFA* (Analiza e flukseve të materialeve) (Kennedy, C., Pincetl, S. & Bunje, P. , 2010). Koncepti biologjik i metabolizmit u huazua kështu me entuziazëm nga disiplina e ekologjisë në shek. 20, kryesisht në teorinë pionere të ekologjisë së sistemeve të prezantuar në 1960 nga *Eugene Odum* (Odum, 1963). Ai njihet për konceptualizimin e flukseve të energjisë të cilat ai i emërtoi si *Emergji*. Ky ishte një mjet matës për të kuptuar qytetet në lidhje me rezervat ekologjike të tyre si dhe energjisë së përdorur për të prodhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të një produkti apo një shërbim (Holmes, T. & Pincetl, S., 2012, p. 3). Më vonë dolën termat matës të *Fluskit të Materialeve (MFA)* dhe Vlerësimit Ciklik të Jetës ore (*LCA*). Punët kërkimore nën influencën e kësaj tradite konsideruan në analizën e tyre ekosistemet si

një tërësi unitare, kjo i lejoi studiuesve të modelonin dhe të studionin si një entitet, mjedisin dhe ndërveprimet në të. *Ekologjistët e Sistemeve* konceptuan vizionin për ekosisteme me metabolizëm të balancuar dhe efficient, një teori e cila nuk mbështet më nga punimet e fundit të ekologjisë, kryesisht të fushës “*non-- equilibrium ecology*” (White, 2004). Megjithatë, ishte pikërisht fusha e ekologjisë së sistemeve, burimi i idesë për metabolizmin urban dhe analogjisë së ndërveprimit të ekosistemeve me mjedisin e tyre si një “super organizëm” i vetëm. (Odum, 1959; Patten&Odum, 1981). Sipas kësaj pikëpamjeje, ekosistemet analizohen si entitete funksionale duke përshkruar dinamikat e energjisë dhe të flukseve ushqyese (Conan, 2000).

Marrja e qasjes së ekologjisë së sistemeve ndaj metabolizmit gjithashtu lidhet me ndikimin dhe popullaritetin e *teorisë së sistemeve* në gjysmën e dytë të shekullit XX. *Teoria e sistemeve* përfshin një sërë qasjesh që i kanë rrënjët në teorinë e përgjithshme të sistemeve të zhvilluara fillimisht nga biologu **von Bertalanffy** në vitet 1930-të, i cili synonte të nxirrte një sërë parimesh të përgjithshme të zbatueshme për të gjitha sistemet (Bertalanffy L. v., 1968). Gjuha e sistemeve shpesh thirret në parimet e termodinamikës, të zhvilluara fillimisht nga fizikantët në lidhje me energjinë dhe më vonë u zgjeruan për të përfshirë edhe materien. Ligji i parë i termodinamikës, mbi ruajtjen e materies dhe energjisë, thotë se energjia nuk mund të krijohet ose shkatërrohet. Ligji i dytë i termodinamikës, ligji i entropisë, thotë që energjia dhe materia në univers lëvizin në mënyrë të pashmangshme drejt një gjendje më pak të rregulluar (ose të dobishme).

Ky moment është i rëndësishëm pasi përshkruan evolimin teorik dhe mpleksjen e idesë së sistemeve dhe metabolizmit urban, duke dëshmuar për ngjashmëritë dhe ndërlidhjen e tyre. Është pikërisht kjo bazë teorike e cila reflektohet edhe në ndryshimet ligjore radikale në Ligjin e Planifikimit të Territorit në Shqipëri (2014), por ndryshe nga vendet e tjera kjo nuk erdhi si pasojë e një debati apo zhvillimeve në fushën kërkimore të ngritur në vend në këtë drejtim, por si një transplant i huazuar nga eksperiencat perëndimore. Vetëm duke kuptuar në thelb këtë sfond teorik mund të jemi të vërtetë në integrimin e qasjes së metabolizmit në praktikatat e planifikimit urban e të ecim përpara në hartimin e planeve të reja të territorit.

Përhapja gjatë 40 viteve të fundit apo më shumë e 'qasjeve të sistemeve' në një larmi fushash është shoqëruar me nocionin e 'sistemeve të përgjithshme' si një rrugë e mundshme për në Gral-in e Shenjtë intelektual, unitetin e të gjithë njohurive njerëzore (Bertalanffy L. v., *General system theory; a new approach to unity of science*, 1951). Nga sa është thënë tashmë, kuptohet se paradigma e sistemeve ishte një 'ide gjerësisht e përhapur gjatë viteve 1950 dhe 1960. E gjithë ajo që duhej për përfshirjen e saj në një fushë specifike siç është planifikimi urban ishte një bashkim i kushteve pararendëse dhe aktuale. Duke synuar zhvendosjen e planifikimit urban nga paradigma e modelit sintetik në pyetjet analitike të përdorimit të tokës dhe bashkëveprimit të inxhinierisë e transportit, në pyetjet e mjediseve të ndërtuara për sjelljen dhe zgjedhjet njerëzore (Mc Loughlin, 1985).

Studjues të ndryshëm pohojnë qartë lidhjen midis metabolizmit urban dhe qasjes sistemike të mjedisit sipas teorive të mësipërme, ku shprehen se ‘kuptimi metabolik i qytetit u mundësua nga ndërlidhja e tij me teorinë e sistemeve. Gjithashtu edhe planifikimi i territorit po adoptonte teorinë e sistemeve gjerësisht gjatë viteve 1960-të, megjithatë zbatimi i tij kryesor u përqendrua fillimisht në marrëdhëniet e ndërsjellta midis përdorimit të tokës dhe transportit. Në fund të viteve 1960-të, McLoughlin (1969) zbatoi teorinë e sistemeve, jo vetëm për të promovuar *teorinë e vendndodhjes*, por gjithashtu për të vënë në dyshim rolin e master planeve, duke i përfytyruar *planet e qyteteve si trajektore* dhe jo si propozime për të zgjidhur në mënyrë përfundimtare të

ardhmen e qyteteve. Ky në fakt është edhe ndryshimi thelbësor midis urbanistikës dhe planifikimit si koncepte teorike dhe si zbatim praktik, ndërkohë që e para përmes metodave racionale e tradicionale paraqet në mënyrë statike gjendjen fundore të dëshiruar të një territori dhe shoqërisë së tij, planifikimi është një proces në vazhdim të rregullimit të marrëdhënieve midis elementëve të një makrosistemi që ndryshon vazhdimisht. Ndërkohë, tek (Rapoport, 2011) i referohemi klasifikimit të studimeve që fokusohen tek metabolizmi si koncept i huazuar nga ekonomia politike dhe në shkencat bio-fizike, të tilla si degëzimet e ndryshme të teorisë së sistemeve dhe principet e termodinamizmit. Studiues të tjerë pohojnë se metabolizmi urban në mënyrën e sotme të të konceptuarit ka në qendër të tij ‘ri-organizimin e marrëdhënieve midis shoqërisë dhe individit’ (Schalk, 2014, p. 284) duke veçuar edhe anën social- kulturore të tij.

Sa më lart, konkludojmë se gati të gjitha përjasjet e ndryshme të metabolizmit urban kanë të rrënjosur brenda tyre teorinë e sistemeve, por në këndvështrime të ndryshme metodologjike. Kështu, ekologjia urbane bazohet më shumë në teorinë e sistemeve komplekse dhe tek analogjia e formës. Por, teoria e sistemeve komplekse në **ekologjinë urbane** e shikon qytetin si një sistem të mbyllur dhe nuk merr në shqyrtim aspektet socio-politike të krijimit dhe vazhdimësisë së qyteteve. Ndërkohë që **ekologjia industriale**, e cila përfshin ekonominë politike dhe ekonomiksin ekologjik, bazohet te përjasje bio-fizike. Vetë teoria e sistemeve bazohet në ligjet e termo-dinamikës e cila e vendos theksin më shumë te analogjia funksionale dhe jo tek analogjia e formës. Qytetet konsiderohen si të vetë-mjaftueshme dhe merren në shqyrtim burimet hyrëse dhe lëndët dalëse të qyteteve. Kësaj përjasje i mungojnë aspektet socio – politike, të cilat plotësohen në përjasjen e tretë të metabolizmit urban. Përjasja e tretë është *ekologjia ose gjeografia politike* të cilat e shohin qytetin si një *konstrukcion socio-politik* dhe kryesisht bazohen në dialektikën e *Hegelit dhe të Marksit*. Sipas përjasjes dialektike, *qytetet janë prodhime historike* dhe flukset urbane ndikohen nga shpërndarjet socio-politike. Qasja normative e ekologjisë politike nuk bazohet te teoria e sistemeve por tek *metabolizmi social* dhe si pasojë modelet e saj urbane tentojnë drejt qyteteve elastike duke vënë në dyshim strukturën aktuale të qeverisjes së qyteteve dhe politikave neo-liberale dhe kapitaliste. Këto të fundit, kërkojnë që qytetet të qeverisen me metoda të tjera dhe jo sipas metodave të kapitalit apo të ekonomisë së tregut, por nuk kanë elaboruar akoma ndonjë metodologji për të zëvendësuar politikat neo-liberale dhe si pasojë kjo përjasje kritikohet si një përjasje edhe utopike. Tabela 1 në vazhdim e zhvilluar nga Faraud (2017) jep një përshkrim të detajuar të secilës rrymë, bazave të saj normative, fokusit, metodologjisë, kufizimeve kryesore teorike dhe praktike si dhe autorëve përfaqësues.

Disiplina	Baza normative	Lloji	Fokusi	Metodologjia/Mjetet	Kufizimet	Autorët
-----------	----------------	-------	--------	---------------------	-----------	---------

Ekologjia Urbane	Është studimi shkencor i marrëdhënies së organizmave të gjallë me njëri-tjetrin dhe rrethinat e tyre në kontekstin e një mjedisi urban.	Teoria e ekosistemeve Teoria e sistemeve Teoria e sistemeve komplekse	Analogjia e formës	Qyteti anatomik. ADN-ja e qyteteve Përbërësit e qytetit dhe ndërlidhjet, cirkulariteti, balanca dhe renditose elasticiteti dhe vetë-rregullimi	Mbështetete shkenca Biomimicry Pejsazhi Arkitektura	Qyteti shihet si një sistem i mbyllur Ndërlidhjet me pjesët e tjera të vendit nuk merren parasysh Mungesa e aspekteve socio-politike	Girard et Neëman and Jennings Benyus Pawlyn
Ekologjia	Është studimi i rrjedhave të materialit dhe energjisë përmes sistemeve industriale.	Përfaqsj e bio-fizike	Analogjia funksionale	Funksionet e qytetit Vetë-mjaftueshmëria Efikasiteti i burimeve	Ekonomia cirkulare	Bazohet në zgjidhjet teknike	Baccini Barles Brunner
Ekonomia politike	Është studimi i prodhimit dhe tregtisë dhe marrëdhëniet e tyre me ligjin, zakonin dhe qeverinë; dhe me shpërndarjen e të ardhurave dhe pasurisë kombëtare.	Teoria e sistemeve e bazuar në ligjet e termodinamikës			Mjetet kryesore që përdor metodologjia MFA, SFA, Gjurma ekologjike e qytetit	I mungojnë aspektet socio-politike	
Ekonomiksi		Teoria Botërore e sistemit		Qytetet si produkte historike		Është e varur nga saktësia e të dhënave	Kennedy Girard et McDonough
Ekologjia politike	Është studimi i marrëdhënieve midis faktorëve politikë, ekonomikë dhe socialë me çështjet dhe ndryshimet mjedisore	Qytetet janë konstruksione socio-politike	Përfaqsj dialektike	Shpërndarja socio-politike e flukseve urbane	Drejtësia mjedisore Drejtësia socio – mjedisore	Nuk ka metoda zbatimi	Gandy Harvey Heynen

Gjeografia politike	Ka të bëjë me studimin e rezultateve hapësinore të pabarabarta të proceseve politike dhe mënyrave në të cilat vetë proceset politike ndikohen nga strukturat hapësinore. Në mënyrë konvencionale, për qëllime të analizës, gjeografia politike miraton një strukturë në tre shkallë me studimin e shtetit në qendër, studimin e marrëdhënieve ndërkombëtare (ose gjeopolitikën) mbi të dhe studimin e lokaliteteve nën të. Shqetësimet kryesore të nën-disiplinës mund të përmblihen si ndër-marrëdhëniet midis njerëzve, shtetit dhe territorit.	Metabolizmi social i Marksit		Vë në diskutim rendin aktual socio-politik	Qytetet elastike	Sfidon kapitalizmin dhe neoliberalizmin.	Swyn gedou w
---------------------	---	------------------------------	--	--	------------------	--	--------------

Tabela 2.1-1: Përmbledhje mbi Metabolizmin Urban (Faraud, 2017, p. 9)

Megjithatë, nuk mund të flasim për metabolizmin, pa përmendur ndikimin e tij, jo vetëm në zhvillimin urban, por edhe në arkitekturën e qytetit. E lindur me Lëvizjen e metabolizmit japonez në 1960 dhe e risjellë nga **Rem Koolhaas dhe Hans Ulrich Obrist** në 2009 në Project Japan (publikuar për herë të parë në vitin 2011), ashtu si për Team 10's "asocioni human" edhe koncepti i Metabolizmit gjithashtu eksploronte koncepte të reja për dizajnin urban (Lin, 2010, p. 26).

Metabolizmi japonez (shinchintaisha) ishte një lëvizje arkitektonike japoneze e pas Luftës së II Botërore (vitet 1950-1960), që shkriu idetë për megastrukturat arkitektonike me ato të rritjes biologjike organike. Gjithçka po ndryshonte në Japoninë e Luftës së Dytë Botërore. Fenomeni masiv i migrimin, lindja e qytete të reja nga hiri dhe një zhvillim ekonomik shpërthyes ishte pjesë e skenës aktuale kombëtare. E ardhmja po mbërrinte më shpejt sesa të gjithë mendonin dhe ndërtesat nuk mund ta mbanin hapin me të. Metabolizmi ishte përgjigja arkitektonike nga një grup i ri arkitektësh në një qytet statik dhe të shkatërruar nga lufta, një premtim i ri i ndryshimit në një shoqëri të nxitur. Ekspozimin i parë ndërkombëtar i saj ndodhi gjatë takimit të CIAM në 1959 me ide të testuara paraprakisht nga studentë (Kikutake, Kurokawa, Fumihiko Maki, dhe kritiku Kawazoe) klasës së MIT të profesorit star-arkitekt Kenzo Tange. Kështu duke përshkruar stilin e arkitektëve metabolistë në Japoni, (Schalk, 2014, p. 280) shkruan se 'ata ndërmjetësojnë midis formave të mëdha teknike të urbanizmit, infrastrukturës institucionale si dhe lirisë së individit dhe një arkitekture me qeliza të përkohshme të adaptuara në apartamente, të cilat mund të zgjerohen ose të zvogëlohen sipas nevojave'. Ideja kryesore ishte rikonceptim i shoqërisë duke përdorur arkitekturën si një mjet për

ndryshime të mundshme, duke spekuluar se si ndërtesat mund të ndryshojnë, rriten dhe evoluojnë.

Kuptimi i fjalës *Metabolizëm*, frymëzoi arkitektët Japonezë në disa drejtime. Ai përfaqësonte jo vetëm kontekstin biologjik të rritjes dhe evolucionit të gjallesave, dhe reaksionet kimike që ndodhin në trupin e një gjallese, por në gjuhën japoneze termi Metabolizëm ‘shinchintaisha’ nënvizon një perspektivë shpirtërore, më afër konceptit budist të papërkulshmërisë, kuptimit të ripërtëritjes, zëvendësimit dhe rigjenerimit. Të dy kuptimet, biologjike dhe shpirtërore, shërbyen si kornizë referimi për projektimin kolektiv, një hap më pranë një arkitekture të bazuar në rrethin natyror të jetës. Qytetet e vjetra ishin të vjetruara, ndaj duhej ngritur një sistem i ri metropoli. E ardhmja e Tokios ishte një ardhme organike, një Bio-Tokio. Një vend ku shkëmbimi i energjisë, burimeve me ekosistemin bëhet thelbësor. Ndërtesat që mund të sillen si qeliza - ose të rriten si bimësi - ku janë faktorë të domosdoshëm për planin. Ashtu siç shkruan Schalk (2014) ‘në skemat metabolike, nocioni i hapësirës lihet pas dore duke favorizuar çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet *hapësinore, të tilla si ndryshimi, përkohësia dhe procesi*. Interesi për të zbuluar organizime të reja hapësinore është më i vlefshëm sesa ri-krijimi i hapësirës të humbur tashmë; dhe ndërkohë eksplorohej forma të reja ‘habitati’. Kështu duke iu referuar eksperiencës japoneze gjatë Luftës së Dytë Botërore, problemeve pas bombës atomike, probleme natyrore me tërmetet dhe cunamet, Schalk shkruan që të gjitha këto eksperiencia sollën si pasojë një tërheqje të nocionit të vendndodhjes dhe krijimin e termave të reja arkitekture, në përfytyrimin arkitekturor, dhe një zhvendosje në diskurs. Në punën e studiuesve metabolikë, imazhi arkitekturor zëvendëson elementin e ‘vendndodhjes’.

Për këtë arsye, edhe sot vëmë re një rikthim të kërkesave për ndërtesa eko-organike dhe përshtatjen në arkitekturë të elementëve që imitojnë natyrën dhe kërkojnë të mimitizohen me mjedisin. Midis kontrastit dhe simbiozës kërkesat mbeten për projektimin e një arkitekturë që është pjesë e peisazhit natyror. Nga pyjet vertikale tek taracat e gjelbëruara ‘tendencat janë në rritje për ndërtimet ekologjike që ndikojnë zhvillime të ndryshme që nga shtëpitë ekologjike e deri tek dezajnet ekologjike utopike. Megjithatë duhet të jemi të kujdesshëm nëse ‘pylli vertikal’ që ndërtojmë është pjesë e metabolizmit cirkular të qytetit dhe mjedisit përreth, apo po konsumon më tepër resurse dhe energji se një arkitekturë më e ‘thjeshtë’. Lëvizja *biomimicry*, është pjesë e kësaj tendence, e cila synon drejt projekteve që spikasin për arkitekturën e tyre estetike dhe njëkohësisht pretendojnë që të zgjidhin shumë probleme mjedisore duke imituar modelet e natyrës (Faraut, 2017). Biomimetika ose biomimika është modelimi i sistemeve dhe elementeve të natyrës me qëllim të zgjidhjes së problemeve komplekse njerëzore. Analiza e kësaj ‘mode’ në arkitekturë dhe efikasitetit të saj në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm janë për t’u diskutuar, por nuk bëjnë pjesë në kërkimin e kësaj teze. Ato vlejnë për të konkluduar se, edhe pse eksperimentet për kalimin nga pjesëzat e vogla tek kuadri i gjerë janë me vlerë, duket se zgjidhja për një zhvillim të qëndrueshëm duhet të vijë nga një rikonceptim më holistik i hapësirës dhe i marrëdhënieve mes njeriut dhe mjedisit. Arkitektët japonezë, kishin një qëndrim të qartë dhe zgjidhje teknologjike duke u shprehur se: “*Ne e konsiderojmë shoqërinë njerëzore si një proces jetësor - një zhvillim i vazhdueshëm nga atomi te nebula. Arsyeja pse ne përdorim një fjalë të tillë biologjike, metabolizmin, është se besojmë se dizajni dhe teknologjia duhet të jenë një synim i shoqërisë njerëzore. Nuk do ta pranojmë metabolizmin si një proces natyral, por përpiqemi të inkurajojmë zhvillimin aktiv metabolik të shoqërisë sonë përmes propozimeve tona*” (Noboru, 1960, pp. 48–49). Megjithatë, më tepër se me stilin e veçantë të projektimit arkitektonik të objekteve të

ndryshme të ndërtimit, diskursi mbi metabolizmit lidhet me zhvillimin hapësinor dhe marrëdhënien e re që duhet ndërtuar mes qyteteve, shoqërisë dhe natyrës. Idetë e arkitektëve japonezë u orientuan më tepërdrejt zbatimeve teknike arkitektonike sesa të modelimit hapësinor të sistemeve të planifikimit, por kontributi i tyre mbi nevojën për ndërveprimin e sistemeve që përbëjnë zhvillimin e një qyteti dhe të urbanizimit u shpreh qartë në esetë dhe projektet e tyre për qytetet e reja të propozuara.

2.2 Metodatat bazë në aplikimin e Metabolizmit Urban

Vitet e fundit, me përhapjen e urbanizimit si fenomeni më dominues botëror, shumica e qyteteve përdorin sasi gjithmonë e më të mëdha burimesh natyrore, të cilat pasi procesohen sjellin reduktim të cilësisë së jetës, një sasi të madhe mbetjesh dhe emetime të gazrave të dëmshme në atmosferë. Sipas Roggema & Alshboul, në ditët tona, është e qartë se kur shumica e popullsisë botërore jeton nëpër qytete, atëherë qytetet duhet të njihen si vendet më të rëndësishme për të adresuar kërcënimet mjedisore, të tilla si ndryshimi i klimës, mungesa e ujit të pijshëm, mungesa e biodiversitetit dhe mungesa e burimeve. “Thelbi i sfidës për të ruajtur cilësinë e jetës në zonat urbane është nevoja për furnizime të mjaftueshme dhe të qëndrueshme të energjisë për të siguruar aktivitetin ekonomik, duke mbështetur kërkesat dhe pritshmëritë në rritje të energjisë. Kjo është bërë gjithnjë e më e vështirë në kohën kur tregjet e energjisë tkurren, kërkesat globale zgjerohen dhe rrethanat gjeopolitike janë gjithmonë e më komplekse. Për të zbutur rreziqet e ndryshme me qëllim ruajtjen e cilësisë së jetës, përpjekjet duhet të vazhdojnë të zvogëlojnë kërkesa për energji dhe shërbime energjetike në përgjithësi, dhe në zonat urbane në vecanti” (EEA, 2009). Studimet tregojnë se qytetet e ditëve të sotme kryesisht priren drejt flukseve lineare të materialeve dhe energjisë që i përshkon ato. Metafora e organizimit përfaqëson konfigurimin aktual të metabolizmit të qytetit, i cili është në shumicën e rasteve linear (Musango, 2017).

Dy janë format më të përhapura të metabolizmit urban: linear, i cili karakterizohet nga flukse hyrëse dhe dalje përmes një procesi të njëanshëm shndërrues, dhe metabolizmi cirkular, ku proceset shndërruese të flukseve bëjnë që output-i të shndërrohet sërish në input, duke reduktuar në këtë mënyrë konsumin e burimeve të lëndëve të para. Kjo e fundit përbën sjelljen e synuar të funksionimit të sistemeve. **Metabolizmi linear**, është problematik dhe kundërshtohet me anë të përqsjes ciklike që thekson përdorimin eficient të materialeve dhe të energjisë. Një ekosistem natyror sillet ndryshe nga bota e krijuar nga njeriu. Dallimi kryesor qëndron në faktin se natyra në thelb ka një metabolizëm rrethor të mbetjeve zero, ku çdo prodhim nga një organizëm është gjithashtu një input që rimbush dhe mban të gjithë mjedisin jetësor. Në të kundërt, metabolizmi i shumë qyteteve moderne është në thelb linear, me burime që rrjedhin përmes sistemit urban pa u shqetësuar për origjinën e tyre apo destinacionin e mbetjeve. Hyrjet dhe daljet konsiderohen kryesisht të palidhura. **Metabolizmi cirkular** përkufizohet si ‘metabolizmi ku çdo output mund të përdoret si input për një proces tjetër’ (Roggema, R. & Alshboul, A., 2014, p. 738). Në këtë mënyrë qëndrueshmëria afatgjatë e qyteteve mund të arrihet vetëm duke u zhvendosur nga modeli linear i metabolizmit në modelin cirkular të tij, në të cilin outputet riciklohen sërish në sistem për t’u shndërruar në inpute, duke pasur një përfitim të dyfishtë në kosto dhe në mjedis. Një shembull i tillë është zbatuar në Hammarby Sjostad (një qytezë brenda Stokohomit në Suedi), i ndërtuar si një qytet i cili nuk prodhon mbetje (Roggema, R. & Alshboul, A., 2014, p. 738). Në mënyrë që qytetet të bëhen më të qëndrueshme, ata duhet të ndryshojnë nga një metabolizëm linear në rrethor, duke krijuar një marrëdhënie të vetë-rregullueshme e të qëndrueshme me biosferën. Sfidat e sotme është krijimi i qyteteve të qëndrueshme, vërtetë të rigjenerueshme. “Një qytet i qëndrueshëm [...] është një qytet

ku arrijtjet në zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe fizik bëhen për të zgjatur. Një qytet i qëndrueshëm ka një furnizim që zgjat të burimeve natyrore nga të cilat varet zhvillimi i tij (duke i përdorur ato vetëm në nivelin e rendimentit të qëndrueshëm). Në këtë drejtim theksi drejtohet tek krijimi i **‘Ekonomive cirkulare** të cilat theksojnë marrëdhënien e fshehtë midis industrisë, mbetjeve dhe urbanizmit. Ato kërkojnë strategji të shumëanshme, duke përfshirë devijimin e mbeturinave, ndarjen, riciklimin, kompostimin dhe ripërdorimin, etj. të cilat janë alternativa efektive e të qëndrueshme të sistemeve konvencionale të administrimit të mbetjeve, të cilat më parë mbështeteshin në format e konsoliduara të deponimit’ (Roggema, R. & Alshboul, A., 2014, p. 739). Në fakt koncepti i ekonomisë cirkulare sipas Kirchherr et al. (2017) është një koncept i ri në modelin e biznesit, qëllimi kryesor i të cilit është prosperiteti ekonomik i ndjekur nga mbrojtja mjedisore. Ata nënvizuan që ekonomia cirkulare është shumë e lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm dhe përkufizohet si kombinimi i procedurave të kombinuara të reduktimit, ri-përdorimit dhe aktiviteteve të ri-ciklimit, pa iu referuar urgjencës së një ndërrimi sistemik të qeverisjes aktuale politike, kulturore dhe ekonomike. Kështu në njëfarë mënyre, në rrethin e studiuesve është pranuar kalimi nga ekonomia lineare në atë cirkulare, gjë e cila është pasqyruar dhe te metabolizmi urban dhe përqendrimi i sotëm i mjeteve dhe metodologjive te metabolizmi cirkular.




Figura 2-4: Metabolizmi linear dhe metabolizmi circular i qyteteve (Faraud, 2017)

Sipas këtij modeli, ‘qytetet’ studiohen si produkte të rrjeteve të dendura të ndërveprimit të proceseve socio-ekologjike që janë njëkohësisht dhe procese njerëzore, fizike, diskursive, kulturore, materiale, dhe organike (Heynen, N., Kaika, M. & Swyngedouw, E., 2006, p. 20). Sot, sipas Tisha & Pincetl (2012) ‘metabolizmi urban është një koncept shumë-disiplinor dhe një platformë e integruar që ekzaminon flukset e materialeve dhe të energjisë në qytete si sisteme komplekse dhe të cilat ndikohen nga forca të ndryshme sociale, ekonomike dhe mjedisore. Ashtu si organizmat biologjike dhe ekosistemet, edhe qytetet ciklojnë dhe transformojnë lëndët e para, ushqimin, ujin dhe lëndët djegëse në struktura fizike, biomasë dhe mbetje. Faktorë të tillë si struktura urbane, forma, klima, cilësia dhe vjetërsia e ndërtesave, vegjetacioni urban dhe teknologjia e transportit mund të ndikojnë shkallën e metabolizmit të një qyteti. Ndërkohë që rriten kërkesat për inpute më të larta për materiale dhe energji për të mbështetur rritjen e qyteteve, kuptueshmëria e metabolizmit të qyteteve bëhet shumë e rëndësishme për politikëbërësit dhe vendimmarrësit. Për këtë qëllim janë zhvilluar disa metoda kryesore për matjen e Metabolizmit Urban në praktikë të cilat po i përshkruajmë shkurtimisht, më poshtë.

2.2.1 Metoda e Emergjisë

Ezhvilluar nga ekologjia e sistemeve, e cila thekson varësinë nga burimi i pothuajse të gjithë energjisë në planet: dielli (Kennedy, C., Pincetl, S. & Bunje, P., 2010). Odum besonte se kërkimi dhe zhvillimi i mëparshëm mbi metabolizmin urban mungonte dhe

nuk merrte parasysh ndryshimet cilësore të fluksit të masës apo të energjisë. Studimi i Odum e mori parasysh këtë dhe ai shpiku termin "emergji" për të gjurmuar dhe llogaritur flukset metabolike duke matur energjinë diellore të përdorur direkt ose indirekt për të bërë një produkt ose për të ofruar një shërbim. Kjo metodë gjithashtu thekson përdorimin e një njësie standarde të matjes për të llogaritur energjinë, lëndët ushqyese dhe lëvizjen e mbeturinave në sistemin biofizik; njësia e zgjedhur ishte "xhaulët e energjisë diellore". Në pamje të parë, nocioni për të përdorur njësitë standarde duket si një ide e dobishme për llogaritjen dhe krahasimin e shifrave; në të vërtetë aftësia për të shndërruar të gjitha proceset urbane në xhaul të energjisë diellore është provuar të jetë një arritje e vështirë dhe e vështirë për tu kuptuar (Pincetl, S., Bunjeb, P. Holmes, T., 2012). 'Përgjithësisht, studimet mbi metabolizmin urban u kufizuan në nxjerrjen e totalit të inputeve dhe outputeve të një sistemi urban. Por, në ditët tona studimet metabolike shkojnë përtej kësaj përqsaje që e shikonte qytetin si një sistem të mbyllur, dhe sot përfshihen edhe flukset e resurseve brenda qyteteve, që nga burimi deri tek derdhja.

2.2.2 Analiza e Fluksit të Materialeve (MFA)

Është metoda më e njohur e përdorur për këtë. Një analizë e tillë siguron të dhëna si nga ana cilësore ashtu dhe sasiore për mënyrën e rrjedhjes së flukseve, mënyrat sesi ato konvertohen dhe se ku ato vendosen. Gjithashtu MFA mundëson aksesin sistematik ndaj inputeve dhe outputeve të burimeve të përzgjedhura të një sistemi të paracaktuar si dhe flukset dhe rezervat brenda kufijve të atij sistemi' (Voskamp, Ilse.& Stremke, 2014, p. 2). Nga rasti i aplikimit të Wolman, theksohet se 'prezantimi i parë i konceptit të metabolizmit (të qyteteve) përshkroi problemet kryesore metabolike të furnizimit me ujë të pijshëm, shpërndarjes së ujërave të zeza si dhe ndotjes së ajrit [...] Kryesisht ky model metabolizmi i përshkruante qytetet si një ekosistem me inpute të energjisë dhe materialeve dhe menaxhimin e outputeve gjithnjë në rritje.

Modeli i metabolizmit urban, integronte infrastruktura inxhinierike të ndërthurura, njerëzit dhe sistemet natyrore janë të rëndësishme për të kuptuar dhe për të nxitur qëndrueshmërinë e qyteteve' (Roggema, R. & Alshboul, A., 2014). Ata japin përkufizimin për metabolizmin urban si përmbledhja e proceseve teknike dhe socio-ekonomike që ndodhin brenda qyteteve, që rezultojnë me rritjen e tyre, prodhimin e energjisë dhe zhdukjen e mbeturinave. Postulatet mbi balancën e materies apo konservimin e masës, janë formuluar që në Greqinë e Lashtë për tu përfshirë më vonë në shkencat moderne të kimisë e ku më pas gjeti rrugën për në kiminë industriale dhe në shkencat e ambientit. Kjo metodë përparoi kryesisht në vitet 1980-1990, ku sipas Baccinni dhe Brunner MFA "mati flukset e materialeve që rrjedhin në një sistem, rezervat dhe flukset brenda tij, dhe rezultatet e outputeve nga sistemi në sisteme të tjera në formën e ndotjes, mbeturinave ose eksporteve." Sipas OESC 2008 'është studimi i rrjedhave fizike të burimeve natyrore dhe materiale në, përmes dhe jashtë një sistemi të caktuar (zakonisht ekonomia). Bazohet në llogaritë e organizuara në mënyrë metodike në njësitë fizike dhe përdor parimin e balancimit në masë * për të analizuar marrëdhëniet midis rrjedhave materiale (përfshirë energjinë), aktivitetet njerëzore (përfshirë zhvillimet ekonomike dhe tregtare) dhe ndryshimet mjedisore. 'Metoda e MFA është bërë shkolla kryesore referuese e metabolizmit urban sepse përdor më shumë njësi praktike që publiku, punëtorët, zyrtarët qeveritarë dhe studiuesit mund t'i kuptojnë. Japonia është zhvilluar në një pikë të nxehtë për hulumtimet e MFA. Vendi ka burime të pakta minerale dhe prandaj varet nga importi i transportuesve të energjisë, arit dhe lëndëve të para të tjera. Qeveria japoneze nxit kërkimin mbi ciklet materiale dhe përuroi gjithashtu konceptin 3-R. (Japan, 2020) Edhe nga vëzhgimi i studimeve të

165 rasteve të aplikimit të metabolizmit urban nga (Musango, 2017) vërehet një numër në rritje i kësaj qasjeje që nga viti 2000. Ajo që është vënë re është se: qasja metabolike tipikisht realizohen në nivel kombëtar dhe rajonal, ku të dhëna për flukset, janë më të disponueshme.




Figura 2-5: Numri i studimeve të metabolizmit ndër vite, tregon rritjen e diversitetit të përjasjes ku metoda përlogaritëse MFA është dominuese (Musango, 2017)

Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore gjithashtu bën pjesë në modulet e Llogarive Ekonomike në Mjedis. Qëllimi i tyre është integrimi i informacionit mjedisor në një mënyrë koherente me sistemin qendror të Llogarive Kombëtare. Këto kanë për objekt kryesor të përshkruaj lidhjen midis ekonomisë vendase dhe mjedisit natyror. Ajo përfshin sasinë totale të burimeve natyrore dhe produkteve të përdorura në ekonomi, në mënyrë direkte në prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve, ose indirekt përmes nxjerrjes së materialeve të cilat do të përdoren për prodhim. (INSTAT, Metodologjia, të dhënat Ekonomike Mjedisore, 2020) Indikatorë të flukseve të Materialeve sipas llogarive kombëtare për Flukset e Materialeve po i përshkruajmë më poshtë referuar (OECD, Measuring material flows and resource productivity, Synthesis report, 2008, p. 10):

- Lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore (Domestic extraction used DEU) DEU mat rrjedhat e materialeve që vijnë nga mjedisi dhe që hyjnë fizikisht në sistemin ekonomik për përpunim të mëtejshëm ose konsum të drejtpërdrejtë (ato "përdoren" nga ekonomia).

- Inputet direkte të materialeve (Direct Input Material DMI) DMI përfaqëson furnizimin e materialeve. Mat hyrjen e drejtpërdrejtë të materialeve për përdorim në ekonomi, d.m.th. të gjitha materialet që kanë vlerë ekonomike dhe përdoren në aktivitetet e prodhimit dhe konsumit.

- Kërkesa totale për material, Total Material Requirement(TMR) TMR përfshin, përveç TMI, flukset materiale (indirekte) që lidhen me importet por që ndodhin në vendet e tjera. Ajo mat "bazën materiale" totale të një ekonomie. Shtimi i flukseve indirekte i shndërron importet në "ekuivalentin e tyre kryesor të nxjerrjes së burimeve".

- Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore (Domestic Material Consumption DMC)

DMC përfaqëson përdorimin e materialeve. DMC mat sasinë totale të materialit të përdorur drejtpërdrejt në një ekonomi (d.m.th. konsumi i drejtpërdrejtë i dukshëm i materialeve, duke përjashtuar flukset indirekte). DMC përcaktohet në të njëjtën mënyrë si indikatorët e tjerë kryesorë fizikë siç është konsumi bruto i energjisë në brendësi.

- Konsumi total i materialit (TMC)

TMC mat përdorimin total të materialit të shoqëruar me prodhimin vendas dhe aktivitetet e konsumit, përfshirë flukset indirekte të importuara (shih TMR) por pa eksporte dhe flukset indirekte shoqëruese të eksporteve.

- Bilanci i Tregtisë Fizike (PTB)

PTB pasqyron tepricën fizike të tregtisë ose deficitin e një ekonomie. Ajo përcaktohet si importe minus eksportet (duke përjashtuar ose përfshirë flukset e tyre të fshehura).

- Prodhimi i brendshëm total (TDO)

TDO përfaqëson barrën mjedisore të përdorimit të materialeve, **d.m.th. sasinë totale** të materialit në mjedis të shkaktuar nga aktiviteti ekonomik.

- Sipas një sondazhi midis vendeve anëtare të (OECD, 2008, p. 50), llogaritë e flukseve të materialeve dhe informacioni që ato ofrojnë përdoren zakonisht për:

- lidhjen e informacionit mjedisor dhe ekonomik midis vendeve anëtare
- mbështetjen e aktiviteteve të modelimit dhe parashikimit
- informimi i vendimmarrjes dhe si bazë për analizën e politikave (6 shtete)
- informimi i publikut dhe politikëbërësve për çështjet kryesore dhe trendet (12 vende).
- monitorimin e efikasitetit të përdorimit të materialeve (19 vende) dhe qëndrueshmërinë e tij (14 vende) në nivele të ndryshme, shpesh me një lidhje me menaxhimin e mbetjeve ose me aspekte të tjera të tilla si: efektet e globalizimit dhe tregtisë; ndikimet mjedisore të rrjedhave materiale, ndikimi ekonomik i rrjedhave materiale; dhe siguria e furnizimit me materiale.

2.2.3 Vlerësimi i ciklit jetësor (LCA)

Vlerësimi i ciklit jetësor (LCA) ofron një analizë "nga djepi në varr" i rrjedhave të materiale të ngulitura brenda produkteve dhe shërbimeve për të identifikuar ndikimin e tyre më të gjerë (Ferrao, P. & Nhambiu, J., 2009). Kjo metodë vlerëson të gjitha fazat e 'ciklit jetësor' të një produkti apo shërbimi, nga nxjerrja e lëndëve të para, përmes krijimit të produkteve dhe shërbimeve, deri në asgjësimin e tyre në mjedis (Musango, J.K., Currie, P. & Robinson, B., 2017). Në këtë mënyrë, vlerësimi i ciklit jetësor njeh që industrinë varen, drejtpërdrejt ose indirekt, nga njëra-tjetra dhe është kryesisht i përshtatshëm për vlerësimin e flukseve indirekte të shoqëruara me lëndë të parë dhe produkte me një nivel të ulët përpunimi. Në këtë drejtim, kryerja e vlerësimit të ciklit jetësor mund të kërkojë shumë burime dhe kohë, pasi kërkohen të dhëna të konsiderueshme të hyrjes së materialit në secilën fazë të prodhimit për të llogaritur flukset indirekte për produktet gjysëm të prodhuara dhe të gatshme. Çdo ndikim mjedisor i demonstruar nga vlerësimi i ciklit jetësor paraqitet si një masë relative midis produkteve dhe shërbimeve (Pincetl, 2012). Kjo do të thotë që vlerësimi i qëndrueshmërisë së një sistemi urban është i kufizuar pa studime të kohërave të tjera ose sistemeve me të cilat mund të krahasohen. Përkundër vështirësive të tilla, vlerësimi i ciklit jetësor është një mjet i paçmuar kur krahason ndikimet mjedisore të produkteve dhe proceseve të ndryshme, për shembull për të zgjedhur midis opsioneve të ndryshme të ndërhyrjes në teknologji. Studjues sugjerojnë se është metoda më e dobishme për marrjen e vendimeve politike, megjithatë vetëm katër përqind e studimeve të tyre të rishikuara përdorin vlerësimin e ciklit jetësor.

2.2.4 Gjurma Ekologjike

Analiza e gjurmës ekologjike është një metodë për llogaritëse për vlerësimin e konsumit të burimeve dhe kërkesave për asimilimin e mbetjeve të një popullsie njerëzore ose ekonomie të përcaktuar në drejtim të përdorimit përkatës të tokës prodhuese. Metoda mat ndikimet e mundshme dhe shkallën e pasigurisë së ndikimit si edhe mundësitë e

rrezikut për sistemet e qëndrueshme të energjisë. Analiza e fluksit të materialit është një mjet i llogaritjes së materialeve që mund të përdoret për të gjurmuar lëvizjen e elementeve shqetësuese përgjatë një kufiri të specifikuar të sistemit (Dincer, I. & Bicer, Y., 2019). Analiza e gjurmëve ekologjike u zhvillua si një tregues i një ekonomie të qëndrueshme njerëzore, në çdo shkallë, bazuar në aftësinë bartëse të tokës. Sipas kësaj metode, konsumi i burimeve të një popullsie shndërrohet në një tregues të vetëm, baraz me sipërfaqen e tokës që nevojitet për të mbajtur atë popullsi për një kohë të pacaktuar. Popullsi të paqëndrueshme konsiderohen të jenë ato me një gjurmë ekologjike që tejkalon tokën aktuale në dispozicion të tyre. Analiza e gjurmëve ekologjike në këtë mënyrë kombinon kërkesat e zhvillimit socio-ekonomik me kapacitetin mbajtës të ekosistemit në një kornizë të thjeshtë që informon studiuesit dhe praktikuesit nëse një metabolizëm i dhënë është tepër konsumues apo funksionon brenda mundësive të tij. Indikator i gjurmës ekologjike kryesisht është përdorur si një tregues për të rritur ndërgjegjjen e shoqërisë në konsumin e resurseve, dhe për shkak të kritikave të mbi thjeshtëzimit për të llogaritur qëndrueshmërinë e një popullsie, vetëm 10% e studimeve kanë preferuar ta përdorin. (sipas analizës së studimeve nga Beloin-Saint-Pierre et al (2016)) Metoda të tjera si Analizat IOA (Input Output Analysis) kryesisht për të vlerësuar sektorë të caktuar, metoda Hibride apo të Simulimit që ka në thelb një qasje më të integruar midis sistemeve urbane që ndërveprojnë dhe aktorëve pjesëmarrës, kanë rezultuar akoma më pak të praktikueshme, për arsye si : të dhëna për të kufizuar sistemin burojnë nga vlerësime objektive dhe jo të dhëna empirike, vështirësia në mpleksjen e qasjes metabolike të faktorëve ekologjikë dhe socialë të varur kryesisht nga sjellja njerëzore, etj.

2.3 Përafrimi në Sisteme

Metodat e prezantuara më sipër tregojnë për një drejtim multidisiplinor të studiuesve në përpjekjet për të modeluar sisteme të qëndrueshme urbane-sociale-natyrore. Një tranzicion i qëndrueshëm urban është bërë i vështirë për shkak të natyrës komplekse të qyteteve: ndryshoret që karakterizojnë janë të shumta dhe ndërlidhjet midis tyre janë të vështira për t'u zbërthyer. Analiza e shkaqeve dhe efekteve mund të keqkuptohen duke sjellë pasojë në politikëbërjen dhe planifikimin e zhvillimit urban. Metabolizmi urban është një sistem kompleks që del nga proceset e brendshme të sistemeve socio-ekonomike dhe socio-ekologjike. Prandaj, analizimi i metabolizmit kërkon një kuptim të të gjithë sistemit. Për ta kuptuar më mirë këtë qasje i referohemi kuptimeve të ndryshme që na ofrojnë në disiplinat e ekologjisë urbane, ekologjisë industriale, ekonomisë ekologjike, ekologjisë politike dhe ekologjisë politike urbane. Metabolizmi përvetëson nga ekologjia urbane qasjen në sisteme e cila ishte e lidhur me ndikimin dhe popullaritetin që fitoi teoria e sistemeve në gjysmën e dytë të shekullit XX. Teoria e sistemeve përfshin një varg qasjesh që i kanë rrënjët e tyre tek teoria e përgjithshme e sistemeve e zhvilluar fillimisht nga biologu Von Bertalanffy në vitet 1930, e cila synonte të nxirrte një seri parimesh të përgjithshme të zbatueshme për të gjitha sistemet (Bertalanffy L. , 1972, p. 12). Teoria e sistemeve është studimi ndërdisiplinor i sistemeve, ku një sistem konsiderohet një bashkim koheziv i pjesëve të ndërlidhura dhe të ndërvarura që mund të jenë të natyrshme ose të bëra nga njeriu. Çdo sistem kufizohet nga hapësira dhe koha, i ndikuar nga mjedisi që e rrethon, i përcaktuar nga struktura dhe qëllimi, dhe shprehet përmes funksioneve të tij. Në këtë mënyrë një sistem është i ndryshëm nga shuma e pjesëve të tij.

Idea e vetë qytetit si sistem ka qenë një metaforë qendrore për menaxhimin urban në gjysmën e dytë të shekullit XX (Marcotullio P. J. & Boyle G. eds., 2003). (Castan

Broto, V., Allen, A., Rapoport, E., 2012) dhe (Rapoport, 2011) shprehin se, ekologjia urbane e sheh qytetin si një ekosistem në sensin biologjik, njëkohësisht si 'sistem' dhe entitet 'natyror'. "Në përdorimin më të zakonshëm, sistemi kuptohet si një kompleks i së tërës, një sërë pjesësh të ndërlidhura, një trup i organizuar sendesh materiale ose jo materiale dhe si një grup objektësh të lidhura ose të ndërlidhura, si një formë e së tërës" (McLoughlin, 1969, p. 75). Vizionet bashkëkohore të qyteteve, të kornizuara nga koncepti i qëndrueshmërisë, zbulojnë qasje disi të njëanshme, që lidhen vetëm me aspekte të veçanta të qëndrueshmërisë, siç janë emetimet e ulëta të karbonit, ripërtëritja, forma urbane, për të përmendur vetëm disa. Përkundrazi, metoda e metabolizmit urban duket se siguron një vizion më holistik dhe të integruar, duke përfshirë përbërës të ndryshëm si energjia, përdorimi i tokës, uji, materialet dhe të tjerët dhe promovimin e një perspektive sasiore bazuar në analizën e stotopeve dhe flukseve. Futja e një dimensionit ekologjik në këtë arsyetim sigurisht që do të siguronte një kuptim më të plotë të sistemeve tona urbane.

Në të ardhmen nevojiten kërkime shtesë për disa fusha të zhvillimit territorial si: ekonomia cirkulare, metabolizmi urban, kapaciteti bartës dhe (in)efikasiteti mjedisor i qyteteve të mëdha.

Metabolizmi urban ka frymëzuar mënyra të reja të të menduarit për **qëndrueshmërinë urbane**. Që nga themelimi i planifikimit urban modern, në fund të shekullit XIX, planifikuesit kanë zbuluar një shqetësim të thellë mbi funksionimin eficient të qyteteve, por ngurtësia e zbatimit të masterplaneve dhe dobësitë në rezultatet statike të krijuara prej implementimit të tyre sollën nevojën për të parë planifikimin gjithmonë e më tepër si një sistem në ndryshim. Sipas Karakiewicz (2011), mesi i viteve 1950 – 1960 ishte koha kur, planifikimi i qyteteve filloi të ndryshonte dhe të shihej jo më si një pjesë e rëndësishme e artit, por si një shkencë. Kjo ndodhi në një kohë kur përjasja shkencore filloi të fitonte terren në shumë fusha, të cilat filluan të marrin vendimet e tyre duke u bazuar në fakte dhe prova shkencore (Karakiewicz, 2011, p. 1). Qytetet janë rezultat i një procesi të vazhdueshëm të zhvillimit urban me shumë aktorë dhe kufizime të ndryshme, që kërkojnë strategji të ndryshme për të arritur qëndrueshmëri. Konteksti ka rëndësi. Kjo është arsyeja që është shumë e vështirë të materializohet një model optimal që të përshkruajë dhe të 'zgjidhë' qytetin. Përjasja e planifikimit në bazë sistemesh, konsiderohet në këtë mënyrë një aplikim universal. Nga ana tjetër, planifikimi shihet si një tërësi procedurash të përgjithshme që nuk janë vetëm 'racionale', por të ndërlidhura me kushte specifike ekonomike, sociale dhe historike. Prandaj, planifikimi mund të konsiderohet njëkohësisht një sistem kontrolli ose rregullimi për të korrigjuar çrregullimet e qyteteve dhe rajoneve kudo në çdo kohë dhe gjithashtu është për të mirën e përgjithshme, në "nxitjen e rritjes njerëzore" (Faludi, 1973). Planifikuesit gjenden kështu në një dilemë në të cilën ata duhet të lëkundin midis optimizmit utopik për sa i përket teorisë së sistemit dhe pesimizmit të zymtë të fakteve të jetës urbane. Është pikërisht natyra shumë abstrakte dhe e zbrazët e paradigmes së sistemeve e cila ka penguar mundësitë reale të kuptimit më të thellë të urbanizimit dhe planifikimit. Mjaft studime janë kryer për të përcaktuar rolin e përgjithshëm ideologjik të paradigmes së sistemeve (p.sh. Scott dhe Roweis, 1977; Kirk, 1980; Dear dhe Scott, 1981;) ku shqyrtohet rasti i përgjithshëm në lidhje me vendndodhjen e urbanizimit, planifikimin dhe rolin e shtetit brenda dinamikës së përgjithshme të kapitalizmit të vonë. (p.sh. Scott and Roweis, 1977; Kirk, 1980; Dear and Scott, 1981).

Tabela e mëposhtme tregon ndryshimet thelbësore në kuptimin e botës midis teorisë së sistemeve dhe pikpamjes klasike, duke dëshmuar një evolucion të rëndësishëm në këtë drejtim. Për këtë arsye, përafrimi sipas **teorisë së sistemeve** duhet nxitur për urbanistët dhe projektuesit e qyteteve, pasi në mungesë të saj, përcaktimet urbane në qytete

politizohen dhe njëkohësisht politizohen dhe projektuesit, dhe përzgjedhjet e tyre nuk cilësohen si përzgjedhje shkencore në ndihmë të qytetit por të interesave të ndryshme që konfliktojnë në një qytet të caktuar. *Ashtu siç shkruante Loughlin (1985) (McLoughlin, 1969) teoria e sistemeve është e paanshme ndaj konfliktit të interesave.* Ky pretendim, sipas tij, ka tre rezultate kryesore: së pari, planifikuesit po veprojnë në ndihmë të interesit të përgjithshëm, së dyti, mistifikon punën e planifikuesve për shkak të distancës që vendoset midis planifikimit dhe jetës së përditshme dhe së treti, bën pjesë në shndërrimin shkencor të politikës, dhe atëherë kur duhet që të merren vendime politike (për shpërndarjen dhe konsumimin e të mirave midis zonave të ndryshme) ato përfaqësohen si vendime teknike. Por të gjitha arsyet e sipërmendura sipas Loughlin nuk mohojnë pushtetin politik që mund të kenë planifikuesit, dhe ky pushtet duhet përpunuar dhe teorizuar më tej nga studiuesit (Mc Loughlin, 1985, p. 14). Hartimi i një kornize ligjore për zbatimin e metabolizmit urban, brenda kuadrit të planifikimit, mund të sigurojë një mjet të rëndësishëm për analizimin e qyteteve sipas qasjes sistematike. Kështu mund të analizojmë në mënyra të ndryshme flukset e rëndësishme të energjisë, në shkallë të ndryshme, të cilat çojnë drejt zhvillimit të sistemeve menaxhuese të qyteteve dhe rrisin efikasitetin e përdorimit të burimeve, riciklimit të mbetjeve dhe ruajtjes së energjisë (Holmes, T. & Pincetl, S., 2012, p. 2). Mënyra se si konceptohet sistemi i qytetit sjell implikime të drejtpërdrejta mbi rekomandimet e politikave të planifikimit, që prodhohen nga këto vlerësime dhe metabolizmi mund të na japë përgjigjet e disa pyetjeve si psh.: Si mund të mendojmë përtej gjurmëve ose kufijve? Si mund t'i ndryshojmë nocionet tona të kapaciteteve bartëse? A mund të lëvizim përtej nocionit të kompaktësisë hapësinore dhe kontrollit përmes planifikimit? Cilat janë modelet e reja urbane që mund të eksplorojmë përmes strukturave të shpërndara, dendësive difuze, formateve fluide apo morfologjive fleksibël?

Në këtë mënyrë, shtrirja e metaforës së metabolizmit urban në shumë fusha nënkupton linja të reja kërkimi që nuk mund të adresohen plotësisht me metodat tradicionale. Vetëm kështu, urbanizimi mund të zërthehet përmes një optike ekologjike, e cila shpalos një karakter të urbanizimit më të ndërlikuar, më fluid dhe me shumë nuanca, duke na ofruar një strategji të re për t'iu përgjigjur sot proceseve mbizotëruese të migrimit të popullsisë, ndryshimeve klimatike dhe ekonomive me bazë resurset natyrore.

Pikëpamje Atomistike Klasika Mekanistike	Pikëpamje Sistemike Vizion Holistik
Këndvështrimi për botën	
Natyra konceptohet si një makineri gjigande e përbërë nga pjesë të ndërlikuara por të zëvendësueshme.	Natyra si një organizëm e pajisur me elementë të pazëvendësueshëm dhe një qëllim të lindur por jo vendimtar për zgjedhje, për flukse, për spontanitet.
Pikëvështrim individualist, i sheh objektet e ndarë nga njëri tjetri dhe nga rrethinat.	Percepton lidhje dhe komunikim midis njerëzve, midis njerëzve dhe natyrës dhe thekson komunitetin dhe integritetin në të dyja botët natyrore dhe njerëzore.
Kënvështrim materialist, që sheh cdo gjë të ndarë, të matshme dhe si entitete materie.	Jep një kuptim të ri nocionit të materies, si një konfigurim energjish që rrjedh dhe ndërvepron në procese propabilitike, për vete kreativitet si edhe për paparashikueshmëri.
Në aplikimet për çështje të përditshme lartëson akumulimin e të mirave materiale dhe promovon një uri për fuqi dhe etosin e garo-përfitore.	Thekson rëndësinë e informacionit dhe për pasojë edukimit, komunikimit dhe shërbimit njerëzor përkundrejt akumulimit

	të të mirave dhe përvetësimit të energjisë së papërpunuar.
Kënvështrimi klasik i botës e sheh rritjen në sferën materiale si majën e progresit social-ekonomik dhe promovon përdorim gjithmon e më të madh (dhe pashmangshmërisht mbetje) të energjisë, materialeve të para dhe burimeve të tjera natyrore.	Kënvështrimi në sisteme duke parë së pari të tërën të formuar nga pjesë sociale dhe ekonomike, ngulmon në zhvillimin e qëndrueshëm përmes fleksibilitetit dhe përshtatjes midis pjesëve kooperuese dhe interaktive.
Këndvështrimi klasik është Eurocentrik, që konsideron shoqëritë e industrializuara perëndimore si paradigma të progresit dhe të zhvillimit.	Këndvështrimi holistik bazohet në diversitetin e kulturave njerëzore dhe shoqërore dhe i sheh ato njësoj të vlefshme, duke i renditur vetëm në bazë të qëndrueshmërisë dhe satisfaksionit që sigurojnë për anëtarët e tyre.
Antropocentrike, percepton qenien njerëzore si padronët e kontrollit të natyrës për qëllimet e tyre.	Sheh njerëzit si pjesë organike brenda një së tërë që vetëevoluon dhe vetë-mbahet që është konteksti dhe parakushti për jetën në këtë planet.
Kur këndvështrimi klasik aplikohet në shkencat sociale nocioni dominues është lufta për mbijetesë, përfitimet individuale në rastin më të mirë supozimin e rastësisë automatike të së mirës individuale dhe shoqërore (përmes “dorës së padukshme” të Adam Smith)	Kur këndvështrimi i sistemeve fejmëzon teoritë e shkencave sociale, vlerat e konkurrencës mitigohe nga ato të kooperimit dhe ethosi i punës individuale temperohet me tolerancën e diversitetit dhe eksperimentimit përmes institucioneve dhe praktiva që nxisin adaptimin dhe harmoninë midis njeriut - me -njeriun dhe njeriun - me-natyren.
Kur këndvështrimi klasik aplikohet në shkencat mjeksore, trupi i njeriut shfaqet si makineri në nevojë të vazhdueshme për riparime dhe ndërhyrje faktike dhe inpersonale. Problemet e mendjes shihen të ndara nga trupi për rrjedhojë të trajtohen të ndara.	Kur këndvështrimi i sistemeve është baza për diagnozë, trupi shihet si sistem i pjesëve ndërvepruese dhe trupi dhe mendja nuk janë të ndarë. Shëndeti i të gjithë sistemit duhet mbajtur me vëmendje të vecantë sa ndaj faktorëve psikikë dhe ndërpersonale aq edhe faktorëve fizikë dhe psikologjikë.

Tabela 2.3-1 Krahësim midis këndvështrimeve mbi Botën nga pikëpamja klasike dhe asaj të Sistemeve. Përpunim i Autorit sipas (Laszlo, 1996)

2.4 Rastet e zbatimit të metabolizmit urban në Europë

Deri më tani, nuk ka një metodë të unifikuar që mundëson qasjen ndaj planifikimit të territorit sipas konceptit të metabolizmit urban. Ashtu siç u përshkrua edhe më sipër , ekzistojnë një sërë metodash për matjen e qëndrueshmërisë së sistemeve urbane dhe natyrore si dhe lidhjen organike midis tyre. Ato variojnë sipas territorit të kufijve të sistemit në studimit, karakteristikave të sistemit dhe qëllimit të studimit. Më poshtë do të paraqesim disa raste studimore të cilat përmbledhin dhe ilustrojnë aplikimin në praktikë të metabolizmit urban për rastet: Paris, Roterdam, dhe raportin kërkimor në nivel europian ‘Metabolizmi i Qëndrueshëm Urban i Europës’.

Metabolizmi i Rajonit të Parisit, analizohet në ‘*Urban Metabolism of Paris and Its Region*’ (Barles, 2009) dhe shqyrton realizueshmërinë e MFA-së në shkallë rajonale dhe urbane në Francë. Studimi bazohet në metodën e Eurostat për realizimin e MFA dhe konkludon se është një metodë e vlefshme nëse zhvillohet në nivel rajoni, si ai i rastit

të Parisit dhe zonës përreth tij. Një analizë e flukseve të materialeve në të gjithë ekonominë e Parisit, në disa nivele, tregoi konsum më të lartë të ushqimit dhe mallrave në qendër të qytetit dhe konsum më të lartë të lëndëve djegëse fosile dhe materialeve të ndërtimit në zonat periferike të përhapura përreth qytetit. Rekomandimet përfshijnë krijimin e politikave të reja publike që lidhen me menaxhimin e mbetjeve për të zvogëluar importet e materialeve të ndërtimit dhe forcimin e lidhjeve midis politikave urbane dhe bujqësore për të ripërdorur mbetjet lokale dhe për të rritur prodhimin vendas të ushqimit. Gjithashtu Barles konkludon se 'Për të marrë rezultate të konsiderueshme, do të ishte e rëndësishme të lidhej MFA me kushtet socioekologjike që ndikojnë flukset materiale dhe evolucionin e tyre. Kjo lloj analize do të çonte në një kuptim më të mirë të sistemeve të tilla'. Përmbledhjet e studimit janë strukturuar sipas hkalës territoriale në studim, metodës së aplikuar, flukseve të studjuara, faktorëve ndikues në profilin metabolik dhe rezultatet e rekomandimit.

Territori: Niveli Rajonal, 1. Parisi, 2. Parisi dhe zona Suburbane dhe 3. Rajoni i Ile de Paris. "Qasja në shumë shkallë zbulon se metabolizmi urban ndikohet fort nga dendësia dhe shpërndarja e aktiviteteve: qendra e dendur e qytetit (Paris) eksporton të gjitha mbeturinat e saj në pjesët e tjera të rajonit dhe përqendron konsumin e ushqimit, ndërsa zona bujqësore dhe zona e shpërhapjes urbane konsumon nivele të larta të materialeve të ndërtimit dhe karburantit" (Barles, 2009).

Metoda: Analiza e Flukseve Materiale (MFA) sipas Eurostat 2001 e cila bazohet në parimin e ruajtjes së masës. Kjo metodë është zhvilluar kryesisht për nivelin kombëtar të të dhënave dhe krahasimin mes tyre. Ndryshimi midis aplikimit në nivel kombëtar nga ai rajonal qëndron se në nivelin rajonal mbetjet konsiderohen si eksporte pasi impiantet e trajtimit të ujërave, inceneratorët apo landfillet shpesh ndërtohen përtej kufirit administrativ të qytetit. Në nivelin kombëtar ndërkohë, maten katër tipe fluksesh kryesore: flukset në natyrë, eksportet, flukset indirekte që lidhen me eksportet dhe nxjerrja e materialeve shtëpiake (domestic extraction) të papërdorur, duke supozuar indirekt se rrjedhat drejt natyrës janë të brendshme. Metoda e EUROSTAT mundëson disa indikatorë globalë të rëndësishëm në kontekstin e politikave të qëndrueshmërisë. Kufijtë e sistemit u përputhën me kufijtë administrativë duke ndjekur kështu parimin territorial dhe jo atë të vendbanimeve.

Flukset: Përdorimi i tokës si përqindje e territorit të rajonit për : Ujë, Pyll, Bujqësia, Parqe dhe sheshe, Strehimi, Aktivitetet ekonomike (sekondare dhe terciare), Objektet publike, Transporti, Të tjera.

Faktorët ndikues në flukset metabolike: shkalla territoriale e analizës, parametrat urbane (dendësia kundrejt shtrirjes) dhe një larmi aktivitete (rezidenciale, terciare, industriale dhe bujqësore)

Rezultatet: Studimi mbështet përdorimin e MFA në shkallë urbane dhe rajonale si bazë për menaxhimin e flukseve të burimeve të materialeve dhe strategjitë e dematerializimit. Studimi zbulon qartë ndërveprimet e rëndësishme midis planifikimit dhe zhvillimit urban dhe rajonal, dhe flukseve materiale. MFA i jep peshë funksioneve urbane duke reflektuar faktin që zonat urbane importojnë pjesën më të madhe të asaj që konsumojnë dhe "krijojnë" flukse të mëdha të fshehura.

Studimi u krye në tre nivele dhe rezultatet nxjerrin në pah qartë vlerën e përdorimit të një qasjeje të tillë me shumë shkallë. Të dhënat treguan se Parisi varet nga një zonë e gjerë përreth për sigurimin e inputeve të tij nga periferitë dhe rajoni në tërësi për trajtimin e mbeturinave. Këto rezultate demonstrojnë pasojat materiale si të përqendrimit të aktiviteteve në qendër të qytetit - konsumi i ushqimit - dhe shtrirjes urbane në rajon - konsumi i lartë i materialeve të ndërtimit dhe karburantit. Vlen të përmendet edhe lidhja e vendosur midis rrjedhave të materialeve të ndërtimit dhe

çështjeve të planifikimit. Barles zbulon nevojën për politika të reja publike, veçanërisht në lidhje me administrimin e mbeturinave - për të zvogëluar importet e materialeve të ndërtimit - dhe planifikimin urban - për të zvogëluar konsumin e tyre. Përveç kësaj, bëhet thirrje për më shumë kërkime dhe hartim të planeve të veprimit për të lidhur politikat urbane me ato bujqësore, për të përmirësuar përdorimin e plehrave urbane dhe për të favorizuar furnizimin me ushqim lokal. Politikat e tilla do të kishin nevojë për një analizë të thelluar ndër-disiplinore të qeverisjes së flukseve materiale. Gjithashtu, për të marrë rezultate të rëndësishme, do të ishte me vlerë krahasimi i të dhënave në hapësirë dhe kohë dhe lidhja e MFA me kushtet e veçanta socio-ekologjike që ndikojnë në rrjedhat materiale dhe evolucionin e tyre. Kjo lloj analize do të sillte dhe një kuptueshmëri më të mirë të sistemeve të tilla.




Figura 2-6: Parisi (2.2 milion banorë), Parisi dhe rrethinat e tij (6.3 milion banorë), dhe rajoni më i madh i Parisit (11.3 milion banorë) Përshtati në shqip, autori.




Figura 2-7 Skema e thjeshtuar e përgjithshme e bilancit të materialit (përfshirë ajrin dhe ujin) (OECD, 2011) si dhe skema e bilancit material të gjerë ekonomik (duke përjashtuar rrjedhat e ajrit dhe ujit) (OECD, 2011) Përshtati në shqip, autori.

“Sustainable Urban Metabolism for Europe” SUME ‘Metabolizmi i Qëndrueshëm Urban për Evropën’, është projekti më i gjerë krahasues i zhvilluar në nivel evropian financiar nga Komuniteti Europian, duke rezultuar në një seri raportesh, me fokus kryesor optimizimi i burimeve në strukturën urbane ‘hulimtimin në mënyrën se si sistemet e ardhshme urbane mund të projektohen për të qenë vazhdimisht më pak të dëmshme për mjedisin dhe veçanërisht për ndryshimet klimatike’ (Schremmer, C., Mollay, U., Neugebauer, W., Novak, S., Beiglböck, S., Bory, B., Panwinkler, T., Schmitt, P., Dubois, A., Galera-Lindblom, P, October 2009). Në këtë studim, koncepti

i metabolizmit urban analizohet përmes studimit të flukseve të burimeve të materialeve dhe energjisë që përdoren për të operuar dhe mbështetur një sistem të caktuar urban në tërësinë e tij. Projekti investigon mënyrën se si sistemet urbane të së ardhmes mund të projektohen për të qenë më pak dëmtes ndaj ambjentit dhe më pak ndikues ndaj ndryshimeve klimatike. Përafrimi metabolik, trajtohet në këtë kërkim nën një debat gjithpërfshirës mes temave të qytetit, efikasitetit ndaj energjisë dhe emetimit të ulët të karbonit duke analizuar **impaktin e formës urbane** në përdorimin e resurseve natyrore. “Si një qasje gjithpërfshirëse, projekti SUME bazohet në tre shtresa të formës urbane, në për të integruar njohuritë ekzistuese në një kërkim holistik mbi ndikimin e formës urbane në metabolizmin urban.” (Schremmer, C., Mollay, U., Neugebauer, W., Novak, S., Beiglböck, S., Bory, B., Panwinkler, T., Schmitt, P., Dubois, A., Galera-Lindblom, P., October 2009) . Këto janë:

(1) Konfigurimi urban, për të përshkruar formën e përgjithshme dhe zgjerimin e një qyteti

(2) Paterni i diversitetit urban, për të përshkruar funksionet më të rëndësishme brenda qytetit dhe ndërlidhjet hapësinore midis pjesëve të ndryshme të një qyteti, veçanërisht transporti

(3) Stoku i ndërtesave urbane, për të përshkruar cilësitë hapësinore dhe cilësitë teknike të stokut të ndërtesave, veçanërisht të lidhura me konsumin e tokës dhe energjisë.

Të tre këto shtresa përdoren në studim për të përkufizuar formën urbane dhe zbërthehen në komponentët e tyre për të kuptuar më mirë ndikimin e tyre në metabolizmin e qytetit sipas tre dimensioneve të tij: konsumi i Tokës, konsumi i Energjisë dhe konsumi i Materialeve.

Qëllimi i studimit është të propozojë qytete të ndërtuara në një mënyrë që mundësojnë të jetuarit në harmoni me sistemet e tyre natyrore, duke siguruar një vazhdimësi ekologjike. Nga ana tjetër, duhet të sigurohet aftësia për të mbyllur ciklet ekzistuese të hapura metabolike, duke përmirësuar kapacitetin e një sistemi urban për t'u bërë i vetë-mjaftueshëm. Qasja bazohet në idenë se një qyteti nuk duhet të jetë një vrimë e zezë brenda një ekosistemi të caktuar, por përkundrazi, të jetë pjesë e ekosistemit të përgjithshëm, duke funksionuar në mënyrë simbiotike me të (Pinho, P., Santos, S., Oliveira, V., Barbosa, M., Silva, M., 2010). Meqenëse, modelet metabolike përdorin të dhëna të përgjithshme input-outputi, për një numër resursesh të caktuara, si lëndët djegëse, materiale ndërtimi, minerale etj. dhe burimet e të dhënave për këto qëllime janë mjaft të kufizuara në termat hapësinorë, kryesisht sepse sigurohen nga njësitë administrative ose statistikore në nivele mjaft të mëdha (NUTS I ose NUTS II në rastin më të mirë), në SUME, përdoret një qasje nga poshtë lart duke përdorur të dhëna të hollësishme statistikore nga sistemi i ndërtuar në nivelet lokale. Në këtë studim, koncepti i metabolizmit urban zbatohet mbi organizimin e hapësirës, duke demonstruar për herë të parë ndikimin e formës urbane në flukset e burimeve duke analizuar shpërndarjen hapësinore të popullsisë, vendeve të punës, sistemin e transportit dhe teknologjinë e ndërtimit urban.

Territori: Sipas ndarjes administrative dhe tipareve morfologjike urbane të qyteteve në studim.

Flukset: Toka, Energjia, Materialet.

Faktorët ndikues në flukset metabolike: Forma urbane sipas shkallëve të Konfigurimit Urban, Diversitetit Urban dhe Stokut të ndërtesave .

Rezultatet: *Tipologjia e formës urbane ndikon në metabolizmin e territorit*

Studimi identifikon disa modele me performancë më të mirë metabolike. Lidhur me “Konfigurimin Urban, modeli "formë kompakte me dendësi të lartë" duket të jetë më i qëndrueshmi. Si trend, dendësia e ulët dhe format e fragmentuara janë më pak efikase

sesa dendësia e lartë dhe format kompakte. Sidoqoftë, këto të fundit nuk janë modele optimale, pasi u mungon një farë integrimi i strukturave ekologjike brenda zonës urbane dhe performojnë dobët në lidhje me indikatorin e Mjaftueshmërisë. Për Diversitetin Urban, "modeli i fshatit urban" është më efikas. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se një model i tillë mund të jetë i vështirë për t'u arritur në praktikë. Edhe modelet monocentrike, edhe ato policentrike nuk janë optimale. Sidoqoftë, modelet policentrike ofrojnë një situatë të preferueshme, sepse ato janë më afër përmbushjes së atributit të Mjaftueshmërisë.

Lidhur me Stokun e Ndërtesave Urbane, "ndërtesat multifamiljare" pavarësisht se kontribuojnë në dendësi më të lartë, një tipar përgjithësisht i cituar mirë në këtë matricë, nuk paraqesin një performancë kaq të mirë. Kjo për shkak të faktit se "ndërtesat shumëfamiljare" nuk lënë shumë mundësi për Mjaftueshmëri dhe atributin Eko-integrimit (megjithëse vlerësohen më mirë për sa i përket Efijencës). Tipologjitë "njëfamiljare" dhe "gjysmë të shkëputura" paraqesin disa tipare interesante në nivele të ndryshme."

Atributet kryesore për një qytet metabolikisht të qëndrueshëm sugjerohen: Kompaktësia, Plotësia, Përdorimi i përzier i tokës, Konservimi, Koordinimi, Konforti, Bashkëpunimi, Transporti i qëndrueshëm, Dendësia, Diversiteti, Përfitimi pasiv diellor dhe Gjelbërimi dhe maten përmes indikatorëve të mëposhtëm.

Efijenca - përcaktohet nga aftësia e ndërtimit të strukturave urbane efikase dhe që kursejnë burimet e materialeve. Bëhet fjalë për mundësimin e përdorimit të burimeve që zgjasin, duke shmangur harxhimin dhe mundësojnë rigjenerimin e sistemeve. Në zonat urbane, mënyrat më të dukshme dhe të drejtpërdrejta për të përmirësuar menaxhimin e burimeve janë duke vepruar në nivelin e stokut të ndërtesave dhe sistemet e transportit.

Mjaftueshmëria - është përcaktuar nga Osmond (2008) si "aftësia e agjentëve në sistem për të zvogëluar me vetëdije outputet metabolike, në përputhje me mirëqenien dhe barazinë". Megjithatë në këtë kontekst mjaftueshmëria ka një kuptim tjetër. Meqenëse zonat urbane janë sisteme të hapura, mjaftueshmëria urbane duhet të orientohet drejt burimeve. Me fjalë të tjera, popullsia e një zone përcaktohet nga sasia e burimeve të disponueshme dhe që mund të sigurohen nga mjetet e prodhimit vendas. Popullsia stabilizohet deri në arritjen e aftësisë bartëse të sistemit.





Ripërtëritja/Elasticiteti (Resilience) - Osmond (2008) e përkufizon qëndrueshmërinë si "Aftësia e një sistemi urban për t'u përshtatur me ndryshimin e kushteve të jashtme ose të brendshme ndërsa ruajtja e attributeve thelbësore strukturore dhe funksionale".




Konfigurimi

Eko-Integrimi - konsiston në përfshirjen strukturave ekologjikisht të ekuilibruara në kontekstin urban dhe konsiderohet aftësia e integrimit dhe riprodhimit të ekosistemeve natyrore në qytete.

Jetueshmëria - është karakteristika e të qenit i shëndetshëm nga ana mjedisore dhe shoqërore, duke siguruar mirëqenien dhe cilësinë e jetës së banorëve. "*Kur mendojmë për jetueshmërinë, ne mendojmë për cilësinë e jetës dhe një vend me kushte të këndshme si për banorët ashtu edhe për vizitorët. Si e tillë, jetueshmëria e zonave urbane ka të bëjë me përmirësimin e cilësisë së tyre të përgjithshme në mënyrë që të lehtësojë dhe sigurojë kushte të mira jetese. Duke u përqëndruar në lidhjen midis shoqërisë dhe mjedisit, jetueshmëria lidhet me konceptin e metabolizmit shoqëror. Arritja e qyteteve të jetueshme nënkupton kuptimin dhe zbutjen e origjinës midis presioneve mjedisore të shkaktuara nga aktivitetet njerëzore"* (Pinho, P., Santos, S., Oliveira, V., Barbosa, M., Silva, M., Galera Lindblom, P., Weber, R., Reardon, M., Schmitt, P., 2011, p. 69).

Tabela 2.4-1: Analiza metabolike e modeleve urbane (Burimi: SUME, WP 3.3 (2011) f.72-74)

Shtresat	Modeli	Pikat e Forta	Dobësitë	Mundësitë	Sfidat	Atributet				
						resilience	Eco-integration	sufficiency	efficiency	liveability
Konfigurimi urban (LIC)		-përdorimi efikas i tokës përmes boshteve përcuese; - mundësia e ekzistencës së prodhimit të ushqimit dhe zonave ekologjike të	- joefikasiteti i mundshëm i infrastrukturave; - rritje e ngarkesës urbane përreth sisteme mjedisore; - forma e	- dendësimi i gishtave; - ruajtja e strukturave ekologjike	- dendësimi i vazhdueshëm i përgjatë akseve radiale të struktura ekzistuese të përqendrosur në ngarkesa	√	√	-	√	√
	Dendesi e lartë formë fragmentuar									
	Rekomandime	- dendësimi midis gishtave; - ruajtja e strukturave ekologjike - dendësimi i vazhdueshëm përgjatë akseve radiale të strukturave ekzistuese të përqendrosur në ngarkesat negative; - distancat e rritura mund të zvogëlojnë banorët cilësia e jetës - dendësimi midis gishtave duhet të bëhet përveç zonave të gjelbërta (korridoret e gjelbërta); - zgjerimi i infrastrukturës së bashku me zhvillimin e ri; - potencimi i lidhjes midis infrastrukturës ekzistuese								
		-përdorimi efikas i tokës; -mjetet e efektshme të udhëtimit (jo motorizuara dhe publike); -përdorimi efikas i infrastrukturës	- përqendrim më i lartë i mbeturinat dhe ndotësve; - varësia relativisht (e burimeve) e zonave në brendësi të territorit.	Zhvillimi i vazhdueshëm i formë kompakte të duke marrë parasysh ekuilibrin sistemit urban	Dendësimet e vazhdueshme ekzistuese tentojnë për të përqendruar ngarkesën negative; - mos ekzistenca e zonave të		√	√	-	-
	Dendesi e lartë formë fragmentuar									
	Rekomandime	- kontrolli i dendësimit ekstrem; - krijimi e zonave të gjelbërta për të ekuilibruar të gjithë sistemin;								
	- kontrolli i dendësimit ekstrem; - krijimin e zonave të gjelbërta për të ekuilibruar të gjithë sistemin;	- përdorimi joefikas i tokës; - rritje e ngarkesës urbane në mjedisore përreth; - rritje e kërkesës për energji për qëllime transporti;	- përfitoni nga indet ekzistuese urbane për të zhvilluar qytetin	- sistem paekuilibruar e shkaktuar nga mungesa e artikullimit midis pjesëve	√	√	√	√	√	
Dendesi i ulët formë fragmentuar										
Rekomandime	- krijimi i infrastrukturës për një sistem koherent; - dendësimi duhet të bëhet përveç zonave të gjelbërta (korridoret e gjelbërta)									
	- mundësia e sigurimit më të mirë të infrastruktura në mënyrë të vazhdueshme; - ekzistenca e një baze për zhvillim më të dendur urban dhe për krijimin e përdorimeve të larmishme të tokës	- përdorimi joefikas i tokës; - rritje e ngarkesës urbane në mjedisore përreth; - rritja e energjisë kërkesa për transporte; - probabilitet më i ulët i ekzistencës së prodhimit të ushqimit dhe zonave ekologjike të lidhura shkurtimisht distances from urban centres;	- dendësimi, duke përfituar nga ekzistuesja indet dhe infrastruktura urbane	- trendi për zgjerimin urban dhe tokën konsumi do të amplifikojë dobësitë ekzistuese		√	√	√	√	
Dendesi e ulët, formë fragmentuar										
Rekomandime	- densifikim i diversitetit të përdorimit të tokës; - promovimi i zhvillimeve mbushese (infill)									

Paterni i Diversitetit Urban (UDP)		- probabilitet i lartë i larmia e përdorimeve të tokës urbane pranë qendrës; - përdorimi i transporteve publike me efikas në afërsi të qendra	- udhëtimet në rritje distancat nga qendra; - humbja e efikasitetit të infrastrukturës nga qendra; - prodhimi i ushqimit dhe shërbime të tjera ekologjike ka më shumë të ngjarë të jenë në periferi	- fuqizoj zhvillimi i nën-qendrave të reja të mjaftueshme	- zhvillimi vazhdueshëm rreth qendrës çon në modele të paqëndrueshme udhëtimesh; - zhvillimi vazhdueshëm rreth qendrës çon në	✓	-	✓	✓	✓
	monocentrike	Rekomandime - zbatimi i përdorimeve të përziera të tokës; - potencializimi zhvillimin e nën-qendrave të reja të vetëmjaftueshme								
		- probabiliteti i ekzistencës së ushqimit zonat e lidhura me prodhimin dhe ekologjinë në distanca të shkurtra nga qendrat urbane	- mungesa e infrastrukturës që lidh secilën nën-qendër; - për shkak të shpërndarjes jo të barabartë të funksioneve në secilën nën-qendër, qendra kryesore funksionon si një pol tërheqës, duke rritur numrin e udhëtimeve dhe kërkesës për energji	- fuqizojnë dhe zhvillojnë nën-qendra të tjera ekzistuese, duke rritur mjaftueshmërinë; - ruajtja e strukturave ekologjike	- rritje e pabalancuar e vazhdueshme nga mbizotërimi i qendrës kryesore	✓	-	-	✓	✓
policentrike	Rekomandime - potencimi dhe zhvillimi i nën-qendrave të tjera ekzistuese, duke rritur mjaftueshmërinë; - zbatimi i përdorimeve të përziera të tokës në secilën nën-qendër;									
Fshat urban		- ekzistenca e nën-qendrave mjaftueshme sigurojnë distanca të shkurtra udhëtimi dhe inkurajojnë mjete transporti pa motor, si dhe krijimin e transportit publik efektiv brenda secilës nën-qendër; - probabiliteti i ekzistencës së prodhimit të ushqimit dhe zonave ekologjike të lidhura në distanca të shkurtra nga qendrat urbane; - konsumi i mirë-menaxhuar i	- mungesa e infrastrukturës për të lidhur secilën nën-qendër	- zhvillimi vazhdueshëm i modelit të fshatit urban	- nëse një nga nën-qendrat bëhet dominuese, atëherë modelin tenton të jetë më ngjashëm me modelin policentrik; - nëse verifikohet nevojja e udhëtimeve nga një nën-qendër në tjetrën të dyja distancat e udhëtimeve dhe kërkesa për energji për qëllime transporti rritet ndjeshëm; - krijimi i	-	-	-	-	
	Fshat urban	Rekomandime - potencializimi i autonomisë së secilës qendër (larmia e funksioneve); - të përfitojnë nga hapësirat ndërmjet nën-qendrave për korridoret ekologjike dhe prodhimin e ushqimit;								
Stoku i ndërtesave (UBS)		- probabiliteti më i lartë i ekzistencës së sipërfaqeve të pavulosa në parcelat urbane; - përfitime më të mëdha diellore për shkak të ekspozimit më të lartë të diellit (në rastin e vendeve me numër të lartë të orëve të dritës); - probabilitet i lartë i vetë-prodhimit të	- më pak diversitet përdorimit të tokës; - dendësi të ulët efikasiteti i ulët përdorimit të tokës; - distanca më të larta për të udhëtuar (për hyrë në urbane shërbime ose vende pune); - nivele më të larta të konsumit të energjisë në transport dhe efikasitet më të ulët të energjisë në ndërtesa	- promovojnë vetë-mjaftueshmërinë rritjen e cilësisë së jetës, me uljen e niveleve të ndotjes sipërfaqeve të gjelbra, duke lejuar më shumë ruajtje natyrore	- tendencë e vazhdueshme për një ind urban joefikas, duke inkurajuar dendësinë e ulët;	n.a.	-	-	✓	✓
	njefamiljare	Rekomandime - përcaktimi i akteve të zhvillimit të orientuar drejt tranzitit me dendësim përgjatë tyre akteve; - rritjen e diversitetit të përdorimeve të tokës; - mirëmbajtja e zonave të lidhura me prodhimin e ushqimit; - investimi në materiale izoluese në mënyrë që të kompensohen humbjet e nxehtësisë së ndërtesave;								

		- probability of existence of unsealed surfaces	- land use efficiency is still relatively low; - still significant distances to travel	- potentiate the transition of this urban tissue to						
	Te bashakangjitura									
	Rekomandime	- përcaktimi i akteve të zhvillimit të orientuar drejt tranzitit me dendësim përgjatë atyre akteve; - rritjen e diversitetit të përdorimeve të tokës; - mirëmbajtja e zonave të lidhura me prodhimin e ushqimit; - investimi në materiale izoluese në mënyrë që të kompensohen humbjet e nxehtësisë së ndërtesave								
	shumefamiljare	- përdorime të përziera të tokës; - efikasitet i lartë i përdorimit të tokës; - efikasitet i lartë i transportit; - efikasitet i lartë i ndërtesave; - efikasitet i lartë i infrastrukturës	- probabilitet i ulët i ekzistencës së sipërfaqeve të pambyllura; - probabilitet i ulët i vetë-prodhimit të ushqimit; - fitime më të ulëta diellore (në rastin e vendeve me numër të lartë të orëve të ditës)	- potencojnë dendësimin tepërt; - më pak promovimin e transportit publik ekologjike						
	Rekomandime	- përcaktimi i sipërfaqeve maksimale të zonave të mbyllura; - stimuj për krijimin e fermave urbane; - stimuj për asimilimin lokal të mbeturinave; - krijimin e hapësirave publike me cilësi të gjelbër dhe ciklizmin; - zbatimi i paneleve diellore për të ndihmuar në zbutjen e kërkesës së përqendruar të energjisë;								

Më lart paraqitet lidhja midis karakteristikave të formës urbane dhe profilit metabolik të tyre. Analiza e tabelës zbulon se mjaftueshmëria është një nga atributet që dallon vlerësimin e shumicës së modeleve urbane. Jetueshmëria, nga ana e saj, është një atribut i këshillueshëm që duhet të zbatohet më shpesh. Në përgjithësi, format me dendësi të lartë dhe modelet policentrike prirën të jenë më të qëndrueshme. Sidoqoftë, këto struktura urbane kanë gjithashtu disa aspekte negative si për shembull, modelet me dendësi të lartë mund të çojnë në një degradim të cilësisë së mjedisit dhe intensifikimin e ndikimeve në zonat e mbrojtura. Nga ana tjetër, modelet policentrike mund të jenë më të qëndrueshme nëse secila nën-qendër është minimalisht e pavarur dhe e vetë-mjaftueshme. Nëse jo, ndikimet në mjedis prirën të përkeqësohen. Është e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm se ende nuk ka diçka të tillë si një model optimal i qëndrueshëm metabolikisht.

Metabolizmi i Rotterdambit sjellë nga International Architecture Biennale, kryesisht përqendrohet në konceptin e metabolizmit urban nga perspektiva e dizajnit si një mjet për të eksploruar forma të reja të zhvillimit të qëndrueshëm urban.

Flukset urbane të studiuara: janë gjithsej nëntë, mallrat, njerëzit, mbetjet, biota (jeta e bimëve dhe kafshëve), energjia, ushqimi, uji, ajri, rëra dhe argjilë për qytetin e Rotterdambit. Fluksi i informacionit dhe i të dhënave gjithashtu adresohen shkurtimisht.

Territori: Këto flukse janë analizuar kryesisht për qytetin e Rotterdambit dhe hapësirën e tij më të gjerë rajonale. “Mendimi metabolik kërkon kalimin midis shkallëve të ndryshme, midis strategjisë dhe modelit hapësinor, flukseve të ndërmjetme dhe infrastrukturës shoqëruese.”

Rezultate dhe propozime: Në vend të optimizimeve të vlerësuara jokohërente për reduktimin e mbetjeve, studimi propozon një ide për të zhvilluar një perspektivë të re, të integruar ku ‘ekonomia, ekologjia dhe diversifikimi hapësinor bashkohen me qytetin, natyrën dhe peizazhin’ (IABR, FABRIC, JCFO,TNO, 2014, p. 130). Ndërkohë propozohet se "afërsia gjeografike e flukseve materiale dhe flukseve të tjera të përdoret dhe të bëhet një përpjekje e ndërjegjeshme për të arritur sinergji midis flukseve të ndryshme duke i lidhur ato me njëra-tjetrën në nivelin lokal ose duke bërë më shumë shkëmbime ndërmjet flukseve” (IABR, FABRIC, JCFO,TNO, 2014, p. 78) Këto flukse ndikohen më tepër përmes zgjidhjeve teknike sesa nga ndryshimi i sjelljes së aktorëve individualë përmes llojeve të ndryshme të qeverisjes urbane. Kështu, shumë ndërhyrje

të propozuara në raport duket se janë të rrënjësura në traditën e përllogaritjeve të flukseve të materialit MFA siç sugjerohet edhe në fushën e ekologjisë industriale.

Ky studim paraqet interes për t'u analizuar pasi përbën referencën kryesore në hartimin e Metabolism of Albania(2013), ku sic do të shohim më tej, disa nga aktorët e grupit të punës janë të njëjtë si psh. IABR dhe FABRIC, pjesë e projektit të zgjeruar nga Atelier Rotterdam në Atelier Albania.

Së pari, studimi vë theksin se shkollat e zhvilluara deri më tani të metabolizmit urban përqëndrohen kryesisht në aspektin mjedisor dhe në aspektin sociologjik, duke lënë jashtë vëmendjes aspektin e zhvillimit hapësinor. Së dyti, raporti thekson nevojën për këtë përfaqje të re si të domosdoshme nëse duam të zgjidhim sfidën për ndërtimin e komuniteteve urbane të qëndrueshme përballë fenomenit të urbanizimit dhe eksternaliteteve që e shoqërojnë atë. Së treti, duke pranuar idenë e një epoke të re Antropogjene të njeriut, Sijmons D. sugjeron për këtë studim se “nuk është më e dobishme të ndajmë njeriun nga natyra, përderisa qyteti dhe natyra mbivendosen në hapësirë dhe ndërveprojnë funksionalisht (...) Cilat janë qasjet e reja që do të zgjidhin problemet nëse do të konsiderojmë rrjetin e marrëdhënieve mes të dyve (njeriut dhe natyrës) si një të tërë, dhe jo si të kundërta ku njerëzit apo sendet marrin më tepër vlerë se njëra apo tjetra” (IABR, FABRIC, JCFO,TNO, 2014, p. 15). Një vështrim nga afër i flukseve të analizuar na tregon zgjidhjen për problemet e evidentuara të qytetit të Roterdamit, orjentim drejt një ekonomie cirkulare. Kështu psh. analiza e fluksit të i mallrave për qytetin na tregon se edhe pse Roterdami është një nga qytetet porte më të mëdha në botë, me transitin e 220milion ton mallra në vit, punësimi në të është vetëm 17% më shumë se Antwerpi që përpunon gjysmën e volumit të transportit. Gjithashtu, studimi tregon, se pavarësisht nga volumi i mallrave që përshkon qytetin, ato nuk sjellin një vlerë të shtuar në ekonominë lokale apo në cilësinë e jetës urbane të Roterdamit, përkundrazi, qyteti dhe rrugët e tij po kthehen gjithmonë e më të pajetuara për shkak edhe të trendeve të tjera si “online shopping” apo prodhimi i materialeve në vende të largëta. Studimi investigon mundësi se si një pjesë e vogël e këtij volumi të madh mallrash mund të përdoret për të rritur zinxhirin e vlerës ekonomike të vetë qytetit. Fluksi i njerëzve analizohet në përputhje me mundësinë e aksesit në transport dhe në infrastrukturën sociale-arsimore që ofron qyteti. Zonimi i qytetit ndan pjesën e shërbimeve dhe tregëtisë të vendosur në veri të qytetit nga pjesa e jugore ku janë vendosur pjesa më e madhe e zonave të banimit, me pyetjen se si mund të përmirësohet aksesimi i jugut të Roterdamit në zonat e punës dhe të edukimit. Fluksi i ushqimit analizohet në lidhje me konsumin e fosfateve dhe pritshmërinë për mbarimin e rezervave të tij në 50 viteve të ardhshme duke e vendosur sektorin e prodhimit ushqimor në krizë. Fluksi i energjisë, në lidhje me emetimet e CO2 ne 29 megaton, dhe me qëllimin për të arritur objektivat e Kyotos cilrimi i nxehtësisë në atmosferë në shumë rajone si në Kopenhagen dhe Malmo është ndaluar. (IABR, FABRIC, JCFO,TNO, 2014, p. 46) Fluksi i mbetjeve analizohet në përputhje me ripërdorimin e tyre, duke nxjerrë në pah faktin se një pjesë e madhe e mbetjeve të gjeneruara përmban material të parë, qyteti mund të konsiderohet si një “minierë” e re për nxjerrjen e lëndëve të para. Këtu duhet patur parasysh se 1 ton telefona celulare nxjerrin 140 kg bakër, 3.14kg argjend, 300gm ar, 130g palladium dhe 3g platinium.nKështu një hollandez gjeneron mesatarisht në vit 530 kile nga të cilat 49-75 janë mbetje ushqimore të ripërdorura në sistemin ngrohës të lagjjes, 3.4 kg materiale elektronike. Në përfundim propozon katër strategji që marrin pikënisjen nga analiza e flukseve dhe adresojnë sfidat e qytetit:

- 1- Mbledhja e materialeve dhe përfitimi i lëndëve të para nga mbetjet dhe ushqimi. Psh ngritja e infrastrukturave bregdetare e kombinuar me teknikat e aquafarming do të mundësonte jo vetëm prodhimin e energjisë nga uji i përdorur në bujqësi por

edhe mbledhjen e mineraleve që pasurojnë tokën duke mos lejuar shpëlarjen dhe humbjen e tyre në det, si edhe ekstraktimi i fosfatit nga impiantet e trajtimit të ujërave. Apo përmes teknologjive të reja prodhimi i materialeve nga me bazë ushqimore si psh plastika me bazë bimore, etj.

- 2- Krijimi i Biotopeve, Përmirësimi i i natyrës urbane përmes përdorimit lokal të ujit, rërës dhe argjilës.
- 3- Përdorimi i i nënprodukteve të prodhimit të energjisë. Si psh përdorimi i nxehtësisë të prodhuar për përfitimin e energjisë, për ngrohje shtëpiake, apo mbledhja e CO2 dhe përdorimi i tij për hortikulturën.
- 4- Katalizimi i Ri-industrializimit, rritja e cilësisë së flukseve të ushqimit, mallrave dhe njerëzve. Kështu, projekti sugjeron riindustrializimin e disa bulevardeve të Roterdamit me qëllim për të sjellë punën tek njerëzit dhe jo njerëzit tek puna. Gjithashtu, shfrytëzohen infrastruktura e transportit për të lidhur mallrat që transporton me hapjen e laboratorëve të kërkimit psh., përgjatë tyre që investigojnë mbi ripërdorimin e mallrave apo të prodhimit të bioprodukteve.




Figura 2-8: Hartëzim i flukseve të Rotterdarmit. Burimi: Urban metabolism, sustainable development of Rotterdam (2014)




Figura 2-9: Vizualizimi i katër strategjive si për shembull ri-industrializimi i bulevardëve përmes korridoreve të infrastrukturës, infrastruktura e mbetjeve organike etj. Burimi: Urban metabolism, sustainable development of Rotterdam(2014)

3 KAPITULLI III_PLANIFIKIMI HAPËSINOR NË SHQIPËRI

Urbanistika formale e rrënjosur në ‘fizikalizëm’ është një perspektivë që supozon se problemet sociale mund të zgjidhen duke manipuluar mjedisin e ndërtuar fizik. Kjo ideologji filloi të fragmentohej rreth mesit të shekullit XX me rritjen e pikëpyetjeve mbi efektivitetin e saj në gjenerimin e një jete urbane cilësore dhe mjedisi urban më të drejtë. Megjithatë, tani, ka shenja që me problemet bashkëkohore të ndryshimit të klimës, energjisë dhe qëndrueshmërisë, ky këndvështrim po rikonfirmohet. Studiues si Batty dhe Marshall argumentojnë se edhe pse rrënjët e kësaj perspektive u zhvilluan për herë të parë më shumë se përpara 100 vjetësh, kryesisht nga Patrick Geddes, stili i tij unik e zgjeroi fushën e kuptimit drejt një fizizmi evolucionar, i cili vetëm tani po bëhet i dukshëm. Sipas (Michael Batty, Stephen Marshall, 2009), ekziston një konsensus që pranon se po lindin bazat për një lloj të ri shkence që na mundëson të kuptojmë me të vërtetë se si gjenerohen rezultatet fizike nga proceset shoqërore. Kjo është një shkencë që lidh funksionet dhe flukset me morfologjinë përmes metaforave biomorfike. “Kjo është shkencë e evolucionit, dhe një nga etërit themelues të planifikimit të qytetit, Patrick Geddes, ishte i pranishëm në fillimet e saj. Kjo shkencë e re po drejtohet nga shqetësimi për problemet fizike që lidhen me mënyrën e funksionimit të qyteteve për sa i përket energjisë së tyre (Batty, 2005). Pavarësisht se shumë populllore, analogjitë organike shpesh kanë mbetur në kufirin metaforik dhe frymëzues ideologjik, por të pashfrytëzuara në kalim nga teorik në praktikat tona të planifikimit dhe zhvillimit të qytetit, për pasojë rezultatet e tyre nuk janë hulumtuar plotësisht. Përdorimi i krahasimeve të formave organike me qytetin kanë qenë aq të zakonshme një shekull më parë sa edhe përdorimi në ditët e sotme të termit ‘zhvillim i qëndrueshëm’, i cili i atribuohet çdo aspekti të planifikimit.

Në Shqipëri, sfondi i historik që na tregon për kapërcimet nga konceptet e urbanistikës tradicionale të shek të XIX në shkencën komplekse të planifikimit hapësinor të shek XXI, është karakterizohet nga ndikime politike të qeverisjes dhe artikulohet përmes gjuhës së kuadrit ligjor më tepër sesa përmes debatit akademik apo aplikimit praktik. Ky kapitull analizon kalimin nga urbanistika në planifikim hapësinor në Shqipëri dhe ndikimin e qasjes metabolike ndaj planifikimit të territorit pikërisht përmes ndryshimeve të kuadrit ligjor dhe instrumentave të planifikimit në vend. Në prill të vitit 2009 miratohet “Ligji Për Planifikimin e Territorit” (L.10119, Për Planifikimin e Territorit, 2009, p. shfuq.), i cili solli një rikonceptim jo vetëm të sjelljes ndaj problematikave të territorit, por të metodave të reja të planifikimit. Kalimi nga Urbanistika tradicionale në Planifikim, synoi të zgjeronte kufijtë e mundësive për të menaxhuar territorin përmes instrumentave të reja. Këtu prezantohen për herë të parë, në kuadrin e rregullimit të territorit konceptet e “zhvillimit të qëndrueshëm”, “transparenca në planifikim”, “planifikimi me pjesmarrje” “politika territoriale”, “planifikimi i integruar” etj. Të gjitha koncepte të cilat qartësisht kërkonin të zgjeronin platformën e njohurive për zgjidhjen e problematikave territoriale, të cilat tashmë nuk lidheshin vetëm me çështjen e ndërtimit dhe shpërndarjen e objekteve në territor, por me konceptin e zhvillimit në tërë kompleksitetin e tij. Në 2014, Ligji pëson një përshtatje të re me miratimin e Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (L.107/2014, Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, p. ndrysh.), i cili gjithashtu prezanton një koncept të ri si “Metabolizmi i Territorit”, përkufizuar në Rregulloren e Planifikimit si “modeli që përdoret për identifikimin dhe analizën e flukseve të materialeve dhe të energjisë brenda territoreve të caktuara” (VKM 686 Për

Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit, pika 17, 2017), si edhe “Analizës Metabolike” të flukseve kryesore me rëndësi për territorin apo sektorin që studiohet sipas nivelit dhe llojit të planit. Në këtë drejtim, Shqipëria bëhet vendi i parë në rajon që vendos qasjen metabolike si një detyrim ligjor në procesin e hartimit të planeve territoriale. Ndërsa me Miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar konceptet e ‘zhvillimit inteligjent’, ‘kohezion territorial’, ‘zhvillim gjithpërfshirës’ etj. reflektojnë ndikimin e gjerë nga politikat e zhvillimit territorial në nivel evropian. Pesëvjeçari i fundit, dëshmon për një rrugëtim të vështirë të ngritjes së këtij momenti ndërrimi ligjesh, në një reformë të mirëfilltë të planifikimit hapësinor.

3.1 Ndikimi i dimensionit evropian

Territori dhe mirëqeverisja e tij janë një dimension i ri i Politikave të Kohezionit edhe në nivelin evropian. Megjithëse planifikimi hapësinor nuk bie brenda fushës së autoritetit të BE-së, ka pasur lëvizje të tilla si formulimi i Perspektivës Evropiane të Zhvillimit Hapësinor (ESDP) përmes bashkëpunimit jozyrtar në nivel qeveritar. Zhvillimi hapësinor u vu në krye të politikave të kohezionit të BE-së me përfshirjen e këtij koncepti në Traktatin e Lisbonës në 2009. Nga kjo kohë, BE po përpiqet të promovojë autoritetin e saj për të koordinuar politika të ndryshme hapësinore, si dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis palëve përgjegjëse për përdorimin e tokës dhe planifikimin e zhvillimit. Konceptet si Kohezion Territorial dhe Planifikim hapësinor, kanë marrë një peshë më domethënëse në debatin politik dhe profesional dhe janë zhvilluar kryesisht në sajë të presionit për një zhvillim koheziv e të qendrueshëm të vendeve evropiane kryesisht pas procesit të bashkimit. Të gjitha këto koncepte janë fatkeqësisht shumë eluzive, se pari për shkak të shumëdimensionalitetit që merr koncepti i territorit në varësi të fushës ku studiohet, dhe së dyti edhe për shkak të kulturës diverse që karakterizon vendet anëtare të Bashkimit Evropian në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Kështu, edhe pse qeverisja territoriale si nocion nuk është përcaktuar në mënyrë specifike, as në literaturën e përgjithshme dhe as në kornizën legjislativë të politikës së kohezionit (Böhme, K., Zillmer, S., Toptsidou, M. & Holstein, F., 2015), dhe termi duket se rrjedh nga diskuri mbi politikat hapësinore të BE-së, në fakt ka qenë Organizata për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik (OECD) ajo që ka promovuar së pari konceptin e qeverisjes së territorit duke e përkufizuar si: ‘mënyra në të cilën administrohen dhe zbatohen politikat e territorit për një shtet, të cilat i referohen veçanërisht shpërndarjes së roleve dhe përgjegjësisë në nivelet e ndryshme të qeverisjes (mbi-shtetëror, shtetëror dhe nën-shtetëror), dhe proceset që rrjedhin nga negociatat dhe ndërtimi i konsensusit’ (Schmitt, P. & Van Well, L., 2017, p. 5). I nxitur nga debati politik mbi kohezionin territorial, qeverisja territoriale është konceptuar si një mjet për të arritur zhvillimin endogjen territorial përmes organizimit të aktorëve, institucioneve dhe interesave të reja (Gualini 2008, p.16). Nevoja për qëndrueshmërinë mjedisore nënvizohet si prioritetet sëbashku me politikat e ruajtjes dhe me mënyrat e reja të të menduarit për flukset e njerëzve, të mirave dhe mbetjeve të produkteve. Arritja e një kohezioni social sjell mundësi për rritje të cilësisë së jetës përmes menaxhimit të burimeve parësore për qytetin dhe rajonin.

Territori, në këtë mënyrë merr një rëndësi të veçantë në politikat për qeverisje të mirë dhe shumë dimensionale, dhe instrumenti për të menaxhuar outputin e tij mbetet planifikimi. Për shkak se planifikimi i territorit nuk kufizohet vetëm në aspektet dydimensionale si përdorimi i tokës apo treguesit e zhvillimit, por përfshin aspekte sociale dhe kulturore, mjedisore dhe impakton flukset ekonomike, karakteri politik i tij

dhe përfshirja e rolit të institucioneve shtetërore nëpërmjet metodave të ndryshme që kërkojnë të influencojnë shpërndarje të drejtë të kërkesave dhe oportuniteteve, i jep atij karakterin hapësinor.

Planifikimi hapësinor ka përkufizime të shumta. Një nga përkufizimet më të hershme vjen nga Karta e Planifikimit Rajonal / Hapësinor Evropian (shpesh i quajtur "Karta Torremolinos"), miratuar në 1983 nga Konferenca Evropiane e Ministrave përgjegjës për Planifikimin Rajonal (CEMAT): "Planifikimi Rajonale / Hapësinor jep shprehje gjeografike të politikave ekonomike, sociale, kulturore dhe ekologjike të shoqërisë. Është njëkohësisht një disiplinë shkencore, një teknikë administrative dhe një politikë e zhvilluar si një qasje ndërdisiplinore dhe gjithëpërfshirëse drejtuar drejt një zhvillimi të balancuar rajonal dhe organizimin fizik të hapësirës sipas një strategjie të përgjithshme". Në këtë mënyrë, planifikimi hapësinor i referohet metodave të përdorura nga sektori publik për të ndikuar në shpërndarjen e njerëzve dhe aktiviteteve në hapësira të shkallëve të ndryshme. Disiplinat profesionale që përfshijnë planifikimin hapësinor përfshijnë përdorimin e tokës, urban, rajonal, transportin dhe planifikimin mjedisor. Fusha të tjera të lidhura janë gjithashtu të rëndësishme, duke përfshirë planifikimin ekonomik dhe të komuniteteve lokale. Planifikimi hapësinor zhvillohet në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndër-kombëtar që shpesh rezultojnë në krijimin e një plani hapësinor.

Politikat evropiane tashmë kanë një rol nxitës për planifikimin në nivel kombëtar, sidomos gjatë viteve 1990-të, kur BE hartoi dokumente të planifikimit hapësinor *Europe 2000* dhe *Europe 2020*. Zhdukja e pabarazive ndër-rajonale është nga objektivat kryesore. Ky qëllim ka qenë dhe një nga fokuset kryesore të disa nga mjetet më të mëdha implementuese të tilla si fondet strukturore apo politikat e mbështetjes së komunitetit. Politikat e BE-së pohojnë që pjesëmarrja në incentiva të llojeve të ndryshme, të tilla si fondet strukturore, është e kushtëzuar nga një nivel i përshtatshëm i planifikimit në nivel kombëtar, i cili duhet të jetë një prioritet i secilit vend anëtar (Alterman, 2001, p. 17). Dokument me rëndësi në identifikimin e politikave të planifikimit hapësinor është Perspektiva Evropiane për Zhvillimin Hapësinor (ESDP), e cila u aprovua në maj të vitit 1999, përmbledh dhe pasqyron gjithë punën e bërë gjatë viteve 1990-të mbi planifikimin hapësinor si një politikë apo si një mjet integruar brenda Evropës, duke rezultuar në lëvizje për të promovuar zhvillimin hapësinor në të gjithë territorin evropian. Sidoqoftë, ESDP nuk siguron rregullat e një master plani për zhvillimin e Evropës si një të tërë; sesa siguron një kornizë konceptuale dhe gjuhësore për të menduar në mënyrë strategjike për modelet më me ndikim të zhvillimit hapësinor. Adoptimi i tij nga shtetet anëtare do të thotë që ka pasur një angazhim të gjerë prej qeverive kombëtare për ta çuar përpara punën e ESDP-së në prodhimin e politikave të tyre rajonale dhe kombëtare (Graham, H., Allmendinger, P. & Vigar, G., 2010, pp. 19-20). Ashtu siç shkruajnë dhe Haughton, Allmendinger, & Vigar (2010) 'në një nivel abstragimi, ESDP siguron një aparat konceptual dhe lingvistik, i cili është i nevojshëm për planifikuesit që po përpiqen që të sigurojnë një mënyrë për të prezantuar politikat e tyre si me përfitim të gjerë sesa thjesht si përfitim të fushave kryesore. Në një nivel më praktik, zbatimi i ideve në nivel evropian dhe korniza e tij ligjore është e nevojshme për të aksesuar fondet evropiane, dhe si e tillë, gjuha e ESDP-së është vecanërisht e dukshme në fushat që kërkojnë të tërheqin investimet për infrastrukturën e transportit, Fondet Strukturore dhe iniciativat e tjera. Dimensioni ndërkombëtar është i rëndësishëm për të faktuar që ka një rol evropian, por nën parimin e subsidiaritetit, Komisioni nuk duhet të përfshihet në çështjet e planifikimit. Prandaj, është e rëndësishme që të theksohet që vizionet rajonale transkombëtare janë prodhuar si dokumente këshilluese dhe ato nuk janë subjekt i miratimit nga ministrat e vendeve

anëtare dhe në këtë mënyrë nuk kanë një status formal: 'të gjitha vizionet hapësinore janë në thelb produkte të një grupi të vogël ekspertësh dhe janë shprehje e konsensusit të arritur si grup. Kjo mungesë e statusit formal ka ngritur pikëpyetje për faktin se kush është përgjegjës për përmbajtjen e vizionit hapësinor në mungesë të ndonjë legjitimiteti politik (Graham, H., Allmendinger, P. & Vigar, G., 2010). Në disa raste, ESDP kritikohet për mungesën përcaktive të qarta, edhe pse është e pasur me harta e piktograme që ilustrojnë principet dhe konceptet e një politike të përgjithshme. Në këtë paraqitje formale të tyre të përgjithshme, asnjë nga këto vizione hapësinore nuk mund të sigurojë një bazë të përshtatshme për zbatimin e politikave hapësinore të BE-së në nivelin kombëtar dhe nënkombëtar. Rolet e tyre janë vetëm këshilluese dhe në mënyrë të pashmangshme pasojat e ndikimit të tyre në politikat hapësinore të shteteve anëtare janë të ndryshme. Për shembull, në ishujt britanikë, dy planet e para hapësinore në nivel kombëtar, Strategjia Rajonale e Zhvillimit në Irlandën e Veriut (RDS) dhe Strategjia Kombëtare Hapësinore Irlandeze (NSS), njihen të dyja si kontribuese në mendimin evropian, si dhe është i dukshëm fakti që kanë përdorur konceptet të tilla si korridoret dhe qendrat rajonale (Graham, H., Allmendinger, P. & Vigar, G., 2010, pp. 19-20). Kompendiumi i BE-së për sistemet e planifikimit hapësinor në EU, dhe studime të tjera në këtë fushë, shprehen se 'variacioni është pjesë e rëndësishme e sistemeve të planifikimit' dhe që 'është e vështirë klasifikimi i tyre, përderisa cdo shtet anëtar varion në aspekte dhe stile të ndryshme apo se cilit prej kriterëve i është dhënë më shumë rëndësi' (Commission, 1997, p. 36). (Nadin & Stead, 2008, p. 33) argumentojnë që Belgjika, Franca, Irlanda, Luksemburgu dhe Britania e Madhe po marrin elemente të përqasjes gjithëpërfshirëse të integruar. Ndërs pohojnë se, Gjermania, Irlanda, Suedia dhe Britani e Madhe po lëvizin drejt planifikimit ekonomik rajonal, dhe që Spanja dhe Portugalia po lëvizin në drejtim të rregullimit të përdorimit të tokës.

Ndër dokumentat kryesore që kanë ndikuar në politikat evropiane të planifikimit hapësinor kanë qenë 'Vështrim mbi territorin i OECD-së', qeverisja e territorit sipas Këshillit të Ministrave botuar në vitin 2006, dokumenti për gjendjen territoriale dhe perspektivat e BE-së (2007); Karta e gjelbër për kohezionin territorial e Komisionit European (2008) dhe Politika e Kohezionit të BE-së 2014- 2020. Kohët e fundit, nocioni i qeverisjes së territorit është parë si një proces në të cilin kohezioni territorial mund të arrihet ashtu sic pasqyrohet në 'Axhendën e Territorit të Bashkimit Evropian 2020' dhe përmes 'Rrjetit të Pikave të Kontaktit për Kohezionin Territorial' në raportin e vitit 2013. Të dy këta dokumente bëjnë thirrje për një përqasje të integruar, dhe të ndjeshme ndaj territorit lokal, për të përmirësuar performancën e veprimeve në shumë nivele dhe të sinergjive midis llojeve të ndryshme të politikave ndërhyrëse (Schmitt, P. & Van Well, L., 2017, p. 5).

Shumë sisteme planifikimi në Evropë, veçanërisht ato në vendet nordike, historikisht kanë qenë organizuar përmes strukturave formale dhe hierarkisë nga lart-poshtë, ku politikat kombëtare janë konceptuar për të qeverisur shkallët territoriale më të ulta. Si rezultat, roli tradicional i planifikimit hapësinor në nivel kombëtar, në kontekste të tilla ka qenë ai i udhëheqjes së mjeteve të zhvillimit hapësinor si instrumente politike të shkallëve të ndryshme të qeverisjes. Një përafrim i tillë planifikimi kombëtar ka si qëllim shpërndarjen e investimeve të sektorit publik dhe burimeve të shtetit e të mirëqenies midis rajoneve. Këto mekanizma hierarkikë dhe funksioni i tyre tradicional i planifikimit kombëtar mund të portretizohet si një pasojë e modeleve të shtetit të mirëqenies i cili ndodhi si fenomen pas Luftës së Dytë Botërore (Gallard, 2012, p. 1360). Në vendet evropiane, axhendat e planifikimit hapësinor janë përqendruar në mënyrë konvencionale në shpërndarjen e qëllimeve të përdorimit të tokës. Axhenda të tilla, zakonisht kanë rezultuar si një sërë politikash dhe praktikash që mbivendosen me

njëra- tjetrën, të tilla si balanca e popullsisë midis zonave urbane dhe rurale, rregullimi i përdorimit dhe zhvillimit të përdorimit të tokës, masat për zhvillimin ekonomik urban dhe rajonal, zhvillimi i infrastrukturës së transportit dhe koordinimi i ndikimeve hapësinore në politikat e tjera sektoriale, ndërmjet të tjerave’ (Gallard, 2012, p. 1361). Këto përbënin edhe qëllimet kryesore të planeve hapësinore përgjatë viteve 1990-të dhe 2000, duke realizuar kalimin drejt zhvillimit të strategjive për planifikimin hapësinor. Nocionet e një konteksti të tillë instrumentash strategjike, ku territori vështrohet si baza e materializimit të politikave dhe interesave të aktorëve të ndryshëm, ndikuan Shqipërinë dhe ndryshimet e saj në hartimin e kuadrit të ri ligjor në fushën e planifikimit të territorit. Mënyra dhe masa e përshtatjes së këtyre koncepteve në kuadrin e ri ligjor të Shqipërisë, trajtohen më gjerësisht në vijim.

3.2 Planifikimi në nivel Kombëtar në Shqipëri - vështrimi historik

Planifikimi kombëtar në vendin tonë mund të gjurmohet me formimin e Shtetit të parë modern Shqiptar. Lindja e urbanistikës moderne dhe më pas e planifikimit hapësinor në Shqipëri nuk është trajtuar ende gjerësisht si nga pikëpamja historike e formimit dhe as e ndikimeve dhe influencave përmbajtësore. Shtetformimi i vonë dhe ndryshueshmëria e modeleve qeverisëse politike, dhe për pasojë institucionalizimi jo i konsoliduar për një kohë të gjatë i vendit reflektuar në një zhvillim të dobët ekonomik dhe kaotik urban, janë nga motivet kryesore që kanë ndikuar në një qasje të vakët të planifikimit urban. Siç pohon (Elezi I. , 2017). “krijimi i shtetit të pavarur shqiptar nuk lindi nga hiçi, por mbi bazën e traditës së lashtë shtetformuese, duke filluar nga shteti ilir (shteti IV-II) para e.r., shteti i Arbërit (shek.XII), shteti i Skënderbeut (shek.XV), Pashallëqet e Janinës të Ali Pashë Tepelenës në Jug (shek.XVIII-XIX), të Bushatllinjve në Veri (shek.XVIII), të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878)”. Por, nëse në shek.XV mesjeta ishte zhdukur nga pjesa më e madhe e vendeve të Europës Perëndimore, në Shqipëri përkundrazi, ajo vazhdoi edhe për rreth pesëqind vjet të tjerë nën pushtimin osman, duke lënë gjurmë të thella në zhvillimin e vendit si në aspektin social kulturor, ku gati 90% e popullsisë ishte analfabete, edhe në aspektin ndërtimor. Sipas Koço Miho, “Shqipëria para pushtimit osman ishte e barabartë për nga zhvillimi, me vendet e tjerë të perëndimit bashkohës, por në kufijtë e saj shtetëror të vitit 1913 kishte mbetur mjaft mbrapa tyre, si kudo edhe në fushën e urbanistikës” (Miho, 2003, p. 18). Nga ana tjetër “pushtuesit osmanë si rregull, nuk shquheshin për ndërtime jashtë vendit të tyre”. Si rrjedhim, veprimtaria ndërtimore, në shekujt XV-XIX, mund të konsiderohet në përgjithësi, investim material e shpirtëror i forcave të brendshme të vendit dhe pikërisht të shtresave zejtare dhe tregtare. Situatën e rëndë të atyre viteve nuk e ndihmuan as disa fatkeqësi natyrore që prekën vendin. Nga viti 1912-1920, vetëm brenda tetë vitesh, pesë lëkundje të fuqishme tërmeti, me intensitet 8-9 ballë prekën një sërë zonash urbane duke shkatërruar, rrëzuar apo dëmtuar shumë banesa, ndërtesa publike e struktura ekonomike (Miho, 2003, p. 43).

Ndërkohë që lindja e urbanistikës moderne në historinë botërore lidhet ngushtësisht me lulëzimin ekonomik që solli Revolucioni Industrial i viteve 1800, dhe nevoja për adresimin e eksternaliteteve të tij, Shqipëria e fitoi pavaresinë vetëm në 1912, duke ngritur organet e para shtetërore juridike në 1913. Trashëgimia kulturore juridike e shtetit të pavarur shqiptar, si edhe pëpjekjet për një rimekembje ekonomike, do të pësonin goditje të fuqishme për shkak të rrethanave politike që u krijuan nga Luftërat Ballkanike, Lufta e Parë Botërore, kur Shqipëria u bë shesh luftimesh si dhe për shkak të dorëheqjes së Qeverisë së Vlorës e të largimit nga Shqipëria të themeluesit të shtetit të pavarur e të së drejtës pozitive – Ismail Qemalit (Elezi I. , 2017).

Nëse në kapitullin e mëparshëm përshkruam natyrën e lartë të institucionalizimit që paraqet planifikimi dhe rolin e rëndësishëm që luajnë organet shtetërore në konsolidimin e kësaj praktike, bëhet e qartë nga faktet historike se një konsolidim i vonë i një shtetit të pavarur shqiptar do të shoqërohej me mungesa të karakterit zhvillimore në disa drejtime të fushave teknike, përfshirë këtu edhe planifikimin e territorit.

Megjithatë, është pikërisht në këto momente historike të pavarësisë dhe të implementimit të ideve të Rilindasve Shqiptar, ku mund të gjurmohen idetë e para për një planifikim në nivel kombëtar. Kështu vepra e Sami Frasherit, “Shqipëria ç’ka qenë ç’është dhe ç’do të bëhet”, ishte jo vetëm një ese programatike politike, por njëkohësisht edhe një “plan kombëtar” për organizimin hapësinor të vendit. Si mendimtar demokrat dhe iluminist, Samiu parashtron një projekt të gjerë me ide të përparura për të ardhmen e Shqipërisë. Përveç se një traktat politiko-shoqëror për kohën, vepra e Frashërit është edhe një projekt për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Me një vëmendje të veçantë për rritjen e kulturës dhe diturisë shqiptare ai paraqiti një program të hollësishëm për ngritjen e arsimit *“të përgjithshëm e të detyrueshëm për të gjithë, djem e vajza. Arsimin e donte në gjuhën amtare shqipe dhe shkolla të ishte laike, e shkëputur nga kisha e xhamia, një shkollë që të shërbente si vatër diturie dhe atdhetarizmi”*. Kapitulli “Punë të Përgjithçme” i veprës së tij, mund të konsiderohet si baza për planifikim hapësinor të vendit. Këtu ai kërkon të ngrihet një industri kombëtare, të mëkëmbej bujqësia, të zhvillohej rrjeti automobilistik dhe hekurudhor, të forcohej mbrojtja, etj. Dhe tregon rrugën për realizimin e këtyre projekteve. Kështu ai përshkruan projektet e para të rëndësishme të infrastrukturës rrugore që duhet të kryheshin menjëherë pas shkëputjes nga Perandoria Osmane. Në transport, rrugët Manastir - Korçë rrugë kryesore, dhe nga kjo degë Janinë- Prevezë dhe Berat-Skenderbegas (Gramshi i sotëm) *“duke xgjaturë edhe një degë gjer në Elbasan”*. Rrugë tjetër: Manastir – Ohër duke vazhduar anës Drinit në Shkodrë e në Lezhë, një degë tjetër nga Prizreni në Ferizaj dhe nga aty *“me udhët te madhe, që vet në Selanik e në Avstri”*. Këtu, kemi për herë të parë, vizatimin e skemës së parë korridoreve kombëtare me rëndësi për Shqipërinë, që lidhin trevat kryesore të saj me njëra tjetrën si edhe me vendet kryesore të Europës, si ishte Austria në atë kohë. Siç do të pohojë më vonë në veprën e tij (Miho, 2003, pp. 13-32) *rrugët kanë përbërë e përbëjnë, në çdo vend e në çdo kohë “arteriet e qytetërimit” edhe në fushën e urbanizimit*. Ndryshe nga plani aktual ‘Shqipëria 2030’ (2016), plani i Frashërit meriton të quhet kombëtar pasi përfshin në të, të gjitha trevat shqipfolëse përpara ndarjes së kufijve në 1913. Sektori tjetër me përparësi i përshkruar në veprën ishte arsimit. Edhe në këtë fushë programi i tij shkon përtej një organizimi politik drejt një vendosje dhe organizimi hapësinore. Vendosja e shërbimit të arsimit, që në këtë fazë të parë të gjenezës së tij karakterizohet nga tre tipare kryesore: i detyrueshëm, falas dhe për të gjithë duke dëshmuar për tiparin social dhe gjithëpërfshirës, përtej kësaj kemi edhe karakterin e organizimit hapësinor.

Pas mbarimit të rrugëve të para, të cilat Frashëri sugjeronte të ndërtoheshin “shpejt” prej shoqërive të huaja apo Shqiptare, apo edhe duke marrë hua për realizimin e tyre, gjithësesi renditen të parat ndër projektet kryesore të vendit, ndërlidhja. Më pas, për nga rëndësia përshkruhen punët për mëkëmbjen e ekonomisë bujqësore duke filluar nga kthimi në tokë bujqësore e fushës së Myzeqesë. *“Myzeqeja do të bëhet një ar’ e gjer’ e e gjatë e cila, me qenë nën’ujë e me të pasurë një dhe fort pallor, do të bëhet një Egjipt’ e dytë. Bregoret’ e Myzeqesë munt të mbulohenë me vreshta e me ullinj; edhe luadhër’ e saj munt t’ushqejnë kuaj e bagëti, sa të mbushinë jo vetëm Shqipërinë po edhe Evropënë”*. Për këtë, rilindasi sugjeron punime në rrjedhat e lumenjve që rrethojnë

fushën dhe porta komandimi me hapjen dhe mbylljen e të cilave do të sigurohej ujitja e fushave. Rëndësi në projektin politik dhe të zhvillimit hapësinor të vendit marrin investimet në portet kryesore ose siç thekson rilindasi: zgjerimi i “Limanit të Durrësit”, i mbyllur nga Sulltani në ‘padituri të tij’ për të penguar anijet veneciane, hapja dhe thellimi i këtij porti do ta kthente Durrësin “si një Trieste të dytë a një tjetër Selanik”. Gjithashtu limane të tjera sugjerohen përgjatë bregdetit si në Butrint etj., vizioni vazhdon me ngritjen e një shoqërie vaporësh që do të siguronte udhëtimin nga këto porte në portet e Triestes e Selanikut, por edhe udhëtime në liqenet e Shkodrës Prespës dhe Ohërit, apo edhe të lumenjve të cilët do të përfshiheshin nga këto punë të përdhithshme. Megjithatë Frashëri përveç mëkëmbjes ekonomike, investimeve në infrastrukturë dhe ngritjes së një sistemi arësimor mbarëkombëtar, tregoi një ndjeshmëri të veçantë për karakterin e qëndrueshëm të zhvillimit që duhej të kishte Shqipëria. Këtë e vëmë re tek sugjerimet e tij për ekonominë pyjore dhe shfrytëzimin e pyjeve, ku sipas tij ato duhet të shfrytëzoheshin sipas një ndarje me parcela ku “gjer sa të vinjë radha të pritete gastr' e funditë, gastra q'u pre të parenë herë, do të jet' e arritur sërish; e kështu gjithnjë do të pritete lëndë nga pyjet edhe kurrë pyjetë do të mos mbarohenë, po do të përsëriten' e të jenë kurdo të lulëzuarë”. Vëmendje në vepër marrin edhe industria e kërkimit dhe përpunimit të metaleve si edhe industria e lehtë e përpunimit të tekstileve.

Vepra “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet” u botua për herë të parë me 1889 në Bukuresht, e do të shërbente më pas si frymëzim për ngritjen dhe organizimin e shtetit të parë të pavarur shqiptar nga Ismail Qemali në 1912-1913. Sipas (Elezi I. , 2017), ishte filozofia e Sami Frashërit se “ dy gjëra duhen në këtë jetë: E drejta dhe Fuqia” si analogji për Ligjin dhe Shtetin, të cilat do të udhëhiqnin Ismail Qemalin për organizimin administrativ të shtetit, ndarjen dhe balancimin e pushteteve, pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Kështu vepra e Sami Frashërit njihet dhe është studiuar gjerësisht për ndikimin në ngritjet e themelit e trashëgimisë juridike e kulturore të Shqipërisë, është studiuar dhe vlerësuar nga pikëpamja stilistik gjuhësor, dhe këtu mund të themi pa mëdyshje se është vizioni i parë i hartuar për zhvillim hapësinor kombëtar për Shqipërinë. Për shkak të rrethanave historike politike që pasuan si luftrat e ndryshme edhe dorëheqja e Qeverisë së Vlorës, bëri që shtetformimi shqiptar të pësonte goditje të rënda e bashkë me të edhe konsolidimi dhe zbatimi i një vizioni kombëtar për zhvillimin strategjik afatgjatë të territorit.

3.1. Planifikimi në Shqipëri, 1922-1938

Momenti tjetër historik kur rimerret mendimi dhe vizioni për një planifikim kombëtar është i trajtuar më shpesh në literaturën kërkimore, dhe i përket periudhës midis 1922-1938 gjatë mbretërimit, me një shkëputje midis shkurtit 1924 dhe janarit 1925, të Ahmet Zogut, si ideatori i ri i shtetit e më pas mbretërisë shqiptare të kësaj periudhe. Gjatë kësaj kohe fillojnë planet e para rregulluese, për kryeqytetin Tiranë dhe për qytete të tjera të rëndësishme të Shqipërisë si Durrësi, Vlora, Elbasani, Kucova etj. Fillimisht ndikimi Austrohungarez, ai Francez por mbi të gjitha ai Italian do të lënë gjurmë në konfigurimin urban të këtyre qyteteve. Këto fuqi të huaja gjatë luftrave ballkanike ushtruan influencën e tyre në zona të caktuara të Shqipërisë, dhe ca për motive strategjike luftarake, e disa për interesa ekonomike, të gjitha kishin zhvilluar studime të pavarura në territorin shqiptar të shoqëruara me disa investime në infrastrukturë rrugore dhe apo/edhe industriale. Prandaj mund të themi se ndryshe nga vendet e tjera të Europës, ku lindja e urbanistikës moderne erdhi për rrjedhojë të zhvillimit ekonomik dhe inovacionit teknologjik që solli revolucionin industrial, në Shqipëri, zhvillimi i territorit dhe urbanistikës kryesisht erdhi si qasje e interesave politike të huaja dhe

vendase, si nevojë për forcimin e pushtetit të politikës së brendshmi. Tregëtia e zhvilluar e kompanive private rriti presionin për rregullimin e infrastrukturës së transportit ujor e hekurudhor në Anglinë e viteve 1850, dhe shumë investime të tilla u investuan nga kapitali privat, duke përfshirë vetëm më vonë rolin e shtetit si rregullator, ndërkohë në Shqipëri, ndodhi e kundërta. Shtyrë nga mungesa e rrugëve të komunikacionit automobilistik, ushtritë e huaja, për lëvizjen e shpejtë dhe furnizimin e trupave të tyre, por edhe për shfrytëzimin ekonomik të vendit, me robër lufte, punëtor vendas të detyruar e me pagesë si dhe njësi të xhenios, u detyruan të ndërmerrenin e të realizonin, me nxitim, disa punime të tilla. (Ferrero, 1923). Fakti që me modifikime modeste, ato u përdorën deri nga vitet '27 e më tej shërbyen si nënshtetas për ndërtimet e rrjeteve rrugore 1928-1931....dëshmuar se ishin të domosdoshme, të dobishme e të kohës (Miho, 2003, p. 28) . Më tej Miho përshkruan se në periudha midis viteve 1912-1920, ndër të tjera shënoi fillimin e një kthese me tipare përparimtare edhe në urbanistikën e vendit, ku siç dëshmohet edhe nga shtypi i kohës, më 1920 u ngrit drejtorja e përgjithshme e ndërtimeve e cila në 1921 u kthye në Ministrinë e Punëve Botore.

Tabela 3.2-1 Lidhja midis planifikimit kombëtar dhe regjimeve politike në Shqipëri

	Rilindja Kombëtare	Regjimi Zogist	Regjimi Komunist	Pluralizim politik Demokraci-Socializëm	
Vite		16	45	20	7
Vepra	Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e çdo të bëhet	Plane Rregulluese-Urbane	Plane ekonomike 3-5 vjeçare Plane Rregulluese për zonat Urbane të shpallura Qytet	Strategji Sektoriale	PPK 2030
Viti	1890	1922-1938	1945-1991	1992-2013	2013-2020

Përpunoi: Autori

Në aspektin e zhvillimit ekonomik ndikim patën edhe investimet në industri. Shqipëria deri në ato kohë ishte një vend i paeksploruar për sa i përket pasurive nëntokësore, “toka shqiptare ishte virtualisht një pasuri e sigurt, ndërsa në fakt një realitet i varfër” (Miho, 2003, p. 79), por studimeve të shumta nga ekspertë të fushës ardhur nga AustroHungaria dhe Italia, për këto qëllime shumë shpejt identifikuan potencialet në këtë drejtim. Vrojtimit e para për ekzistencën e naftës janë bërë në vitet 1914-1918 nga Ing. Gjeolog i Naftës Ernest Novak, qytetar Çek, i pranishëm në qytetin e Kuçovës në vitet e luftës së parë botërore, ku ngriti edhe zyrën e parë gjeologjike në Shqipëri. Rëndësia për kontrollin dhe shfrytëzimin e burimeve petrolifere e rritën rëndësinë e tyre sidomos pas Luftës së Parë Botërore dëshmuar edhe nga telegrami i njohur në histori drejtuar presidentit amerikan Woodrow Wilson në 1917 nga kryeministri francez Georges Clemenceau, «[...] për kombet dhe për popujt, një pikë naftë ka të njëjtën vlerë me një pikë gjaku» (Sette, 2014, pp. 99-134). Më poshtë janë paraqitur dy nga dhjetë hartat e atlasit të hartuara nga Pollastri F. në 1939 të cilat japin një fotografim të zhvillimit kombëtar në vend, që nga akset kryesore rrugore dhe lidhjet ajrore fig.10.a) me prodhimtarinë në bujqësi fig.10 b), industri etj.

Vini re këtu strukturën gjashtëkëndore të komunikimit midis qendrave kryesore e cila mund të gjurmohet edhe sot në propozimet e planit të parë Kombëtar Shqipëria 2030. Shpërndarja e qendrave primare urbane të tilla që minimizojnë pabarazinë e zhvillimit territorial. Në këto vite, infrastruktura rrugore dhe hekurudhore ishin më të rëndësishmet. Megjithatë për qëllime ushtarake, ato provojnë të jenë një punë shumë e

rëndësishme që do të drejtojë investimet e qeverisë së pasluftës. Mbi këto gjurmë dhe mbi këto parashikime dhe punimet e mëparshme u bazuan planet pasuese për të ndërtuar shtetin e ri të Shqipërisë nën një regjim të ri, atë të socialist, i cili shumë shpejt do të kthehet në një nga regjimet më të ashpra totalitare të asaj kohe.




Figura 3-1: Atlasi me 10 harta “ALBANIA” nga puna kërkimore e ing. Francesco Pollastri, Drejtor i “Ufficio Geografico dell’Istituto Centrale di Statistica del Regno d’Italia” Gusht 1939.

3..2. Planifikimi në Shqipëri, 1945-1991

Zhvillimi urban i Shqipërisë në këtë periudhë identifikohet me ekonominë e planifikuar dhe ideologjinë për ndërtimin e një shoqërie të re socialiste nën ndikimin e ideologjise marksiste-leniniste. Aliaj e klasifikon në disa nën periudha zhvillimin ekonomik të Shqipërisë të asaj kohe me karakteristikat e mëposhtme: ‘(i) nivele fillimisht më të larta të rritjes ekonomike sesa rritja e popullsisë; (ii) rritje e shpejtë, por e çrregullt deri në fund të vitit 1960; (iii) rënia e vazhdueshme nga fillimi i viteve 1970-të; (iv) situata më e rëndë e regjistruar ndonjëherë, gjatë viteve 1984-85; (v) ulja e mtejshme e aktiviteteve ekonomike gjatë viteve 1987-1988; (vi) kolapsi total ekonomik në prag të dhe gjatë fillimit të viteve 1990. Planifikimi midis viteve 1945-1991, në përgjithësi karakterizohet nga përqëndrimi dhe qendërzimi’ (Aliaj, 2003).

Ndërkohë, prishja e marrëdhënieve të Shqipërisë me ish Bashkimin Sovjetik (iBS) dhe dalja e saj ‘de facto’ nga kampi socialist pas viteve ‘60, i ridimensionoi së tepërmi ambicjet dhe strategjinë e industrializimit. Në politikat e zhvillimit të vendit hyri gjithnjë e më shumë koncepti dhe praktikrat e “mbështetjes vetëm në forcat e brendshme”. “Rritja e nivelit të autonomisë ekonomike, konsolidimi i sistemit socialist, ngritja e nivelit të jetesës dhe zhdukja e dallimeve fshat-qytet etj.”, përbënin thelbin e objektivave të zhvillimit ekonomik në periudhën 1971–1985. Me vendosjen e regjimit totalitar dhe influencën e gjerë të stalinizmit i vendosur në iBS, ekonomia e planifikuar kishte parakushte të qarta:

- Lëvizja e popullsisë nga fshati në qytet dhe anasjelltas dhe nga një qytet në tjetrin, ishte një lëvizje e kontrolluar vetëm nga organet shtetërore me një raport 1/3 në zona urbane dhe 2/3 e popullsisë në zona rurale; Qëllimi për ruajtjen e një balance të detyruar midis zhvillimit urban dhe rural lehtësoi planifikimin e qendëruar për shërbime të tilla si spitalet, shkollat etj. të përlogariten me saktësi për numër banorësh në një vend të caktuar.
- Vendosja e kufirit të zonës urbane përmes prezantimit të ashtuquajturës “Vija e Verdhë” synonte të kufizonte urbanizimin dhe gjithashtu nënkuptonte kufirin e zonave për të cilat mund të hartohej një plan zhvillimi urban. Pjesa tjetër e territorit zhvillohej në bazë të planeve ekonomike tre dhe pesëvjeçare të huazuara nga modeli stalinist. Ashtu si pohon dhe Aliaj, koncepti i zonës urbane në Shqipëri u përcaktua në terma të zonës administrative urbane. ‘Ekzistonin tre kritere kryesore për qendrat urbane për të marrë statusin e qytetit: (i) aktiviteti, duke përfshirë dominimin e tregut industrial të punës, si dhe vendndodhjen e administratës / autoriteteve lokale në qendrën e jetesës (ii) numri i banorëve, për shembull, popullsia e zonës duhet të jetë e një madhësie të caktuar, por asnjë kufi i ulët nuk ishte caktuar zyrtarisht, që varioi nga 2,000-5,000 banorë; (iii) dhe ndikimi në mjedis (tregu i punës) dhe në dimensionin shoqëror (stili i jetës urbane)’ (Aliaj, 2003).
- Prona dhe iniciativa private u eliminua sëbashku me tregëtinë e lirë. Kolektivizimi njohu disa faza duke nisur me Reformën Agrare në 1945 për shpronësimin e pronarëve të mëdhenj e të mesëm të tokave, të kapitalit të huaj apo ato në pronësi të institucioneve fetare, dhe shpërndarjen e tyre në favor të fshatarëve të varfër e pa tokë dhe duke u përshkallëzuar me reformën e Kolektivizimit të prodhuesve të vegjël dhe krijimi i fermave të mëdha shtetërore.

Tabela 3.2-2: Përmbledhje e ndikimeve politike ekonomike dhe urbane në Shqipërinë e viteve 1945-1990.

	1945	1950	1960	1970	1980	1990
Ekonomia	Rritje e ekonomisë		Rritje e shpejtë, por e çrregullt	Fillimi i rënies ekonomike	Ulje e mëtejshme	
	<i>Agrar gjysmëfeudal</i>	<i>Agraro-industrial</i>	<i>industrialo-agrar / industrializimit socialist</i>		<i>Sistemi tallonëve ushqimorë</i>	
Ndikimi	BRSS			Kinez		Izolim
Vizioni	-Reforma agrare radikale “Toka i takon atij që e punon” -Kolektivizimi dhe krijimi i fermave të mëdha shtetërore -Industria kontribuonte me më shumë se 50% në PBB			-Rritja e nivelit të autonomisë ekonomike “mbështetjes vetëm në forcat e brendshme” -zhdukja e dallimeve fshat-qytet		
Ndërtimi	-Bonifikime të tokës bujqësore -Zhdukje e analfabetizmit;		-Kombinati siderurgjik Elbasan -Hydrocentralet mbi lumin Drin Një rafineri e madhe naftë -Zhvillimi i industrisë nxjerrëse e përpunuese të kromit, hekur-nikelit dhe bakrit; -Uzina për prodhimin dhe përpunimin e plehrave kimike, bitumit, çimentos, tullave, etj.; -Uzina të industrisë së lehtë e përpunuese			
Territori	Qytetet Ideale – Satelite të Punëtorëve Ndërtimi i qyteteve të reja industriale			Planet rregulluese për të gjitha qytetet Plane zhvillimi urban për teritorët brenda Vijës së Verdhë		

Përpunoi: Autori

Urbanizimi gjatë kësaj periudhe njohu pikun më të lartë në mesin e viteve '50 me një rritje prej 1.4%, por me dhe mbylljen gjithnjë e më të madhe të vendit ndaj kapitalit të huaj dhe rënien e ekonomisë, urbanizimi njohu shifrat nga më të ulëtat deri në '0.10% në vitet 1980-1990' (Aliaj, 2003). Ndërkohë, vendbanimet e reja urbane dhe rurale u karakterizuan nga një strukturë e klasës pothuajse një-dimensionale e ashtuquajtura 'klasa punëtore' dhe për shkak të 'standartizimit' si proces për ekonomizimin e resurseve vendbanimet e reja u karakterizuan nga ndërtimi i banesave homogjene, me plane tip të cilat transplantoheshin pa asnjë përshtatje në kontekste të ndryshme gjeografike, social-ekonomike dhe kulturore.

Me këto ndryshore të rëndësishme si popullsia, toka e disponueshme, tashmë të shndërruara në konstante, planifikimi i territorit u kthye në një rast 'ideal', me kushte gati laboratorike për t'u ushtruar, larg realitetit. Për shkak të kolapsit ekonomik në të cilën u gjend vendi në 1990, rezultoi qartë se ky model zhvillimi dështoi, siç thekson A.Civici (2012), 'kjo ishte një krizë e vetë sistemit socialist e cila nuk mund të zgjidhej pa e ndryshuar atë' (Civici, 2012).

3.3. Planifikimi në Shqipëri, 2009-2020

Dhjetëvjeçari i fundit, vitet 2009-2020, mund të pohojmë se kompreson evoluimin më kompleks të sistemit të planifikimit në Shqipëri, përmes nismave ligjore, reformave institucionale, programeve politike me rëndësi dhe debateve të ndryshme mes aktorëve. Në kushtet kur planifikimi i territorit synon të jetë shumëdimensional duke përfshirë aspekte të disa sektorëve njëkohësisht si: mjedisi, bujqësia, zhvillimi rural, ekonomik, turizmi, transporti etj., duke balancuar interesa të shumë grupimeve, institucionale apo individuale, publike dhe private, rritet edhe shkalla e vështirësisë së zbatimit të proceseve që duhet të trajtojnë dokumentat e planifikimit të territorit. Për më tepër, në kushtet kur çështjet e pronës private mbeten ende të pazgjidhura në Shqipëri dhe ekonomia e tregut jo gjithmonë vepron sipas ligjeve të konkurrencës së pastër, zhvillimi i tokës bëhet më i komplikuar për t'u zgjidhur. Gjithashtu "në Shqipëri problemi nuk qëndron vetëm në faktin se është vështirësuar konteksti urban dhe ai i zhvillimit të territorit, por edhe në faktin se sistemi i planifikimit dhe instrumentet e tij ndryshojnë shpejt e vazhdimisht, pa pritur që praktikatat përkatëse të konsolidohen" (MZHU,AKPT,USAID,CoPlan, 2015). Tabela e mëposhtme kondeson ndryshimet kryesore:

Viti 1991:	Ligji Nr. 7491 "PerUrbanistiken"	ndryshuar me Ligji me Nr.7491 date 29.4.1991,
Viti 1993:	- Ligji Nr.7693, "Per Urbanistiken" datë 6.4.1993	ndryshuar , 3 herë me : Dekretin nr. 772, datë 14.2.1994, Ligjin nr. 8015, datë 19.10.1995, Ligjin nr. 8249, datë 7.10.1997
Viti 1998	- LIGJ Nr.8405, "Per Urbanistiken" datë 17.9.1998	i ndryshuar 12 herë me: <i>Ligjin Nr. 8453, datë 04/02/1999, Ligjin Nr. 8501, datë 16/06/1999, Ligjin Nr. 8682, datë 07/11/2000, Ligjin Nr. 8991, datë 23/01/2003, Ndrejje Gabimi, Fletore Zyrtare Nr.59, datë 18.07.2003, Ligjin Nr. 9632, datë 30/10/2006, Ligjin Nr. 9743, datë 28/05/2007, Ligjin Nr.9843, datë 17/12/2007, Ligjin Nr.10 078, datë 16.02.2009, Ligjin Nr.10 097, datë 19.03.2009, Ligjin Nr.10 137, datë 11.5.2009, Ligjin Nr. 10 319, datë 16.9.2010</i>
Viti 2009:	Ligji Nr. 10 119, datë 23.4.2009 "PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT"	ndryshuar 5 herë me: <i>Ligjin Nr. 10 258, datë 25.03.2010, Aktin Normativ Nr.4, datë 25.8.2010 (miratuar me ligjin nr.10 315, datë 16.9.2010), Ligjin Nr.10 360, datë 16.12.2010, Ligjin Nr. 22/2013, Ligj Nr. 110/2013, datë 01.04.2013</i>

Viti 2014	Ligji Nr. 107/2014, “PËR PLANIFIKIMIN dhe zhvillimin e TERRITORIT”	ndryshuar 4 herë me: Ligjin Nr.73/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.107/2014“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”; Ligjin Nr.28/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.107/2014“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar. Ligjin Nr.42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.107/2014“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar. Ligjin Nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar.
-----------	---	---

Pra, si vihet, vetëm në 10 vitet e fundit ligji ka ndryshuar të paktën 10 herë, pa përfshirë këtu modifikimet dhe ndryshimet e akteve nënligjore në zbatim të tyre (Rregulloret e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit) të cilat detajojnë ligjin me qëllim zbatimin praktik. Nevoja për përmirësim dhe reflektimi i vazhdueshëm i kontekstit e bëjnë ligjin të priret drejt ndryshimeve, si një tipar pozitiv evolutiv të tij. Megjithatë shpeshtësia e këtyre ndryshimeve mund të interpretohet njëkohësisht si tregues i dinamikës social ekonomike që përjeton vendi ynë (kryesisht tipar i vendeve në tranzicion si Shqipëria), por edhe i mungesës së përvojës në ndërtimin e një procesi në vazhdim siç është vetë planifikimi, duke cënuar tiparin kulturë-ndërtues në çështjet e zhvillimit të territorit. Për të kuptuar tiparet e planeve të reja të hartuara në Shqipëri, në nivel kombëtar dhe lokal, është e nevojshme të njihen karakteristikat e kontekstit që ushqyen këto produkte. Ky kontekst vlen të analizohet nën këto këndvështrime kryesore:

- Konteksti Ligjor;
- Faktori Politik dhe Reformat institucionale dhe administrative;
- Kërkesat për Integrim European dhe
- Nevoja për balancimin e Zhvillimit dhe zbutjet e pabarazive hapësinore.

Klasifikimi kronologjik i etapave kryesore të ndryshimeve ligjore në vendin tonë, përputhen me ndryshimet kryesore në qeverisjen e shtetit, duke dëshmuar për lidhjen e ndërsjellë midis politikës dhe urbanistikës, karakteristikave të formimit të shtetit dhe tipareve që pasqyrojnë ligji dhe anasjelltas. Këto etapa janë:

- (i) *1912-1945 (33 vjet) – vitet e formimit të shtetit të pavarur shqiptar shënojnë edhe gjenezën;*
- (ii) *1945-1990, (45vjet) – kjo periudhë karakterizohet nga ekonomia e centralizuar shtetërore, lëvizja e kontrolluar e popullsisë, ndalimi i pronës dhe sipërmarrjeve private. Kryesisht planifikimi realizohej në nivel kombëtar përmes planeve ekonomike tre dhe pesëvjeçare nën modelin e shtetit sovjetik, ndërsa planifikimi vendor, përmes planeve urbane për zonat e urbanizuara nën aplikimin e urbanistikës racionale.*
- (iii) *1990-2010 - këto 20 vite dominohen nga një tipar unifikues, ai i ndërtimeve informale të cilat më vonë u aglomeruan në zona informale, për të cilat ligji i urbanistikës nuk mund ti përgjigjej ndaj menaxhimi i tyre u kërkuar të arrihej përmes Ligjit të Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale.*
- (iv) *2010-2021 - kalimin nga koncepti i Urbanistikës racionale në atë të Planifikimit Hapësinor*

Ky kapitull përqëndrohet në etapën e fundit, në risitë dhe ndryshimet që u reflektuan në 10-vjeçarin e 2009 - 2020, me reformën ligjore në fushën e planifikimit, kalimin nga koncepti i Urbanistikës racionale në atë të Planifikimit Hapësinor. Sjelljen e faktorëve

kryesorë që sollën këto ndryshime si edhe tiparet unike që ofroi konteksti për realizimin e një reforme të gjithanshme në planifikimin e territorit. Së fundmi, do të ndalemi tek disa premisa për të ardhmen e sistemit aktual në lidhje me aplikimin e mëtejshëm të Analizës Metabolike dhe Planit të Përgjithshëm Kombëtar si dy tiparet më të reja që sollli zbatimimi i sistemit të ri.

3.4. *Problematikat e identifikuara dhe parakushtet për ndryshim*

Planifikimi, në përkufizim lidhet me sistemet administrative, ligjore dhe politike. Si rezultat, sistemi i planifikimit në Shqipëri, siç shkruan dhe Shutina (2012) ka përjetuar një transformim dramatik pas ndryshimit të regjimit politik dhe ekonomik të viteve 1990-të, kështu ka bërë edhe sjellja e grupeve dhe aktorëve kryesorë, nga hartuesit e politikave deri tek zhvilluesit (Shutina, D. & Toto, R. et al., 2012, p. 14). Që prej vitit 1991, kur lëvizja e lirë u kthye në një mundësi, lindi trendi i urbanizimit duke u zhvilluar si një dukuri e dukshme dhe e pashmangshme, edhe pse Shqipëria mbetet një nga vendet e fundit të urbanizuara të Europës dhe Azisë Qëndrore. Gjatë këtyre viteve urbanizimi është karakterizuar nga tre faza të veçanta:

- Dominimi i sektorit informal;
- Konsolidimi i informalitetit dhe fillimi i krijimit të sektorit formal;
- Themelimi e vazhdueshëm të sektorit formal dhe rregullimi i zhvillimeve informale.

Sfidat e urbanizimit me të cilat përballlet Shqipëria që nga 1991, janë të shumëfishta dhe kjo rritje e shkallës së urbanizimit duhet të studiohet e të orientohet në drejtime të qëndrueshme. Njohja dhe zbatimi i koncepteve të reja në planifikim për kontekstin shqiptar thërret për kapacitete institucionale dhe profesionale të afta për t'i zbatuar këto dhe për të aplikuar një mendësi të re për zhvillimin e territorit. Në fokus gjithashtu vjen edhe nevoja për një sjellje të re qytetare që respekton pronën individuale, pronën e tjetrit dhe atë publike, nga e cila në fakt përfitojmë të gjithë si shoqëri. Detyrimi ligjor për zbatimin e këtyre koncepteve të reja kërkon krijimin dhe adaptimin e një mendësie të re profesionale si edhe sjellje të re qytetare, nevoja që tregojnë për një proces afatgjatë përpara implementimit të tyre.

Kërkesat për reformim të sistemit ligjor urban në vendin tonë, arritën të artikuloreshin në formë publike, vetëm pas vitit 2006, konkretisht gjatë një takimi në nivel kombëtar, zhvilluar në qershor të vitit 2006, nga ekspertë të fushës dhe përfaqësues të autoriteteve shtetërore. Gjatë diskutimeve u identifikuan problematikat dhe mangësitë e sistemit të planifikimit kryesisht si:

- hapësirat për interpretim të ligjit “Për Urbanistikën”
- mungesën e koherencës së parashikimeve ligjore me realitetin dhe nevojave për zhvillim të territorit në Shqipëri.
- mungesën e zbatimit të hierarkisë midis instrumentave të ndryshëm planifikues.
- mungesën e kufijve ndarës të interesit kombëtar, rajonal dhe vendor të cilat krijojnë përplasje midis autoriteteve zbatuese ligjore ekzistues duke shkaktuar vonesa në procedurat e zbatimit, ndërlikim dhe zgjatje të procesit subjekt për abuzime.

Megjithë angazhimin e aktorëve, në këtë takim kombëtar nuk u arritën ndryshime konkrete në kuadrin ligjor të planifikimit, megjithatë shënoi inicimin e një procesi të gjatë që do të konkretizohet në 2011 me hyrjen në fuqi të plotë të ligjit të ri Nr. 10119

‘Për Planifikimin e Territorit’. Pamundësia për të ndërtuar në këtë moment një kornizë komplekse ligjore dhe instrumentash planifikimi që do të mund të adresonte problemet e lidhura me zhvillimet hapësinore, prodhoi hartimin e një zgjidhjeje artificiale të fenomenit më dominues territorial të viteve 2000 në Shqipëri, ai i ndërtimeve informale, nëpërmjet miratimit të Ligjit për Legalizimet dhe Urbanizimin e Zonave Informale (L. 9482, ‘Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje’ , 2006). Nga disa studiuues vendas dhe të huaj informaliteti u pa si një zgjidhje ‘e natyrshme’ ndaj zhvillimit të padrejtë që shkaktoi regjimi i kaluar, por edhe hapja e menjëhershme e vendit drejt ekonomisë, tregut dhe lëvizjes së lirë individuale. Sot informaliteti dhe (mos)zbatimi i këtij ligji mund të gjurmohet si një nga shkaqet kryesore të fragmentimit të territorit dhe vështirësive të sotme për zhvillimin në ekonominë bujqësore, industrinë e ndërtimit, investimet në fushën e turizmit etj. Ndryshe nga vendet e rajonit, ku informaliteti lulëzoi si procedurë për shkak të vonësive administrative shtetërore për zhvillimin e pronës private të individëve që e zotëronin atë, në Shqipëri u legalizua “marrja e tokës” duke përfituar nga mungesa e qartësisë mbi titujt e pronësisë. Ambiguiteti që krijuan strukturat shtetërore për njohjen dhe kthimin e pronës private, favorizoi zënien e saj ilegale ndërkohë që lëvizjet demografike dhe hapja e tregut të lirë dhe iniciativës private, pa një sistem ligjor të fuqizuar për orientimin e tyre, solli një zhvillimin kaotik territorial.

Adresimi i pjesshëm dhe pa një zgjidhje ezauruese i fenomenit të informalitetit, i regjistrimit të pronave dhe mungesa e qartësisë të titujve të pronësisë, ishin faktorët kryesorë që kanë ndikuar negativisht në zbatimin e reformës së planifikimit në 2006 duke vazhduar impaktin prapësues deri në ditët e sotme.

Disa nga mangësitë e evidentuara të sistemit të planifikimit 1990-2009

Sistemi i planifikimit i viteve 1990-2009 u konsiderua i huaj ndaj reflektimit të disa kritereve të rrënjësura në vendet perëndimore në lidhje me parimet evropiane ku duhet të mbështetet procesi i planifikimit si:

- “Dokumenti i Bardhë për Qeverisjen Evropiane”, në të cilin termi "Qeverisje Evropiane" i referohet rregullave, proceseve dhe sjelljes që prekin mënyrën në të cilën ushtrohen kompetencat në nivel evropian, veçanërisht përsa i takon të qenit i hapur, pjesëmarrjen, llogaridhënien, efikasitetin dhe koherencën. Këto pëse "parime të qeverisjes së mire" përforcojnë ato të subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit. Ato aplikohen ndaj të gjitha niveleve të qeverisë – globale, Evropiane, kombëtare, rajonale dhe vendore.
- Rregulla të përdorshme, uniforme dhe të qarta: të gjitha rregullat që drejtojnë planifikimin territorial duhet të jënë të shkruara shume qarte dhe duhet që të jënë lehtësisht të përdorshme nga publiku. Në të gjitha aspektet, rregullat duhet të jënë uniforme përsa i përket zbatimit të tyre dhe t’i garantojnë pronarit të tokës një siguri të arsyeshme lidhur me mënyrën se si do të përdoren rregullat ndaj tokës se atij apo të asaj.
- Proces Transparent: Procesi me ane të cilit aplikohen rregullat për planifikimin territorial duhet të përmbajë: dokumentacion me shkrim për vendimet, mundësinë e palëve të interesuara për të rishikuar dokumentacionin dhe për të pare vëmendjen e treguar nga organet vendim marrëse dhe e drejta e palëve të interesuara për të shprehur mendimet e tyre rreth vendimeve përpara se të merren vendimet.

Një nga shqetësimet e ngritura në lidhje me procesin e planifikimit gjithashtu, ishte shkalla e lartë e paqartësisë dhe boshllëqeve ligjore, e cila shndërrohet në një pengesë

serioze në ndërmarrjen e iniciativave nga çdo aktor (publik ose privat). Konstatohen mangësi të trajtimit të çështjeve të rëndësishme si për shembull:

- Mungesa e përkufizimit të koncepteve ‘Menaxhim Urban’ si dhe ‘Interes Publik’;
- U vlerësua se sistemi rezultonte jo në përputhje me interesin për zhvillim pasi ishte formal, më procedura të tejzgjatura administrative. Boshllëqet në zbatim janë edhe më të theksuara, veçanërisht në mungesën e studimeve sociale, ekonomike, mjedisore, e deri tek masterplanet.
- Planifikimi i organizuar vetëm në nivelet e qeverisjes vendore e qendrore pa marrë parasysh perspektivat e zhvillimit rajonal. Mospërthithja e konceptit administrativ të ‘qarkut’ me konceptin evropian ‘të rajonit’ vështirëson planifikimin në nivel rajonal duke artikuluar këtu për herë të parë edhe nevojën për një reformë administrative, territoriale.
- Zbatimi në praktikë mbështetet kryesisht tek studimet pjesore ndërkohë, vihet re Ngurtësia e rregullave në procedurat e vendimmarrjes edhe në mbizotërimin e standardeve e procedurave taksative në dëm të fleksibilitetit dhe zgjedhjes më të mirë. Për shembull, në rastin e planifikimit urban distancat mes ndërtesave marrin vlerën e absolute ndërkohë që vendimmarrja duhet të tentojë drejt optimizimit të përdorimit të burimeve dhe cilësisë e jetesës. Sistemi i vitit 1991-2009 i planifikimit nuk parashikon ndarjen e qartë të kompetencave midis nivelit vendor dhe atij kombëtar.
- Duke ju referuar termave të ligjit “Për Urbanistikën”, dallojmë qartë se ndarja e kompetencave midis nivelit vendor dhe atij kombëtar nuk sjell funksionimin në mënyrë të pavarur të tyre, por përkundrazi çon në një sistem vendimmarrës me dy nivele, dhe në disa raste me tre, që ka si pasojë kryesore mbivendosjen e kompetencave në këtë fushë (Raport i Ministrisë së transportit). ‘Njësitë vendore duhet të kenë kompetenca të plota planifikuese dhe vendimmarrëse në lidhje me instrumentat të cilët trajtojnë çështje të planifikimit urban dhe nuk prekin interesat kombëtare, si për shembull Planet e Përgjithshme Rregulluese për ato çështje që nuk prekin interesat kombëtare.

Është e rëndësishme të theksohet se problematika që u evidentua në sistemin e planifikimit 1990-2000, nuk burojnë vetëm nga mangësitë e boshllëqet lidhur me kuadrin ligjor të atëherëshëm. Nevoja për të nisur një reformë ligjore të gjerë në fushën e planifikimit urban u vlerësua e domosdoshme edhe si pasojë e ndryshimeve të mëdha që njohu Shqipëria në 15 vitet e fundit në fushën ekonomike, sociale, demografike dhe sidomos atë të pronës. Të gjithë këto faktorë kanë ndikuar dhe nxorrën në pah nevojën e reformimit të disa sektorëve me qëllim përshtatjen me realitetin. Ligji Nr. 10 119, datë 23.4.2009 ‘Për Planifikimin e Territorit’, (tashmë i shfuqizuar), arriti të adresonte pjesën më të madhe të mangësive të artikuluar më lart. Kështu për herë të parë kemi: Reflektimin në ligj të parimeve themelore të planifikimit të qëndrueshëm gjithpërfshirjen, bashkërendimin, këshillimi dhe pjesëmarrja e palëve të interesuara, transparencën (Neni 56,57,58 Ligji 10119 ‘Per Planifikimin e Territorit’ i shfuqizuar) dhe detyrimin e publikimit të procesit dhe vendimmarrjeve në planifikim, të gjitha këto të rregulluara nëpërmjet instrumentave të reja të prezantuara si Regjistri Kombëtar i Territorit (Neni 51, Regjistri i planifikimit të territorit, Ligji 10119 ‘Per Planifikimin e Territorit’ i shfuqizuar.), Degjësat publike (Neni 37, Dëgjimi publik, Ligji 10119 ‘Per Planifikimin e Territorit’ i shfuqizuar), etj.

- Mundësinë për Ankimim neni 84,85 (L.10119, Për Planifikimin e Territorit, 2009) ndaj padrejtësive apo mos dakordësive të vendimmarrjeve nga këto akte ligjore

në fushën e planifikimit, duke demokratizuar procesin e planifikimit dhe respektuar të drejtat dhe liritë themelore në çështjet e zhvillimit të pronës.

- Novator është edhe prezantimi i rolit të planifikimit në edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut si dhe prezantimin e institucioneve koordinuese si AKPT (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit) me rol kryesor në koordinimin e autoriteteve planifikuese dhe sigurimin e përputhshmërisë së instrumentave të planifikimit si edhe të hartimit të programe trajnimi, edukimi e ndërgjegjësimi të publikut (kompetencat e plota, shih: Neni 91, Ligji Nr. 10119, PT).

Ligji, gjithashtu artikuloi për herë të parë disa parime shumë të rëndësishme të planifikimit të territorit, të cilat specifikuar në nenin 4 të tij, si: Zhvillimin e qëndrueshëm, Bashkëndimi mes autoriteteve të çdo niveli, Shumëllojshmërinë e instrumenteve, Planifikimi i detyrueshëm., Vazhdimësinë e instrumenteve, Transparenca, pjesëmarrjen dhe aksesin në informacion., Shërbimi me një ndalesë dhe pranimit në heshtje, Përshtatshmërinë e instrumentit ndaj specifikave të vendit, Delegimin dhe kontraktimin, Subsidiaritetin, Harmonizimi dhe përshtatja ndaj sistemeve apo standardeve europiane dhe Zhvillim gjithëpërfshirës dhe me shanse të barabarta ndaj territorit.

Megjithë tiparet e reja pozitive që sollën ndryshimet e 2009 në ligjin Per Planifikimin e Territorit, procesi për zbatimin e tij u përball me disa pengesa. Një nga problematikat e para me të cilat u ndesh zbatimi i ligjit, ishin nevoja për trajnim të stafit të ekspertëve urbanistë që operonin në zyrat e urbanistikës të pushtetit vendor. Së dyti, pamundësia për hartimin në kohë të planeve të reja territoriale për bashkitë e vendit, sipas parashikimeve të reja. Ligji ri edhe pse vendosi një kufij kohor arbitrar prej 2 vjetesh për të gjithë autoritetet lokale, me qëllim hartimin e planeve vendore për territoret e tyre administrative, stafi i kufizuar i këtyre bashkive si dhe mungesa e trajnimeve të mjaftueshme të tyre e bëri të pamundur plotësimin e këtij detyrimi ligjor.

Nën këto kusht, zgjedhjet politike të vitit 2013 që sollën edhe ndryshimin e aparatit shtetëror, u nxitën për të ndikuar më tej në reformën e nisur ligjore të planifikimit deri në ndryshimin e ligjit të 2009 me ligjin 107/2014 'Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit', ligj i cili edhe pse me shumë ndryshime, është edhe sot në fuqi.

Së pari, njëkohshmëria e tre reformave me domethenie të rëndësishme në realizimin e një sistemi planifikimi si: ndryshimet dhe detajimet ligjore, reforma institucionale dhe reforma administrative. Reforma institucionale lidhet me krijimin e një institucioni qendror, të dedikuar ekskluzivisht për zhvillimin urban, siç është Ministria e Zhvillimit Urban, ndërkohë që roli i AKPT si institucion vijoi të konsolidohej si koordinuese e proceseve dhe autoritetetve planifikuese. Reforma Administrative Territoriale e 2014, konsolidoi numrin e autoriteteve vendore nga 374 komuna dhe bashki në 61 bashki dhe rriti kompetencat e autoriteteve vendore në qeverisjen e territorit lokal.

Së dyti, Hartimi i planeve sipas hierarkisë ligjore, ku vëmendje ju kushtua hartimit të planit të Parë Kombëtar të Territorit. Njëkohësisht filloi edhe procesi i hartimit të planeve vendore për 61 bashkitë e reja. Sot bilanci i instrumentave të planifikimit në fuqi është pozitiv, dhe dëshmon për punën dhe nivelin e implementimit të këtyre reformave si edhe rëndësinë e këtij sektori në zhvillimin e qëndrueshëm.

Ligji 107/2014 prezantoi si detyrim ligjor hartimin e Analizës Metabolike në hartimin e planeve të të gjitha niveleve, edhe pse nuk ka arritur ende detajojë përmbajtjen dhe strukturimin, për të siguruar një zbatim cilësor të saj.

Zhvillimet dinamike të ekonomisë duket se ushtrojnë një presion të vazhdueshmë për moszbatim, anashkalim apo thjeshtëzim të praktikave të planifikimit, për këtë arsye është e rëndësishme fuqizimin e planifikimit, jo vetëm si praktikë, por edhe si shkencë

e zhvillimit të territorit. Prezantimi i metodologjive dhe koncepteve të reja si analizat metabolike të territorit, qasja sistemike ndaj territorit dhe hulumtimet mbi marrëdhëniet e raportit urban rurale mbeten ende të patrajtuara në mënyrë të thelluar duke u bërë shkas për një zbatim sipërfaqësor të ligjit .

3.3 Rëndësia e planifikimit të territorit në nivelin kombëtar

Pavarësisht se **planifikimi kombëtar** filloi të luante një rol të rëndësishëm përgjatë viteve 1990-të, akoma sot nuk ka një konsensus midis vendeve, në lidhje me formatin që duhet të ketë planifikimi në nivelin kombëtar, qoftë gjithëpërfshirës apo sektorial. Alterman i referohet më së shumti ‘planifikimit në nivel kombëtar’ sesa ‘planifikimit kombëtar’ sepse sipas saj planifikimi në nivel kombëtar do të thotë planifikim hapësinor që ndërmerret në nivel kombëtar, ndërsa planifikimi kombëtar është një nga modelet e planifikimit, por nuk është i vetmi (Alterman, 2001, p. 3). Sipas saj ‘planifikimi hapësinor në nivelin kombëtar mund të klasifikohet duke u bazuar në dy tipe skematike: gjithëpërfshirës dhe sektorial. Planifikimi gjithëpërfshirës kërkon që të ketë një vështrim të integruar dhe shumë-sektorial të fizibilitetit, si nga ana gjeografike ashtu dhe të drejtuar ndaj subjektit, dhe kërkon që të drejtojë përdorimin e tokës për të gjitha llojet e nevojave në një mënyrë të koordinuar [...] megjithëse gjithëpërfshirja e plotë është e vështirë për tu arritur, dhe shumë ‘planifikime gjithëpërfshirëse’ mund të jenë më pak gjithëpërfshirëse sesa ‘modeli ideal’. Në ekstremin tjetër, planifikimi sektorial merret me një sektor të vetëm të tilla si për shembull transporti, strehimi, bujqësia, parqet apo shëndeti. Zakonisht, planifikimi sektorial zhvillohet nga një agjenci specifike e cila është ngarkuar për të iniciuar projektet për atë fushë të caktuar. Shumë nga planifikimet e ditëve tona, të cdo niveli, dhe sidomos të nivelit kombëtar, mund të klasifikohen si diçka e ndërmjetme, midis planifikimit gjithëpërfshirës dhe atij sektorial’ (Alterman, 2001, p. 7).

Në fakt planet dhe politikat vetëm sektoriale kritikohen shumë për disa arsye. Ndodh shumë shpesh që në politikat sektoriale të ketë një mungesë koordinimi midis sektorit të planifikimit dhe sektorëve të politikave të tjera. Kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në dy lloje të çështjeve hapësinore: 1) vendimet që merren sipas prioritetit sektorial pa i kushtuar vëmendje marrëdhënies midis sektorëve të ndryshëm, ose pasojave të tjera hapësinore; dhe 2) incidenca e eksternaliteteve mund ose nuk mund të koincidojë me kufijtë administrativë, të tilla si bashkitë apo ndarjet e tjera të njësive administrative. Është për këto arsye, që është e rëndësishme që në plan të përfshihen çështje, aktorë apo marrëdhënie që përbëjnë një rrjet gjeografik midis planifikimit hapësinor dhe atij strategjik. “Një analizë nga perspektiva hapësinore është e rëndësishme për të promovuar një politikë më efikase dhe kohezive, për të adresuar çështje të ndryshme hapësinore” (OECD, Towards a New Role for Spatial Planning, 2001, p. 22). Po aq e rëndësishme është dhe zhvillimi i partneriteteve. Në shumë vende është vënë re kalimi nga një proces hierarkik dhe vertikal i hartimit të strategjive, drejt një procesi të bazuar më shumë te bashkëpunimi, partneriteti dhe negocimi. Në këtë drejtim, roli i planit në nivel kombëtar bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm si një standard koordinimi. Më përpara planifikimi ka qenë një rol i atribuar vetëm institucioneve publike. Tani, gjithmonë e më shumë, agjentë privatë të ndryshëm (qytetarë, biznese dhe shoqata që mbështesin interesa të ndryshme) gjithnjë e më shumë po përfshihen në proceset e planifikimit. Nevoja për përfshirjen e sektorit privat në projektet e infrastrukturës është gjithnjë në rritje në mënyrë që të përdoren burimet e tyre financiare, idetë krijuese dhe aftësitë e menaxhimit. Në shumë vende të botës, kontributi dhe pjesëmarrja e sektorit privat ka qenë në rritje dhe instrumente të reja të politikave janë prezantuar në mënyrë që të promovohen kompanitë privatë, qoftë vendase apo të huaja, në mënyrë që të

investojnë. Në këtë drejtim, planifikimi hapësinor synon të rrisë besimin e sektorit privat dhe publik në mundësitë e tyre për investime (OECD, Towards a New Role for Spatial Planning, 2001, p. 29). Megjithatë, praktika ka vënë në dukje, ashtu sikundër edhe në Shqipëri, se roli i institucioneve shtetërore është i domosdoshëm të paktën për koordinimin e procesit të planifikimit dhe respektimit të standarteve dhe kuadrit ligjor në fuqi. Për këtë arsye shumë studiues e lidhin procesin e planifikimit hapësinor me tiparin e *institucionalizimit* të tij.

Është e kuptueshme që politikat dhe metodat e planifikimit të vendeve lider të Bashkimit Europian të kenë influencuar qasjen e dokumentave me këtë temë si të ESDP apo edhe raportet OECD mbi rolin e planifikimit. Sisteme të shumta të planifikimit ekzistojnë rreth botës. Sidomos në Evropën Veri Perendimore planifikimi hapësinor ka evoluar në masë të madhe që nga fundi i viteve 1950-të. Edhe pse keto shtete mund të kenë dallime thelbësore të sistemit të planifikimit, referuar familjes ligjore apo administrative se ku ato bëjnë pjesë, influenca e tyre në keto dokumenta është e dukshme. Kështu psh. në Holandë, planifikimi është një nga institucionet kryesore kulturore të shoqërisë holandeze. Alexander (1992) e përshkruante planifikimin hapësinor në Holandë si një sistem që bazohet në një rregullore pasive, në të cilën lejohen ndërhyrjet pas një vlerësimi paraprak, në të cilin grupet e interesit konsultohen në një fazë të hershme të procedurës së planifikimit. Kompendiumi i planifikimit të BE-së e përshkruan sistemin e planifikimit holandez si një nga shembujt më domethënës të *sistemit gjithëpërfshirës , të integruar, në të cilin 'planet janë më të interesuar për koordinimin e aspektit hapësinor sesa zhvillimit ekonomik'*. Në vend që të punojë me master plane, planifikimi hapësinor në Holandë punon me dokumentet indikative (comprehensive) të politikës kombëtare. Planet staturore janë përgjegjësi e provincave dhe të bashkive dhe vetëm këto të fundit kanë të drejtën e refuzimit të lejeve të zhvillimit përmes planifikimit. Pjesa më e madhe e konsultimeve dhe negociemeve në këtë mënyrë ndodh për të integruar politikat e niveleve të larta të qeverisë në plane dhe politika të niveleve të ulëta. Qeveria qendrore është burimi kryesor i financimit të planeve në të gjitha nivelet, dhe ka shumë ndikim në këtë marrëdhënie. Sistemi i planifikimit holandez është i udhëhequr nga plani: asgjë nuk mund të zhvillohet nëse nuk është në përputhje me planin lokal të përdorimit të tokës, përderisa kjo gjë kërkohet ligjërisht. Megjithatë, zhvilluesit e pronës mund të ushtrojnë një ndikim të rëndësishëm në përmbajtjen e planit. Praktika e planifikimit është e ndikuar në mënyrë të fuqishme nga mënyra informale në përdorimin e rregullave formale i cili njihet ndryshe si *pragmatizmi administrativ*. Ndryshimet më të rëndësishme në planifikimin hapësinor në Holandë gjatë viteve të fundit kanë ndodhur me zhvillimin e strategjisë së planifikimit të ri hapësinor, e cila u miratua gjatë vitit 2006 (Nadin & Stead, 2008, p. 41). Kjo strategji e re përbën një ndryshim radikal me traditën centralizuese në të cilën qeverisja kombëtare përcakton në detaje ato që ndërtohen dhe se ku ndërtohen. Filozofia kryesore e kësaj strategjie është *'decentralizo nëse është e mundur dhe centralizo nëse është e nevojshme'*.

Akti i parë ligjor i planifikimit hapësinor në Holandë i përket vitit 1965, dhe që nga ajo kohë është amenduar disa herë. Për shembull, në vitet 1990-të, legjislacioni u amendua për të shpejtuar zhvillimin e projekteve të mëdha (të tilla si zhvillimet infrastrukturore, digat e lumenjve). Por puna për një ligj të ri të planifikimit hapësinor filloi në vitet 2000, kur u vendos që të mos vazhdohej më me kornizën ligjore të vitit 1965, por për të zhvilluar një të re. Ligji i ri i Planifikimit Hapësinor u miratua në vitin 2006 ndërsa hyri në fuqi në vitin 2008. Ndërkohë që akti i ri ofroi më shumë mundësinë për negociim në planifikim, sistemi i planifikimit megjithatë ruan një orientim të fortë të udhëhequr nga plani.

Një nga ndryshimet e aktit të planifikimit që është më domethënëse, është rritja e pushtetit të planifikimit të qeverisjes qendrore ndaj pushtetit planifikues të bashkive (pavarësisht se fokusi kryesor është decentralizimi në strategjinë hapësinore më të fundit). Planifikimi i ri hapësinor në Holandë, për shembull i jep qeverisë kombëtare dhe atyre të provincave pushtet më të fortë ndaj bashkive, duke bërë që këto të fundit të ndjekin në mënyrë më strikte dhe të detyruar direktivat dhe politikat e miratuara më lart. Akti i ri i planifikimit do të bëjë të mundur që qeveria qendrore dhe ajo vendore të jenë në gjendje që të ndërhyjë më shpejt kur janë vënë në lëvizje interesa të mëdha, të cilat mund të interpretohen si krijimi i një sistemi planifikimi më të centralizuar që binte ndesh me principin e Hollandës si një shtet unitar i decentralizuar (Nadin & Stead, 2008, p. 43). Nga ana tjetër, studiues të ndryshëm theksojnë që sistemi i Hollandës duket sikur ka më shumë ngjashmëri me sistemin e Japonisë, Koresë së Jugut dhe të Irlandës. Në këto vende, brenda kornizës së planifikimit hapësinor, qeveria në nivelin kombëtar duket se luan tre role qendrore:

- Për të analizuar dhe përthithur tendencat globale dhe evropiane, dhe evidentimin e skenarëve që mund të ndihmojnë përgatitjen për zhvillimet e ardhshme;
- Për të formuluar integrimin e politikave afatgjatë përgjatë fushave të planifikimit hapësinor, zhvillimit ekonomik dhe social si dhe zhvillimit mjedisor;
- Për të krijuar kushtet e përshtatshme për zhvillimin rajonal dhe lokal, përfshirë kontributin për hartimin e politikave evropiane në mënyrë që të ketë sa më shumë rëndësi për kontekstin e zhvillimit rajonal’.

Ashtu siç konkludon dhe raporti i (OECD, Towards a New Role for Spatial Planning, 2001, p. 14) ‘përgjatë viteve 1990-të, u prezantuan shumë instrumente të reja inovatore përsa i përket planifikimit hapësinor në shumë vende anëtare të OECD-së. Qeveritë e ndryshme ndërtuan strukturat administrative dhe ministeriale për të mbështetur koordinimin sektorial; ato kanë gjithashtu kompetenca të decentralizuara për nivelin rajonal në mënyrë që të arrihet integrimi sektorial; dhe së fundi ato janë përpjekur që të përforcojnë dhe të modernizojnë sistemet e planifikimit të tyre hapësinor në mënyrë që të menaxhohet më mirë koordinimi horizontal dhe vertikal. Gjurmët e metabolizmit mund ti gjejmë në planifikimin në nivel kombëtar, sipas këtij raporti, i cili shprehet se metabolizmi e ndihmon planifikimin në disa aspekte: “... *madhësia e duhur e qytetit, aksesit efikas së jashtëm dhe së brendshëm, lëvizshmëria, forma dhe struktura e përshtatshme e sistemit urban apo hierarkia urbane dhe nivelet e kompaktësisë së vendbanimeve janë elementë vendimtar në përcaktimin jo vetëm të mirëqenies së popullsisë lokale, por gjithnjë e më tërheqëse për lidhjet me firmat e jashtme dhe efikasë për aktivitet e vendosura aty tashmë*” (OECD, Towards a New Role for Spatial Planning, 2001, p. 154).

Alterman thekson se, planifikimi në nivel kombëtar përgjithësisht asociohet me vendet totalitare me pushtet të përqendruar nga ‘lart -poshtë’ si ato të ish vendeve të Bashkimit Sovjetik, por, një instrument i tillë i pasuruar me elementet e reja që reflektojnë një shoqëri lirë e demokratike, paraqitet i rëndësishëm për të siguruar kohezionin territorial dhe zhvillimin e qëndrueshëm të një vendi. Gjithashtu, Alterman (2001) konkludon se, vendimi për të zhvilluar planifikimin hapësinor në nivel kombëtar nuk është dicka e paracaktuar nga një sërë variablash specifike që tregojnë që është i ‘nevojshëm’ ky lloj planifikimi. Por është një çështje zgjedhjeje e vendimmarrësve dhe e votuesve. *Planifikimi kombëtar* ndikon në përdorimin e burimeve urbane dhe gjithashtu mundet që të reduktojë konsumin në një rajon të caktuar.

Planifikimi hapësinor në nivel kombëtar është dhe një mjet për ndërtimin e kombit. Shembulli i mësipërm i Holandës është marrë për shkak të historisë së saj të gjatë të planifikimit, dhe rolit të saj si një nga vendet pararojë të planifikimit hapësinor në nivel kombëtar. Studiuesit ia kanë atribuar këtë pararojë në planifikim, ‘nevojës ekzistenciale për të menaxhuar ujërat në ultësirat tokësore të saj dhe nevojës kombëtare për rifitimin e tokës’. Kështu, megjithëse gjatë dekadave të fundit, infrastruktura kryesore dhe politikat mjedisore janë kthyer në rutinë dhe nevojat kryesore janë plotësuar, sërish planifikimi hapësinor në nivel kombëtar nuk është dobësuar. Përkundrazi, studiuesit e kanë zhvendosur fokusin e tyre drejt sfidave për ndërkombëtarizimin e ekonomisë, dhe sesi të konkurohet më mirë brenda një bashkimi shtetesh si BE-së, ruajtjes së mjedisit, dhe për të plotësuar nevojat për strehim (Alterman, 2001, p. 16). Gjithashtu, edhe Japonia dhe Izraeli, megjithëse kaq larg nga ana gjeografike, socialisht dhe historikisht, janë më të afërtat për sa i përket rolit të tyre për përdorimin e planifikimit kombëtar si një mjet për ndërtimin e shtet-kombit.

Analiza dëshmon se shkaqet që nxitën një vend si Shqipëria për të adoptuar planifikimin në nivel kombëtar qëndron jo vetëm në huazimet e reja ligjore dhe në nevojën për harmonizim të kuadrit ligjor që lehtëson procesin e anëtarësimit në BE, por edhe si një instrument i rëndësishëm për të ndikuar në zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtjen e mjedisit, uljen e pabarazive ndërmjet rajoneve, plotësimin e nevojave për strehim etj. Gjithashtu, duhet theksuar fakti, se studimet dhe praktikrat e vendeve të Bashkimit Europian, si edhe nga kërkimi i praktikës së Shqipërisë:

- Planifikimi në nivel Kombëtar nuk duhet të ngatërrohet me planifikimin e qendëruar të zhvillimit të shtetit shqiptar, ku e kaluara komuniste e viteve 1945-1991 ka dhënë dëshmi të qarta të falimentimit të kësaj metode, përkundrazi duhet përkrahur si një vizion i përbashkët i zhvilluar mbi parimet e transparencës pjesmarrjes dhe demokracisë që ofron një strategji për zhvillim afatgjatë e të integruar të vendit.
- Planifikimi në nivel kombëtar ka një rol të dyfishtë pozitiv; nga njëra anë tenton të orientojë vendimmarrjet politike më tepër drejt zgjidhjeve të bazuara në të dhëna shkencore se sa në aksione elektorale, dhe nga ana tjetër roli i të mësuarit të aktorëve që marrin pjesë në hartimin e tij, por edhe i shoqërisë është i rëndësishëm.
- Ka nevojë për zhvillimin e metodave teknike të thelluara të planifikimit hapësinor të bazuara në të dhëna të sakta e të përditësuara, të cilat mund të ofrojnë skenarë të ndryshëm zhvillimi të vendit brenda kufirit në rolin e forcimit të zhvillimit dhe zbutjes së pabarazive por edhe ndërkufitar, në forcimin e mrrdhënies me rajonin e më gjerë për një zhvillim konkurrues dhe inteligjent.
- Rritja e vëmendjes së akademisë dhe instituteve të kërkimit në çështjet e planifikimit hapësinor kombëtar është vendimtar për zhvillimin e këtij instrumenti, rritjen e dobishmërisë së tij dhe rritjen e shkallës së zbatimit të tij.

Të gjitha këto diskutime do të ilustron në anatominë e dokumentit të parë të planifikimit kombëtar në vendin tonë mënyra e miratimit dhe e konceptimit të ‘Planit të Përgjithshëm Kombëtar- Shqipëria 2030’.

3.4 Plani i parë kombëtar ‘Shqipëria 2030’

Ashtu siç u përmend edhe më sipër, kuadri i ri politik i vendit në vitet 2009-2013 dhe nga viti 2013 e në vijim, ndikoi drejtpërdrejt në kërkesat për një qasje të re në

planifikim. Ligji i ri mbi planifikimin e territorit i miratuar në 2009 dhe i ndryshuar në 2014, shoqëruar me ngritjen e institucioneve politike e administrative përkatëse (Ministria e Zhvillimit Urban MZHU) si edhe presioni për europianizim në prag të një ndienje të përgjithshme kombëtare për çeljen e negociatave për anëtarësim, sollën në përfshirjen e programit politik për 100 ditët e para të MZHU nisjen e procesit për hartimin, e më pas miratimin e një plani kombëtar që do të orientonte zhvillimin për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Çështja e ndërtimeve informale e zvarritur për gati një dekadë vazhdoi të identifikohet si një faktor pengues për zhvillimin e territorit, por reforma në planifikim sërish nuk arriti të zgjidhë çështjen e ndërtimeve informale dhe Ligji për legalizimet vazhdoi paralelisht të zbatohet gjatë këtyre viteve sëbashku me ligjin e ri dhe hartimin e planeve të reja kombëtar dhe vendore. Kjo përplasje midis misionit për planifikim si kusht i vetëm dhe i nevojshëm për udhëheqjen e zhvillimit dhe vijimit të “tolerancës” për zhvillime informale paralajmëroi cedimet e para në zbatim të planeve të reja të hartuara. Ndërkohë, hartimi dhe përmbajtja e dokumentit të parë të planifikimit kombëtar territorial, përshkruhen si dëshmi e rolit të autores si drejtuese në proces dhe kontribuese në hartim.

Nxijtja për hartimin e një dokumenti si PPK erdhi së pari, për të orjentuar bashkitë e reja që rezultuan nga Reform Administrative Territoriale me një territor dhe popullsi për menaxhim disa herë më të madh se territori i mëparshëm urban i kufizuar nga zonat e urbanizuara. Së dyti, të madh planet e reja vendore në proces hartimi PPK Plani i ri kombëtar synon të shërbejë si dokument orientues për hartimin e koordinuar të planeve të reja sektoriale dhe vendore në proces rihartimi, dhe së dyti për të plotësuar një detyrim të ligjit i cili komandon hartimin e planeve territoriale sipas nivelit hierarkik. Vështirësitë e identifikuar në fillim të procesit mund të grupohen në:

- mungesa e një metodologjie dhe i një modeli paraprijës i cili do të mund të siguronte bazat dhe kuadrin referues.
- mungesa e të dhënave të përditësuara në nivel kombëtar dhe të detajuara sipas nivelit më të vogël administrativ, të nevojshme për kryerjen e analizave në shkallë të ndryshme të territorit.
- informacioni për planifikimin sektorial i shprehur nga ministrinë përgjegjëse përmes Strategjive Sektoriale të sektorëve rezultonin të papërditësuara në lidhje me të dhënat e sektorit dhe parashikimet për zhvillimin në 10 vitet e ardhshme.

Mungesën e një modeli paraprak për hartimin e një dokumenti të tillë e zëvendësoi dokumenti strategjik i nivelit europian: ESDP, kryesisht për orientimin e politikave shtyllë kurriore të PPK, modeli holandez i hartimit të strategjisë kombëtare të zhvillimit në mënyrën e një qasjeje strategjike për ndërtimin e vizionit të zhvillimit, si edhe modeli gjerman⁵.

Mundësia për implementimin e politikave të dokumentit ndryshojnë në përputhje me territorin gjeografik ku ato aplikohen, prandaj i ESDP rekomandon tre nivele kooperimi hapësinor: në nivel komuniteti, niveli kombëtar dhe ndërkombëtar, niveli lokal dhe rajonal (EC, Committee on Spatial Development, 1999, p. 35).

Karakteristikat kryesore që identifikojnë nivelet e mësipërme dhe territorin e studiuar variojnë nga pozicioni gjeografik, fuqia ekonomike, integrimi social, shkalla e integritit hapësinor, presioni mbi përdorimet e tokës, menaxhimi i aseteve natyrore dhe kulturore.

Edhe pse ESDP u hartua edhe me synimin për të bërë më efektive politikat në nivel europian të infrastrukturës, mjedisit, bujqësisë etj., shprehu qartë udhëzime mbi

⁵ Shënim: Grupi i punës së ekspertëve nga AKPT dhe MZHUT u asistuan nga GIZ përmes një programi që siguroi konsulencë teknike nga eksperte të ndryshme nga Departamenti i Planifikimit të Përbashkët të Shtetit Berlin-Brandenburg.

politikat e orientimit hapësinor, të vendosura edhe në themel të hartimit të PPK ‘Shqipëria 2030’ si: Zhvillimi hapësinor policentrik dhe një marrëdhënie e re urbane-rurale; nxitja e Qyteteve Dinamike, Tërheqëse dhe Konkurruese në Rajone të Urbanizuara; një qasje e integruar për lidhje të përmirësuara të transportit dhe aksesit në dije; Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë natyrore, etj.

Të gjitha këto politika u adresuan në dokumentin e ri të planit kombëtar përmes organizimit të sistemeve territoriale dhe projekteve strategjike, por nuk arritën të materializoheshin në tregues të matshëm, të unifikuar dhe të krahasueshëm. Rekomandimet mbetën në nivel strategjik dhe parimor, jo vetëm për shkak të mungesës së të dhënave por edhe me qëllim që plani kombëtar të ishte një kornizë orientuese, parimore dhe jokufizuese.

Koncepti i planifikimit kombëtar mbetet i ri, abstrakt dhe i pa kuptuar mirë ende në sektorët e zhvillimit në nivel qendror dhe vendor në Shqipëri, ndaj PPK u hartua si një dokument orientues strategjik, pa kufinj të prerë zonimi apo tregues të ngurtë, duke paraqitur një model zhvillimi të bazuar tek kooperimi dhe ndërkëmbimi midis sektorëve (ndërsektorial) dhe niveleve të qeverisjes (ndërvendor) apo/edhe ndërkufitar duke patur si far orientues parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe politikat e orientimit hapësinor të mësipërm.

Në lidhje me mungesën e të dhënave cilësore, Plani u mbështet në rezultatet e Census 2011 dhe botimet e të INSTAT që ofronin një interpretim cilësor të këtyre të dhënave si “Lëvizjet vajtje-ardhje për qëllime punësimi”(2014), “Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare” (2014) dhe “Tipologjia e komunave dhe bashkive”(2014) për herë të parë në këto botime kemi edhe një interpretim hapësinor të të dhënave statistikore. Disa nga përfundimet statistikore më të rëndësishme që orientuan PPK ishin:

- Për herë të parë “popullsia urbane e Shqipërisë rezultoi 58,2% e popullsisë së përgjithshme, të përcaktuar me tipologjinë e re të BE-së. Vlera e saj është 10% më e lartë sesa e popullsisë urbane të përcaktuar sipas kriterëve administrative (qytete të përcaktuara me ligj), 47,7 %” (INSTAT, Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare, 2014, p. 45).
- Rajoni Tiranë - Durrës ka përqindjen më të madhe të fluksit të lëvizjeve vajtje ardhje për qëllime punësimi. Ndryshimi midis popullsisë vendbanuese të zakonshme dhe popullsisë ditore, vlen veçanërisht për popullsinë e Tiranës, ku rezultoi në një fluks pozitiv neto prej 25 mijë individësh. Matja e ndikimit të flukseve ditore te popullsia me vendbanim të zakonshëm konfirmon rolin mbizotërues të luajtur nga bashkitë më të mëdha shqiptare në sistemin e ndërveprimeve ditore hapësinore.
- Ndryshimi i strukturës së punësimit ku ‘të punësuarit në bujqësi përbënin gjysmën e popullsisë në vitin 2001, ndërsa në 2011 janë vetëm 27,1% e të punësuarve gjithsej’. (INSTAT, Lëvizjet vajtje-ardhje për qëllime punësimi, 2014, p. 97)

Si edhe një sërë përfundimesh të tjera bazuar në metodologji statistikore të aplikuara nga OECD: Sipas metodës së re të BE-së për matjen e shkallës së urbanizimit të njërive vendore, rezultoi se në Shqipëri ka vetëm ‘10 njësi vendore të cilat mund të klasifikohen si urbane (zona me dendësi të lartë); 57 janë zona me dendësi të ndërmjetme dhe 306 janë njësi vendore rurale (zona me dendësi të ulët). Pesë rajonet statistikore shqiptare të nivelit NUTS 3 janë klasifikuar në bazë të tipologjisë së re urban-rural të BE-së. Vetëm rajoni i Tiranës është me ‘mbizotërim urban’. Rajonet e Durrësit dhe Vlorës janë ‘të ndërmjetme’. Rajonet e tjera shqiptare janë me ‘mbizotërim rural’ (INSTAT, Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare, 2014, p. 45). Figura 12 paraqet klasifikimin e komunave dhe bashkive sipas të dhënave statistikore të Census 2011

sipas statusit: Qendra Urbane, njësi vendore periferike, ndërsa Figura 13 paraqet rrjetin e qendrave urbane sipas hierarkisë dhe mënyrat e ndërhyrjes në territor.

Në këtë mënyrë informacioni i përpunuar i të dhënave të Census 2011 nga INSTAT rezultoi i vlefshëm për punën e hartimit të PPK, por ashtu si do të theksohet edhe në dokument, të dhënat statistikore dhe interpretimi i tyre, paraqesin vetëm një fotografim të ngurtë, në një moment të caktuar kohor (ditën e kryerjes së census 2011) mbi territorin dhe njerëzit që e banojnë atë, duke u shoqëruar në këtë mënyrë me disa kufizime të rëndësishme në saktësi dhe fragmentim të të dhënave:

- saktësia e të dhënave varet nga vullneti për të marrë pjesë apo jo në Census i qytetarëve apo nga prania rastësore në banesë gjatë kryerjes së Censurit;
- niveli i fragmentimit të të dhënave statistikore të mbledhura për 1km², reflekton modelin e aprovuar sipas EUROSTAT, dhe niveli i agregimit të tyre nga INSTAT publikohet në nivel Qarku, njësi administrative joqeverisëse dhe një shkallë jo e kënaqshme nga pikëpamja e nevojave të hartimit të politikave urbane.




Figura 3-2: Tipologjia e komunave dhe bashkive sipas Census2011, INSTAT




Figura 3-3: Rrjeti i qendrave urbane sipas hierarkisë dhe mënyrat e ndërhyrjes në territor, PPK2030, MZHU, AKPT 2014

Ndaj, mund të pohojmë se, edhe pse politikat e planifikimit kanë nevojë për një lexim të qartë të situatës së dhënë përmes statistikave, ato synojnë të formulohen drejt

realizimit të një vizioni dhe jo vetëm në reflektimin e gjendjes ekzistuese. Modeli statistikor ofron përgjithësimin e nevojshëm të një gjendje ekzistuese zhvillimi dhe jep informacion për forcat shtytëse të zhvillimit, por nuk mjafton për të arritur në përkufizime ezauruese të politikave të zhvillimit hapësinor. Një shembull i tillë është psh. rezultati i përfuar për ndarjen urbane/rurale që ofron metoda statistikore, e cila nuk merr në konsideratë kriteret të tjera me rëndësi për zhvillimin hapësinor. Ndërkohë që metoda e ndjekur nga INSTAT është plotësisht legjitime dhe e vlefshme për krahasimet statistikore të vendit tonë me ato të Bashkimit Europian, ajo vështirë se i përgjigjet shkallës së zhvillimit, historikut, kulturës dhe fragmentimit territorial të vendit tonë. E thënë ndryshe, nëse nga analiza statistikore rezultojnë se ‘në Shqipëri ka vetëm 10 njësi vendore të cilat klasifikohen si urbane’ apo ‘Rajonet statistikore shqiptare të nivelit NUTS 3 janë klasifikuar në bazë të tipologjisë së re urban-rural të BE-së. Vetëm rajoni i Tiranës është me ‘mbizotërim urban’. Rajonet e Durrësit dhe Vlorës janë ‘të ndërmjetme’. Rajonet e tjera shqiptare janë me ‘mbizotërim rural’ (INSTAT, Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare, 2014, p. 45), gjë e cila përjashton nga ky përkufizim elementë të tjerë të rëndësishëm që duhen konsideruar si psh: tradita historike e zhvillimit të një qyteti a rajoni, investimet strategjike infrastrukturore që rrisin peshën specifike të një rajoni apo territori në zhvillimet urbane, potencialin për ndërlidhje ndërkufitare për shkak të pozicionit strategjik etj. Të gjithë këto elementë e më tepër janë konsideruar në PPK Shqipëria 2030 në një hierarkizim të ri të qendrave urbane dhe klasifikimin e tyre si qendra rajonale, qendra urbane qendra të talentuara dhe qendra rurale (MZHU&AKPT, 2016, p. 64) . Më tej duhen zhvilluar disa specifikime në sistemin urban dhe hierarkizimi i qendrave urbane. Yi-FU-Tan (1977), shprehet se [...] ‘nëse e shohim botën si një proces, vazhdimisht në ndryshim, nuk e kemi të mundur të zhvillojmë një sens vendi’. Në këtë mënyrë koncepti i kohës duhet përfshirë si një faktor në planifikimin hapësinor ku ndryshimi i vazhdueshëm ndodh dhe dokumenti dhe vete disiplina e planifikimit duhet të evoluojë me të në përmbushje të qëllimit të tyre.

Në Shqipëri, procesi i planifikimit hapësinor po ndodh disa dekada më vonë se zhvillimet legjislativë në vendet e zhvilluara evropiane, por vetë hartimi i PPK Shqipëria 2030 u bazua në 3 hapa të rëndësishëm dhe plotësues të njëri-tjetrit:

1. Analiza metabolike e territorit, si një model që përdoret për identifikimin dhe analizën e flukseve të materialeve dhe të energjisë brenda territoreve të caktuara. Ky model u ofron studiuesve një kuadër, nëpërmjet të cilit të studiojnë ndërveprimet e sistemeve natyrore dhe njerëzore në rajone të caktuara.
2. Hartimi i Deklaratës së Vizionit.
3. Planifikimi Strategjik, si një teknikë që zbatohet për njësi të qeverisjes vendore, zona metropolitane, rajone dhe integron çështjet sociale, ekonomike, financiare, territoriale, mjedisore, të qeverisjes, institucionale dhe ligjore në një kornizë të vetme. Përcakton zhvillimin mbi bazën e vizionit dhe mundëson objektiva, programe dhe plane veprimi për zbatim. Nuk ka natyrë të ngurtë rregullatore. Krijon mënyra për të adresuar sfidat, për të shmangur pengesat dhe përdorur mundësitë dhe burimet në mënyrë eficiente. Gjithashtu ai realizohet me pjesëmarrjen e të gjithë grupeve të interesit (MZHU&AKPT, 2016, pp. 19-20). Procesi i analizës metabolike të territorit u bazua në skanimin e territorit dhe u bë i mundur nëpërmjet: i) strategjive sektoriale të miratuara dhe në proces hartimi të ministrive dhe institucioneve qendrore; ii) takimeve ndërministrorë, seminareve me ekspertë vendas dhe të huaj, shoqëruar me vizita në territor; iii) mbledhjes dhe analizës së të dhënave për flukset me ndikim më të madh në

zhvillimin e territorit: uji, ushqimi, energjia dhe turizmi (MZHU&AKPT, 2016, pp. 19-20).

‘Qëllimet e PPK përfshijnë përfitimet mjedisore dhe përfitimet sociale. Ndër përfitimet sociale përfshihen: (a) Nxit kohezionin territorial nëpërmjet zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social të rajoneve dhe përmirëson konkurrencën; (b) Përkrah zhvillimin e gjeneruar nga funksionet urbane mikse dhe përmirëson marrëdhënien mes zonave urbane dhe zonave rurale; (c) Promovon aksesibilitet; (d) Rrit aksesin në njohuri dhe informacion; (e) Zvogëlon dëmet mjedisore; (f) Mbron dhe përforcon resurset natyrore dhe të trashëgimisë kulturore, (referuar ligjit nr. 9048, datë 07/04/2003 "Për trashëgiminë kulturore", i ndryshuar); (g) Përforcon trashëgiminë kulturore si faktor zhvillimi; (h) Zhvillon burimet energjetike ndërkohë që ruan sigurinë; (i) Nxit turizmin cilësor dhe të qëndrueshëm; (j) Kufizon impaktin e fatkeqësive natyrore (MZHU&AKPT, 2016, p. 21). Ndër konstastimet dhe orientimet kryesore të PKK-së për sistemet territoriale janë që: ‘Struktura hapësinore dhe territoriale e Shqipërisë është ndikuar fort nga përqendrimi i investimeve dhe infrastrukturës ekzistuese, të cilat kanë influencuar vendosjen dhe përqendrimin e vendeve të punës dhe të vendbanimeve’ (MZHU&AKPT, 2016, p. 56). Struktura hapësinore dhe territoriale është ndikuar edhe nga struktura e punësimit. Kjo e fundit ka ndryshuar në 25 vitet e fundit: së pari, si pasojë e ndryshimeve të modelit ekonomik e politik, nga një shoqëri me ekonomi të centralizuar dhe bazë pronën shtetërore, në një model bazuar në tregtinë e lirë dhe pronën private; së dyti, struktura e punësimit ka ndryshuar edhe për shkak të investimeve, të cilat janë ndikuar nga afërsia dhe cilësia e infrastrukturës lidhëse dhe komunikuese, shërbimeve ndihmëse apo të kualifikimeve dhe potencialit intelektual të njerëzve të aftë për t’u punësuar, që ofrojnë qytete dhe zona të caktuara (MZHU&AKPT, 2016, p. 56).

Në formulimin e Vizionit të PPK shërbeu puna paraprake në hartimin e “Metabolism of Albania”. Grupi i punës, përmes takimeve me ekspertë të fushave të ndryshme ndërtoan hartat konceptuale “anekdodike” të cilat paraqesnin në menyre të koncentruar potencialet dhe problematikat e zhvillimit hapësinor të vendit. Hartimi i Deklaratës së Vizionit u zhvillua më tej si rezultat i një procesi mbështetur nga ekspertë të sektorëve prioritarë të zhvillimit të vendit, pranë institucioneve qendrore dhe përfaqësues të shoqatave e organizatave jofitimprurëse. Hartimi i Vizionit ndoqi metodologjinë dhe procesin e përshkruar nga ESPON⁶ për hartimin e Vizionit Territorial (TEVI) Europe 2050. Ndër qëllimet kryesore të dokumentit që shprehen që në fillim në deklaratën e vizionit janë:

- Realizimin e integritetit hapësinor të vendit dhe të shpërndarjes së balancuar të flukseve brenda territorit të tij, ngritja dhe forcimi i një pozite ekonomike të fortë dhe konkurruese të Shqipërisë në rajon (ndër të tjera plani inkurajon projekte që rrisin ekonominë e vendit);
- Planifikim i hapësirës për të mundësuar ripërtëritjen e ekosistemeve dhe hapësira inteligjente e prodhimtare. Sigurimi i integritetit fizik territorial të peisazhit kulturor, natyror dhe urban në të gjithë territorin shqipëtar (në planifikimin e përdorimit të tokës, ndiqet parimi i zhvillimit sa më përfshirës);

⁶ Shënim i Autorit: ESPON (European Spatial Planning Observation) është program i BE-së që ka pasur në fillim qëllimin të marrë hapa konkrete drejt zbatimit të ESDP (European Spatial Development Perspective), veçanërisht për përmirësimin e njohurisë, kërkimit dhe informacionit për zhvillimin territorial dhe për t’u përgatitur për zgjerimin e territorit të BE-së. Aktualisht, misioni i ESPON 2020, është të vazhdojë punën për konsolidimin e Rrjetit të Observatorit Territorial Europian, dhe të fuqizojë ofrimin dhe përdorimin politik të të dhënave territoriale të besueshme, sistematike dhe të krahasueshme.

- Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për njerëzit (duke promovuar rritje ekonomike , duke eliminuar pabarazitë hapësimore, duke rritur aksesin në infrastrukture, duke nxitur bashkëveprimin e në të njëjtën kohë duke promovuar identitetin. Në këtë kuptim duhet kuptuar e mira publike e planifikimit në tërësi dhe e PPK në veçanti).

Shqipëria një Qendër e Integruar në Sistemin Ekonomik dhe Infrastrukturor Europian, një Ekonomi e Shumëllojshme dhe konkurruese në Hapësirën Ballkanike, një Shtet që Synon Barazinë në Aksesin në Infrastrukturë, Ekonomi dhe Dije, Siguron Mbrojtje të Trashëgimisë Natyrore, Historike dhe Kulturore me Synimin për t'u Shndërruar në një Destinacion Autentik.

Tabela 3.4-1 Deklarata e Vizionit PPK 2030 (MZHU&AKPT, 2016, p. 35)

PPK zgjedh një përafrim nga një kuadër më i gjere; reflektimi mbi kushtet e vendit në kontekstin Europian dhe Ballkanik, në një panoramë me të ngushtë në nivel kufijsh administrativë shtetëror.

Së pari, vendos në një kalendar investimesh strategjike projektet afatgjata, impakt me të lart ekonomik dhe integrues të vendit. Realizimi në afatgjatësi i tyre bën që ato të duhen të konsiderohen nga çdo qeverisje politike si prioritare.




Figura 3-4: Vendosja e Shqipërisë në raport me korridoret ekonomike me rëndësi europiane. Aksi industrial, Brezi i Diellit, Linjat e pritshme të zgjerimit (MZHU&AKPT, 2016, p. 50)

Figura 3-5: Diagrama e Vizionit PPK 2030, përcaktimi i drejtimeve kryesore të lidhjeve me korridoret ekonomike me rëndësi europiane dhe detajimi i infrastrukturës kombëtare për të arritur këtë qëllim.




Figura 3-6 Hierarkia e Instrumentave të planifikimit të territorit sipas ligjit 107/2014. Përpunoi autori, AKPT(2016).

mëparshme politike dhe ekonomike janë:

- Procesi i hartimit me pjesëmarrje dhe i integruar, me të gjitha nivelet e qeverisjes. Hartimi i PPK u mundësua nga shkëmbimi i njohurive dhe eksperiencës mes grupeve teknike në nivele të ndryshme qendror ndërministror.
- Transparenca, për herë të parë një instrument planifikimi i nivelit kombëtar realizon procesin e dëgjësive dhe takimeve konsultative me publikun.
- Përputhja ligjore, një plan me fuqi ligjore pasi miratohet, në ndryshim nga cdo instrument i mëparshëm planifikimi, si një akt nënligjor me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 881, datë 14.12.2016.
- Hedh bazat për vizion të integruar zhvillimi me bazë rajonale.
- Përmbajtja, prezanton në mënyrë konkrete strategji planifikimi për të siguruar zhvillim policentrik dhe gjithpërfshirës.

Në këtë mënyrë, 'Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) "Shqipëria 2030" mbetet instrumenti më i lartë i planifikimit territorial në Shqipëri, i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke e parë territorin shqiptar si një të tërë. Në bazë të parimeve, objektivave dhe specifikimeve të tij, do të detajohen planet e hierarkive më të ulëta, Planet kombëtare sektoriale (PKS), Planet e detajuara për zonat e rëndësishme kombëtare (PDZK), Planet për zhvillimin rajonal (PZHR), Planet sektoriale në nivel qarku (PSNQ), Planet e përgjithshme vendore (PPV) dhe çdo instrument tjetër planifikimi territorial, që buron si rrjedhojë e nevojave për zhvillim. PPK ofron kornizën strategjike referuese për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, për 15 vitet e ardhshme, me qëllim sigurimin e zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social të vendit,

Së dyti, zgjidh konfliktin hierarkik të predominimit të një sektori ndaj një tjetri në një hapësirë të caktuar territoriale, në këtë rast të sektorit infrastrukturor ndaj sektorëve të tjerë. Duke argumentuar zgjidhjen dhe impaktin me përfitimin më të lartë, duke eliminuar konfliktet apo mbivendosjet e mundshme nga strategjite sektoriale.

Së treti, korridoret rrugore që lidhin vendin me kontinentin për herë të parë vendosen në një nevojë për zhvillim të njëkohshëm me portet kryesore si ato të Durrësit, Vlorës, Shëngjinit dhe Sarandës. Vetëm në këtë mënyrë këto akse nuk përfundojnë në pika të 'vdekura' por ndërkëmbehen me korridoret e transportit ujor.

Tiparet kryesore që e bëjnë PPK të parin dhe të vetmin plan për zhvillim kombëtar, unik nga planet dhe programet e

menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore të tij, mbrojtjen e mjedisit, duke siguruar njëkohësisht edhe përdorimin racional të tokës⁷.

Një risi e PPK Shqipëria 2030, është trajtimi i Sistemit Urban, prezantimi i metodave për hierarkizimin urban dhe bazat për zhvillimin rajonal. Ndryshimet ligjore nga Ligji 8405 “Për Urbanistikën” në ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, u shoqëruan me disa boshllëqe në përcaktimin e Sistemit Urban. Kështu në Ligjin për Urbanistikën, një nga konceptet përfaqësuese si ai i Vijës së Verdhë e cila përcaktonte kufirin e zonës së urbanizuar dhe njëkohësisht atë të zonës së planifikuar, bëri që të gjitha planet lokale rregulluese nën këtë ligj të hartohen vetëm për territore brenda kësaj vije, pavarësisht kufirit administrativ. Zbatimi i këtij kufizimi rezultoi jo real nën dritën e zhvillimeve urbane të 1991-2006 e akoma edhe sot, me shfaqjen e zonave informale të cilat ishin shtrirë gjerësisht në kufijtë e zonave urbane përtej vijës së verdhë duke vërtetuar se aty ku vendoset një kufi lindin dhe spekulimet. Me ndryshimet e reja ligjore që ndodhën pas vitit 2013, koncepti i vijës së verdhë ra edhe nga pikëpamja formale, së pari për shkak të mos efektivitetit në zbatimin e saj, arbitraritetit të kufirit urban rural që përcaktonte dhe mospërputhjes me realitetin e zhvillimit të ri urban. Kështu u krijua një boshllëk në terminologjinë e identifikimi dhe të metodave për zhvillimin e mëtejshëm të territorit të urbanizuar.

Pavarësisht objektivit pozitiv, për të përfshirë në instrumentat e planifikimit lokal të gjithë territorin administrativ të një bashkie, përfshirë territorin urban dhe territorin rural të tyre, ligji i ri nuk solli udhëzime për mënyrën e menaxhimit të tyre, mënyrën e planifikimit, duke e lënë evazive procesin e planifikimit dhe të marrdhënies së re urbane rurale. Në këtë hapësirë kohore, i vetmi instrument ligjor që mbron territoret e lira natyrore apo tokat bujqësore nga ‘dëshira për ndërtim’ dhe urbanizimi ekstensiv, janë ligjet sektoriale për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe deri diku përdorimet e tokës sipas planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura mjedisore. Edhe pse keto dy instrumente paraqesin të njëjtat mangësi si Vija e Verdhë në lidhje me mungesën e përditësimit me realitetin, ato qëndruan në fuqi ligjore dhe përmbushën misionin e tyre pjesërisht.

Në planet lokale të hartuara në këtë periudhë argumentimet për zgjerimin e zonave të urbanizuara në territore të reja mungonin ashtu si edhe parimet e mëparshme që udhëzonin planifikuesit për rastet se kur mund të propozonin zgjerim të zonave urbane. Vetëm në PPK 2030 u prezantua qasja për “densifikim në përputhje me kapacitetin mbajtës” për urbanizimin dhe në ndryshimet e fundit të ligjit u riprezantuan koncepti i zonave të urbanizuara dhe vija e gjelbër. Megjithatë, edhe sot, nuk kemi në kuadrin ligjor të planifikimit përcaktime të qarta për urbanizimin si proces dhe qasjen e planifikimit ndaj fenomenit. Metodot e përcaktimit të zonave të urbanizuara gjatë kësaj periudhe në Shqipëri vijnë përmes Vendimi i KKT, Nr.5 datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”⁸. Në raportin shpjegues që shoqëron vendimit thuhet se:

‘Evidentimi i zonave të urbanizuara është realizuar nëpërmjet qarkimit të sipërfaqeve të tokës, të cilat rezultojnë të ndërtuara, pasi tashmë e kanë humbur funksionin e tyre primar të prodhimit bujqësor apo të kategorive të ngjashme, për shkak të veprimtarisë ndërtimore që është ushtruar mbi to. Gjithashtu, janë përfshirë në zonat e urbanizuara

⁷ Plan i Përgjithshëm Kombëtar “Shqipëria 2030”, fq.18.

⁸ Burimi:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3018&token=8e50c84a20a9079e87ed6d1a47fbc0ae9fc065ce>

edhe ato sipërfaqe, të cilat rrethohen ose lidhin me njëra-tjetrën, sipërfaqe të ndërtuara të gjendura fare pranë, duke mundësuar kështu krijimin e grupimeve kompakte gjithandej ku zhvillimi urban i pakontrolluar ka ndryshuar karakterin e territorit duke mos lenë mundësi të ardhme për një zhvillim tjetër (bujqësor, natyror, e të ngjashme) përveç atij urban’.

Megjithatë, metodat e përcaktimit të zonave të urbanizuara janë objekt i një kërkimi tjetër bashkë me mungesat dhe boshllëqet që e karakterizojnë atë, por ajo që duhet theksuar, është se planet e reja lokale të hartuara nga 2013-2016 përfituan paraprakisht nga përmirësimet, sado të vogla të ligjit në këtë drejtim dhe nga politikat orientuese të Planit të Përgjithshëm kombëtar të Territorit mbi zhvillimin urban.

3..5. Sistemi Urban dhe Hierarkia e Qyteteve

Qytetet janë sisteme, një set qytetesh janë gjithashtu një sistem. Një sistem urban është një rrjet i pavarur qendrash urbane. Planifikimi hapësinor ngrihet mbi përcaktimin e hapësirës euklidiane tredimensionale, dhe pasurohet me variabla të paprekshëm, zhvillimi kulturor e social edhe këto të ndryshueshme në kohë. Këto themele ekstra-empirike e afrojnë hapësirën më tepër me perkufizimin e Kantit për të: Hapësira nuk është dicka tjetër në botë, por një realitet i krijuar nga ndërveprimi i arsyes njerezore me atë botë. Prandaj ajo reflekton tiparet e të dyve: të observuesit dhe objektit të observuar. Në termat më të përgjithshëm, një sistem urban mund të perkufizohet si çdo rrjet i vendeve të ndërvarura urbane. Çdo ndryshim i rëndësishëm në një qytet do të ketë pasojë për qytetet e tjera në sistem⁹.

Sistemi i qendrave urbane që prezantohet në PPK 2030 kërkon të jetë i standartizuar, gjithëpërfshirës me një hierarki vendesh (qytetesh), të cilat përbushin funksione komplekse për zonat urbane dhe rurale përreth. Qendrat urbane janë epiqendra të jetës ekonomike, sociale dhe kulturore, në të gjithë territorin kombëtar. Sipas funksionit dhe klasifikimit të tyre në sistemin urban, ato marrin përsipër funksione/detyra/shërbime për komunitetet dhe territorin që mbulojnë. Nevoja për prezantimin e hierarkizimit të qendrave urbane në politikat e planifikimit hapësinor, vjen në Shqipëri pas rënies së planifikimit të qendëruar të para viteve ‘90 dhe fillimit të zbatimit të politikave të “decentralizimit”.

Rritja e lirisë së politikave urbane në nivelin vendor nën vakumin e koordinimit të tyre në nivel qendror nxiti për 20 vjet, një zhvillim kaotik urban, më tepër drejt metodës ‘*laissez faire*’ të udhëhequr nga forcat e ekonomisë së tregut. Kjo prodhoi një polarizim urban të theksuar drejt rajonit qendror Tiranë Durrës dhe drejt disa qendrave urbane kryesisht në Ulëtisrën Perëndimore për pasojë depopullimin dhe rënien e ndjeshme të ekonomisë në qytetet e pjesës lindore dhe të periferive rurale. Në mungesën e një vizioni gjithëpërfshirës për zhvillimin e ekuilibruar urban-rural, të gjitha qytetet hartuan politika zhvillimi sikundër një kryeqytet duke krijuar një kuadër aspak realist për shpërndarjen e financave qendrore në ndihmë të pushtetit lokal. Hierarkia është një nga karakteristikat themelore të sistemeve komplekse siç janë qytetet dhe rrjetet e qyteteve. Identifikimi i hierarkisë urbane jo më si pasojë e monopolizimit të shpërndarjes së investimeve dhe ekonomisë shtetërore, por si një reflektim për realizimin e një vizioni zhvillimi gjithëpërfshirës, afatgjatë e cilësor është i rëndësishëm dhe përbën një obligim të dyanshëm (të qeverisjes në nivel qendror dhe vendor) për zhvillimin e balancuar hapësinor. Vendosja e kategorizimit nga ana tjetër, përbën thelbin e zhvillimit të qëndrueshëm, duke përqendruar dhe diferencuar sasinë dhe tipin e projekteve sektoriale

⁹ Berry, B.J.L. (1964). Cities as systems within systems of cities (Qytetet si sisteme brenda sistemeve të qyteteve). Papers of the Regional Science Association. Vëll 13, fq.146–163.

sipas karakteristikave dhe veçorive të tyre të këtyre qendrave urbane drejt zhvillimit policentrik dhe inteligjent Sistemit Urban.

Sa më lart mund të themi se tre janë elementët kryesorë që karakterizojnë organizimin e Sistemit Urban në PPK:

Së pari, realizimi i vizionit të zhvillimit policentrik shpjeguar në paragrafin më lart. Në kapitullin e Sistemit Urban të PPK2030, plani prezanton “Zhvillim policentrik dhe Inteligent” me fokus nxitjen e zhvillimit të “ Qyteteve dinamike dhe krijuese” dhe mënyrat për arritjen e tij në kontekstin vendas me:

- krijimin e një marrëdhënie të re midis hapësirës urbane dhe asaj rurale;
- ekspansioni fizik i qyteteve dhe zonave të urbanizuara, duke promovuar densifikimin në vend të shpërhapjes urbane;
- planifikimin për infrastruktura multimodale;
- Funksione mikse dhe komplementare të rajoneve ;
- Përdorim dhe menaxhim inteligjent i sistemit urban në veçanti të flukseve të ujit, energjisë dhe mbetjeve;
- menaxhimi i pasurive natyrore dhe të trashëgimise historike kulturore, në kuptim të përmirësimit dhe të aktivizimit të këtyre aseteve në jetën urbane.

Së dyti, zhvillimi mbi modelin teorik të *Christaller* për qendrat urbane si një nga politikat e vetme që pavarësisht kritikave, ka arritur të argumentojë teorikisht zhvillimin e sistemit urban dhe sistemin e qyteteve, dhe së treti ndërtimi i sistemit mbi të ‘talentet’ e qyteteve dhe potencialin e ardhshëm për zhvillim. Metodologjia e hierarkizimit të qendrave urbane merr nisjen nga teoria e vendeve qendrore¹⁰. Në këtë teori, vendi qendror ka funksion primar të sigurojë të mira dhe shërbime për popullsinë përreth. Shkalla e ndikimit të vendit qendror është funksion i zonës së shërbimit dhe përmasa e kësaj zone shërbimi do të përcaktojë natyrën e organizimit hapësinor. Organizimi i mjedisit të individit dhe një shoqërie objektivisht ekziston që nga lindja e njerëzimit¹¹. Modelet e vendosjes dhe të lëvizjes së njeriut në territor, aglomerimi në vendbanime në varësi të resurseve territoriale por edhe tërheqjes dhe ngjashmërive kulturore e sociale kanë qenë objekt i teorive të shumta që në fillim të shekullit të XIX. Kështu kanë qenë organizimi në sisteme të vendbanimeve në raport me tokën bazuar në Teorinë e Vendosies (Location theory) nga Von Thunen (1826) në lidhje me produktin bujqësor, Weber (1909) për vendosjen e industrive në raport me tregun dhe burimin e dy resurseve primare, mbi shërbimet dhe tregtinë (Reilly: 1931, Christaller: 1933) deri tek Hagerstrand në vitin 1953 ku për herë të parë organizimi hapësinor i tejkaloi përcaktimet ekonomike dhe u orientua edhe drejt çështjeve kulturore dhe sociale. Diagrami i paraqitur në figurën e mëposhtme është hipotetike dhe përfaqëson modelin e një qyteti koncentrik multi - nyjor me një rrugë unazore. Për qëllime të këtij plani, qendrat urbane dhe hierarkizimi i tyre janë mbështetur në konceptet bazë të metodës së vendeve qendrore, por janë pasuruar me reflektimet që burojnë nga funksione shtesë më dinamike, të cilat lidhen me:

¹⁰ Teoria e vendeve qendrore është kontribut i gjeografit gjerman Ëalter Christaller, i cili zhvilloi kerkime për sistemin urban të Gjermanisë Jugore gjate viteve 1930. Kryesisht Christaller kerkonte te gjente ndervaresine ne marrredhenien midis mases, numrit dhe shperndarjes gjeografike te qyteteve. Edhe pse puna e tij ishte kryesisht empirike, pjesa teorike pati nje impakt te thelle ne gjeografine urbane. Vezhgimet e tij mundesuan perpunimin e teorise se rregullit te shperndarjes se struktures hapesinore, thelbesore ne studimet urbane, ekonomike, te transportit dhe te gjeografise urbane.

¹¹ Klapka, P., Frantál B., Halás M., Kunc J., “Spatial Organisation: Development, Structure And Approximation Of Geographical Systems, Vol. 18, 3/2010 Moravian Geographical Reports.

- Infrastruktura e rëndësishme kombëtare ekzistuese dhe të propozuar;
- Përqendrimin dhe veçorinë e vendosjes në raport me burimet karakteristike natyrore;
- Balancimin e presioneve dhe kërkesave për zhvillim urban kryesisht në pjesën perëndimore;
- Zbutjen e tendencave të shpopullimit dhe varfërisë kryesisht në rajonet periferike lindore;




Figura 3-7: Sistemi i vendeve qendrore sipas principit të tregut me tre renditje qendrash (PKK 2030)

Figura 3-8: Modeli hipotetik i një qyteti multinyjor (MZHU&AKPT, 2016).

Figura shfaq në mënyrë të thjeshtuar sistemin e vendeve qendrore sipas principit të tregut me tre renditje qendrash. Në këtë rast zona e shërbimit të një qendre të rendit më të lartë, përfshin ekuivalentin e tri zonave të tregut të qendrave që pasojnë të një rendi më të ulët.

Hierarkia e qendrave urbane përshtatet në një pjesë të madhe me një hierarki të niveleve të shërbimeve që ata përqendrojnë, të organizuara nga frekuenca e përdorimit, amplituda e diapazonit të tyre hapësinor dhe madhësia e pragjeve të tyre të shfaqjes. Teoria është përdorur nga planifikimi hapësinor, veçanërisht për të zbatuar vendosjen e grupeve në Holandë, ose gjithashtu për të justifikuar politikën e "métropoles d'équilibre" në Francë. Përdoret gjithashtu si model referimi nga arkeologët që studiojnë sistemet e lashta të vendbanimeve (Pumain, 2004).

Kriteret për organizimin e sistemit urban sipas PPK 2030 i japin një peshë specifike më të lartë treguesve që lidhen me investime të rëndësishme publike (aktuale ose në të ardhmen e afërt) në sektorë të ndryshëm ekonomik, zhvillimit tradicional historik si qendër primare, pozicionit gjeografik në kuptimin e potencialit të zhvillimit të lidhjeve ndërkufitare etj. më konkretisht, kriteret për hierarkinë e qendrave urbane nga PPK renditen më poshtë:

1. Popullsia
2. Dendësia urbane

3. Zhvillimi ekonomik
4. Burime ekonomike
5. Infrastruktura me rëndësi kombëtare: - Korridore rrugore - Korridore energjetikë;
6. Porte
7. Aeroporte
8. Qendra historike me rëndësi ndërkombëtare (psh qendrat urbane të trashëgimisë UNESCO)
9. Burime natyrore me rëndësi kombëtare e rajonale.

Është e kuptueshme që jo të gjitha qytetet e vlerësuara si qendra primare urbane plotësojnë të gjithë kriteret e mësipërme, por PPK-ja vlerëson se në 15 vitet e ardhshme, me realizimin e investimeve të projekteve strategjike të propozuara në PPK, do të realizohet nxitja e nevojshme për zhvillimin ekonomik dhe social të tyre (MZHU&AKPT, 2016, p. 64). *Faktorët shtesë që propozohen nga PPK dhe që ndikojnë hierarkinë e qendrave urbane dhe mëtej organizimin rajonal të vendit janë:*

- Ndërlidhja dhe shkalla e aksesit, e përcaktuar nga infrastruktura me rëndësi kombëtare ekzistuese dhe apo në planifikim;
- Burimet natyrore ekzistuese dhe korridoret energjetike me rëndësi kombëtare e rajonale;
- Mundësia e rritjes së përqendrimit të popullsisë dhe potenciali për kualifikim i forcës punëtore;
- Asetet unike të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore, që ndikojnë në potencialin për zhvillimin e qendrës si destinacion autentik (zonat e trashëgimisë UNESCO etj);
- Funksionet dhe aktivitetet ekonomike të specializuara sipas aseteve (zonat me pasuri nëntokësoree minerare).

Së treti, prezantimi i një modeli i zhvillimit urban që shkon përtej modelit statistikor dhe ndihmon politkat administrative territoriale në konsolidimin e tyre¹². Me miratimin e Reformës së re Administrative territoriale gjatë procesit të hartimit të planit, hierarkizimi i qendrave urbane erdhi si një politikë që synonte të drejtonte qeverisjen e territorit dhe investimet në përputhje me kërkesat e reja të zhvillimit urban, në zonat e planifikuara për zhvillim (polet e reja të zhvillimit urban) sipas karakteristikave të tyre në funksione të specializuara drejt talentëve që rajoni paraqiste dhe komplementaritetit me rajonet fqinje (MZHU&AKPT, 2016).

¹² Shpjegim i autorit: Kujtojmë se gjatë hartimit të PPK miratohet Reforma Administrative territoriale që konsolidoi pushtetin lokal dhe territorin në administrim të tyre nga mbi 300 komuna e bashki në 61 bashki, si edhe faktin që një qëllim i PPK është krijimi i bazave për zhvillim rajonal.




Figura 3-9: Klasifikimi i qendrave urbane sipas periferialitetit. Burimi: INSTAT, PPK2030

Përkufizimet e territorit Urban dhe Rural nga planet e përgjithshme vendore dhe legjislacioni në fuqi. PPV Tiranë për sistemin urban:

Plani i Përgjithshëm Vendor Tiranë Neni 7 - hierarkia territoriale

1. Përtej përcaktimit të 5 sistemeve, territori urban i Bashkisë Tiranë është klasifikuar në tre makro klasifikime për qëllim planifikimi dhe administrimi, në një ndarje hierarkie sipas zhvillimit aktual dhe të propozuar në territor, si vijon:

- a. territor urban
- b. territor sub-urban
- c. territor rural

2. Plani përcakton si “territor urban” sipërfaqen e territorit të ndërtuar apo në proces zhvillimi dhe rihvillimi, të përbërë nga territor urban kompakt, me densitet të lartë dhe mesatar, ku mbizotërojnë funksionet urbane të banimit, të shërbimit publik, kulturore, ekonomike dhe tregtare.

3. Plani përcakton si “territor sub-urban” të gjithë territorin periferik të territorit urban, me dendësi mesatare, të përbëra nga vend-banime nga ndërtime ku mbizotërojnë funksionet e banimit dhe industriale apo tregtare, në proces formalizimi dhe konsolidimi.

4. Plani përcakton si “territor rural” të gjithë territorin, të vendosur kryesisht përtej kufijve të territorit sub-urban, ku bëjnë pjesë grumbullimet e vogla tradicionale urbane si fshatrat, si dhe ndërtesat e shpërndara në territory të ndërthurura me territoret bujqësore dhe natyrore, ku ekonomia bazohet kryesisht në bujqësi dhe blegtori.

Pra, siç vihet re, kriteret e PPV Tiranë për dallimin mes Urbanes dhe Rurale mund të renditen në:

Territor Urban:

- o territori i ndërtuar apo në process zhvillimi
- o kompakt
- o densitet i lartë dhe mesatar
- o funksionet: banim të shërbimit publik, kulturore, ekonomike dhe tregtare

Territor Sub-urban:

- o periferik i territorit urban
- o dendësi mesatare
- o funksione industri, tregti,

Territor Rural:

- o pertej territorit suburban
- o grumbullimet e vogla tradicionale urbane si fshatrat
- o banesa të nderthurura me territore bujqesore
- o ekonomi kryesisht bujqesore dhe blegtorale

Për të plotësuar vakumin mbi fenomenin e urbanizimit, disa ndryshime u prezantuan edhe në kuadrin ligjor. Kështu përkufizime u dhanë për sistemet territoriale dhe mënyrën e klasifikimit të tyre si edhe përkufizime të termave “Urbanizim”, ri prezantohet kufiri për përmbajtjen e shpërhapjes urbane me nocionin e :“Vija e gjelbër” për më tepër Kutia 1. Ndërkohë me hartimin e planeve tqë reja të Përgjithshme Vendore , disa bashki tentuan të prezantonin në varësi të kontekstit urban specifik të tyre klasifikimi dhe përshkallëzimin e nivelit të urbanizimit në territorin e tyre, kuadrati i mësipërm.

Kutia 1- klasifikimi i territorit sipas legjislacionit në fuqi

Ligji 107/2014, **Neni 1, pika 31, 34, 36**

“Sistem territorial”, bashkësia e një seri përbërësish territorialë për qëllime planifikimi, të ndërvarur dhe

“Urbanizim”, procesi i ndërhyrjes në territor nëpërmjet zhvillimeve të reja, i cili sjell ndryshime të strukturës së popullsisë dhe territorit, në funksion të rritjes së sistemit urban.

“Vija e gjelbër” ose “Kufiri i territorit urban”, perimetri që përcakton/kufizon shtrirjen territoriale të ndërtimeve në funksion të sistemit urban. Në këtë kufizim nuk hyjnë ndërtimet që janë në funksion të sistemit bujqësor dhe natyror.

i) leximi i territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor;

Neni 75 Sistemet territorial, pika 3 dhe 5

Sistemi urban (UB) formohet nga tërësia e vendbanimeve urbane dhe rurale, territoreve të ndërtuara ku kryhen funksione dhe aktivitete social-ekonomike. Sistemi urban kufizohet nga vija e gjelbër.

Sistemi bujqësor (B) formohet nga tërësia e tokave bujqësore të zëna me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtet, me veçori thelbësore të saj pjellorinë e tokës, si dhe infrastruktura e objektet në funksion të aktivitetit bujqësor. Ky sistem është rezultati i ndërveprimit në kohë të aktiviteteve njerëzore për kultivim dhe ndërtime me karakter bujqësor në territor.

Së katërti, krijimi i bazave për një model zhvillimi me bazë rajonesh. Një nga tiparet më të dallueshme të fund shekullit XX lidhet ngushtë me krijimin e qyteteve dhe rajoneve si hapësira të rëndësishme në ekonominë dhe politikën kombëtare e globale. Përballë globalizimit dhe procesit të integritit ku ndodhet Shqipëria, krijimi i rajoneve paraqet potencialin më të lartë për zhvillim ekonomik në nivel kombëtar dhe nxit qëndrueshmëri në rritjen ekonomike dhe të lidhjeve nërkufitare. Rajoni si një formë organizimi hapësinor, që bën të mundur lidhjen midis territorit, politikës dhe ekonomisë përbën një sistem fleksibël që ndihmon decentralizimin, siguron ekonominë e shkallës, lehtëson marrëdhënien institucionale dhe më gjerë. Gjithsesi rajonalizimi mund të ndodhë vetëm nëse komponentë strategjikë të caktuar brenda këtyre hapësirave, si qytetet dhe zonat rurale përreth, bashkëpunojnë më ngushtësisht për rritjen e përfitimeve të përbashkëta. Për pasojë, pranohet gjerësisht se nëpërmjet bashkëpunimit me përfitim të përbashkët, krijohet një vlerë e shtuar për rajonet, mbi normën e përfitimit që mund të arrihet, nëse qendrat urbane do të zgjidhnin të zhvilloheshin në mënyrë individuale. Në fillimet e një riorganizimi territorial në Shqipëri, ku sukcesi i parë u arrit me miratimin e Reformës Administrative Territoriale, rajonalizimi pritet të jetë hapi i ardhshëm në mbështetje të Integritit European të vendit dhe në zbatim të rekomandimeve të Strategjisë së

Decentralizimit. Teoritë aktuale të nyjeve rajonale dhe hierarkitë e vendeve qendrore sigurojnë bazat për njohjen të organizimit të gjerë të qyteteve në rrjete, gjë që kontribuon në shpërndarjen e ekuilibruar të cilësisë së qyteteve.

Plani prezanton 7 pole ekonomike parësore të identifikuara si pole të zhvillimit rajonal. Në hartat e mëposhtme për secilin pol të zhvillimit rajonal prezantohen: Qendrat e banuara; Infrastruktura me rëndësi kombëtare e fokusuar kryesisht te rrjeti i transportit dhe ai energjetik; dhe Ndërhyrjet territoriale; konsolidimi, rigjenerimi, përforcimi, rrizhvillimi, fuqizimi dhe kooperimi në bazë të një vlerësimi cilësor të sektorëve bazë ekonomikë të rajonit, bujqësi, energji - industri, turizmi dhe zhvillimi urban. Në qendër të polit të zhvillimit rajonal ndodhet të paktën një qytet-portë. Diversifikimi i propozuar vjen me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së sektorëve bazë të ekonomisë, bujqësi, turizëm, industri etj.




Figura 3-10: Modeli i zhvillimit hapësinor, AKPT Figura 21 harta e hierarkisë së qendrave urbane




Figura 3-11: Polet e zhvillimit dhe ndërhyrjet ne territor Gjirokastrë –Sarandë dhe Vlorë Fier Berat, AKPT, PPK 2030.

Megjithë përpjekjet në PPK 2030 dhe në PPV e bashkive të reja, deri më tani nuk kemi një metodë thellësisht të hulumtuar dhe të aplikuar që do të mund të maste shkallën e urbanizimit dhe për pasojë efektin e politikave në drejtim të zhvillimit policentrik dhe të balancuar hapësinor. Metoda e propozuar nga PPK jep indikatorë të drejtë, gjerësisht

të përdorur edhe në vende të tjera për këtë qëllim, por jo ezaurues dhe mbi të gjitha mbështetet në vlerësim cilësor të tyre sesa sasiorë. Një mënyrë për dizenjimin e një metode të aplikueshme dhe shkencore propozon ; së pari identifikimi i indikatorëve të dakordësuar, së dyti, zberthimi i tyre në nënindikatorë përbërës dhe së treti kuantifikimi i tyre dhe caktimi i një peshe specifike për secilin prej tyre. Një model të ngjashëm ofron Modeli Gjerman aktual sipas për shembull ofron një sistem të tillë rankimi:

Treguesi	Përbërësit e treguesit/nënindikatorët	Pesha
Popullsia	<ul style="list-style-type: none"> - numri i popullsisë, - balanca e migrimit në 7 vitet e fundit, - projeksioni i popullsisë në 10 vjeçarin e ardhshëm, - rritja e popullsisë në% 	25%
Punësimi dhe ekonomia	<ul style="list-style-type: none"> - numri i të punësuarve, - densiteti i të punësuarve për 1000 banorë, - rritja e punësimit, - struktura e ndërmarrjeve (>250 të punësuar), - bilanci i udhëtarëve 	- 25%
Vendndodhja, aksesibiliteti dhe lidhjet	<ul style="list-style-type: none"> - vendndodhja në % e popullsisë në lidhje me aksesin në transportin publik brenda 60 min, - në transportin privat brenda 60 min, - afërsia me nyjen më të afërt autostradale, - cilësia e lidhjes me transportin hekurudhor, - sasia e lidhjeve hekurudhore 	25%
Shërbimet publike	<ul style="list-style-type: none"> - Shkollat sekondare dhe profesionale publike, - Spitalet, shkëmbimet tregtare (tregtare turnover / fuqinë reale blerëse; e indeksuar), - funksionet e mëparshme qendrore etj. 	25%

Tabela 3.4-2: Rankimi i shkallës së urbanizimit sipas modelit gjerman

Tabela e mësipërme, ka vend për thellim, dhe kërkim të mëtejshëm të parametrave dhe treguesëve, s si këto mund të përdoren në kontekstin tonë, për është një ilustrim që na kërkon të shkojmë drejt rankimit dhe peshimit të indikatorëve që përdorim për ndërtimin e sistemit të qendrave urbane. Peshimi i secilës karakteristikë të mësipërme është i rëndësishëm për çdo vend, duke bërë që vende të ndryshme të zgjedhin një sistem hierarkik qendrash. Në këtë mënyrë, ashtu siç u shpjegua edhe gjatë zhvillimit të këtij kapitulli PKK Shqipëria 2030 paraqet një risi sepse janë prezantuar metoda të reja për hierarkizimin urban dhe janë hedhur bazat për zhvillimin rajonal, duke bërë që Sistemi Urban të trajtohet në një mënyrë të re.

4 KAPITULLI IV _METABOLIZMI I SHQIPËRISË

4.1 Zbatimi i Metabolizmit, Niveli Kombëtar

Metabolizmi i Shqipërisë, u zhvillua si një projekt kërkimor midis Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Zhvillimit Urban, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe grupit të bashkëpunëtorëve nga: *Interantional Architecture Biennale of Rotterdam*, të cilët sapo kishin përfunduar një projekt të ngjashëm mbi metabolizmin e qytetit të Roterdamit dhe përfaqësuesve nga Agjencia e Mjedisit e Holandës (PBL) me eksperiencë në matjen e flukseve të burimeve natyrore nëpërmjet *sankey diagrams dhe MFA*, profesorit dhe kërkuesit David G. Simmons dhe studiove arkitekturore dhe kërkimore përmes dizajnit si 51N4E dhe Fabric. Ndryshe nga rastet e përshkruara në kapitullin e dytë, ku flukset metabolike sipas metodës së përcaktuar nga OECD maten sipas të dhënave dhe indikatorëve sasiorë të mirëpërcaktuar, Metabolizmi i Shqipërisë u bazua në të dhëna të grumbulluara përmes informacionit nga takime me ekspertë shqiptar të fushave të ndryshme në vitin 2013-2014. Mungesa e të dhënave të detajuara sipas nënjësive administrative dhe të përditësuara në vite, bënë që një pjesë e mirë e të dhënave në nivel kombëtar të siguroheshin nga burime si FAO për bujqësinë, IEA për energjinë dhe FAO e CIA FACT Book për ujin. Këto burime shërbyen për ndërtimin e hartave në nivel kombëtar për flukset e: Ujit fig. 21-22, për fluksin e Energjisë fig.25-26 etj. Metoda për mbledhjen e të dhënave u emërua DOCA si Data, Oportunities, Challenges and Anecdotes (të Dhëna, Mundësi, Rreziqe dhe Histori). Në këtë mënyrë, përmes të dhënave dhe dëshmimeve të njohurive nga ekspertët pjesëmarrës në takime u hartuan hartat territoriale të flukseve të burimeve. Për herë të parë, në hartat e metabolizmit të Shqipërisë, flukset e burimeve marrin shprehje hapësinore. *Nisur nga koncepti i sistemit urban si 'ekosistem artificial' që mund të arrijë të njëjtën eficiencë si ekosistemet natyrore, Metabolizmi i Shqipërisë e projektin zhvillimin hapësinor jo më si përcaktim vendndodhjeje, por si ndërlikim të flukseve të burimeve dhe materialeve. Kufiri administrativ bie dhe kufiri i sistemit përcaktohet nga, ndërtimi i marrëdhënieve midis flukseve dhe mbyllja e cikleve të përdorimit dhe reduktimit e mbetjeve.* Nga ana tjetër konfigurimi i sfidave hapësinore në nivele të ndryshme dhe të ndërkëmbyeshme nga lokale në rajonale, kombëtare dhe anasjelltas vjen më natyrshëm dhe pa kufizime përmes flukseve metabolike. Në këtë mënyrë përcaktimi i ndërhyrjeve të nevojshme në nivelin e duhur bëhet më e thjeshtë pasi identifikohet problematika si pjesë e një sistemi. Ndryshe nga rastet e evidentuara në kapitullin II, Metabolizmi i Shqipërisë nis sipas një qasje analitike, por nuk mbetet në zgjidhje teorike. Fokusi në flukset më kryesore si Uji, Ushqimi, Energjia janë 'nexus' i sfidës për zhvillim të qëndrueshëm pasi janë flukset që janë nën presionin më të madh të zhvillimit dhe ato që do të kenë ndikimin më domethënës në kontekstin e Shqipërisë. Veçoritë e qasjes së metabolizmit të Shqipërisë mund të përmbliken në:

- Krijimi i bazave për ndërtimin e të dhënave dhe të njohurive mbi flukset kryesore të zhvillimit hapësinor dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme;
- Të menduarit mbi problemet dhe zgjidhjen e tyre në sisteme komplekse ku integrohen nivelet dhe ndërkëmbehen flukset;
- Propozimi i Projekteve strategjike që burojnë nga transformimi i njohurisë dhe vizualizimi hapësinor i sfidave dhe oportuniteteve. Dekonstruktimi dhe rikonceptimi i hapësirës për zhvillim në përputhje me sfidat e sistemit dhe të flukseve të burimeve.



Figura 4-1 Harta e Fluksit të Ujit. “Metabolism of Albania”, IABR, AKPT et.al, 2014




Figura 4-2 Harta e ASistemit ujqor. Burimi: AKPT, PPK 2030, 2016.f.120

Shtresat kryesore për ndërtimin e hartës së fluksit të ujit

Harta bazë

Reshje vjetore (në kategori)

Infrastruktura ujqore

Zonat e ujitura (ose ujitur më parë)

Konturet e shtrateve të trupave ujqorë (përfshirë pellgjet jashtë vendit)

Rrjeti ujqor, liqene (artificial), lumenj, rezervuarë etj

Diga (të mëdha)

Diga të parashikuara (të mëdha)

Cilësia

Cilësia e ujit (e lumenjve kryesorë, liqeneve dhe rezervuarëve)

Cilësia e ujit bregdetar

Vendet e pastrimit / infrastrukturë e ujit

Zonat me sisteme kanalizimesh

Konteksti

Zonat e ujitura

Zonat e prirura nga përmbytjet dhe zonat që vuajnë nga kripëzimi

Vendet me aktivitete rekreative në lidhje me ujin

(Plazhe por edhe lundrim, rafting, kayaking, canyoning, etj)

Zonë e urbanizuar (rezolucion i lartë - baza e të dhënave CORINE)

Propozimet strategjike territoriale të Planit të Përgjithshëm Kombëtar ‘Shqipëria 2030’ jepen në bazë të 5 sistemeve kryesore: Infrastrukturë, Ujor, Natyror, Bujqësor dhe Urban, të organizuara në korridore, zona dhe qendra. Elementet e konsideruara në këto propozime kanë në themel: potencialin për zhvillim ekonomik shumëdimensional të përcaktuar nga vendndodhja, madhësia, arritshmëria dhe lidhshmëria; karakterin identifikues lokal të përcaktuar nga tiparet specifike gjeografike, natyrore, historike, kulturore, tradicionale të zhvillimit ekonomik, urban dhe social; masat për sigurinë nga katastrofat natyrore dhe ndryshimet klimatike (MZHU&AKPT, 2016, p. 20). Roli i PPK, ashtu siç shprehet edhe në këtë dokument, është të verifikojë kërkesat sektoriale në lidhje me zhvillimin afatgjatë hapësinor duke përdorur përjasje integrale si për shembull: përfrimin ndërsektorial i cili është në përputhje me përdorimin optimal për një hapësirë (territor/zonë) të kufizuar si një burim i fundëm. Kjo synon të zgjidhë konfliktet midis kërkesave të sektorëve të ndryshëm të cilët duhet të balancohen midis përdorimeve të një sektori në favor apo jo përkundrejt përdorimeve të mundshme të një sektori tjetër, për një zonë të caktuar dhe të kufizuar në hapësirë dhe kohë, përdorime të cilat janë më të përshtatshme ndaj parimeve dhe kriterëve të zhvillimit të qëndrueshëm. (Gallard, 2012) thekson se forcat kryesore që nxisin praktikën e planifikimit hapësinor në një vend të caktuar apo ndryshimin e tyre janë *ekonomike, mjedisore dhe politike*. Ndër forcat ekonomike ai përmend: ristrukturimin e marrëdhënieve të prodhimit, pozicionimin global të rajoneve të qyteteve dhe konkurrenca midis tyre; zgjerimi i marrëdhënieve ekonomike nga rrjetet lokale drejt marrëdhënieve globale; zbatimin e rregullave të BE-së (fondi për zhvillimin e rajoneve të BE-së), ndikimi fiskal i qeverive dhe kërkimi i partneriteteve për të rritur kapacitetet në investime. Ndër forcat mjedisore përmend: vulnerabilitetin ekologjik dhe kufizimet mjedisore të rritjes ekonomike; shqetësimin për cilësinë e jetës dhe ndërgjegjësimin mjedisor. Ndër faktorët politikë renditen: decentralizimi i funksioneve të qeverisjes dhe formave të reja të qeverisjes dhe ri-organizimit qeveritar; ndryshimet në financimin e qeverisjes lokale (nevoja për ndarjen e buxhetit); theksimi politik dhe kulturor në rajon dhe identitetin dhe kohezionin lokal; mënyrat e reja të politikave të integritetit të territorit; si dhe diskuret dhe praktikën e politikave të komunitetit për planifikimin hapësinor trans-evropian.

Sa më lart, Shqipëria identifikohet me ndryshime që shtrihen në tre grupet kryesore ku veçojmë: në aspektin ekonomik kërkesën për zhvillim të një pozicioni konkurues në Ballkan si dhe nevojën për të përshtatur sistemin rregullator të prodhimit referuar cilësisë, por edhe regjimit fiskal si parapërgatitje e nevojshme për të qenë pjesë e tregut të BE. Nga pikëpamja mjedisore, vulnerabiliteti ekologjik i zonave të mbrojtura është gjithmonë e më i lartë nën presionin e modelit të ri të zhvillimit ekonomik, që pas viteve '90 me ndryshimin e regjimit, bën thirrje për një metodë të re menaxhimi; ndërsa nga pikëpamja politike përmenden reformat e ndryshme ndër vite dhe sidomos reforma më e fundit Reforma Administrative Territoriale e vitit 2014. Kjo e fundit solli dhe konsolidimin e autoriteteve qeverisëse lokale dhe për pasojë edhe në menaxhimin e territoreve më të gjera dhe komplekse të një bashkie, ndikuan thellësisht në planifikimin hapësinor të vendit në përgjithësi dhe në metodën e konceptimit të Sistemeve Territoriale në veçanti. Ndryshe nga raste të ngjashme të planeve në nivel kombëtar, Sistemet territoriale të analizuara në PPK rrjedhin nga analiza e flukseve Metabolike duke i dhënë kështu shprehje territoriale flukseve të Ujit në Sistemin Ujor, Fluksit të Energjisë dhe të Lëvizjes (Transportit dhe Turizmit) në Sistemin Infrastruktural dhe fluksin e Ushqimit në Sistemin Bujqësor.

Metabolizmi i Shqipërisë, ndryshe nga rastet e përshkruara në Kapitullin II, ka një qasje më praktike, pasi ashtu siç theksohet edhe në dokument, përfundimet dhe gjetjet e kësaj analize do të duhet të procesohen më tej nga institucionet qeverisëse dhe politike të vendit. Kjo është arsyeja pse fokusi ngushtohet kryesisht në tre flukset kryesore të energjisë, ushqimit dhe ujit si një alternativë ndaj zgjidhjeve përmes masterplaneve. Studimi i qasës territoriale të Shqipërisë jo vetëm si një vend i Ballkanit, por në panoramën më të gjerë mesdhetare duke hequr disa paralele krahasimore midis vendeve në të njëjtën gjatësi gjeografike nga bregu përrëndimor i Portugalisë deri në Detin Marmara. Këtu studiuesit bëjnë një ngacim për kërkime të mëtejshme krahasimore midis tipologjive të zhvillimeve urbane bregdetare, shkallës hapësinore të zhvillimeve turistike, natyrës së marrëdhënies midis bregdetit dhe brendësisë së territorit kontinental, aksesit etj.

Demografia dhe biogeografia janë ndryshe nga çdo vend tjetër i Europës, përse i përket amplitudave të ndryshimit të tyre brenda një sipërfaqeje të vogël territoriale por të ngjashme përse i përket braktisjes së tokave bujqësore. Këtu shfaqen lidhjet e reja midis shpërndarjes demografike, natyrës dhe në mënyrë indirekte të mundësive për zhvillimin e një ekonomie të turizmit. Për çdo fluks paraqiten katër skenarë të mundshëm zhvillimi relativ ndaj modelit të tregut, shkallës territoriale dhe të menaxhimit të fluksit për fluksin e ushqimit, raportit midis rolit kryesor publik-privat në fluksin e ujit dhe qendërimit apo decentralizimit të alternativave fosile apo të rinovueshme për fluksin e energjisë. Studimi nuk përzgjedh një skenar optimal duke njohur rolin e vendimmarrjes politike në këtë drejtim. Megjithatë pesë projekte prioritare propozohen sipas flukseve përkatëse në përfundim të analizës së skenarëve të mundshëm:

1. Pastrim radikal në nivel kombëtar i sistemit ujqor që nga ndërtimi i impianteve të pastrimit të ujit, si një detyrë publike, pa përfshirjen e tregut dhe të detyrueshme në çdo nivel dhe sektor që nga bujqësia, turizmi dhe energjia.
2. Projektimi i kujdesshëm i autostradave ndërqytetase dhe rajonale të cilat nuk duhen trajtuar vetëm si projekte transporti por edhe si instrumenta rregulluese të sektorit turistik.
3. Dedikimi i basenit të lumit Vjosa si peizazh të mbrojtur duke përjashtuar ndërtimin e investimeve hidrike në të.
4. Projekti i katërt qëndron midis rritjes së kapacitetit dhe kursimit të energjisë elektrike. Këtu sugjerohen investime në rritjen e kapaciteteve të katër hidrocentraleve ekzistuese në vend dhe investime në reduktimin e humbjeve në rrjet. Analizat e fluksit të energjisë tregojnë se këto masa do të kompensonin për të gjitha nevojat dhe mungesat që paraqet furnizimi me energji elektrike aktualisht.
5. Projekti i pestë lidhet me hedhjen e themeleve për një sektor bujqësor që mund të lulëzojë sërish. Në këtë drejtim rekomandohen masa të gjera për konsolidimin e tokës bujqësore dhe rialokime për ndërtimin e fermave më të mëdha.

Në këtë mënyrë, propozimet e PPK u ndikuan nga analiza metabolike në nivel kombëtar '*Metabolism of Albania*' dhe projekte prioritare të këtij studimi, plani kombëtar shkoi më tej duke prezantuar një profil urban të propozuar të drejtuar nga profili metabolik i dhënë tashmë përmes këtij Studimi. Më poshtë po paraqesim shkurtimisht qasjen e PPK për secilin nga sistemet territoriale. Sistemi Ujqor: pjesa më e madhe e ujit të pijshëm në Shqipëri merret nga burimet nëntokësore (80%), dhe 20% nga ujërat sipërfaqësore. Njohja, mbrojtja dhe përdorimi i ujërave nëntokësore është thelbësore për planifikimin

e fluksit të ujit. Sasia mesatare e ujit të pijshëm për frymë është 12.800 m³ në vit, një ndër më të lartat në Europë, ndërkohë që për prodhimin aktual vjetor për frymë për furnizimin me ujë të pijshëm, shfrytëzohen 80 m³ në vit. Autoritetet e qeverisjes qendrore janë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore. Në këtë aspekt njohja e vulnerabilitetit të ujërave nëntokësore dhe mbitokësore si burime primare për furnizimin e sigurt me ujë të pijshëm është thelbësore për PPK-në.

Parashikimet e PPK-së për përqendrimin e popullsisë në 15 vitet e ardhshme dhe të aktiviteteve ekonomike me rëndësi kombëtare shkojnë në përputhje me objektivat e furnizimit të sigurt të popullatës (MZHU&AKPT, 2016, p. 113). Ndërkohë, diagrama e Sankey për fluksin e Ujit na tregon se Shqipëria edhe pse një vend me burime të konsiderueshme ujore, vetëm një përqindje mjaft e vogël shkon për përdorim ekonomik e shtëpiak, nga këto pjesën më madhe e zë përdorimi për prodhim të energjisë elektrike. Harta e Sistemit Ujor nga PPK, përveç informacionit sasior dhe cilësor të fluksit të ujit shoqërohet edhe me propozime territoriale të politikave për këtë sektor. PPK përcakton një masë si përcaktimi i ‘Vijës Blu’ për mbrojtjen e resursit, por nuk vendos vlera apo distanca të fundme për të, por përcakton tre parimet bazë për të udhëhequr çdo vendimmarrje të mëtejshme në lidhje me Sistemin Ujor: 1. Barazi Sociale: që të sigurohet akses i barabartë për të gjithë përdoruesit (veçanërisht grupet e marginalizuara dhe përdoruesit e varfër) për një sasi dhe cilësi të nevojshme të ujit, për të plotësuar nevojat dhe mirëqenien e tyre; 2. Efikasitet Ekonomik: që të sjellë përfitime për një numër sa më të madh përdoruesish; 3. Qëndrueshmëri Ekologjike: për të siguruar që ekosistemet ujore të shihen si përdorues më vete dhe ndarja e tyre të bëhet për të mbështetur funksionin e tyre natyror (MZHU&AKPT, 2016, p. 127).




Figura 4-3 Shtresat e hartës së Sistemit Natyror. Burimi: AKPT, PPK 2030, 2016

Metabolizmi i Shqipërisë gjithashtu hodhi hapat për ndërtimin e të ashtuquajturave llogari kombëtare të resurseve kryesore, stokut, shfrytëzimit dhe përfitimit të tyre, të cilat do të trajtohen në kapitullin 5.4.

Në Planin e Përgjithshëm Kombëtar, mjedisi i adresuar në analizën e Sistemit Natyror nuk është një sipërfaqe e ruajtur nga veprimtaria e njeriut, por një aset që ruhet në shërbim të njeriut dhe të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Aktualisht, sipërfaqja e zonave të mbrojtura të Shqipërisë zë gati 15% të territorit kombëtar. Brenda territorit shtetëror numërohen 15 parqe kombëtare, 22 rezervate natyrore, pa numëruar peizazhet e mbrojtura dhe monumentet natyrore, që janë shumë pak të vizituara dhe aspak të trajtuara si pjesë e ndonjë sektori ekonomik, fig. 23. Mjedisi përfaqëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore, karakteristikat fizike të territorit natyror, por edhe të atij të

ndërtuar. Në këtë kontekst, dy janë tiparet kryesore të sistemit natyror: është pjesë e pasurisë kombëtare, dhe forma dhe karakteristikat e tij varen njëkohësisht nga veprimtaria natyrore dhe njerëzore. Meqenëse, si veprimtaria natyrore dhe ajo njerëzore janë dinamike edhe sistemi natyror është gjithmonë në ndryshim. Politikat territoriale duhet ta njohin këtë dinamikë dhe të punojnë me këto ndryshime në mënyrë krijuese për të orientuar ndryshimet drejt zhvillimit më të qëndrueshëm të sistemit natyror.

Mjedisi dhe natyra, për shkak të karakterit të tyre gjerësisht ndërvepruese, janë sisteme të cilat nuk i përkasin vetëm një territori apo popullsi, ato janë pjesë e një rrjeti më të gjerë. Koncepti i përdorimit të një pasurie që nuk e zotërojmë totalisht, por e ndajmë atë në kohë dhe hapësirë është thelbësor në politikën e zhvillimit territorial. Shembulli më tipik i këtij ndërveprimi është ndikimi në ndryshimet klimatike, që përjetojnë vende dhe popuj të ndryshëm nga shfrytëzimi pa kriter i resurseve të parinovueshme e të ndotjes së mjedisit në vende të tjera.

Në zhvillimin ekonomik, mjedisi ofron bazën e burimeve ku mbështeten një sërë aktiviteteve ekonomike si bujqësia, pylltaria, peshkimi, akuakultura, përdorimi mineralëve, përdorimi i energjisë, industrisë, shërbimeve dhe turizmit. Për këto aktivitete, duhet siguruar që burimet e tyre të përdoren në mënyrë të tillë që të sigurohet sa më shumë të jetë e mundur rinovimi dhe ripërtëritja e tyre.

Sistemi Bujqësor. Bujqësia tradicionalisht ka qenë një ndër degët e rëndësishme të zhvillimit ekonomik. Produktet bujqësore janë pjesë e formimit të identitetit rajonal të vendit, me një gamë të gjerë të ndryshimeve mjedisore, natyrore dhe klimatike.

Ndonëse zhvillimet teknologjike pritet të zëvendësojnë rolin e njeriut në shumë procese bujqësore, ky sektor mbetet akoma burimi parësor i të ardhurave ekonomike dhe i mundësive për punësim në vendbanimet rurale. Gjithsesi sektorit të bujqësisë do t'i duhet të përballet dhe të përshtatet me kërkesat gjithmonë e në rritje të konsumatorëve si pasojë e modernizimit dhe ristrukturimit të tipologjisë së të tregtuarit dhe me pasojat e ndryshimeve klimatike. Rajonalizimi i prodhimit sipas karakteristikave të peisazhit agrar dhe eficientimi përmes strukturave të menaxhimit të quajtura pole bujqëore është propozimi i PPK. Në këtë drejtim, ashtu si në *'Metabolism of Albania'*, tipari i konsolidimit të sistemit është risillet në PPK dhe detajohet përmes projekteve strategjike si: ngritja e poleve bujqësore. Projekte për pyllëzimet dhe veprat inxhinierike si: hidrovore, pompa dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse dhe kulluese në kuadër të masave për mbrojtjen dhe adaptimin nga ndryshimet klimatike. Integrimi dhe ngritja e lidhjeve fizike dhe ekonomike e zonave rurale me bregdetin e Shqipërisë (MZHU&AKPT, 2016, pp. 220-221).

Sistemi Infrastrukturor, Energjia. Në mënyrë që të sigurohet një treg i brendshëm energjetik konkurrues, është i domosdoshëm orientimi i prodhimit të energjisë drejt burimeve alternative, si ato të rinovueshme apo hidrokarbureve. Nga ana tjetër, kjo strategji zhvillimi do të sigurojë një furnizim të qëndrueshëm me energji, që do të përputhet me kërkesat në rritje të popullsisë dhe impaktet e ndryshimeve klimaterike. Diagrama *Sankey* e fluksit të energjisë në rang kombëtar tregon për ineficencën e sektorit të përpunimit të naftës ku prodhimi kombëtar eksportohet për përpunim dhe importi për përdorim të brendshëm ekuivalentohet me totalin e importuar të përpunuar. Gjithashtu edhe sektori i energjisë elektrike dëshmon se investimi në shmangien e humbjeve të energjisë në rrjet do të kompesonte vlerën e energjisë elektrike të importuar. Harta e Sistemit të Energjisë fig. 24 propozon shpërndarjen e rrjetit sipas zhvillimit të sistemit urban.




Figura 4-4 Shtresat e hartës së Sistemit Infrastruktural Energjetik. Burimi: AKPT, PPK 2030

Elementët e Hartës

Harta bazë	Prodhimi i Naftës
Zonë e urbanizuar	Fushat
Rrjeti ujor	Rafineritë
Hidrocentrale	Tubacione
I madh (> 200 kw)	Transporti
I vogël	Era
Projektuar	Vendndodhjet e kërkimit
Linjat e energjisë elektrike	Diellore
Kv e lartë (> 300)	Lokacione me energji diellore relativisht të lartë
Kv mesatare	Zonat natyrore '
Kv e ulët (<100 kv)	<i>Zona natyrore të dëmtuara (parqe kombëtare, rezerva?)</i>
Gazit	<i>Toka pyjore ose shkurre që përdoren për prerjen dhe djegien e drurit</i>
Tubacioni i gazit (i parashikuar)	

Tabela 4.1-1 Shtresat për ndërtimin e hartës të fluksit të energjisë, PPK 2030. Burimi. Autori

Harta e Energjisë tregon infrastrukturën energjetike të Shqipërisë në hartën e Shqipërisë, vendet e prodhimit, vendet e konvertimit, linjat e shpërndarjes dhe vendndodhjet e konsumatorëve.




Figura 4-5 Harta e Fluksit të Energjisë. Burimi: Metabolism of Albania, IABR, AKPT et.al, 2014



Figura 4-6 Harta e Energjisë. Burimi: AKPT, PPK 2030, 2016.f.120




Figura 4-7 Fluksi i transportit rrugor në akset kryesore kombëtare (majtas) analizat nga Instituti i Transportit




Figura 4-8 Lokacionet e pikave turistike me kërkesë më të lartë për të vizituar

Në sistemin e infrastrukturës energjetike, Plani i Përgjithshëm Kombëtar synon: 0 % import energjie duke shndërruar Shqipërinë nga një vend importues, në vend eksportues të energjisë elektrike.

Gjatë viteve të fundit varësia e vendit tonë nga importi i energjisë elektrike ka ardhur duke u rritur pamvarësisht burimeve hidrike të bollshme që sigurojnë atë. Resursret e naftës dhe gazit gjithashtu kanë pësuar ulje në kontributin ekonomik edhe pse Shqipëria përbën një korridor të rëndësishëm që lidh Greqinë me vendet e Bashkimit European dhe Kroacinë. Gjithashtu përmes gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (TAP), sigurohet lidhja energjetike nëndetare mes Shqipërisë dhe Italisë, një nga ekonomitë më të mëdha të Bashkimit European. Gjithashtu ky projekt është dhe realizim i tri makro-objektivave për krijimin e një tregu të brendshëm energjetik në nivel europian: Konkurrueshmëri - Furnizim i sigurt - Qëndrueshmëri (MZHU&AKPT, 2016, p. 146).



Figura 4-9 Harta e Fluksit të Turizmit. Burimi: Metabolism of Albania, IABR, AKPT et.al, 2014
Figura 4-10 Harta Sistemit Infrastrukturor. Burimi: AKPT, PPK 2030, 2016.f.132

Zbatimi i Metabolizmit në hartimin e politikave dhe strategjive në nivel kombëtar përmes PPK mund të përmblihen në:

- Vendosjen e një kënvështrimi të ri krahasimor dhe konkurues në aspektin gjeografik dhe biodemografik që thërret për analogji dhe krahasime në një hapësirë më të gjerë sesa kontakti kombëtar, në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë.
- Planifikimi i pesë sistemeve territoriale sipas një analize të integruar të flukseve të burimeve të materialeve dhe energjisë. Kjo siguroi propozimin e politikave sektoriale që ndërthurin rezultatet, mangësitë e njërit sektor për ti përdorur si oportunitete të një sektori tjetër.
- Projekte strategjike që integrojnë zgjidhjet lokale në një panoramë më të gjerë territoriale, që shfaqen në një kontekst të kufizuar urban, por që adresohen përtej kufizimeve të ndarjeve administrative.

Metabolizmi i Shqipërisë, sëbashku me planin e Përgjithshëm Kombëtar thërrasin për një planifikim territori që duke u bazuar në metoda shkencore dhe njohuri teknike kërkon të udhëheqi vendimmarrjet politike. Ky tipar, në një vend në zhvillim si Shqipëria, ku demokracia vlerësohet ende e brishtë dhe vendimmarrja politike paraprin mendimin teknik është i domosdoshëm për tu përforcuar. Gjithashtu, kur flasim për integrimin e vendit në Bashkimin Europian, kohezioni territorial është një temë thelbësore që mund të arrihet përmes planifikimit të integruar dhe qeverisjen e territorit në disa nivele. Shqipëria në këtë drejtim ka akoma shumë punë për të bërë por forcimi i dokumentave të tilla si PPK dhe metabolizmi Kombëtar rrisin mundësitë për sukses në këtë drejtim.

4.2 Zbatimi i Metabolizmit, Niveli Lokal

Në dhjetë vitet e fundit, Shqipëria zbatoi kalimin nga urbanizmi racional në qasjen ndaj planifikimit hapësinor me zbatimin e një kuadri të ri ligjor të planifikimit. Në këtë kontekst, sistemi i planifikimit të territorit po i përshtatet një transformimi rrënjësor që paraqet risitë dhe problematikat e tij. Duke krahasuar planet e përgjithshme lokale të hartuara nën ndikimin e këtyre ndryshimeve të viteve të fundit, ne identifikojmë zbatimin e analizës metabolike territoriale si një nga elementët më inovativë të sistemit të ri të planifikimit. Rezultatet tregojnë se përkundër potencialit në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve hapësinore në një mënyrë më organike dhe gjithëpërfshirëse, qasja metabolike duhet të strukturohet më tej në varësi të tipologjisë së planit dhe territorit për të cilin hartohet, në mënyrë që të pasqyrojë dinamikën e kontekstit. Ka rëndësi të identifikojmë flukset e materialeve dhe të energjisë në metabolizmin urban për të rritur ndikimin e planifikimit në cilësinë e jetës urbane dhe sigurimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Përdorimi i konceptit të metabolizmit urban shërben për të përshkruar sistemin urban në terma organike, jo artificiale, ku metabolizmi është koncepti kyç për të përshkruar peisazhin e ri urban të qyteteve tona gjithmonë e më komplekse. Këtu paraqiten zhvillimi dhe rezultatet e analizës krahasuese të planeve të përgjithshme lokale dhe zbatimit të tyre të Analizës Metabolike. Qasja metabolike e analizave territoriale në planet lokale u parapri nga raporti i ‘*Metabolism of Albania*’ i përshkruar në kapitullin e mësipërm. Konceptuar si një kërkim përmes dizajnit, ai eksploroj modelin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik për gjeneratën tjetër të Shqipërisë.

Megjithëse, në dekadat e fundit, koncepti i metabolizmit urban ka qenë një temë qendrore e debatit për qytetet e diskutuar nga një numër gjithnjë në rritje i artikujve dhe librave shkencorë, veçanërisht pas viteve 2000, në Shqipëri kjo është një qasje krejtësisht e re. Duke marrë në konsideratë se kërkime të ndryshme sugjerojnë që shkenca e planifikimit hapësinor do të përfitonte nga përfshirja e metabolizmit dhe

zbatimi i tij në planifikimin urban, qëllimi i AKPT, ishte integrimi i mëtejshëm i metabolizmit në kornizën ligjore dhe praktikën e planifikimit urban. Kështu, kur në vitin 2017 Rregullorja e Planifikimit të Territorit u miratua në përputhje me Ligjin 107/2014, ajo përfshiu përkufizimin e 'Metabolizmit të Territorit' dhe e bëri të detyrueshëm për çdo plan në nivelin kombëtar dhe lokal hartimin e 'Analizës Metabolike' për territorin për të cilin hartohet plani. Plani Kombëtar Hapësinor 'Shqipëria 2030' ishte dokumenti i parë i planifikimit që përfshiu gjetjet nga një qasje metabolike ndaj propozimeve të planit. Hartat e përpiluara të "Metabolizmi i Shqipërisë" u përkthyen në harta të politikave për pesë sistemet territoriale në Planin Kombëtar 'Shqipëria 2030'. Ky kapitull përqendrohet në cilësinë e zbatimit të qasjes metabolike në planet lokale, me referenca të aplikimit në nivel kombëtar. Për këtë qëllim, u krahasuan dokumentet e planeve lokale të hartuara nga disa bashki (16), në lidhje me mënyrën e zbatimit të analizës metabolike. Krahasimi u bazua në katër karakteristika kryesore: metoda e përdorur për të matur rrjedhat e burimeve, shkalla territoriale e analizës/ ndikimi nga struktura urbane, si dhe ndikimin e metodës së metabolizmit në instrumentet kryesore për zbatimin e planit siç është harta e propozuar e përdorimit të tokës, harta e njësive strukturore dhe treguesit e zhvillimit. Katër grupe kryesore të komunave u identifikuan sipas këtyre kriterëve.

4.3 Krahasimi, analiza e rezultateve

Krahasimi i zbatimit të AM (Analiza Metabolike) në hartimin e planeve vendore, siç theksohet edhe në paragrafin më lart, ndalet tek metodologjia, dhe jo tek parametrat apo indikatorët e veçantë urbanë që mund të paraqesë territori specifik i secilës bashki. Megjithatë, ashtu siç do të vërehet edhe më tej njohja e këtyre indikatorëve paraprakisht është e rëndësishme për të vlerësuar nëse planet performojnë nga pikëpamja metabolike. Katër grupe kryesore planesh vendore u identifikuan sipas pesë kriterëve të zbatimit të analizës metabolike: (I) Metodologjia, (II) Lloji i Flukseve Metabolike të analizuar, (III) Shkalla/niveli territorial i analizës; (IV) Paraqitja hapësinore e flukseve dhe (V) Niveli i Detajimit të të Dhënave.

Grupi I, analiza është kryesisht interpretative, megjithëse synon të 'bazohet në identifikimin e proceseve që ndodhin midis hyrjeve dhe daljeve të energjisë dhe burimeve brenda kufijve të qytetit, përmes ndërveprimit të natyrës dhe shoqërisë, qytetit dhe fshatit'. Objektivi është të kuptohet sjellja e zonës së studimit dhe përshtatja e saj në një bazë më të qëndrueshme. Raportet në përgjithësi kanë përfundime të ngjashme si për shembull: '*Hartimi i AM nuk është e realizueshme. Të dhënat statistikore të gjetura janë jo të plota dhe të paqarta dhe me vlefshmëri dhe përfaqësim të panjohur*'. Grupet e punës theksojnë se dimensionet që përcaktojnë intensitetin e metabolizmit janë të shumta, kështu që për të analizuar bashkinë si ekosistem, do të duheshin studime të veçanta. Për këto bashki, analiza metabolike vjen si një përshkrim i të dhënave të përgjithshme në nivelin kombëtar për rrjedhat e energjisë, ujit dhe materialeve, dhe të dhënave në nivelin lokal në lidhje me menaxhimin e mbeturinave. Ndër konkluzionet kryesore mbetet: 'Pamundësia për të zbatuar modelin, në një shkallë të gjerë dhe veçanërisht në zonën e studimit, për shkak të mungesës së të dhënave dhe statistikave të vazhdueshme analitike. Ka shumë parametra vendimtare që bashkëveprojnë, si rrethanat ekonomike, struktura urbane, shkalla e vetëmjaftueshmërisë së komuniteteve, efikasiteti i burimeve dhe aksesit, që e bëjnë akoma më të vështirë zbatimin' (Gjirokastër, PPV Bashkia Gjirokastër, p. 367). Projektet strategjike të propozuara për 15 vitet e ardhshme nuk reflektojnë realizimin e flukseve cirkulare por limitohen në zgjidhjen e nevojave imediate që paraqet territori (si për shembull në rastin e Bashkisë Gjirokastër).

Grupi II, përfaqëson një përpjekje reale për zhvillimin e MA si dhe për ta lidhur atë me kontributin për hartimin dhe zbatimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Kështu, grupi i punës vlerëson MA në shërbim të VSM (Vlerësimi Strategjik Mjedisor) duke identifikuar nivelin e ndotjes së ujit, ajrit, mbeturinave të burimeve, humbjes së tokës dhe degradimit, energjisë së nevojshme të konsumuar dhe lidhjes që ata kanë qytete në periferi. Rrjedha e energjisë dhe ujit analizohen paraprakisht në nivelin rajonal, dhe më pas të dhënat me interpolim tregohen për nivelin komunal pasi që këto burime nuk gjenerohen tërësisht në territorin e komunës. Për të analizuar flukset janë vëzhguar hyrjet dhe daljet për secilin prej tyre, për të kuptuar problemet mjedisore dhe humbjet. Për të llogaritur vlerat e konsumit për familje/vit kanë shërbyer të dhënat nga INSTAT, Censusi 2011 sipas rrjetit 1km². Duke iu referuar numrit të banorëve që gjenden për çdo km² në të gjithë territorin e Bashkisë Lezhë dhe duke marrë parasysh vlerat për konsumin total në Shqipëri për vitin 2011, është llogaritur konsumi mesatar për familje në vit për energjinë dhe ujin. Ndërkohë, duke qenë se bashkia Lezhë, pas ndarjes territoriale administrative, është një njësi administrative turistike me dalje në Detin Adriatik përmes qytetit të Shëngjinit, grupi i punës ka tentuar të analizojë edhe “fluksin e turistëve” në këtë bashki, fig.30-35.

Grupi III gjithashtu ndjek të njëjtën metodologji për paraqitjen territoriale të flukseve. Analiza për prodhimin dhe konsumin jepet e llogaritur për frymë/km² ose për familje/km². Analizat në nivelin rajonal kryhen mbi rrjedhën e ujit dhe energjisë, për shkak të shkallës në të cilën administrohen këto burime, ndërsa në nivelin vendor flukset konfigurohen sipas përqendrimit të popullsisë dhe llogaritjeve nga vlerat mesatare të vendit. Struktura urbane e një komune shprehet përmes dendësisë urbane në zonën statistikore prej 1 km², e cila është larg strukturës organike që ofron në realitet qytetit. Fig.36-41

Planet e **Grupit IV** përdorin analizën e të dhënave përshkruese në nivelin kombëtar dhe përshkallëzimin interpretues të këtyre të dhënave në nivelin lokal. Analiza kërkon të vendosë një lidhje midis efekteve të ndryshimit të klimës në nivel global dhe nevojës për një qasje metabolike të planifikimit. Nga ky këndvështrim global, grupi i punës zbrit në nivelin lokal duke shkallëzuar nga pikëpamja teorike rrjedhat metabolike të analizuar. Në çdo rast, ne kemi një qasje teorike ndaj problemit në vend të përpjekjeve praktike për të matur rrjedhat e burimeve. Gjithashtu ndryshe nga grupet e tjera, paraqitja territoriale e rrjedhave nuk pasqyron ndikimin e strukturës urbane, por mbetet në paraqitjen statike të infrastrukturës të përfaqësuar nga sektori. Megjithatë ndryshe nga planet e grupeve të tjera, paraqitja territoriale e flukseve për planet e grupit të IV nuk shoqërohet me identifikimin e përqendrimit të tyre sipas dendësisë së popullsisë. Kështu, hartat territoriale të flukse metabolike në këtë rast janë të ngjashme me ato të analizës statike të sektorëve. Në fig. 38 deri në 42 jepen rrjeti i infrastrukturës së energjisë ujit dhe mbetjeve, por jo ndryshimi i prodhimit dhe konsumit të tyre sipas përqendrimit të popullsisë dhe sipas potencialit të territorit. Fig.42-50.

	<i>Metoda</i>	<i>Flukset metabolike</i>	<i>Shkalla analizës</i>	<i>e</i>	<i>Paraqitja territoriale</i>	<i>Detaji i të dhënave/Burimi i të dhënave</i>
--	---------------	---------------------------	-------------------------	----------	-------------------------------	--

GRUPI I	Analizë cilësore e të dhëna të agreguara.	Uji Energjia Materialet Mbetjet Emetimet	Kombëtare Rajonale.	Grafike të ndryshimit të të dhenave në nivel kombëtar ndër vite	Burimi: INSTAT Census 2011 DPUK, ERRE, AKBN, Public Data Kalkulime mbi vlerat mesatar kombëtare vetjake për vlera të mesatarizuara dhe për km ² dhe për banorë.
GRUPI II	Analizë e Flukseve të Prodhimit dhe –Konsumit.	Energjia, Uji, Ushqimi, Mbetje Turizmi.	Rajonale për fluksin e Ujit dhe energjisë. Lokale për Energjinë, Ujin, Mbetjet, Turizmin	Harta e konsumit në kuadrate 1km ² Harta të potencialeve të prodhimit të fluksit	Burimi: INSTAT, Censusi 2011, raportet vjetore nga Agjencitë Kombëtare (DPUK, ERRE, AKBN MBZHRAU) Përlogaritje sipas mesatares së vlerave kombëtare dhe shpërndarjes së popullsisë sipas rrjetit 1km ²
GRUPI III	Analizë e Flukseve të prodhimit dhe –Konsumit.	Ushqimi Uji Energjia Mbetjet	Rajonale për fluksin e Ujit & Energjisë Shkalla lokale për Energjinë, Ujin, Mbetjet	Harta e konsumit të flukseve sipas rrjetit kuadratik 1km ² në nivel bashkie fig34-38 Harta të potencialeve të prodhimit të fluksit në nivel rajonal. fig32-33 Diagrama - Sankey për shprehjen e prodhimit të flukseve.	Burimi: INSTAT, Censusi 2011, raportet vjetore nga Agjencitë Kombëtare (DPUK, ERRE, AKBN MBZHRAU) Llogaritja e të dhënave bazuar në vlerat mesatare vjetore për njësi familjare ¹³
GRUPI IV	Argumentuese Interpretative	Ushqimi Uji Energjia Mbetjet Turizmi	Rajonale(VHSK) në interpretimin e të dhënave dhe ndërtimin diagramave sankey. Lokale për paraqitjen territorial te sektorit.	Harta të rrjetit të infrastrukturës ekzistuese të sektorit. Rrjeti i energjisë Elektrike, rrjeti i Ujsjellës Kanalizimeve, Harta e rrjetit te vendgrumbullimit të mbetjeve Fig.38-42	Burimi: INSTAT, Censusi 2011, MBZHRAU, UPT, ERE, MIE

Tabela 4.3-1 Kkrahassimi në strukturën kryesore të përmbajtjes së analizës metabolike në nivel lokal për 4 bashkitë në studim. Përpunim i Autorit.

Rendësi ne analizën krahasimore, merr shprehja hapësinore e flukseve metabolike. Në *‘Metabolism of Albania’* këto flukse shprehen në mënyrë të kuantifikuar nga *diagramat*

¹³ Shënim: Për shembull, për të gjeneruar energjinë e konsumuar për çdo km², është shumëzuar numri i familjeve të një sipërfaqe 1 km² me vlerën mesatare vjetore të konsumit të energjisë elektrike.

sankey, ndërsa në territor përmes hartave të flukseve që ndryshojnë intensitetin e tyre sipas vendit të prodhimit dhe të konsumit. Në përgjithësi, shprehja territoriale e flukseve të energjisë dhe të ujit në planet vendore është shprehur përmes gridës 1km², mbi bazën e kësaj sipërfaqeje janë dhënë edhe të dhënat statistikore për numër banorësh apo për njësi ekonomike familjare. Për rrjedhojë, aty ku përqëndrimi i popullsisë urbane është më i lartë edhe intensiteti i konsumit të energjisë dhe ujit është më i lartë. Siç vihet re edhe nga hartat e mëposhtme, kjo strategji konfigurimi është e përshtatshme për konsumin por jo për prodhimin. Hartat që tregojnë prodhimin e flukseve të burimeve të materialeve dhe të energjisë kryesisht shprehin potencialin e mundshëm për prodhimin e fluksit sesa prodhimin faktik. Kështu psh. hartat e fluksit të prodhimit të ujit tregojnë sasinë e burimeve nëntokësore ujore, të shtresave të akuifereve, por jo sasinë reale të prodhuar për qëllime furnizimi të popullsisë familjare dhe për qëllime biznesi dhe apo shërbimesh. Në këtë mënyrë, territorialisht bilanci i flukseve vizualizohet me vështirësi, dhe planifikuesit kanë preferuar përdorimin e diagramave sankey për këtë qëllim.




Figura 4-11 Fluksi i energjisë, PPV Lezhë




Figura 4-12 potenciali energjisë, PPV Lezhë



Figura 4-13 Potenciali i Ujit, PPV Lezhë




Figura 4-14 Konsumi i Ujit, PPV Lezhë

Fig.30 dhe 31 paraqesin Fluksin e energjisë për bashkinë Lezhë dhe potencialin e prodhimit të energjisë. Siç vërehet nga hartat, por edhe nga analiza cilësore e fluksit, kufiri administrativ i bashkisë nuk përbën hapësirën territoriale të përshtatshme dhe të mjaftueshme për analizën e këtij fluksi, ku pjesa më e madhe e inputeve të tij ndodhen jashtë kufirit administrativ të bashkisë dhe për pasojë jashtë mundësive për administrim të saj. E vetmja mundësi që paraqet ky nivel territorial në analizë, për të realizuar një cikël rrethor të fluksit të energjisë, është shfrytëzimi i energjisë alternative diellore brenda territorit të saj, me qëllim për të siguruar një vërtetmjaftueshmëri dhe siguri më të lartë të energjetike, konsumi i të cilës luhet në vlera të larta brenda një viti edhe për shkak të sezonit turistik.



Figura 4-15 harta e potencialeve turistike, PPV Lezhë




Figura 4-16 Fluksi i Ushqimit, PPV Lezhë

Një kufizim tjetër, përveç kufizimit të nivelit administrativ territorial të analizës, është edhe niveli i administrimit të sektorit në fjalë kryesisht për fluksin e ujit dhe të energjisë, administrim i cili ndodh nga organe qeverisëse dhe agjenci të nivelit qendror. Kështu, për shembull, në fluksin e energjisë një analizë sektoriale në nivel bashkie do të jepte mundësinë e propozimeve konkrete për zhvillimin e projekteve lokale të prodhimit të EE nga burime alternative, e lidhur kjo me një sërë përdorimesh, jo vetëm për konsum familjar e shërbimesh turistike, por edhe për shërbull të transportit të gjelbër (makinave elektrike) uljen e shpenzimeve për operimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotur në zonë, një ekonomi e turizimit më miqësore ndaj mjedisit etj.




Figura 4-17 Harta e fluksit të energjisë në rajon, PPV Elbasan




Figura 4-18 Harta e fluksit të ujit në rajon (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore)




Figura 4-19 Harta e fluksit të energjisë në bashki, PPV Elbasan Elbasan




Figura 4-20 Fluksi i ujit në Bashkinë Elbasan, PPV




Figura 4-21 Fluksi i ushqimit në Bashkinë Elbasan Elbasan




Figura 4-22 Fluksi i mbetjeve në Bashkinë Elbasan



Figura 4-23 Fluksi i ushqimit PPV Vlorë



Figura 4-24 Fluksi i Ujit, PPV Vlorë




Figura 4-25 Fluksi i Energjisë PPV Vlorë Figura 4-26 Fluksi i mbetjeve. PPV Vlorë




Figura 4-27 Diagrama sankey e mbetjeve. Burimi: PPV VHSK




Figura 4-28 Bilanci ushqimor i paraqitur per bashkite Vlore, Himare, Sarandë dhe Konsipol. Burimi: PPV VHSK




Figura 4-29 Bilanci uhor në të katër bashkitë. PPV VHSK Figura 4-30 Fluksi i turistëve për rajonin.

PPV VHSK




Figura 4-31 Bilanci energjetik për bashkitë Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol. Burimi: PPV VHSK

Një përpjekje interesante, nën shembullin e PPK dhe ‘Metabolism of Albania’, është përpjekja e planeve të bashkive që kanë një sektor turizmi të zhvilluar si për shembull Bashkia Lezhë dhe Vlorë, për të paraqitur fluksin e turistëve.

Turizmi nuk konsiderohet një fluks klasik për analizën metabolike, por disa nga bashkitë e kanë përdorur për të treguar origjinën e ardhjes së turistëve dhe përqëndrimin e tyre në territorin në studim. Analiza do të merrte vlerë nëse këto të dhëna do të integroheshin për shembull me të dhënat e studiuara për për të ardhurat sipas sektorëve në bashki, apo për të evidentuar shkallën e ndikimit të fluksit të turistëve tek gjenerimi i fluksit të mbetjeve, konsumit të energjisë apo të ujit. Në këtë drejtim, numri i turistëve mund reflektohet në numrin e popullsisë së një vendi dhe të ndikojë në llogaritjet totale me bazë vjetor. Vetëm atëherë kur duam të studiojmë impaktin e turistëve në flukset metabolike, merr vlerë veçimi i tyre.

Këtu, një analizë e të dhënave ndërsektoriale ndërmjet flukseve, nxjerr edhe disa mospërputhje të konkluzioneve të të dhënave. Për shembull, Fig.44, paraqet diagramën e fluksit të turistëve për të gjithë zonën në studim sipas njësive administrative të Vlorëa, Sarandëa, Konispolit dhe Himarës. Fluksin më të madh duket se e ka Bashkia Sarandë me 7450830 turistë në vit e ndjekur nga Vlora me 343 200 turistë /vit dhe Bashkia Himarë me 184470 turistë në vit. Në këtë drejtim del në pah mospërputhje në lidhje me të dhënat midis flukseve, ku për shembull një numër më i madh popullsie dhe turistësh siç paraqet Saranda do të duhej të shoqërohej me një vlerë më të lartë të fluksit të mbetjeve, që në analizën e mësipërme e paraqet Vlora. Ripërdorimi i fluksit të mbetjeve për Bashkinë Sarandë do të justifikonte këto vlera, por analiza nuk paraqet të dhëna të mjaftueshme që të dëshmojnë cirkularitetin e fluksit të mbetjeve. Gjithashtu, ky rezultat mund qëndrojë, nëse vërtetohet se flukset e mbetjeve të njësive të tjera vendore

përbëjnë inputin e mbetjeve për Vlorën, si qendër e rajonit ku janë vendosur qendrat e grumbullimit dhe depozitimit/trajtimit të mbetjeve, por kjo analizë përsëri i mungon përshkrimit të marrëdhënieve mes flukseve dhe diporcionit të të dhënave.

Në përgjithësi shembujt e përdorur deri tani në Shqipëri për matjen e flukseve të materialeve, mbeten elementare pasi bazohen vetëm në diagramat Sankey të një fluksi, të dhënat e të cilëve mbeten të kufizuara nëse kërkojmë të investigojmë marrëdhënien midis sistemeve që këto flukse përfaqësojnë. Kështu psh. integrimi i flukseve të energjisë me ushqimin ujin dhe mbetjet që tregojnë impaktin reciprok tek njëri tjetri, ripërdorimet dhe konvertimet finale në mbetje, gazrat serë etj do të ndërtonte profilin metabolik të një vendi. Megjithatë niveli i detajimit të të dhënave dhe përpunimi i tyre mbetet kompleks dhe ende i pamjaftueshëm për shumë vende të zhvilluara si edhe për Shqipërinë. Aktualisht për planifikuesit është e rëndësishme të fillojnë e të mendojnë në terma ciklike dhe integruese për sa i përket sistemeve të planifikimit hapësinor.

Disa mungesa, paraqiten gjithashtu në detajimin dhe nënkategorizimin e flukseve, si për shembull të turistëve sipas vendit të origjinës dhe raportin e tyre me kapacitetin mbajtës turistik të zonës në hoteleri (njësi akomodimi), ndërkohë që llogaritjet e rritjes së konsumit të ujit, energjisë dhe ushqimit realizohen në diagramat e mësipërme, përsëri, pa pasqyruar ndryshimet demografike si pasojë e zhvillimit të turizmit. Në konkluzion, rezultati është një analizë lineare e të dhënave pasi mungon informacioni për ripërdorimin, riciklimin dhe kthimin e flukseve, por edhe sepse zhvillimi i të gjithë aktivitetëve ekonomik të bazuara në këto flukse nuk është konceptuar të jetë cirkular edhe në dokumentat e planifikimit në nivel sektorial.

4.4 Kufizimet dhe Mundësitë në Zbatimin e Metabolizmit Urban

Planifikimi dhe zhvillimi i territorit sipas një përafrimi dinamik të të menduarit për transformimin e resurseve, që mundohet ti ngjasojë një cikli rrethor dhe organik të tjetërsimit të tyre, përputhet plotësisht me konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm, dhe metabolizmi urban përbën materializimin e këtij mendimi. Metodrat e ndryshme të aplikuara për të arritur qëllimin e këtij zhvillimi organik mbartin limite në realizimin praktik të tyre si edhe kritika për disa nga qasjet teorike në shtjellimin e mëtejshëm të konceptit. Duke iu referuar Roggema & Alshboul (2014) 'kriticizmi kryesor për metabolizmin urban është se diskursi i tanishëm frymëzon një mënyrë të menduarit për qëndrueshmërinë e qytetit, që thekson reduktimin e fluksit të burimeve hyrëse dhe mbetjeve duke marrë parasysh vetëm riciklimin dhe përdorimin e burimeve të qëndrueshme ose dizenjimin hapësinor në një formë shumë të kufizuar' (Roggema, R. & Alshboul, A., 2014, p. 737). Për këtë arsye ata sugjerojnë që e ardhmja urbane e qëndrueshme kërkon një transformim thelbësor të modeleve ekzistuese të prodhimit dhe të konsumit (Roggema, R. & Alshboul, A., 2014, p. 738). Sipas të dhënave të OKB-së 'popullsia urbane globale pritet që të rritet me rreth 2.5 miliardë banorë në zonat e urbanizuara nga viti 2018 deri në vitin 2050, ku 90% e rritjes do të jetë e përqendruar në Azi dhe në Afrikë. Në shumë rajone, pjesa e popullsisë që jeton në qytete, si dhe numri dhe madhëia e qyteteve, do të vazhdojë që të rritet, e nxitur nga një sërë faktorësh, duke përfshirë dhe rritjen e numrit të lindjeve në krahasim me vdekshmërinë në zonat urbane, migrimin nga zonat rurale në zonat urbane si dhe nga vende të tjera, si dhe urbanizimin e zonave që më përpara kanë qenë konsideruar si zona rurale. Urbanizimi po ndryshon gjithashtu edhe jetën e atyre që jetojnë në zonat rurale përreth qyteteve (UN, World Urbanization Prospects: The 2018 Revision, 2018). Në Europë dhe në

Amerikën e Veriut, 4 në 5 persona jetojnë në qytete (Weinstock, 2011, p. 102). Në këtë kontekst roli i qyteteve në të ardhmen e njerëzimit është i padiskutueshëm, dhe qasja ndaj zhvillimit të mëtejshëm të tyre është shumë e rëndësishme. Sipas de Oliveira (2011) e ardhmja e qyteteve është ngushtësisht e lidhur me proceset e metabolizmit urban. Metabolizmi sipas tij do të shërbejë si një mënyrë për të promovuar të ardhmen e zhvillimit të qëndrueshëm të qyteteve dhe duke iu referuar gjithashtu edhe Koohlaas urbanizimi ndihmon në vendosjen e lidhjes midis njeriut dhe proceseve të tij kulturore (Oliveira, 2011, p. 81) është e qartë se kompleksiteti i metodës qëndron në identifikimin e qartë dhe ndërlidhjen organike midis flukseve sasiore dhe atyre cilësisë së tyre dhe lidhjeve social kulturore. Për këtë, shumë studiues e vënë theksin te lidhjet e shumëfishta të proceseve të metabolizmit me kontekstin hapësinor urban në të cilin zhvillohen. Në këtë kontekst i trajton Schalk (2014) edhe propozimet e studiuesve të metabolistëve japonezë të cilët në projektimet e tyre merrnin parasysh kontekstin social dhe kulturor japonez si pikënisje, por gjithashtu theksonin që modelet e reja duhet të ishin universalisht të zbatueshme dhe të vlefshme (Schalk, 2014, p. 284).

Në literaturë, gjithashtu theksohet se pavarësisht potencialit të madh që paraqet metabolizmi urban, ai 'zbatohet shumë rrallë në planifikimet dhe projektimin urban' (Voskamp, Ilse.& Stremke, 2014, p. 5). Kjo është dhe një nga sfidat e ardhshme të këtij koncepti dhe mënyrën e zbatueshmërisë së tij në legjisllacione apo vende të ndryshme. Një nga arsytet e aplikimeve të pakëta sipas Voskamp & Stremke (2014) është mungesa e zbatimit të indikatorëve socio-ekonomikë (si për shembull stili i jetesës) për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm. Është detyra e dizenjimit që të identifikojë zgjidhje të integruara për sfidat ekologjike, hapësinore dhe sociale. Kjo ndodh edhe sepse aktualisht zbatohet më shumë koncepti i metabolizmit industrial apo metabolizmit teknologjik, i cili sipas Voskamp & Stremke (2014) nuk arrin të pranojë që bashkëveprimi midis shoqërisë dhe proceseve biofizike është pjesë dhe ndikon në metabolizmin e qyteteve.

'Një arsye tjetër mund të jetë që deri tani lidhja midis fluksit të burimeve dhe karakteristikave hapësinore ende nuk është vërtetuar mirë. Kjo shihet qartë nga shumica e zbatimeve të MFA-ve, të cilave u mungon një dimension hapësinor. MFA-të nuk japin informacione mbi organizimin hapësinor të rrjedhave dhe proceseve që ata përshkruajnë. Për më tepër, duket qartë se ka një mospërputhje midis nivelit të shkallës në të cilën kryhen studimet e metabolizmit urban (shkallë qyteti ose rajonal) dhe nivelit të shkallës së planifikimit urban dhe praktikës së projektimit (rrethi, lagja, bllok ndërtimi). Së fundmi, koncepti i kohës nuk trajtohet siç duhet në studimet aktuale metabolike. Për të kuptuar plotësisht metabolizmin e një qyteti, është thelbësore të pranohet ndryshueshmëria e furnizimit të burimeve dhe konsumi gjatë kohës. Të kuptuarit e këtyre dinamikave të përkohshme është thelbësore kur planifikohen dhe hartohen qytete të qëndrueshme' (Voskamp, Ilse.& Stremke, 2014, p. 5). Për këtë është e rëndësishme që të ndërtohen modele të avancuara të metabolizmit urban në qytetet të cilat po ndryshojnë me shpejtësi për shkak edhe të përsheptimit të ekonomisë globale. (Roggema, R. & Alshboul, A., 2014) theksojnë që modelet e avancuara të metabolizmit urban duhet që të zhvillojnë sisteme urbane cirkulare, që bëjnë të mundur krijimin e lidhjeve midis sistemeve që më parë janë trajtuar si të veçuara apo thënë ndryshe, integrimin e këtyre sistemeve. Ndërsa qëllimi kryesor i metabolizmit urban cirkular duhet të jetë mbyllja e cikleve të materialit dhe energjisë, ai gjithashtu kërkon ndryshim në teknologji, organizim dhe institucione të sistemeve të shumëfishta. Përafrimi i metabolizmit si një sistem cirkular, përpunimi i tij efikas çon në ulje të flukseve të mbetjeve, cilësi më të mirë mjedisore dhe jetëgjatësi, si dhe funksionimin e riciklimit

dhe ripërdorimit si input shtesë në sistem. Megjithatë, kjo paraqet një kuptim të papërshtatshëm të ekosistemeve, sepse nga një këndvështrim i sistemeve komplekse, të bazuarit te metabolizmi cirkular krijon një sfidë për ekuilibrin dhe rendin e sistemit. Në vend të kësaj, këto sisteme janë në bashkëveprim të vazhdueshëm me njëri-tjetrin dhe botën e jashtme, duke sjellë idenë se dizajni ekologjik për zonat urbane nuk duhet të synojë stabilitetin dhe parashikueshmërinë, por një rezistencë më të madhe ndaj goditjeve të pashmangshme të brendshme dhe të jashtme që do të ndikojnë në zonën urbane, gjë e cila duhet arritur në të ardhmen. Duke marrë sistemet natyrore si model, vetë-mjaftueshmëria vlerësohet si një nga karakteristikat më të rëndësishme të metabolizmit të qëndrueshëm, duke zvogëluar varësinë nga një vend i gjerë për nxjerrjen e burimeve ose hedhjen e mbeturinave.

Prandaj, qyteti dhe mjedisi urban duhet të shihen si një sistem i plotë i planifikimit, hartimit dhe administrimit të zonave urbane, për të cilat karakteristikat hapësinore që ndikojnë në fluksin e materialit dhe energjisë duhet që të kërkohen në mënyrë logjike, dhe për këtë kërkohet edhe një analizë afatgjatë. Kështu, (Roggema, R. & Alshboul, A., 2014, p. 739) propozojnë se në metabolizmin urban të çdo qyteti apo zone tjetër urbane duhet që të zbatohen katër parime kryesore: ndërvarësia, rrjedha ciklike e burimeve, bashkëpunimi dhe partneriteti. Sipas tyre, këto parime përcaktojnë se si një ekosistem organizohet vetë, optimizon qëndrueshmërinë dhe është në gjendje të mbajë ‘ciklin e tij të jetës’ dhe mund të përdoret si bazë për zhvillimin e qyteteve. Nga ana tjetër, procesi i përvetësimit kritik dhe rishikimit selektiv të së kaluarës, mund të na ndihmojë të përpunojmë vizione të mirëinformuara për të ardhmen.

Por mbi të gjitha, ashtu siç shkruan Edward T. Hall(1982) nuk duhen injoruar marrëdhënia e njeriut me zgjatimet e tij në mjedisin rrethues, dhe dimensionet e tyre. ‘Në kuptimin më të shkurtër të mundshëm, mesazhi është se sado që njeriu të përpiket, është e pamundur që ai të devijojë veten nga kultura e tij, sepse ajo ka depërtuar në rrënjët e sistemit të tij nervor dhe përcakton se si e percepton atë botë. Shumica e kulturës qëndron e fshehur dhe është jashtë kontrollit vullnetar, duke përbërë thelbin e ekzistencës njerëzore. Edhe kur fragmente të vogla të kulturës janë ngritur në vetëdije, ato janë të vështira për tu ndryshuar, jo vetëm sepse ata janë me përvojë kaq personale, por sepse njerëzit nuk mund të veprojnë ose bashkëveprojnë fare në ndonjë mënyrë kuptimplote, përveçse përmes mediumit të kulturës’ (Hall, 1982, p. 188).

Parimet kryesore të zbatimit të metabolizmit urban (Roggema & Alshboul, 2014)



Meqenëse popullsia mund të tkurret dhe rritet me kalimin e kohës, modeli i metabolizmit, ose më mirë hyrjet dhe daljet e flukseve të burimeve, duhet të kenë gjithashtu aftësinë të parshtaten e të rregullohen në përputhje me ndryshimet e shkallës së urbanizimit. Kur sasia e njerëzve zvogëlohet, kërkohen më pak burime dhe e anasjellta. Roggema & Alshboul (2014) vlerësojnë që shumica mund të furnizohet nga

mbetjet e riciklueshme ose burime të rinovueshme. Sidomos, pjesa e mbetjeve të ricikluara duhet të rritet për të përmbushur kërkesat e sasisë në rritje të njerëzve, sepse një rritje e papritur e burimeve të rinovueshme është e pamundur. Nëse prodhimi nis kur popullsia rritet në mënyrë të papritur atëherë mund të rezultojë shumë vonë. Me fjalë të tjera, këto burime duhet të jenë tashmë të pranishme dhe të bëhen të disponueshme kur rritet kërkesa. Kjo nënkupton që këto burime duhet të mbahen në ruajtje deri në momentin që kërkohen. Në planifikimin për qytetet duhet të krijohet hapësirë për këto depozitime të burimeve (Roggema, R. & Alshboul, A., 2014, p. 740). Planifikimi i burimeve apo i depozitimit të inputeve të riciklueshme mund të përfshijë si burimet tradicionale ashtu dhe ato të riciklueshme. Për këtë duhen politika vizionare që jo gjithmonë sigurohen nga zhvillimi teknologjik dhe shkencor. Për të zgjidhur këtë konflikt, studiuesit i referohen gjithmonë e më shumë ekologjisë politike urbane, e cila thekson më shumë teorinë se qytetet janë të ngritura (ndërtuara) nga procese socio-ekologjike, dhe i kushton më shumë rëndësi kushteve të mjedisit urban dhe sesi ndërtohen dhe ri-ndërtohen këto kushte. Në këtë mënyrë projektet politike mund të formulohen vetëm në terma demokratike të organizimit të proceseve nëpërmjet të cilave prodhohen mjediset në të cilat jetojnë qeniet njerëzore dhe jonjerëzore (Heynen, N., Kaika, M. & Swyngedouw, E., 2006, p. 2). Kjo është arsyeja se pse shumë studiues pretendojnë që studimet mbi metabolizmin urban mund të shërbejnë edhe si një mjet për identifikimin e problemeve mjedisore dhe dizenjimin e politikave urbane eficiente (Rapoport, 2011, p. 3). Axhenda e metabolizmit është e lidhur gjithashtu dhe me çështjet e identitetit kombëtar të një kombi, siç është për shembull rasti i Japonisë, dhe forcës që ajo gjeti për tu përballur me karakteristikat që e përshkonin territorin e saj të tilla si tragjedia e bombës atomike gjatë Luftës së Dytë Botërore, tërmetet e vazhdueshme dhe të fuqishme si dhe cunamet (Schalk, 2014, p. 280). Ashtu si edhe në rastin e Japonisë, roli i projektuesit urban është vendimtar në zhvillimin dhe zbatimin e koncepteve novatore si edhe në eksperimentimin e efikasitetit të tyre. Kështu, me evoluimin e shkencës së planifikimit nga urbanistika në planifikim hapësinor ka ndryshuar edhe roli i planifikuesit. Ne e përdorim termin planifikim urban 'për të përshkruar një profesion ose proces për organizimin e zhvillimit urban, por në të vërtetë është një fushë me kufijtë të papërcaktuar qartë. Planifikimi urban mësohet si në shkollat e arkitekturës edhe në shkollat e gjeografisë, madje edhe në biznes dhe ekonomi. Edhe pse mund të thuhet se planifikuesi urban është pa një 'identitet të qartë', kjo është njëkohësisht edhe pika më e fortë e planifikuesit, pasi baza e njohurive multi-disiplinore i mundëson atij/asaj të kapërcejë dikotomitë e njeriut kundrejt natyrës dhe objektivit kundrejt diskursit. Gjatë vitit 2015, në master studion me temë "*Metabolism in Context*", Giezen & Roemers pohojnë se planifikuesi është personi i duhur për të bashkuar qasjen inxhinierike me të cilën janë marrë përgjithësisht ekologët industrialë, me qasjen njerëzore dhe politike të ekologjisë politike urbane, përse i përket metabolizmin urban. 'Planifikuesi metabolik, siç e quajmë ne, e koncepton qytetin si një bashkësi rrjedhash që përcaktohen nga proceset socio-natyrore dhe që marrin vetëm kuptimin dhe domethënien e tyre nga një perspektivë shoqërore dhe politike. Planifikuesi metabolik përkthehet midis këtyre proceseve dhe këndvështrimeve dhe përpiqet të drejtojë rrjedhat në qytet, ose me ndërhyrje fizike, ose ndërveprime diskursive nga aktorët brenda qytetit' (Giezen & Roemers, 2015, p. 18). Në këtë mënyrë metabolizmi urban, siç është përshkruar edhe më lart, në rastin e Shqipërisë përbën një mundësi për të ndërtuar politika më të mira urbane në raport me mjedisin, ekonominë dhe historikun e një vendi. Në këtë drejtim, zhvillimi i shkencës së planifikimit hapësinor dhe rritja e rolit të planifikuesit urban, janë vendimtare për zhvillimin e këtyre politikave dhe udhëheqjen e informuar të vendimarrësve në

qeverisjen, planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

5 KAPITULLI V_PROPOZIMI I NJË KORNIZE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR ZHVILLIMIN E ANALIZËS METABOLIKE

Qëllimi i Analizës Metabolike është të arrijë në propozime territoriale që nxisin zhvillimin e qëndrueshëm dhe të nxisë zgjidhjen e problematikave hapësinore në një mënyrë holistike, përmes studimit të flukseve të burimeve kryesore. Kjo analizë synon të adresojë çështjet e sistemit urban sipas shkallëve territoriale të ndryshme administrative, duke filluar nga niveli më i ulët lokal, tek niveli rajonal, kombëtar e pse jo edhe ndërkuftar, në hulumtimin e marrdhënieve të qëndrueshme të Shqipërisë në kontekstin Ballkanik dhe Mesdhetar.

Territori administrativ i bashkive në Shqipëri, subjekt i planeve të reja vendore, paraqitet më kompleks me zbatimin e Reformës së re Administrative Territoriale, pasi përmban në kufijtë e tij disa sisteme territoriale: sistemin natyror, ujqor, bujqësor, urban, dhe infrastrukturor. Planet e reja vendore në këtë drejtim, të paktën formalisht mbartën detyrimin të hartojnë edhe analizën metabolike. Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave VKM. Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” në Nenin 2, pika 17 “Metabolizmi i territorit”, jepet përkufizimi i konceptit të Metabolizmit si “modeli që përdoret për identifikimin dhe analizën e flukseve të materialeve dhe të energjisë brenda territoreve të caktuara”, Nenin 2, pika 17. Ndërsa në nenin 19 dhe 55, përcaktohet detyrimi për përfshirjen e analizës metabolike përkatësisht në PPK dhe në Analizën e Vlerësimit të territorit të Planeve të Përgjithshme Vendore. Megjithatë, tre tipare kryesore identifikohrn se mungojnë në kuadrin e ri ligjor:

- Së pari, struktura e detajuar e të dhënave ku duhet mbështetur kjo analizë;
- Së dyti, metodologjia për realizimin e saj;
- Së treti, normat dhe standartet si vlera që paraqesin objektivin e synuar me qëllim monitorimin për zbatimin e saj, hap që lidhet me cilësinë e zbatimit.

Në mungesë të këtyre referencave, planet e reja vendore ndeshën vështirësi në realizimin e AM, e cila u karakterizua nga një qasje formale për të plotësuar një detyrim ligjor të përmbajtjes së dokumentave të PPV, dhe rezultate të cilat ndikuan pjesërisht ose shumë pak rezultatet e planit. Akoma më e rëndësishme, qasja metabolike mbeti e kufizuar dhe nuk u bë pjesë organike e instrumentave të zbatimit të planit. Modelet ku u bazuan planet vendore për realizimin e kësaj analize ishin “The Metabolism of Albania” dhe “Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Shqipëria 2030”, të cilët edhe pse më të sukseshëm në aplikimin e qasjes metabolike, mbartnin boshllëqet e veta metodologjike në ofrimin e një modeli standart për aplikimin e metabolizmit në planet e niveleve më të ulta administrative të territorit.

Kështu mund të themi se vakumi ligjor është faktori primar që ndikoi në mungesat e zbatimit cilësor të AM në planet vendore. Analiza krahasimore e planeve vendore dëshmoi se ka edhe dy faktorë të tjerë që ndikuan në një aplikim të dobët të qasjes metabolike, të cilat janë:

- Mungesa e një baze teorike të konsoliduar si dhe eksperiencia e autoriteteve të planifikimit në aplikimin kësaj analize shoqëruar me limitin e të dhënave të detajuar në njësine të territorit më të vogël subjekt planifikimi.

- Shkalla territoriale e imponuar për kryerjen e analizës (kufiri administrativ i bashkisë) e papërshtatshme për prodhimin e rezultateve në shkallë për disa nga flukset në studim.
- Mungesa e studimeve shoqëruese mbi shkallën e urbanizimit për qytetet.

Ky kapitull synon të parashtrojë një metodë të konsoliduar për zhvillimin e AM me qëllim gjatë aplikimit të saj në planet hapësinore të niveleve të ndryshme në Shqipëri.

5.1 Qëllimi i kornizës

Qëllimi i kornizës së propozuar është të ofrojë një metodë të integruar që përfshinë në një, aspektet e zhvillimit urban dhe të flukseve metabolike. Vetëm kështu mund të kuptojmë më qartë lidhjen midis faktorëve urbanë dhe flukseve kryesore metabolike dhe njëkohësisht të ndihmojmë në hartimin e planeve hapësinore konsekuente në lidhje me vetveten (vizioni dhe gjetjet e analizave të planit lidhen me propozimet e tij) dhe me njëra tjetrën (planet e hierarkivë të ulëta, zbatojnë më në detaje planet e hierarkive më të larta). Në këtë mënyrë Analiza Metabolike arrin të integrohet në dokumentat e planifikimit që nga vizioni dhe strterritorin në studim është baza ku ngrihet dhe zhvillohet kjo kornizë.

Duhet të theksuar se për nivele të ndryshme territoriale, plane të ndryshme në hierarkinë hapësinore, detajimi i kornizës së propozuar ndryshon. Gjithashtu, për qëllime studimi, funksionet e zonave urbane janë konsideruar më të thjeshtuara, dhe vetëm një numër i kufizuar fluksesh do të prezantohen. Megjithë kufizimet e shprehura, korniza do të ofrojë një seri elementësh që mundosojnë një analizë më komplekse dhe gjithpërfshirëse për hartimin e planeve të reja territoriale në Shqipëri.

5.2 Të dhënat

Për të zbatuar kornizën e analizës ka nevojë për mbledhje, përpunim, dhe interpretim të një numri të madh të dhënash statistikore. Dy elementë që duhen përcaktuar mirë para se të fillojë mbledhja e të dhënave për profilin urban dhe metabolik janë: intervalet/periudhat kohore dhe shkalla hapësinore, si edhe qëllimi dhe rëndësia e tyre. Siç u konstatua edhe nga rastet e aplikuar në Shqipëri (shih 4.1, 4.2), si në nivelin kombëtar ashtu edhe atë lokal, mungesa e të dhënave qëndron në thelb të pamundësisë për zhvillimin e analizave të plota dhe domethënëse. Shpesh ato nuk përputhen me shkallën territoriale në të cilën po kryhet analiza dhe janë të mbledhura në intervale kohore të gjata, si psh të dhënat e detajuara nga Censuset që vijnë cdo 10 vjet dhe shpesh aglomerohen në nivel Qarku i cili rezulton i papërshtatshëm për analizat në nivel bashkie. Gjithashtu, të dhënat statistikore duke patur si qëllim karahasime të vendit me statistika kombëtare të vendeve të rajonit, qëllimi i tyre nuk përputhet me qëllimet e planifikimit ndaj shpesh janë vështirësisht të përdorshme.

Sidoqoftë, për të prodhuar vlerësime mjedisore urbane të qëndrueshme, të riprodhueshme, të përshkallëzueshme dhe të krahasueshme, si dhe identifikimin e drejtuesve të tyre përkatës, së pari është e nevojshme të sigurohet informacion i mjaftueshëm në lidhje me të dhënat që do të përdoren brenda studimit. Për kornizën aktuale, ka disa përshkrime sqaruese paraprake që janë thelbësore për t'u siguruar kur grumbullohen dhe analizohen të dhëna në mënyrë që të rritet cilësia e analizës.

Tipologjia	Treguesit	Shkalla mbledhjes	Shkalla e përpunimit	Referenca	Periodiciteti
------------	-----------	-------------------	----------------------	-----------	---------------

Profili urban	Ekonomik ë Territorial ë Socialë Mjedisorë	Qeliza statistikore Nënjësi strukturore	Njësi strukturore Nënjësi vendore Njësi Vendore Bashki-Qark- Rajon- Kombëtar	Zyrat Statistike dhe Drejtoritë e planifikimit në nivel lokal INSTAT, Institucionet e menaxhimit të burimeve natyrore	Tremujor Vjetor 5 – Vjeçar 10-Vjeçar
Tipologjia	Treguesit	Shkalla mbledhjes	Shkalla e përpunimit	Referenca	Periodiciteti
Profili metaboli k	Energjia Uji Ushqimi Mbetjet Materialet	Matja e flukseve në kufijtë e Sistemit	Territori në Studim, Njësi Vendore Bashki-Qark- Rajon- Kombëtar	Agjencitë/Ministrit ë përgjegjëse për Sektorin Ndërmarrjet e menaxhimit të burimit.	Tremujor Vjetor 5 – Vjeçar 10-Vjeçar

Tabela 5.2-1 Struktura e mbledhjes së të dhënave, niveli, rëndësia dhe detaji. Përpunoi: Autori

5.3 Profili Urban

Për të ndërtuar një profil urban të sistemit që studjojmë na vijnë në ndihmë një numër indikatorësh, të cilët ndryshojnë sipas:

- shkallës territoriale apo shtrirjes së sistemit, i cili në rasin tonë lidhet me tipin e planit hapësinor;
- problematikën apo çështjen nën investigim.

Sasia e flukseve të burimeve, varet nga shkalla territoriale e zonës e cila po analizohet, ose thënë ndryshe nga kufiri i sistemit. Nga njëra anë hapësira territoriale përkufizon sasinë e potencialit të burimeve dhe stokun e tyre, ndërkohë që sistemi urban ndikon në sasinë e flukseve që konsumohen dhe të atyre që rifuten në sistem. Në këtë mënyrë, për planifikuesit është e rëndësishme të kuptojnë se si Sistemi Urban, mund të influencojnë metabolizmin e territorit rreth tij. Studimi dhe identifikimi i kësaj lidhjeje na mundëson planifikimin e qyteteve me performancë të lartë metabolike. Gjithashtu e rëndësishme për ne në këtë kërkim është identifikimi i metodave për zhvillimin e nje analize metabolike sa më pranë metabolizimit real të territorit që analizojmë me qëllim identifikimin e problematikave dhe planifikimin organik të tij. *Shembujt e shqyrtuar deri më tani në rastin e Shqipërisë lidhen pak ose aspak me aspektet e profilit urban, gjë e cila ka penalizuar efikasitetin e kësaj përqsasjeje në aplikimin dhe zbatimin e saj duke e lënë atë të përgjithshme dhe teorike. Kërkimi propozon se për identifikuar metabolizmin e territorit që studiojmë, njohja e profilit urban është shumë e rëndësishme për hartimin e një analize metabolike me vlerë në propozimet territoriale. Tre janë elementet që propozon ky kërkim për zhvillimin e një analize metabolike të shëndoshë dhe e thellë:*

- ✓ Njohja e *profilit urban* dhe karakteristikave të tij;
- ✓ Ndërtimi i *profilit metabolik* dhe flukseve kryesore të tij;
- ✓ Vendosja e një korrelacioni midis *kufijve të sistemit* dhe faktorit hapësirë- kohë si faktor kyc për identifikimin e të dhënave dhe indikatorëve të nevojshëm për këtë analizë;

5.3.1 Shkalla territoriale dhe Kufijtë e Sistemit

Siç vëren Owens (1986) ‘aspekte të ndryshme të strukturës hapësinore bëhen të rëndësishme në shkallë të ndryshme, nga rajoni, ku modeli i gjerë i vendbanimeve është

i rëndësishëm, në atë lokal, ku ajo që ka rëndësi është (cilësia e) vendndodhjes në raport për mikroklimën, paraqitjen dhe orientimin' (Owens, 1986). Në hartimin e një analize metabolike që ushqen planet territoriale me informacion të nevojshëm për vendimmarrje në politikat e zhvillimit hapësinor, përcaktimi i kufirit të sistemit në analizë është i domosdoshëm. Planet territoriale, sipas ligjit të planifikimit në fuqi përputhen me kufijtë administrativë të bashkisë për Planet e Përgjithshme Vendore, Planet Sektoriale në nivel Bashkie (PSNB) dhe Planet Sektoriale në nivel Qarku (PSNQ). 'Burimet administrative janë periodike (...) dhe krijojnë mundësinë e bërjes së analizave deri në njësi administrative më të vogla. Ato bëjnë të mundur ndërtimin e serive kohore dhe studimin e fenomeneve në dinamikën e tyre' (Misha, 2005), por i njëjti raport thekson faktin se të dhënat statistikore, që sigurohen nga burimet administrative nuk janë të plota dhe gjithëpërfshirëse duke humbur shkallën e nevojshme të përfaqësimit dhe për pasojë saktësinë dhe besueshmërinë.

Përcaktimi i kufirit të sistemit ndikohet së pari nga tipologjia e studimit, i cili sikundër vumë re në rastet e mësipërme për analizën metabolike, rrallë ose aspak ndikohet nga kufiri administrativ. Ndërkohë planet territoriale sipas përkufizimeve ligjore janë të lidhura me sistemin administrativ dhe nivelin e qeverisjes së territorit si tipar i rëndësishëm që përcakton vendimmarrjen dhe përgjegjësinë teknike dhe politike për çështjet e zhvillimit dhe të planifikimit. Të dy këto kriteret janë të rëndësishme dhe nuk mund të anashkalohen në detajimin e analizës metabolike, nëse duam që ajo të bëhet e zbatueshme dhe konkrete. Përshkallëzimi i indikatorëve që ndërtojnë profilin urban dhe profilin metabolik sipas nivelit të planifikimit është i domosdoshëm, por ndërkohë ky studim propozon prezantimin e një niveli të mesëm të instrumentave planifikues si ai Planit Hapësinor Rajonal, ku kufiri i Rajonit përputhet me Rajonet e Zhvillimit. Në këtë nivel, analiza e flukseve të materialeve dhe të energjisë mund të kapë potencialin e nevojshëm për t'u realizuar dhe për të ndikuar në politikat e planifikimit kombëtare dhe në detajimin e planeve territoriale të niveleve më të ulta. Për sa i përket vendimarrjes politike në këtë nivel ajo mund të ndahet midis nivelit qendror dhe bashkimit të organeve qeverisëse të disa njësive vendore, në varësi të çështjes apo sektorit që përfaqëson fluksi i analizuar. Institucionet e koordinimit të planifikimit si AKPT duhet të kenë një rol udhëheqës në këtë drejtim.

Koncepti i Rajonit nuk është i ri në lëmin e diskutimeve mbi politikat territoriale të vendit tonë duke nisur diskutimin e tij që me diskutimet për realizimin e një reforme administrative territoriale dhe nevojës për konsolidimin e decentralizimit siç argumentohet dhe nga (Toto, 2008). Megjithatë, edhe pse Reforma Administrative Territoriale u realizuar në vitin 2014 me miratimin e Ligjit Nr. 115/2014 'Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë', vendimarrja për rajonalizimin e vendit ka ndodhur vetëm në vitin 2020 me miratimin e Ligjit Nr. 102/2020, Neni 3, pika 7, 'Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin'. Sipas këtij ligji "Rajoni zhvillimor është një territor ndërmjet nivelit kombëtar dhe vendor, i cili dallohet nga një tërësi karakteristikash gjeografike, socio-ekonomike, historike, kulturore, mjedisore, institucionale dhe politike, që e identifikojnë atë edhe fizikisht". Sipas këtij ligji Territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në katër rajone zhvillimi për territorin e të cilëve hartohet, zbatohet dhe vlerësohet politika kombëtare për zhvillimin dhe kohezionin rajonal.

Rajonet e zhvillimit nuk janë njësi administrative sipas kuptimit të legjislationit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, por përcaktohen si njësi territoriale, që përfshijnë disa njësi të vetëqeverisjes vendore. Qëllimet kryesore të zhvillimit rajonal, përcaktohen në Nenin 5 të po këtij ligji dhe janë a) zhvillimi i qëndrueshëm, i ekuilibruar shoqëror dhe ekonomik, si dhe kohezioni territorial në territorin e Republikës së Shqipërisë; b)

reduktimi i pabarazive ndërmjet dhe brenda rajoneve të zhvillimit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët; c) rritja e konkurrueshmërisë së rajoneve të zhvillimit përmes forcimit të kapaciteteve të tyre inovative, përdorimit maksimal dhe vlerësimit të burimeve natyrore, burimeve njerëzore dhe veçorive ekonomike; ç) ruajtja dhe forcimi i identitetit specifik të rajonit të zhvillimit; d) mbështetja e bashkëpunimit ndërvendor, ndërrajonal dhe ndërkufitar të njësive të vetëqeverisjes vendore për zhvillimin social dhe ekonomik të rajoneve të zhvillimit Neni 5, pika a,b,c,ç dhe d (L. 102/2020, Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin, 2020).

Pozicioni i rajoneve në tregjet botërore nuk përcaktohet më nga kanalet politike por nga avantazhet konkurruese të rajoneve dhe aftësia e tyre për t'i shfrytëzuar me sukses këto avantazhe. Pra kemi një kapërcim nga koncepti statik i avantazhit krahasues në konceptin dinamik të avantazhit konkurrues, ku politikëbërësit, përmes një politike aktive dhe marrëdhëniesh komplekse publike-private, maksimalizojnë kapacitetin e territorit të tyre për të konkuruar dhe këtë e bëjnë duke shtuar burimet dhe mobilizuar energjitë lokale.

	Niveli i mbledhjes i të dhënave	Niveli i përpunimit i të dhënave	Instrumentat e planifikimit	Vendi marrja	Koha
Kufijtë statistikorë	Qeliza statistikore	Kuadrati 1km ² Nivel qarku	NK	NA	Cdo 10 vjet censet Vjetore/sipas raporteve vjetore të cilësisë
Kufijtë administrativë	Nënjësia administrative (ish komuna)	Njesia administrative Bashki	PDV PPV, PSNB, PSNQ,	Vendor	Pjesore, vjetore
Kufijtë sipas çështjes dhe sektorit	Kufij ne varesi te ceshtjes se rendesise kombetare apo sektorit	Bashkim njesish dhe apo nenjesi administrative	PKS, PDZRK	Qendror	Pjesore, vjetore ose cdo 4 vjet
Kufijtë Rajonalë	Sipas flukseve të burimeve Input Output	Rajoni	Planet Rajonale sipas kufiri të Rajoneve të Zhvillimit	Niveli i menaxhi mit/Rajoni	NK

Tabela 5.3-1 Lidhja midis nivelit të mbledhjes së të dhënave, kohës, kufijve të një sistemi , planeve hapësinore dhe nivelit të vendimmarrjes politike. *Burimi: Autori*

Në këtë mënyrë mund të dallojmë katër tipe kufijsh që mund të përcaktojnë një sistem të karakterizuar sipas nivelit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, ndikimi në instrumentat e planifikimit dhe lidhja e tyre me nivelin e vendimmarrjes. Këto karakteristika janë treguar në tabelën e mësipërme. Nga rastet e analizuara në nivel bashkie u vu re se profili metabolik për disa flukse mbetet i reduktuar në këtë nivel administrativ, së pari për shkak të shtrirjes së kufizuar territoriale që shpesh ndërpret flukset kryesore të materialeve dhe energjisë, dhe së dyti për shkak të mungesës për vendimmarrje politike në këtë nivelin lokal që mund të ndikojë flukset metabolike. Ndërkohë niveli kombëtar për hartimin e analizës metabolike, ka nevojë për një shkallë informimi dhe vizualizimi të ndërmjetmë me qëllim formulimin e politikave që zgjidhin problemet e konstatuara nga naliza metabolike në nivelin e përshtatshëm territorial. Për këtë arsye sugjerohet të shtohet niveli i Rajonit të Zhvillimit për hartimin e planeve

hapësinore dhe analizave metabolike, si shkalla më e përshtatshme për agregimin e të dhënave dhe formulimin e politikave kombëtare hapësinore.

Duke iu referuar Herrschel & Newman (2002) rajoni është njësi territoriale fleksibël, i cili luan rolin e ndërmjetësit mes shkallës kombëtare dhe lokale. Mbart identitet kulturor dhe trashëgimi historike dhe nxit ndjenjën e përkatësisë që ndikon në përfaqësi politike dhe vendimmarrje politike. Gjithashtu, rajoni nxit konkurrencën dhe vendosjen e ekonomisë së shkallës si dhe shërben si një hapësirë që stimulon zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore. Po ashtu, ai qëndron në themel të krijimit të drejtësisë ekonomike hapësinore dhe përfitimeve mjedisore (Herrschel, T. & P. Newman, 2002). Rajoni është hapësira më e përshtatshme territoriale ku mund të realizohet marrëdhënia e mësipërme sepse mënjanon tendencat negative të konkurrencës në baza territoriale shumë fragmentare, ofron koordinim të politikave në nivel rajonal dhe më eficient, koordinon investimet kapitale për infrastruktura, etj. (Toto, 2008, pp. 7-8)

5.3.2 Treguesit për ndërtimin e Profilit Urban

Pamvarësisht shtrirjes hapësinore të një sistemi territorial në studim, zonat e urbanizuara me kulmimin e tyre në qytete, mishërojnë artikullimin më kompleks midis fenomeneve jetësore. Njohja e plotë e një sistemi urban është një detyrë shumë delikate që duhet të marrë parasysh të gjitha aspektet e ndryshme të funksionimit të tij, identifikimin e tipareve që e bëjnë atë unik në krahasim me të gjithë të tjerët. Numri i indikatorëve të nevojshëm për të arritur këtë shkallë njohje (sasiorë ose cilësorë) mund të jetë praktikisht i pafund, dhe mund të ndryshojë në varësi tëkallës por edhe nivelit të agregimit. Ky seksion paraqet disa tregues thelbësor që mund të ndihmojnë për të njohur dhe vlersuar më mirë një kontekst urban. Kategoritë e zgjedhura në këtë tabelë nuk janë shteruese por synojnë të mbulojnë një gamë të gjerë të karakteristikave territoriale që janë të rëndësishme për vlerësimet e qëndrueshmërisë urbane. Për më tepër, kategori të reja ose Indikatorët e dhënë nuk janë shterues, por tregues të rinj të profilit urban mund të krijohen duke kombinuar disa nga treguesit e propozuar. Gjithashtu, disa prej indikatorëve, mund të maten në metrika të ndryshme, për shembull, popullsia mund të llogaritet në terma absolutë, në terma relativë krahasuar me shifrat kombëtare, sipas gjinisë, sipas kategorive të moshës (absolute dhe pjesët), etj.

Në mënyrë ideale, për të siguruar një profil urban më gjithëpërfshirës, do të ishte e nevojshme të sigurohen të dhëna të vazhdueshme në kohë, ndër vite, për shkallë të ndryshme hapësinore, si dhe për metrika të ndryshme. Në praktikë, kjo është e vështirë për t'u arritur pasi institucione të ndryshme që merren me mbledhjen e të dhënave si zyrat e statistikave kombëtare INSTAT apo lokale, operojnë për kufij territorial administrativë të ndryshme nga kufijtë e qelizave statistikore. Sidoqoftë, krijimi i një profili të detajuar urban është po aq i rëndësishëm pasi, jo vetëm që shtojnë kontekstin e nevojshëm për studimet e vlerësimit mjedisor, por ato gjithashtu mundësojnë krahasimin midis studimeve të ndryshme, shkallëve hapësinore dhe në kohë. Karakterizimi i duhur i një sistemi urban është gjithashtu një hap i domosdoshëm për të identifikuar përdorimin e burimeve, menaxhimin efikas të tyre dhe mundësisht në krijimin e cikleve qarkulluese të materialeve duke nxitur kështu ripërdorimin dhe reduktimin e humbjeve.

Temat	Indikatorët	Rëndësia
--------------	--------------------	-----------------

Demografia	Popullsia dhe Struktura e saj	Jep informacion në lidhje me popullsinë , strukturën, si dhe evolucionin e saj në zonën e studimit. Kjo mundëson krahasimin me raste të tjera studimore dhe krijimin e treguesve në lidhje me popullsinë (siç janë flukset e burimeve për frymë/familje ose për grupmosha). Kjo gjithashtu lejon të kemi një kuptim më të mirë të trendeve të kaluara dhe të ardhshme në përdorimin e burimeve, aktivitetin ekonomik dhe zhvillimin urban.
	Densiteti dhe Densiteti Urban	
Sociale	Struktura e njësive ekonomike familjare Punësimi dhe Struktura e Punësimit	Informon strukturën dhe madhësinë e familjeve të cilat janë pjesë qendrore e shoqërisë. Profili shoqëror i qyteteve gjithashtu ndihmon në kuptimin e sjelljes së konsumit. Tregues të tillë mund të ilustrojnë dinamikën e fuqisë punëtore të një qyteti që drejton të ardhurat dhe shpenzimet e familjeve.
Ekonomia	Rritja Ekonomike, GDP Kontributi i Sektorëve në Ekonomi Struktura e Prodhimit Të ardhurat sipas sektorëve	Treguesit ekonomikë ilustrojnë produktivitetin e aktiviteteve ekonomike të një zone urbane. Të dhënat për sektorët ekonomikë të prodhimit dhe të shërbimeve na informojnë edhe për nivelin e resurseve, materialeve dhe energjisë së përdorur.
Territori	Përdorimi i tokës sipas kategorive bazëTerritori Urban sipas Shkallës së Urbanizimit/ sipas dendësisë së ndërtimit (e lartë/ulët/mesme) Diversiteti urban (monocentrik, policentrik, fshat urban, model i përbërë)	Përdorimi i tokës dhe shkalla e urbanizimit janë me rëndësi për të ndërtuar profilin urban të një territori në studim, pasi raportet mes këtyre të fundit dhe matja e ndryshimit të tyre në kohë është vendimtare për parashikimin e evolimit në kohë të sistemit urban, disponueshmërisë të resursit tokë dhe mënyrës së aglomerimit të popullsisë.
Ndërtesat	Struktura e ndërtimeve (kompakte/fragmentuar) Ndërtesat sipas periudhës së ndërtimit Ndërtesat sipas llojit dhe Cilësisë	Stoku i ndërtesave ofron të dhëna më specifike mbi profilet e ndërtesave të një qyteti. Ai tregon numrin e tyre, tipologjitë, përbërjen materiale, si dhe sa përfaqësuese janë ato në të gjithë stokun e materialeve. Këto informacione mund të ndihmojnë në modelimin e përdorimit të burimeve dhe emetimeve të ndotjeve që vijnë nga ndërtesat dhe infrastrukturat.
Transporti	Modaliteti i Transportit	Treguesit e transportit ofrojnë informacione për të kuptuar kërkesën për

	Infrastruktura e transportit në raport me dendësinë urbane	energji të transportit dhe ndotjen. Gjithashtu lidh profilin socio-ekonomik të konsumit të familjeve dhe organizimin territorial.
Mjedisi	Mbetjet sipas sektorit Mbetjet sipas llojit Trajtimi i mbetjeve Emetimet në ajër Ndotësit në ujë	Të dhënat mbi ndotjet në mjedis kryesisht ujë ajër tokë, të interpretuara në lidhje me indikatorët e mësipërm na japin një informacion të rëndësishëm mbi ndikimin e urbanizimit në mjedis.

Tabela 5.3-2_Indikatorët për ndërtimin e profilit urban Burimi:Autori

Tabela na paraqet temat dhe indikatorët kryesorë të vlerësuar, për ndërtimin e profilit urban të një sistemi në studim. Duhet theksuar se nuk ka një prerje të qartë mes temave se ku mund të kategorizohet një indikator nga mësipër, pasi interpretimi i secilit në raport me treguesit e tjerë mund të na shpalosë të dhëna për disa tema njëkohësisht.

Projekti SUME ‘Sustainable Urban Metabolism for Europe’(2008-2011), vë theksin tek forma urbane dhe ndikimi i saj në metabolizmin urban përmes një analize krahasuese të disa prej qyteteve europiane. Edhe pse termi i Formës Urbane përdoret gjerësisht në literaturë, për të nuk ka akoma një përkufizim të vetëm dhe të mirëpërcaktuar. Në përgjithësi, "forma urbane" mund të kuptohet si një term gjithëpërfshirës që ofron një pamje të integruar të mjedisit të ndërtuar urban. Shpesh i referohet shpërndarjes hapësinore të treguesëve urbanë të tillë si dendësia, cilësia e stokut të ndërtesave urbane, përfshirë formën e përgjithshme të një qyteti, elementet morfologjike (paraqitja e sistemit rrugor, format e blloqeve të ndërtesave, hapësirave të hapura, parcelave, dhe të llojeve të ndërtesave), ndërsa në raste të tjera lidhet me aspekte të përdorimit të tokës (dhe konceptet historike të zhvillimit urban) dhe organizimin funksional në terma hapësinorë. Edhe në këtë rast mund të themi se termi "formë urbane" është relativ ndaj shkallës hapësinore dhe kufirit të sistemit të kërkimit gjithashtu. Studime të ndryshme konkludojnë se përcaktimi i formës urbane është kompleks dhe rezultat i disa faktorëve si për shembull:

- Popullsia dhe ndryshimet e saj, strukturat e vendbanimeve dhe konsumi i tokës (psh. bazuar në klasifikimet e ndërtesave dhe referimin e konsumit të tokës);
- Dendësia e popullsisë dhe struktura e vendbanimeve (forma të dendura kundrejt hapësirave urbane të shtrira) dhe efektet përkatëse të transportit (gjatësia e udhëtimeve, përdorimi i transportit publik dhe individual mënyrat të motorizuar;
- Shpërndarja hapësinore e njerëzve (si popullsi banimi ose pune) dhe funksionet (përzierja funksionale) brenda rajoneve urbane dhe efektet e lidhura me transportin;
- Cilësia e stokut të ndërtesave e cila lidhet drejtpërdrejt me kërkesën për energji për ngrohjen e tyre. Ky tipar lidhet edhe me periudhat e ndërtimit, llojet e materialeve të ndërtesave dhe / ose madhësia e tyre (tipologjia).

Studimi i mësipërm, identifikon tre tipare specifike të formës urbane për të përshkruar karakteristikat më të rëndësishme, duke bërë të mundur përshkrimin e çështjeve të ndryshme që ndërlidhen midis formës urbane dhe performancës metabolike:

- (1) *Konfigurimi urban*, për të përshkruar formën e përgjithshme dhe zgjerimin e një qyteti. Shpesh ky konfigurim mbart kompleksitetin e tij në përcaktim i cili mund të ndryshojë në varësi të metodës administrative, përafrimi morfologjik apo

funksional në përcaktimin e tij. Parametrat e përdorur për të inkuadruar konfigurimin urban është dendësia e strukturave të ndërtuara të klasifikuara në varësi të shkallës së dendësisë dhe kompaktësisë si më poshtë:

- Dendësia e lartë, struktura kompakte;
- Dendësia e lartë, struktura e fragmentuar;
- Dendësia e ulët, struktura kompakte;
- Dendësia e ulët, struktura e fragmentuar.

(2) *Diversiteti urban*, i cili përdoret për të përshkruar funksionet më të rëndësishme brenda qytetit dhe ndërlidhjet hapësinore midis pjesëve të ndryshme të tij, veçanërisht përmes transportit. Tipologjia e Diversitetit Urban përcaktohet sipas katër modeleve:

- Monocentrik;
- Policentrik;
- Fshat Urban;
- Model i përbërë.

(3) *Stoku i ndërtesave urbane*, për të përshkruar cilësitë hapësinore dhe cilësitë teknike të stokut të ndërtesave, veçanërisht lidhet me konsumin e tokës dhe të energjisë.

Tipologjia e stokut të banesave mund të klasifikohet në: *Banesa një familjare, bifamiljare dhe shumëfamiljare sipas periudhave të ndërtimit. Në rastin e Shqipërisë këto periudha ndërtimi janë ndarë sipas viteve: 1945, 1945-1990, 1990-2005 dhe pas 2005 periudha të cilat reflektojnë edhe ndryshimet më të mëdha të politikave të ndërtimit.*

Në Shqipëri, deri më tani mungon një studim nga pikëpamja e planifikimit hapësinor që përcakton shkallën e urbanizimit. Ashtu siç vihet re edhe gjatë përshkrimit mbi hartimin e PPK, botimi i vitit 2014 nga INSTAT me interpretimin e të dhënave statistikore nga Census 2011 ‘Një Klasifikim i ri Urban Rural’ (2014) është i vetmi botim serioz që bën një përpjekje për të klasifikuar territorin sipas kriterit të Urbanizimit. Megjithatë, ashtu siç kemi theksuar më lart dhe siç argumentohet edhe në PPK Shqipëria 2030, ky klasifikim nuk është i mjaftueshëm për hartimin e politikave të planifikimit: së pari, për ngurtësinë e tij të përcaktuar nga kufijtë administrativë, së dyti për nivelin e pasaktësisë apo të shkallës së lartë të përafrimit për shkak të tipologjisë së të dhënave që sigurohen nga Census 2011 të cilat përbëjnë të dhëna të një momenti unik në kohë dhe jo të konsoliduara, dhe së treti për shkak se anashkalohen në këtë përkufizim përfshirja e karakteristikave të rëndësishme që përbëjnë urbanizimin të tilla si: potenciali për zhvillim, infrastruktura e planifikuar, tradita, kultura dhe trashëgimia historike e zhvillimit të një territori dhe popullsisë së tij etj.

Edhe përpjekja e bërë nga institucione si AKPT përmes miratimit të vendimit të KKT Nr.5, datë 29.12.2014 (Vendimi Nr.5, Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit, 2014) në materialin e saj shpjegues sqaron se ‘evidentimi i zonave të urbanizuara është realizuar nëpërmjet qarkimit të sipërfaqeve të tokës, të cilat rezultojnë të ndërtuara, pasi tashmë e kanë humbur funksionet e tyre primare të prodhimit bujqësor apo të kategorive të ngjashme, për shkak të veprimtarisë ndërtimore që është ushtruar mbi to’ (AZHT, 2014). Brenda të ashtuquajturit "Kufi i Zonës së Urbanizuar" sipas vendimit të KKT të sipërpërmendur lejohen ndërhyrjet në funksion të zhvillimit urban. Ky kufi do të jetë një ‘fashë e ndërmjetme’ ku, në rast se parcela pronësie gjenden në këtë fashë, vendimmarrja për urbanizimin apo jo të tyre do të varet nëse, mbi 70% e pronës ndodhet brenda zonës së urbanizuar dhe fashës së ndërmjetme, prona konsiderohet brenda zonës së urbanizuar. Ky përkufizim, edhe pse

vlerësohet mjaft praktik dhe i lehtë për t'u aplikuar nuk mbart asnjë kriter teknik apo shkencor përcaktimin e tij. Përcaktimi i territorit urban i cili përcakton edhe vazhdimësinë e urbanizimit të mëtejshëm të tij lind nga pranimi i gjendjes ekzistuese pa e vlerësuar atë dhe nga heqja e kufijve sipas një konstatimi vizual, i cili mbart një shkallë të lartë gabimi dhe subjektiviteti.

Kjo është arsyeja se përse ky kërkim propozon ndërtimin e një profili urban përmes disa indikatorëve, sipas tabelës 10, të cilët japin një informacion gjithpërfshirës të zonës urbane, tentojnë të kapin dhe të masin karakterin individual të secilës dhe për pasojë bëhen të krahasueshme dhe të monitorueshme.

5.4 Profili metabolik dhe metodat për matjen e flukseve të burimeve

Në kapitullin 2.2 përshkruhen metodat bazë për matjen e flukseve dhe të proceseve metabolike në kontekstin teorik dhe praktik global. Të gjitha rastet nënvizojnë rëndësinë e të dhënave të sakta dhe të detajuara mbi popullsinë, burimet dhe konsumin e tyre. Metoda e përdorur nga PPV bazohet në metodën e Analizës së Flukseve të Materialeve (Material Floë Analysis, shkurt - MFA) të ndikuar nga 'Metabolism of Albania' dhe Plani i Përgjithshëm Kombëtar 'Shqipëria 2030'.

Aktualisht, Metabolizmi Urban (UM), siç na tregon literatura ndërkombëtare, aplikohet për të vlerësuar dhe përshkruar flukset urbane dhe ndikimet që lidhen me to, duke përdorur mjete të ndryshme si Analiza e Flukseve të Materialeve (MFA) (Ioppolo, G., Heijungs, R., Cucurachi, S., Salomone, R., & Kleijn, R., 2014). MFA, e hulumtuar nga Baccinni dhe Brunner në vitet 1990, "mat materialet që rrjedhin në një sistem, rezervat dhe flukset brenda tij, dhe rezultatet nga sistemi në sisteme të tjera në formën e ndotjes, mbeturinave ose eksporteve" (Pincetl, S., Bunjeb, P. Holmes, T., 2012, pp. 193-202). Ngjashëm me modelin e qytetit hipotetik amerikan të Ëolmans, kjo metodë bazohet në konceptin që masa e burimeve të përdorura do të jetë e barabartë me masën "plus" ndryshimet e stokut të masës në dalje (Po aty).

Teknika e MFA është shndërruar në shkollën kryesore e metabolizmit urban sepse përdor më shumë njësi praktike që publiku, punëtorët, zyrtarët qeveritarë dhe studiuesit është e nevojshme që t'i kuptojnë (Kennedy, C., Pincetl, S. & Bunje, P., 2010). Nocioni i Analizës së Flukseve të Materialeve merr në konsideratë arsyetimin e matricës input-output. Bazuar në parimin e ligjit të parë të termodinamikës për ruajtjen e materies i cili thotë: materia, masa ose energjia, nuk krijohet as shkatërrohet nga ndonjë proces i transformimit fizik (prodhim ose konsum). Ky parim mund të zbatohet si në aspektin e bilancit të stoqeve ose të bilancit të flukseve. Ideja kryesore është që ajo që hyn në sistem bëhet pjesë e sistemit (akumulohet brenda sistemit) ose dërgohet përsëri në mjedis si output (Pinho, P., Santos, S., Oliveira, V., Barbosa, M., Silva, M., 2010).

Vendet e OECD kanë zhvilluar një metodologji më të avancuar të llogarive kombëtare, duke parë kontributin e analizës së flukseve të materialeve në gjurmimin e zhvillimit drejt objektivave të qëndrueshëm. Dy janë dokumentet kryesore që mund të na orjetojnë në këtë drejtim: Guida metodologjike, Llogaritë e rrjedhës së materialit në ekonomi dhe treguesit e nxjerrë nga Komisioni Europian, (Schütz, H., Wuppertal Institute & Mr A. Steurer, A., Eurostat B1, 2001) dhe 'Matja e prurjeve të materialit dhe produktiviteti i burimeve' nga OECD (OECD, Measuring material flows and resource productivity, Volume 1, Guide, 2008).

Disa koncepte bazë janë të domosdoshme për tu shpjeguar me qëllim kuptimin dhe përdorimin e metodës së matjes së flukseve sipas OECD, që janë:

Diferenca në matje dhe vlerësim midis Materialeve dhe Aktiviteteve.

Termi "materiale" përdoret për të përcaktuar të gjitha sendet, në çfarëdo niveli specifik apo grumbullimi që ato mund të konsiderohen dhe trajtohen në një skemë fizike të kontabilitetit, d.m.th. nga elementet kimikë individualë deri tek out-putet e përgjithshme të materialeve të sistemit në fokus. Në varësi të analizës dhe qëllimit të saj mund të përzgjidhen Materiale të ndryshme pasi klasifikime të ndryshme të materialeve mund të jenë të rëndësishme në kontekste të ndryshme.

Termi "aktivitet" përdoret për të përcaktuar çdo proces natyral ose veprim njerëzor që nënkupton menjëherë një ndryshim në statusin fizik (vendndodhjen ose përbërjen) e disa lëndëve. Lloje të ndryshme të aktiviteteve mund të identifikohen si të rëndësishme në funksion të qëllimeve të analizës (p.sh. aktiviteteve njerëzore kundrejt proceseve natyrore, aktiviteteve ekonomike vs jo-ekonomike midis atyre të mëparshme, dhe aktiviteteve industriale vs jo-industriale midis atyre ekonomike) dhe mund të trajtohen individualisht ose kolektivisht. Mbulimi i aktiviteteve në një MFA mund të jetë shterues ose vetëm për aktivitete specifike ose grupe veprimtarish.

Në vendin tonë, INSTAT ka miratuar Nomenklaturat e veprimtarive ekonomike (NVE Rev2) (VKM. 320, Për miratimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të Revizionuara (Rev.2), 2014) me gjithsej 99 ndarje, si edhe Nomenklaturën e Produkteve (NP 2008) (VKM. 433, Për miratimin e zbatimit të nomenklaturës së produkteve, 1996) të cilat janë klasifikimet që përdoren edhe në Llogaritë Kombëtare.

Sistemet dhe nënsistemet

Edhe pse bota materiale mund të konsiderohet si një entitet unitar, me qëllim studimin dhe të kuptuarit se si funksionon ajo, shpesh ndahet në pjesë të njohur si Sisteme. Gjithashtu për lehtësi studimi, sidomos në analizat e flukseve të materialeve për sektorë të veçantë, këto sisteme i konsiderojmë të pambivendosur me njëri tjetrin. MFA zakonisht përqendrohet në funksionimin fizik të një sistemi. Sistemi në fokus duhet të përcaktohet dhe identifikohet me kujdes nga pjesa tjetër e botës fizike. Identifikimi dhe caktimi i kufijve të Sistemit, varet nga çështjet që do të adresohen dhe nga njohuritë dhe instrumentet e politikës në dispozicion.

Nëse qëllimi i një MFA është të përshkruajë qarkullimin e materialeve brenda sistemit në fokus, është e nevojshme të diferencohen aktiviteteve të tij, në mënyrë që të jetë në gjendje të "kapë" materialet ndërsa kalojnë nga një aktivitet te tjetri; mund të jetë gjithashtu e dobishme të përcaktohen nënsistemet përkatëse, d.m.th. nëngrupet e tij aktiviteteve dhe rezervat që janë me interes të veçantë për analizën. Nënsistemet do të përcaktohen këtu si pjesë të dallueshme, jo të mbivendosura dhe bashkërisht shteruese të sistemit ku ata i përkasin.

Një sistem material mund të mendohet si një akumulim i stoqeve dhe aktiviteteve të cilat i përkasin dhe kryhen në të. Kur identifikohet një sistem, përcaktohet një kufi midis tij dhe botës së jashtme. Duke pasur parasysh një kufi të përcaktuar mirë midis dy sistemeve dallohen rezervat materiale që i përkasin secilit prej tyre dhe identifikohen rrjedhat e materialit midis sistemeve. Një karakterizim kolektiv i flukseve ndërkufitare që lejon identifikimin e materialeve që hyjnë ose dalin nga sistemi është ekuivalent me përkufizimin e kufirit vetvetiu, siç është edhe numërimi i plotë i flukseve ndërkufitare. Me fjalë të tjera, flukset e identifikuar si flukse ndërkufitare në mënyrë implicite përcaktojnë kufirin e sistemit dhe anasjelltas. Përmes flukseve ndërkufitare mund të përkufizojmë një sistem nëse është i mbyllur apo i hapur. Flukset materiale që kalojnë kufijtë e sistemit krijojnë lidhje midis sistemeve. Një sistem material i hapur shkëmben

materiale me botën e tij të jashtme. Një sistem i mbyllur material, përkundrazi, është një sistem që nuk ka flukse ndërkufitare.

Flukset dhe rezervat

Termi Fluks përdoret për të identifikuar dhe përshkruar shkëmbimet e materialeve midis dhe brenda aktiviteteve, sistemeve ose nënsistemeve. Flukset maten duke iu referuar periudhës së matjes. Tërësia e flukseve të një sistemi quhet ndryshe edhe metabolizmi i tij material. Duke pasur parasysh një periudhë të përcaktuar mirë (zakonisht një vit kalendarik) rezervat e një sistemi mund të përcaktohen si materiale që nuk largohen nga sistemi brenda së njëjtës periudhë që bëhen matjet. Stoqet maten duke iu referuar një pike kohe, p.sh. fillimi ose mbarimi i periudhës kontabël.

Stoqet rezultojnë nga akumulimi neto i flukseve paraprake dhe ato mund të ndryshojnë nga flukset e periudhës aktuale të matjes. Materialet grumbullohen përmes aktiviteteve në sisteme dhe nënsisteme dhe jo në vetë aktivitete. Si pasojë, aktivitetet nuk kanë stoqe dhe karakterizohen vetëm nga fluksi i tyre.

Ligji i ruajtjes së materies dhe parimi i balancës së masës.

Një tipar themelor i llogaritjes së flukseve të materialeve, është përpjekja për të arritur ekuilibrin duke integruar anën e inputit me anën e outputit dhe të shtesave neto të stoqeve për të përshkruar metabolizmin material të sistemeve njerëzore dhe natyrore. Kjo bëhet duke shfrytëzuar zbatimin e ligjit të ruajtjes së materies në aktivitete, sisteme dhe nënsisteme. Sipas këtij ligji - siç është formuluar nga Lomonosov dhe Lavoisier në shekullin XVIII materia nuk krijohet as shkatërrohet në ndonjë proces natyror ose veprim njerëzor. MFA bazohet në zbatimin e parimit të bilancit të masës ose materialit. Megjithëse e dimë (nga teoria e relativiteti të Ajnshtajnit) që një pjesë e vogël e materies shndërrohet në energji për disa aktivitete, sasia e saj është aq e vogël sa për qëllime llogaritjeje merret në konsideratë vetëm materia dhe gjithçka të matet me njësitë e masës.

5.4.1 Treguesit për ndërtimin e Profilit Metabolik

Vlerësimi i rrjedhave mjedisore që hyjnë dhe dalin nga sistemet erritoriale përmes sistemeve urbane përcaktojnë kornizën e një profili metabolik. Ndërkohë që ekzistojnë disa metoda që përlllogarisin dhe vlerësojnë anën mjedisore të një sistemi urban dhe të paraqitura në kapitullin e mëlart 2.2, metabolizmi urban (MU) u identifikua si më i rëndësishmi për të ndërtuar këtë kornizë gjithëpërfshirëse. Karakteri i lirë i kësaj qasje lejon që korniza e zhvilluar të përshtatet në shkallë të ndryshme hapësinore dhe intervale kohore.

Tabela 14 do të prezantojë shkurtimisht disa flukse të zgjedhura direkte dhe indirekte mjedisore që përdoren shpesh për studime të vlerësimit të mjedisit urban së bashku me disa informacione në lidhje me metrikat përkatëse që mund të përdoren dhe disponueshmërinë e të dhënave. Për të arritur një profil metabolik më të plotë, realist dhe me shumështresor, është e nevojshme të plotësohet qasja MU me vlerësimin e flukseve indirekte të burimeve dhe të ndotjes. Matja e flukseve indirekte është e mundur ose përmes kryerjes së një LCA për të gjitha produktet dhe shërbimet e gjetura brenda një qyteti ose përmes kryerjes së një Input Output Analize për një ekonomi të tërë. Në praktikë, për shkak të një sasive pothuajse të pafund të mallrave dhe shërbimeve, përdorimi i LCA për të vlerësuar flukset indirekte është mjaft e vështirë, prandaj, preferohet përdorimi i IOA për të matur flukset indirekte metabolike për zonat urbane

Flukset	Metrika	Përshkrimi
---------	---------	------------

Hyrëse	Energjia	Sipas Sektorit (privat/publik) Sipas Burimit (ere/diell/ujë/tjeter) Lokalisht e prodhuar / Importuar	Energjia nga burimet fosile: naftë, gaz natyror, qymyr. Energjia nga burimet e rinovueshme: Parqet eolike, fotovoltaike, hidrocentralet.
	Uji	Sipas Sektorit (privat/publik) Sipas Burimit (rezervuar/burim/lum/etj) Lokalisht i prodhuar / Importuar	Uji që hyn në kufi të sistemit, Volumi i Reshjeve
	Ushqimi	Sipas Sektorit (privat/publik) Sipas Llojit (grupimet kryesore) Lokalisht i prodhuar / Importuar	Produktet ushqimore të prodhuara në vend dhe të importuara sipas grupimeve kryesore.
	Mbetjet	Mbetjet e gjeneruara sipas llojit dhe sipas sektorit. Mbetjet e importuara.	
	Materialet	Përdorimi i materialeve pasqyron, disponueshmërinë e burimeve lokale, por edhe aktivitetet ekonomike prodhuese të një zone urbane. Nëse një sistem urban po përdor një sasi në rritje të materialeve të ndërtimit, kjo mund të zbulojë një zgjerim urban. Në rastin e importeve të materialeve të papërpunuara, është gjithashtu e mundur të zbulohen më mirë nevojat materiale të sektorit të prodhimit.	Të dhënat materiale janë më të vështira për t'u marrë pasi rrallë ekziston një ofrues unik që mundëson informacionin e nevojshëm. Të dhënat mbledhen ose nga shuma e inputeve të aktiviteteve të ndryshme ekonomike ose në një shkallë kombëtare nga Anketa e Buxhetit të Familjeve etj.
Rezervat	Energjia	Sipas Sektorit (privat/publik) Sipas Burimit (ere/diell/ujë/tjeter) Lokale / Importuar	Rezervat natyrore të burimeve energjitike në vlerësime të përafërta, si psh. kapaciteti naftëmbajtës, rezervate e gazit natyror..etj
	Uji	Uji sipërfaqësor (volumi i rezervuareve, liqeneve, depove etj) Uji nëntokësor	Kalkulime të përafërta të vëllimeve ujore që janë pjesë e sistemit por nuk përdoren,
	Ushqimi	Nëse ka rezera ushqimore sipas llojit.	Rrallë e aplikueshme
	Mbetjet	Stoku nga depozitimet e mëparshme, psh. Landfille të mbyllura, apo mbetje të magazinuara apo të patrajuara.	Kryesisht përdoret për të treguar kapacitetin mbajtës të sistemit në studim, rezultatet e të cilës mund të cojnë ndryshim të tipologjisë së asgjësimit të mbetjeve.
	Materialet	Stoku i materialeve informon përbërjen materiale të mjedisit të ndërtuar. Ky informacion mund të jetë i dobishëm për të hetuar marrëdhëniet midis organizimit territorial dhe materialeve në mjedisin e ndërtuar. Stoku i materialit është gjithashtu i dobishëm për të hulumtuar se si përbërja materiale e stokut të ndërtesës ndikon në përdorimin e energjisë dhe ujit. Nga ana tjetër, stoku i materialit është një sasi që mund të bëhen mbetje të ardhshme ose burime materiale	Është mjaft e vështirë për të matur stokun e materialeve, dhe në cdo rast vlera e tij do të jetë e përafërt. Për këtë do të duhej informacion mbi përbërjen në nivel komponenti të cdo objekti dhe pozicioni i tij në territor.

		dytësore, ky tregues është jashtëzakonisht i rëndësishëm në kontekstin aktual të ekonomisë cirkulare.	
Përpunimi	Kryesisht Shndërrimet e Burimeve primare nga përpunimi i tyre. Sa më e zhvilluar të jetë industria ushqimore aq më të shumta janë të dhënat në këtë pjesë të grafikut.		
Dalëse	Energjia	Energjia e përdorur Sipas Sektorit (privat/publik) Sipas Burimit (ere/diell/ujë/tjeter) E eksportuar dhe e humbur.	Dalja e energjisë informon për disponueshmërinë e energjisë dhe varësinë ndaj saj të një zone urbane. Mund të jetë gjithashtu një shenjë e industrive të përpunimit dhe e një qendre logjistike.
	Uji	Uji i përdorur sipas sipas sektorit ekonomik, uji i trajtuar, uji i ndotur në sistem apo mjedis, humbjet, avullimi etj.	Rrjedhat e daljes të ujit sigurojnë informacione të përshtatshme, ndër të tjera, në lidhje me hyrjet e ndryshme të ujit (të pijshëm, reshjet, etj.), në lidhje me sistemin e ujërave të zeza dhe efikasitetin e tij, dhe në lidhje me pajisjet e trajtimit të ujërave të ndotura në zonën urbane. Impiantet e ujërave të ndotura gjithashtu mund të japin njohuri për sasinë që mund të ripërdoret në sistemin urban.
	Ushqimi	Ushqimi i përdorur Sipas Sektorit (familjar/industri shërbimi/tregti..etj) Sipas Llojit (grupimet kryesore) Mbetje/ Eksportuar	Kryesisht i rëndësishëm për të parë kontributin e sektorit në sistemin në fokus, efikasitetin e tij por edhe mbetjet që gjenrohen nga ky fluks.
	Mbetjet	Mbetjet e trajtuara sipas metodës landfill, riciklim, ripërdorim, incenerim etj. Mbetjet e eksportuara.	Këto të dhëna gjithashtu informojnë për praninë e impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve në territorin lokal.
	Materialet	Materialet që rrjedhin jashtë një sistemi urban mund të jenë mbetje (që vijnë nga konsumi lokal ose aktivitetet industriale), mallra që janë prodhuar në vend, ose mallra që janë në tranzicion përmes zonës urbane.	Këto lloje të informacionit mund të jenë të dobishëm për të shprehur qarkullimin e rrjedhave materiale brenda sistemeve urbane, dhe varësinë e burimeve primare dhe sekondare të materialeve.

Tabela 5.4-1 Të dhënat kornizë për flukset e profilit metabolik




Figura 5-1 Skema e Profilit metabolik e paraqitur për fluksin e Ujit sipas klasifikimeve të tabelës 13. Përshtatur nga: Water Research (Farooqui, T.A., Renouf, M.A., Kenway, S.J. , 2016)

5.4.2 Flukset Metabolike dhe metodat e vizualizimit

Komunikimi i të dhënave është një hap tjetër i rëndësishëm që ndihmon transmetimin e gjetjeve dhe formulimin e propozimeve. Vizualizimi i tyre lidhet ngushtë me metodën e përzgjedhur për studimin e metabolizmit urban dhe mund të ndryshojë edhe sipas shkallës territoriale dhe sistemit në studim. Më poshtë po paraqesim dy metodat kryesore të përdorura në këtë drejtim, e para Digrama Sankey e përdorur edhe në rastin e Shqipërisë në nivel kombëtar dhe me disa përpjekje për nivelin vendor, si edhe diagramat Chord kryesisht për analizat e flukseve mjedisore.

Mënyra më e përhapur në paraqitjen e fluksit të materialeve janë diagramat *Sankey* të përdorur edhe në ‘Metabolism of Albania’. Diagramet *Sankey* marrin emrin bazuar në punën e Kapitenit Irlandez Mattheë Henry Phineas Riall Sankey, i cili përdori këtë lloj diagrami në 1898 në një figurë klasike që tregon efikasitetin e energjisë së një makine me avull (Kennedy, Alex B. W.; Sankey, H. Riall , 1898). Diagramet e tij fituan popullaritet të madh, sidomos në Gjermani, ku ekonomia u përqendrua në efikasitetin e materialeve dhe energjisë për shkak të pagesave të dëmshpërblimit pas Luftës së Parë Botërore. Sot ky lloj grafiku përdoret në të gjithë botën për vizualizimin e të dhënave, p.sh. në analizat e rrjedhës së materialit dhe sistemet e menaxhimit të energjisë.

Flukset e përdorura në këtë analizë janë Uji, Energjia dhe Ushqimi ku do të paraqiten edhe tabelat e informacioni për ndërtimin e tyre, të përdorura për rastin e metabolizmit të Shqipërisë.

Uji

Në përgjithësi, klasifikimi i materialeve në analizat MFA bëhet sipas tre makrogrupeve: Uji, Ajri dhe pjesa tjetër e materialeve që nuk janë Ajër apo Ujë. Uji përfaqëson përbërësin më të madh të metabolizmit urban për sa i përket masës së pastër. Sasia e ujërave të ndotura përfaqëson afërsisht midis 75% dhe 100% të prurjeve në ujë (Kennedy, C., Cuddihy, J., & Engel-Yan, J., 2007, pp. 43-59).

Studimi i një modeli hidrologjik konsideron kryesisht në dy hyrje në sistem: hyrjet për konsum të ujit dhe ujin nga atmosfera. Sistemi i ujit më pas ndahet në katër përbërës -

toka, antroposfera, ujërat nëntokësore dhe ujërat sipërfaqësore - që analizohen përmes ndërlidhjeve, me qëllim vlerësimin e rezultateve.

Megjithatë është e rëndësishme të evidentohen tipet e inputeve për fluksin e ujit në varësi të kufirit të sistemit që po studiojmë. Kështu psh. figura e mëposhtme paraqet një skemë të përgjithshme që vizualizon flukset që duhet të konsiderojmë kur kërkojmë të masim metabolizmin e një sistemi në lidhje me burimin e ujit. Ndërsa tabela 7 liston të dhënat që janë matur për fluksin e ujit në “*Metabolism of Albania*”




Figura 5-2 Flukset mesatare në Hollandë në milion/m³ në vit . Burimi:pbl.nl(2014)

Flukse hyrëse	Vlerat	Përshkrime dhe Burime
Fluksi i ujit në kufi, për lumë	14.8 km ³ / vit	Sasia mesatare afatgjatë e ujit që hyn çdo vit në vend përmes rrjedhës ndërkufitare (lumenj, kanale, tubacione) Vëllimi i përgjithshëm i ujit arrin çdo vit 42.25 km ³ , (burimi 2004, A.Cullaj, A.Hasko, A.Miho, F.Schanz, H.Brandl, R.Bachofen, Cilësia e ujërave natyrore shqiptare dhe ndikimi njerëzor.)
Reshjet	426.9 km ³ / vit	Për reshjet totale shumëzo sipërfaqen totale territoriale dhe shndërroni në km ³ /vit (28748km ² -sipërfaqe totale, 1485 mm reshje vjetore mesatare) Mesatarja vjetore 1485 mm
Flukse dalëse		
Shkarkimi i ujit në det, për lumë	41 km ³	Uji total i shkarkuar nga të gjithë lumenjtë në det: në mënyrë të barabartë me 1300 m ³ / s të njëjtë me lumin Po në Itali (burimi Agim Selenica, Burimet Ujore të Shqipërisë)

Avullimi total	x	Nëse nuk është i disponueshëm, ky numër përafërsisht mund të llogaritet duke përdorur Avullim = Dalje-Hyrje + Reshje.
Stok:		
Ujë sipërfaqësor (vëllimi i menjëhershëm i liqeneve, rezervuarëve dhe lumenjve)	93km ³	Liqenet mbulojnë 4% të territorit, duke përfshirë tre liqene të mëdhenj dhe 247 liqene të vegjël (burimi: A.Mukaj Menaxhimi i burimeve të ujit) (burimi: llogaritja vetanake nga të dhënat në kolonën e fundit) 625 rezervuarë të vegjël me 562 milion m ³ rezervuari i Fierzës 2700 milion m ³ rezervuari i Ulezës 240milionm ³ Liqeni i Shkodrës, vëllimi total 193 km ³ , 1/3 brenda territorit shqiptar: 63.7km ³ Ohri vëllimi total i ujit 55.5 km ³ , brenda territorit shqiptar 44% e sipërfaqes: 24.4km ³ Prespa liqeni brenda territorit Alabanian 0,556km ³
Ujërat nëntokësore	12.7km ³	Vëllimi i përgjithshëm i ujit në vit arrin 42.25 * 10 * 9 m ³ ose 42.25km ³ , nga të cilat 30% i përket ujërave nëntokësore (burimi 2004, A.Cullaj, A.Hasko, A.Miho, F.Schanz, H.Brandl, R. Bachofen, Cilësia e ujërave natyrore shqiptare dhe ndikimi i njeriut.)
Flukset thelbësore ndërmjet anës së majtë dhe të djathtë të Sankey		
Sasia e përdorur nga hidrocentralet	14 km ³	"Aktualisht, përdoruesi më i madh i burimeve ujore është sektori i energjisë. (rreth 90% e totalit vjetor të energjisë elektrike të prodhuar në vend prodhohet nga hidrocentrale) (burimi: A.Mukaj Menaxhimi i burimeve të ujit) "
Sasia e përdorur për ujitje (bujqësi)	1.01km ³	"Ujitja është konsumatori më i madh i burimeve ujore sipërfaqësore. Nga uji i përgjithshëm sipërfaqësor, vetëm 2.5% ose 1.0 miliard m ³ e disponueshme për ujitje (558 milion m ³ ujë mund të depozitohet në 626 rezervuarë ujitje dhe 450 milion m ³ të devijuar nga lumenjtë dhe liqenet) (burimi: A.Mukaj Menaxhimi i burimeve të ujit) "
Sasia e përdorur për industri	0.22km ³	0.22 billion m ³ or 0.22 km ³ A.Mukaj Menaxhimi i burimeve të ujit)
Sasia e përdorur për përdorim shtëpiak	1.31km ³	Gjithsej: 1.31 km kub / vit (Burimi: CIA Factbook) ose për frymë: 413.6 cu m / vit (2006)

Tabela 5.4-2 Të dhënat për ndërtimin e diagramës Sankey të Ujit, tregon bilancin ujqor të Shqipërisë. Përpunoi Autori, si pjesë e grupit të punës për hartimin e studimit "Metabolism of Albania" (IABR, FABRIC, JCFO,TNO, 2014).

Energjia

Studimet më gjithëpërfshirëse të ndërmarra për energjinë kanë konsideruar ndarjen midis burimeve natyrore dhe antropogjene (Kennedy, C., Cuddihy, J., & Engel-Yan, J., 2007, pp. 43-59). Sidoqoftë, shumica e rasteve janë përqendruar në burimet antropogjene. Energjia duhet të ndahet midis konsumit primar të energjisë dhe energjisë direkte të konsumuar, duke marrë parasysh në këtë mënyrë humbjet në prodhimin e energjisë. Analiza e energjisë përfshin përdorime nga sektorët ekonomikë dhe transporti. Figura e mëposhtme paraqet balancën energjetike për Shqipërinë.




Figura 5-3 Diagrama Sankey per fluksin e Energjisë në (PJ), burimi Metabolism of Albania, IABR, AKPT et.al, 2014

	Flukset	Vlerat në PJ (or TJ)	Përshkrime dhe Burime
INPUT	Import		
	Produkte naftes	37710 TJ	Strategjia Kombëtare e Energjisë. 2001-2003
	Qymyr		
	Elektriciteti	8 362.8 TJ	Te dhenat nga IEA per 2012 jane 9138 TJ, ERE (2013) Raporti Vjetor
	Prodhimi		
	Nafta	50 241.6 TJ	Në fushat ekzistuese të naftës, rezervat totale janë rreth 450 Mtoe nga të cilat 340 Mtoe nga depozitat e gurit ranor dhe rreth 110 Mtoe nga depozitat e gurit gëlqeror (2005). Pjesa më e madhe e rezervave ndodhet në Driza, depozita vlerësohet në një vlerë prej 200 Mtoe dhe në Kuçovë me një vlerë prej 68 Mtoe. Të dy përfaqësojnë 60% të rezervave totale të naftës gjeologjike. Strategjia Kombëtare e Energjisë (2003).pg 71)
	Qymyri		
Elektriciteti		Te dhenat nga IEA per 2012 jane 17013 TJ Broshura_Hidroenergjetika.pdf (2014) f.5, akbn.gov.al kesh.al (akses 07.04.2015) nuk perfshin prodhimin nga Hec-et e vegjel , ERE,Raporti_Vjetor_2013_perfundimtar	

OUTPUT	Konsumi sipas Sektorit	KOnsumi total I energjisë 77096 TJ	Konsumi i energjisë elektrike Strategjia kombetare e Energjise(2003)
	Industria	17%	Bilanci Kombëtar i Energjisë, 2012, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
	<i>Hekur dhe Celik</i>		
	<i>Chemical and petrochemical</i>		
	<i>Minerale jo-metalike</i>		
	Transporti	44%	Strategjia kombetare e Energjise(2003) Bilanci Kombëtar i Energjisë, 2012, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
	<i>Rrugor</i>		
	<i>Hekurudhor</i>		
	<i>Tjeter</i>	6%	Bilanci Kombëtar i Energjisë, 2012, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
	<i>Rezidenciale</i>	27%	Bilanci Kombëtar i Energjisë, 2012, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
<i>Tregeti dhe Sherbime Publike</i>	23%	Sipas IEA the residential sector is the main consumer of electricity. When it comes to total primary energy, the transport sector is bigger Bilanci Kombëtar i Energjisë, 2012, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	
<i>Bujqesi/pyje</i>	1%	Bilanci Kombëtar i Energjisë, 2012, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	
Eksport			
Naftë	42 864 TJ	Eksporti i Naftes sipas IEA ishte 30691 TJ ne 2012. DP Dogana (2012) Eksporti-dhe-importi-i-naftes-ne-vend-2005-2013	
Shndërrime/perpunime			
Rafineri	nuk ka te dhena		
Tec	nuk ka te dhena		

Tabela 5.4-3 Të dhënat bruto për ndërtimin e diagramës Sankey të Energjisë.

Përpunoi Autori, si pjesë e grupit të punës për hartimin e studimit “Metabolism of Albania” (MZHU, AKPT 2015). Shënim : Për shkak të mospërpunimit dhe mungesave të vlerave të ndryshme për flukset e energjisë, nga institucionet shqipëtare, diagrama sankey u ndërtua me të dhënat nga IEA. Megjithatë tabela e mësipërme na tregon strukturimin e informacionit për sektorin e energjisë dhe burime të mundshme për plotësimin e saj.

Ushqimi

Në PPK ‘Shqipëria 2030’ theksohet roli i rëndësishëm të sektorit bujqësor në vendin tonë për sa i përket zhvillimit ekonomik por edhe social. ‘Ndonëse zhvillimet teknologjike do të zëvendësojnë rolin e njeriut në shumë procese bujqësore, ky sektor mbetet akoma burimi parësor i të ardhurave ekonomike dhe i mundësive për punësim

	Flukset	Vlerat në kton
INPUT	Import	
	Fruta Perime	115
	Drithëra	405
	Mish dhe Bagëti	57
	Ushqim për kafshë	117
	Patate	10
	Të procesuara	222
	Prodhimi	
	Fruta Perime	1376
	Drithëra	701
	Mish dhe Bagëti	
	Ushqim për kafshë	-
	Patate	230
	Të korrat e sheqerit	10
Vajore	20	
OUTPUT	Konsumi	
	Fruta Perime	3398
	Drithëra	
	Mish dhe Bagëti	
	Ushqim për kafshë	
	Patate	
	Të procesuara	
	Te tjera	
	Eksporti	
	Fruta Perime	45
Humbje/Mbetje	246	
Shndërrime/perpunime		
Nenprodukte mishi		
Ushqim per kafshe		

në vendbanimet rurale’ (MZHU&AKPT, 2016).

Për këtë qëllim, fluksi i ushqimit është studiuar edhe në *Metabolism of Albania*, ku me të dhënat nga FAO është ndërtuar diagrama Sankey për balancën ushqimore në vend, fig.54. ajo që bie në sy është niveli i ulët i përpunimit të flukseve bazë të prodhimeve ushqimore reflektuar në dendësinë e pjesës qendrore të diagramit. Gjithashtu, nivelet e eksportit në raport me prodhimin e brendshëm në vend mbetet i ulët. Në këtë drejtim, diagrama Sankey e bazuar tek MFA, na tregojnë një informacion të drejtpërdrejtë në lidhje me shkallën e shvillimit të sektorit dhe të qëndrueshmërisë së zhvillimit të tij.

Në nivel kombëtar, digarmat *Chord*, mund të jenë më të përshtatshme për lidhjen midis Flukseve të materialeve dhe produkteve sipas llogarive kombëtare. *Këtu po paraqesim se si mund të ilustron metabolizmi urban i një vendi, përmes diagramave chord dhe kombinimit të të dhënave të burim-përdorime dhe flukseve mjedisore.* Në kapitullin 2.2 përshkruam disa metoda për matjen e flukseve metabolike ku sic u dëshmuar, metoda më e përhapur është ajo e Llogaritjeve të flukseve materiale MFA.




Figura 5-4 Diagrama Sankey e Fluksit Ushqimit(kton). Burimi: Metabolism of Albania, IABR, AKPT et.al, 2014

Analiza e flukseve të materialeve (MFA) ka një rëndësi të vecantë pasi jep një informacion të strukturuar sipas parimit të ruajtjes së masës. Indikatorët e flukseve të materialeve që rrjedhin nga kjo analizë përcjellin mesazhe të rëndësishme për politikatat tek një audiencë jo-eksperte (publiku i gjerë, vendimmarrësit e niveleve të larta, analistët e politikave, etj.) në lidhje me rëndësinë e flukseve materiale me çështjet ekonomike dhe mjedisore që shqetësojnë. MFA jo vetëm tregon burimet natyrore që futen në ekonomi, por gjithashtu zbulon se çfarë ndodh me materialet kur ato lëvizin brenda dhe jashtë ekonomisë, dhe se si kjo lidhet me rreziqet mjedisore, ndikimet dhe me produktivitetin e burimeve. Siguron një pamje të integruar të flukseve të burimeve përmes ekonomisë; identifikojë flukset që nuk hyjnë në ekonomi si transaksione, por që janë të rëndësishme nga pikëpamja mjedisore dhe zbulon se si zhvendosen flukset e materialeve brenda vendeve dhe midis vendeve dhe rajoneve dhe si kjo ndikon në ekonominë dhe mjedisin brenda dhe përtej kufijve kombëtarë. Më poshtë po paraqesim një mënyrë të përdorimit të saj si edhe metodat e vizualizimit.

Tabela 5.4-4 Struktura e të dhënave për ndërtimin e diagramës Sankey të Ushqimit . Përpunoi Autori, si pjesë e grupit të punës për hartimin e studimit “Metabolism of Albania” (MZHU, AKPT 2015).




Figura 5-5 Metabolizmi Urban Seoul, viti 2000.

Burimi: (ADB, 2014, p. 47)




Figura 5-6 Metabolizmi Urban Shangai, viti 2000. Burimi: (ADB, 2014, p. 53)

Metoda e përdorur në Raportin e Bankës së Zhvillimit për Azinë, kombinon të dhënat nga Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore : Biomassë (B), Minerale Metalike (MM), Minerale jo Metalike (NM), Kimikate dhe Fertilizues (FF), Materialet fosile të energjisë (FF) dhe të tjera (O) me të dhënat e Përdorimeve sipas Aktiviteteve.

Vizualizimi nëpërmjet diagramave chord na tregon se për Shangain, fig. 61, mineralet jometalike përdoren kryesisht për Formimin e Kapitalit Fiks (GFCF), dhe përbëjnë gati 90% të materialeve të përdorura për këtë qëllim. Ndërsa Biomasa (71%) dhe lëndët

djegëse fosile (16%) janë llojet kryesore të materialeve që përdoren për konsumin përfundimtar të familjeve dhe qeverisë përkatësisht në vlerat 70% dhe 10%. Përdorimi i biomasës është përhapur në të gjithë ekonominë, me 38% për konsumin përfundimtar të familjeve dhe qeverisë, 22% për prodhimin e produkteve të biomasës dhe 17% për shërbimet.

Ndryshe tregon profili metabolik i Seulit, fig.60. ku mineralet jometalike janë lloji kryesor i materialit të përdorur për ndërtim (97%), GFCF (92%), dhe makineritë dhe pajisjet (79%). Llojet kryesore të materialeve të eksportuara janë lëndët djegëse fosile dhe mineraleve metalikë (përkatësisht 605 dhe 20%). Në sektorin e shërbimeve, mineralet jometalike zënë 48% të materialeve të përdorura në këtë sektor, ndërsa lëndët djegëse fosile përbëjnë 36%. Përdorimi i karburanteve fosile është përhapur relativisht në mënyrë të barabartë në të gjithë ekonominë, në raporte gati të njëjta midis për konsumit përfundimtar të familjeve dhe qeverisë, për eksport dhe për shërbime. Raporti ADB(2014) jep një panoramë të profilit metabolik urban për 6 qytete kryesore aziatike, përfshirë këtu Bnkokun, Manilën, zonën metropolitane të Bangalore dh të Ho Chi Min. Këtu raportohen të dhënat mbi indikatorët e metodës se MFA të shpjeguar në kapitullin 2.2, si edhe raporti i tyre me vlerat kombëtare.

Në rastin e vendit tonë Instat publikon në mënyrë periodike, të dhënat për Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore por vetëm në nivel kombëtar. Tabela e mëposhtme paraqet vlerat për Burimet e brendshme natyrore nga viti 2015-2019

Pershkrimi	2015	2016	2017	2018	2019
Biomasa	7,970.0	8,066.5	8,164.1	7,970.6	7,747.5
Mineralet dhe koncentratet metalike	1,528.7	1,180.0	1,356.8	1,766.0	2,150.7
Mineralet jo metalike	15,380.5	18,062.5	10,593.3	11,074.6	10,742.5
Materialet fosile të energjisë	1,546.5	1,161.2	1,304.9	1,582.6	1,291.2
Total	26,425.7	28,470.1	21,419.1	22,393.8	21,931.9

Tabela 5.4-5 Burimet e brendshme natyrore . Burimi: INSTAT, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore




Figura 5-7 Struktura e përdorimit të brendshëm të materialeve mjedisore Shqipëri, për vitet 2015 dhe 2019. Burimi INSTAT, përpunoi autori




Figura 5-8 Përdorimet sipas aktiviteteve, viti 2017, përpunoi Autori





Figura 5-9 Kontributi i Burimeve dhe importi i tyre sipas sipas aktiviteteve, viti 2017, përpunoi Autori

Figurat 63, 64 dhe 65 janë paraqitje diagramatike e llogaritjeve kombëtare ekonomike për Shqipërinë sipas Burimeve dhe aktiviteteve në vendin tonë. Si vihet re nga grafiku, vlerën më të madhe në formimin e kapitalit e zënë produktet e sektorit të ndërtimit rreth 70% dhe pjesa tjetër Produkte elektronike dhe optike, pajisje elektrike dhe makineri dhe pajisje të paklasifikuara/mjete transporti. Konsumi final mbizotërohet nga produktet bujqësore dhe ushqimore.



Për tabelën e të dhënave dhe kodet e përdorimeve dhe burimeve, shih Aneksin 2

Legjenda e thjeshtuar:

- P3 – Konsumi Final*
- P51 – Formimi i bruto i kapitalit fiks*
- P6 – Eksportet*
- A01-03 - Produkte bujqësore, pyjore dhe të peshkimit*
- B - Produkte të industrisë nxjerrëse*
- C10-C12 - Produkte ushqimore, pije dhe produkte duhani*
- F - Shërbime të ndërtimit dhe punëve në ndërtim*

Figura 5-10 Përdorimet sipas aktiviteteve, viti 2015, përpunoi Autori

Në mënyrë që analizat tona të ishin të krahasueshme me shembullin e sipërpërmendur do të duhej që strukturën e burimeve të përdorura ta kishim të strukturuar sipas materialeve mjedisore dhe të krahasonim përdorimin e këtyre të fundit sipas aktiviteteve. Gjithashtu me interes do të ishte edhe sigurimi i këtyre të dhënave sipas niveleve të rajoneve të zhvillimit për të ndërtuar një profil metabolik më të plotë të territorit, dhe krahasimi i konsumit të burimeve mjedisore me zonat e urbanizuara. Megjithatë, ilustrimet e mësipërme janë me vlerë për të na ilustruar metodat e ndryshme të vizualizimit të flukseve të materialeve dhe lidhjen dhe interpretimin e tyre me aktivitetet e zonave të urbanizuara. Plotësimi i të dhënave për ndërtimin e këtyre profileve metabolike për Shqipërinë do të na ndihmonte të hartonim plane të informuara dhe që reflektojnë të dhëna që ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm.

Në varësi të disponimit të të dhënave kjo analizë mund të hartohet për nivele të ndryshme planifikimi të detajuar sipas tabelës së mëposhtme duke ju përgjigjur pyetjeve që ndihmojnë në plotësimin me informacion mbi flukset e materialeve mjedisore.

Niveli	Pyetjet kryesore	Plani Hapwsin or
--------	------------------	------------------

<p style="text-align: center;">Makro</p>	<p>Është veçanërisht e dobishme për të mbështetur vendimet në fusha të tilla si integrimi i politikave ekonomike, tregtare dhe mjedisore, strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe planet e veprimit dhe politikat kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe ruajtjes së burimeve. Mjetet kryesore të matjes mbështeten në llogaritë kombëtare në të gjithë ekonominë, të cilat në formën e tyre më të thjeshtë, e konsiderojnë vetë sistemin ekonomik si një kuti të zezë. Theksi vihet në shkëmbimet materiale midis ekonomisë dhe mjedisit dhe në akumulimet materiale në ekonominë kombëtare, sesa në flukset brenda ekonomisë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Cila është baza materiale e një ekonomie? Cili është niveli dhe përbërja e kërkesës së brendshme për materiale? - Cili është produktiviteti material i një ekonomie dhe si lidhet ajo me fuqinë punëtore dhe kapitalin? - Deri në çfarë mase inputet materiale në ekonomi shoqërohen me prodhimin ekonomik? me ndotës dhe gjenerim të mbetjeve? - Sa prej materialeve të kërkuara për të mbështetur ekonominë mund të furnizohen nga burimet e brendshme? Cila është përbërja e tyre? - Sa është e varur ekonomia kombëtare nga tregjet e jashtme? Për materialet e importuara dhe kërkesat nga tregjet e jashtme? - Cilat materiale lënë ekonominë si eksporte, dhe si lëshime në mjedis (ndotësit, mbeturinat)? - Sa material grumbullohet në ekonomi në formën e stoqeve (ndërtesat, infrastruktura, mallrat e qëndrueshme, etj.)? - Sa material hiqet nga natyra për të mbështetur ekonominë pa u përdorur? Në shtëpi, jashtë vendit, në të gjithë botën? 	<p style="text-align: center;">Plani i Përgjithshëm Kombëtar Planet hapësinore në Nivel Rajoni Zhvillimi</p>
<p style="text-align: center;">Meso</p>	<p>Mundëson një gjurmim më të diferencuar të informacionit dhe analizon rrjedhat materiale në nivele më të hollësishme brenda ekonomisë, duke dalluar jo vetëm kategoritë e materialeve ose materialet individuale, por edhe industrinë ose degët e prodhimit. Informacioni i MFA i nivelit meso është veçanërisht i dobishëm për të ndjekur ndryshimet strukturore në nivelin makro dhe global, për të monitoruar zhvillimet në produktivitetin e burimeve dhe performancën mjedisore në nivelin e mesëm. Ndhmon në zbulimin e mbeturinave të materialeve, burimeve të ndotjes dhe mundësive për përfitime efikasiteti në sektorë të veçantë dhe shërben si bazë për nxjerrjen e treguesve të ndërlidhur.</p>	<p>Sa intensive janë industrinë/ sektorët ndaj burimeve dhe mbetjet ? Cila është pjesa e tyre në gjenerimin e mbetjeve?</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilat kërkesa për produktet finale ndikojnë më shumë në gjenerimin e mbetjeve? - Sa intensivë janë konsumi i brendshëm, investimet dhe eksporteti në përdorimin e burimeve dhe gjenerimin e mbetjeve? - Cili është niveli i kërkesës për një material të caktuar? - Cila është origjina e një materiali? Sa prodhohet në vend apo importohet? Si zhvendosen flukset e një materiali të caktuar midis vendeve ose rajoneve botërore? A ka reziqe të ndërprerjeve të furnizimit? - Cilat janë kërkesat e lëndës së parë për ciklin e plotë të përdorimit të materialeve? - Me sa efikasitet përdoret materiali brenda sistemit? Sa është përdorur ose nga është furnizuar dhe ku? Sa prej tij bëhet mbeturina, sa riciklohet, dhe sa shkojnë në hedhjen përfundimtare? 	<p style="text-align: center;">Planet Kombëtare Sektoriale Planet hapësinore në Nivel Rajoni Zhvillimi Plani Sektorial në Nivel Qarku</p>

Mikro	<p>Ofron informacion të detajuar për proceset specifike të vendimmarrjeve në biznes (kompani, firmë, bimë) ose në nivelin lokal (qytet, komuna, ekosistemi, habitati, pellgu i lumit) ose në lidhje me substancat specifike ose produkte individuale. Informacioni është i dobishëm për të monitoruar zhvillimet në produktivitetin e burimeve dhe performancën mjedisore në nivel kompanie apo qyteti. Mbështet zbatimin e politikave dhe vendimeve në fusha të tilla si eficiencën e energjisë, mbetjet e integruara menaxhim, menaxhim e qëndrueshëm të materialeve etj.</p>	<p>- Ku dhe sa substancë X rrjedh përmes një sistemi të caktuar? - Ku përfundon rrjedha e substancës X ? Ç'pjesë e substancës X ruhet në mallra të qëndrueshëm? po në mbeturina? - Ku janë potencialet për të përdorur substancën X në mënyrë më efektive në proceset teknike? - Ku janë opsionet për zëvendësimin e substancave të dëmshme ? - Ku përfundojnë substancat pasi lëshohen në mjedisin natyror? - Cilat presione mjedisore ndodhin përgjatë ciklit jetësor (nxjerrja, përpunimi, përdorimi, asgjësimi) të produkteve individuale? - Ku mund të menaxhohen dhe kontrollohen më mirë presionet mjedisore përgjatë ciklit jetësor të një produkti? - Cili është intensiteti i burimeve të një produkti?</p>	<p>Plan Sektorial në Nivel Bashkie Plan i Përgjithshëm Vendor Plan i Detajuar Vendor</p>
--------------	---	--	---

Tabela 5.4-6 Lidhja midis niveleve të Analizës së Flukseve të Materialeve me Instrumentat e Planifikimit në Shqipëri. Burimi:OECD 2008, përpunoi: Autori

5.5 Ndikimi i qasjes metabolike në instrumentet kryesore të planit

Një tipar i rëndësishëm që tregon ndikimin e AM në planet lokale është rezultati i saj në dy mjetet kryesore për zbatimin e planit që janë; harta e përdorimit të propozuar të tokës dhe harta e treguesve të zhvillimit. Këto dy instrumente sëbashku me rregulloren për zbatimin e planit dhe listën e projekteve strategjike, përbëjnë kulminacionin e të gjithë procesit të hartimit të PPV, pasi në bazë të tyre zbatohen të gjitha kërkesat për zhvillim dhe ndërtim në territor.

Instrumentat kryesorë në zbatim të PPV qëndrojnë:

1. Harta e përdorimit të propozuar të tokës;
2. Harta e nënnyësive strukturore dhe treguesit e zhvillimit të propozuar;
3. Harta e Infrastrukturës Inxhinierike dhe të transportit;
4. Rregullorja e planit;
5. Plani i Veprimet dhe Projektet Strategjike.

Elementët e mësipërm nuk paraqesin ndikim në përrcaktimet e tyre nga analiza metabolike e territorit. Kështu për shembull, harta e përdorimit të propozuar të tokës dhe e treguesve të zhvillimit mund të plotësohet nga Harta e Shkallës së Urbanizimit e klasifikuar sipas dendësisë e shprehur në banorë/ha apo njësi banimi për/ha, si edhe të dhëna që tregojnë për tipologjinë e strukturave të propozuara të klasifikuara në numër katesh dhe tipologji të konstruksionit të ndërtimit (ku reflektohen tipologjia e materialeve të ndërtimit që më vonë do të shërbejë edhe për parashikimin e konsumit të energjisë ndër të tjera). Edhe Projektet Strategjike mund të zërthehen sipas parametrave : konsum energjie, toke dhe materialeve dhe flukse të tjera, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e tyre.

Nga këndvështrimi teorik: përdorimi i tokës dhe treguesit e zhvillimit në vetvete përbëjnë indikatorët kryesorë që ndikojnë mbi Profilin Urban të një territori në studim. Studimet tregojnë se Indikatorët e Profilit Urban kanë një ndikim të madh në

dimensionet e metabolizmit urban kryesisht në konsumin e tokës, konsumin e energjisë, ujit dhe në konsumin e materialeve.

Tabela e mëposhtme paraqet ndikimet e llojeve të konfigurimit urban në dimensionet e metabolizmit:

Indikatori Profilit Urban	Ndikimet në dimensionet e metabolizmit urban		
<i>Tipologjia e Konfigurimit Urban</i>	<i>Konsumi i tokës</i>	<i>Konsumi i energjisë</i>	<i>Konsumi i materialeve</i>
Dendësia e lartë, struktura kompakte	I ulët	I ulët	I ulët
Dendësia e lartë, struktura e fragmentuar	Mesatare	Mesatare	Mesatare
Dendësia e ulët, struktura kompakte	Lartë	Mesme	Lartë
Dendësia e ulët, struktura e fragmentuar	Lartë	Lartë	Lartë
<i>Tipologjia e Diversitetit Urban</i>	<i>Konsumi i tokës</i>	<i>Konsumi i energjisë</i>	<i>Konsumi i materialeve</i>
Monocentrik	Nuk aplikohet	Mesatare	Nuk aplikohet
Policentrik		I Lartë	
Fshat Urban		I ulët	
Model i përbërë		Mesatare – Lartë-I ulët	
<i>Tipologjia e stokut të banesave</i>	<i>Konsumi i tokës</i>	<i>Konsumi i energjisë</i>	<i>Konsumi i materialeve</i>
Banesa një familjare të ndërtuara deri në 1945	I Lartë	I Lartë	I Lartë
Banesa një familjare të ndërtuara deri në 1945-1990	I Lartë	I Lartë	I Lartë
Banesa një familjare të ndërtuara deri në 1990-2005	I Lartë	Mesatar	Mesatar
Banesa një familjare të ndërtuara pas 2005	I Lartë	I ulët	Mesatar
Banesa bifamiljare me tarracë të ndërtuara deri në 1945	Mesatar	I Lartë	I Lartë
Banesa bifamiljare me tarracë të ndërtuara deri në 1945-1990	Mesatar	I Lartë	Mesatar
Banesa bifamiljare me tarracë të ndërtuara deri në 1990-2005	Mesatar	Mesatar	I ulët
Banesa bifamiljare me tarracë të ndërtuara pas 2005	Mesatar	I ulët	I ulët
Banesa shumëfamiljare të ndërtuara deri në 1945	I ulët	I Lartë	I Lartë
Banesa shumëfamiljare të ndërtuara deri në 1945-1990	I ulët	I Lartë	Mesatar
Banesa shumëfamiljare të ndërtuara deri në 1990-2005	I ulët	Mesatar	I ulët
Banesa shumëfamiljare të ndërtuara pas 2005	I ulët	I ulët	I ulët

Tabela 5.5-1 Ndikimet e disa Indikatorëve urban në dimensionet e metabolizmit urban.
Përpunimi autori, Burimi: Projekti SUME 2011

Kështu Konfigurimi Urban i karakterizuar nga një Dendësi e lartë dhe Strukturë kompakte është modeli më i qëndrueshëm nga pikëpamja e performancës metabolike.

Ndërkohë, Diversiteti urban i shprehur përmes funksioneve më të rëndësishme brenda qytetit dhe ndërlidhjes hapësinore të diktuar kryesisht nga infrastruktura e transportit është rezultat i përdorimit të propozuar të tokës dhe modelit të zhvillimit urban. I shprehur në katër forma: monocentrik, policentrik, fshat urban dhe modeli i përbërë, tabela paraqet rezultatet e ndikimit të tij në performancën metabolike të qytetit. Modeli me ndikim më të ulët në flukset metabolike duket se jep modeli i Fshatit Urban. Idetë bashkëkohore të fshatit urban janë të lidhura ngushtë me Urbanizmin e Ri dhe idetë për 'Smart Growth' të iniciuara në Shtetet e Bashkuara (Caves, 2004, p. 733).

Ky model sugjeron një zhvillim urban që karakterizohet tipikisht nga strehimi me dendësi të mesme, zonimi i përdorimit të përzier, tranziti i mirë publik dhe thekson këmbësorizimin e hapësirës publike.

Zbatimi i mëtejshëm i planeve vendore përmes lejeve të ndërtimit dhe të zhvillimit do të na jepte informacion mbi ndikimet e mësipërme si psh. tipologjinë e Stokut të banesave, tiparet hapësinore të të cilave dhe cilësia teknike, lidhet me konsumin e tokës dhe të energjisë. Analiza historike e tyre na jep një informacion mbi performancën ekzistuese metabolike të qytetit sipas këtij stoku ndërsa monitorimi i tyre në të ardhmen do të na siguronte të dhëna për profilin e ardhshëm metabolik të qyteti. Tabela e mësipërme e përpunuar sipas informacionit të raportit studimor në nivel European, të cituar edhe më parë SUME-Working Paper (Pinho, P., Santos, S., Oliveira, V., Barbosa, M., Silva, M., Galera Lindblom, P., Weber, R., Reardon, M., Schmitt, P., 2011), ofron në këtë mënyrë, një përmbledhje cilësore të ndërlidhjes midis llojeve të ndryshme të stokut urban dhe dimensioneve të metabolizmit urban nga gjetjet në literaturë. Për shkak të mungesës së hulumtimit mbi ndërtesat jo rezidenciale, vlerësimi cilësor nuk përfshin këtë lloj ndërtesash.

Me qëllim identifikimin e tipareve të mësipërme, studime komplementare mbi konfigurimin urban, paternin dhe stokun e banesave janë të nevojshme për hartimin e AM dhe matjen e ndikimit të saj në territorin administrative të një bashkie. Nga krahasimi i planeve vendore rezulton se ato zhvillojnë një analizë të thelluar të territorit që investigon dhe paraqet të dhëna të kënaqshme në lidhje me tipologjinë e banesave sipas vitit të ndërtimit dhe tipologjisë së tyre por kjo analizë shkon deri në evidentimin e gjendjes ekzistuese dhe gjen pak vend në sjelljen më të gjerë të organizmit të qytetit. Studime të pavarura janë kryer për matjen e efikasitetit energjetik të tyre, por këto kërkime përfundojnë me propozime projektesh rikuperimi apo rihvillimi duke ndikuar pjesërisht në profilin metabolik urban të bashkisë. Në këtë drejtim, njësitë vendore duhet të ngrenë regjistrat e klasifikimit të ndërtesave sipas parametrave të tabelave të mësipërme për të realizuar analiza të thelluara në lidhje me ndikimin e stokut të ndërtimeve në metabolizmin e qytetit.

Me territorin e ri administrativ të bashkive, planet morën në studim një territor më kompleks, ku sistemi urban dhe infrastrukturor ndërveprojnë me sistemin ujor natyror dhe bujqësor. Në këtë drejtim, planet reflektojnë një përpjekje të kënaqshme në identifikimin [paternit dhe morfologjisë urbane]. Kështu sistemi urban klasifikohet në shumicën e rasteve në tre nivele: urbane, suburbane dhe rurale, edhe pse se në vendin tonë nuk kemi ende parametra të unifikuar për ndarjen urban rurale, prandaj edhe vlerat e përdorura nga autoritetet e planifikimit për të përcaktuar tipologjinë e konfigurimit urban nuk janë të unifikuara dhe varen nga tiparet lokale të territorit në studim. Ajo që vihet re është se rezultatet e këtij klasifikimi të territorit urban nuk u përdorën në hartimin e analizës metabolike. Flukset e materialeve dhe të energjisë u llogaritën sipas rrjetit kuadratik 1 km² mbështetur kjo nga percaktim i Urban Rurales

prodhuar nga INSTAT ne vitin 2014 ne bazë të përpunimit të të dhënave nga Census 2011 (INSTAT, Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare, 2014). (INSTAT, Lëvizjet vajtje-ardhje për qëllime punësimi, 2014) (INSTAT, Tipologjia e komunave dhe bashkive, 2014) Duke qenë se për klasifikimin e zonave urbane, ndarja 1km² nga INSTAT ofron të dhëna të kënaqshme mbi popullsinë, njësitë ekonomike familjare etj, planet vendore e kishin më të lehtë ndërtimin e flukseve metabolike.

Sa më lart, mund të themi se planet vendore kanë hartuar analizat e territorit në mënyrë cilësore dhe tërësore, duke na dhënë informacione të detajuara mbi zhvillimet në territor, hapi tjetër i ardhshëm është integrimi i gjetjeve nga kjo analizë në ndërtimin e profilit metabolik të qytetit dhe për pasojë ndikimin e zhvillimit të tij drejt një modeli më të qëndrueshëm zhvillimi.

Me qëllim kryerjen e analizës Metabolike, kërkohen të dhëna të përditësuara në një shkallë të përshtatshme territoriale, në nivel të nënjesive strukturore të cilat përbëjnë edhe njësinë më të vogël nga pikëpamja territoriale për të cilën hartohet një plan i detajuar vendor. Një mundësi për këtë është njëhesimi i kufirit të territorit të njësisë më të vogël të mbledhjes së të dhënave statistikore (qeliza statistikore) me njësinë më të vogël për të cilën hartohet një plan i detajuar vendor (nënjësia strukturore). Ky hap do të përbente një kontribut për pasurimin e planeve me informacionet e nevojshme për ndërtimin e flukseve metabolike.

Gjithashtu kjo tezë sugjeron pasurimin e përmbajtjs së PDV me elementë tregues të konsumit të flukseve metabolike. Në këtë mënyrë mund të ndërhyjmë në metabolizmin e qelizës së planit duke synuar ndërtimin e lagjeve të qëndrueshme. Këto të dhëna do të ndhmojnë në ndërtimin e profilit metabolik të qytetit dhe do të lejonte monitorimin e ecurisë së zhvillimit të tij drejt modeleve të qëndrueshme. Deri më tani kërkesat për përmbajtjen e PDV nuk kanë ndryshuar me parametrat minimalë të studimeve pjesorë të sistemeve të mëparshme të planifikimit. Ato kufizohen në evidentimin e parametrave maksimalë të zhvillimit: si edhe të treguesve për infrastrukturën publike dhe të gjelbërt. Të dhënat mbi performancën metabolike të zonave në zhvillim do të rrisë presionin për ndërtime e eko të qëndrueshme (ekologjeve urbane) dhe nxitjen e zbatimit të iniciativave si për shembull: ripërdorimi i ujit të shiut, prodhimi i energjisë lokale brenda një apo disa njësisë strukturore, trajtimi dhe ripërdorimi i ujërave urbane, etj. Kërkesa të cilat duken shumë larg kritereve të domosdoshme për planifikimin e një njësie strukturore, edhe pse dokumentat e hierarkive më të larta si PPV dhe PPK në analizat strategjike e metabolike të tyre i kushtojnë një vëmendje të veçantë. Si përfundim, mund të themi se në hartimin e planeve në Shqipëri, përafrimi nga ‘lart – poshtë’ ka një sensibilitet të lartë të zbatimit të instrumentave për zhvillimin e qëndrueshëm, dhe analiza metabolike përbën një risi në këtë drejtim, por përkthimi i këtyre nismave në nivelin lokal, nga ‘poshtë – lartë’ është ende i pakonsoliduar.

5.6 Fazat për hartimin e analizës metabolike

Nga aplikimi i AM në nivel kombëtar në atë lokal argumentuam më lart nevojën për ndërtimin e një metode të strukturuar me qëllim që rezultatet e saj të jenë të matshme dhe të krahasueshme dhe mbi të gjitha të ndikojnë modelin e zhvillimit urban të territoreve për të cilat hartohet. Analiza e planeve të përgjithshme vendore tregoi për një numër të lartë të dhënash që sigurojnë këto plane për analizën e thelluar të territorit. Këto të dhëna na japin njohuri të detajuara mbi modelin, strukturën dhe cilësinë e zonave urbane, ajo që na mbetet është të ndërtojmë një platformë që integron të dhënat

nga kjo analizë dhe orjenton propozimet e reja të planeve. Më poshtë prezantojmë hapat dhe modelin e propozuar për strukturimin e të dhënave që përftohen gjatë hartimit të një plani territorial. Modeli i propozuar bazohet në qasjen e përdorur në studimin European Sustainable Urban Metabolism inancuar nga Komuniteti European, duke rezultuar në një seri raportesh, me fokus kryesor Metabolizmin urban dhe optimizimi i burimeve në strukturën urbane, por duke reflektuar kërkesat e punimit dhe kontekstin e territorit shqiptar dhe të instrumentave tona të planifikimit.

Faza I . Përcaktimi i zonës/territorit të studimit, kufiri i sistemit

Në përgjithësi, zona e studimit të një plani, përcaktohet sipas natyrës së planit (mund të jetë plani urbanistiki detajuar, i përgjithshëm vendor, apo ose projektit urban), objektivit që synon të rralizojë, si dhe fushëveprimin të analizës për sa i përket flukseve të burimeve si energjisë, tokës, ujit dhe të tjera. Në rastet e aplikuara në Shqipëri, ky kufij përpulhet me territorin e Republikës së Shqipërisë për rastin e planit kombëtar dhe me territorin administrativ të një bashkie në rastin e hartimit të planeve vendore. Lidhja e territorit të studimit me llojin e dokumentit të planit, paraqiten në tabelën më poshtë.

Plani	PPK	PDZR K	PKS	PSNQ	PSNB	PPV	PDV
<i>Territori që mbulon</i>	Kufiri shtetëror i Rep.Shqip.	Zonë e Rëndësi së Kombëtare	Territori kombëtar ose rajonal, sipas shtrirjes së Sektorit	Territori administrativ i një Qarku, sipas shtrirjes së Sektorit	Territori administrativ i një Bashkie	Territori administrativ i një Bashkie	Nënjësi Strukturore

Megjithatë, përshkak të natyrës fluide të flukseve të burimeve në analizën metabolike, zona e ndërhyrjes shpesh nuk mund të ketë një përcaktim të vetëm dhe të saktë e aq më pak administrativ. Përkundrazi, gjeometria e saj mund të jetë e “ndryshueshme” sipas dimensionit metabolik që analizohet. Rastet e aplikimit të AM në nivel lokal dëshmuar se, për rastin e Shqipërisë, është mjaft e vështirë të ndërtohet një profil i plotë metabolik për një fluks të caktuar, të paktën për disa tipe si energjia uji dhe ushqimi në nivel bashkie. Kjo për shkak se psh, dimensionin e energjisë në analizën metabolike mund të kërkojë një kufi të ndryshëm nga dimensionin e ujit, dimensionin e tokës ose dimensionin e materialeve, apo ndryshimet dhe ndikimet e fluksit të ujit apo ushqimit nuk mund të kufizohen apo të përfshihen plotësisht brenda në territorin administrativ të një bashkie. Në rastin tonë, qëllimi është inkuadrimi i analizës metabolike brenda kufijve territorialë të instrumentit të planifikimit, të cilat zyrtarisht identifikohen me kufij të qartë administrativë sipas llojit dhe nivelit të tyre. Më poshtë kemi identifikuar flukset më përfaqësuese dhe përshtatshmerinë për matjen e tyre në raport me instrumentat e planifikimit dhe kufirit të zonës të mundshme për studim.

		<i>Njësia territoriale e cila mund të përpulhet ose jo me njësine territoriale të planit apo njësine territoriale administrative</i>								
	Fluksi	Nënkategorizimi i fluksit	Blok Banimi/	Aglomerim Urban (Zonë Urbanizuar)	Nënjësi strukturore	Nënjësi vendore	Bashki	Qark	Rajoni Zhvillimi	Rajoni EU
I.	Energjia	Elektrike, Gas, Naftë	√ 0 *	√ 0 Njësioj si për	√ 0 **	√ 1 0 -/-	√ 1 0	√ 1 0	√ 1 0	√

		<i>Nenprodukte Te Naftes, Era Gjeotermale, Dru, Tjeter</i>		<i>bllokune e banimit.</i>						
2.	<i>Uji</i>	<i>Rezerv. ujit te pijshem, Rezerv.e bujqësor, Burime, Lumenj, Liqene</i>	√ O	√ O	√ O	√ IO	√ IO	√ IO	√ IO	√
3.	<i>Ushqimi</i>		-	√ IO	±	√ IO			√ IO	√
4.	<i>Mbetjet</i>	<i>Landfill , Incenerim Riciklueshme, Të depozituara</i>	√ O	√ IO		√ IO	√ In Out		√ IO	√
5.	<i>Materialet</i>	<i>Hekur, Çelik, Tulla, Çimento, Dru, Rërë, Qelq</i>	-	±	±	±	√ IO		√ IO	√
6.	<i>Toka</i>	<i>Përdorimi i Tokës sipas kategorive bazë</i>	-	-	√		√ IO		±	√
	Natyrave instrumentit planit			I detajuar		Ipërgjithshëm	Sektorial			
						Sektorial	Ipërgjithshëm		Rajonal	

Pjeserisht e mundshme matja e fluksit

±

Vleresimi per flukset Hyrese dhe Dalëse (Input /Output)

√ InOut

Matja per flukset Dalëse (Output)që prodhon njësia

√ Out

E pamundur apo jo relevante matja e fluksit në këtë nivel njesie territoriale

-

**Kryesisht të dhëna për konsumin e Energjisë. Në disa raste për shembull me instalimin e paneleve fotovoltaike apo gjeotermale, në të ardhmen edhe prodhimi. Shkallë e vogël impakti kryesisht për matjen e Ecosostenibilitetit të bllokut.*

*** Përdorimi i këtij kufiri për përcaktimin e territorit për matjen e fluksit është interesant të eksplorohet pasi mund të përdoret si njësi më e vogël unifikuese për matjen e të dhënave statistikore, metabolike dhe territori më i vogël është subjekt planifikimi sipas PDV.*

Si vihet re, rëndësia dhe kontributi i analizës metabolike rritet me zgjerimin e kufirit të zonës në studim, së pari pasi efektet e ndikimit të flukseve bëhen më të dukshme dhe së dyti për shkak të natyrës së flukseve të matura dhe shkallës së gjerë të veprimit të tyre (edhe pse niveli më i vogël për matjen e tyre mund të jetë edhe në nivel individual (organizmi). Siç vërehet edhe nga tabela, prezantimi i një niveli të mesëm planifikimi, siç është ai i Rajonit të zhvillimit, është i domosdoshëm për kryerjen e analizave sipas kësaj metodologjie.

Faza 2. Profili urban dhe metabolik ekzistues i territorit në studim

Pasi përcaktohet qartë kufiri i hapësirës, subjekt i analizës, lind nevoja për ndërtimin e një profili fillestar të zonës së studimit, nga pikëpamja urbane dhe metabolike që do

të na ndihmojë të kuptojmë performancën e gjendjes ekzistuese. Ky karakterizim do të përfitojë nga modeli i metabolizmit urban që mund të jetë ndërtuar më parë për qytetin apo rajonin, psh. Në rastin e një profili metabolik të dhënë në nivel kombëtar përmes PPK, mund të detajohen të dhënat për profilin metabolik të një rajoni zhvillimi, apo të një sektori për hartimin e një PKS etj. Këtu duhet të identifikohen qartë flukset kryesore metabolike që prekin zonën e studimit.

Faza 3. Profili urban i plan- propozimit

Indikatorët e profilit urban mund të përlogariten me përfaqësi në këtë fazë për të projektuar profilin e ardhshëm urban të plan propozimit. Treguesit e përzgjedhur në kapitullin 5.4.2, por jo vetëm, përdoren këtu. Gjithsesi, ashtu si jemi shprehur edhe më parë, këto tregues mund të ndryshojnë sipas nivelit administrativ të planit, shtrirjes së territorit dhe qëllimit të planit.

Faza 4. Profili metabolik i plan - propozimit

Ndërkohë, pasi përcaktojmë kufirin e territorit në studim dhe ndërtojmë profilin urban dhe metabolik të tij, ku evidentohen potencialet dhe problemet për t'u adresuar, faza e katërt përbën vlerësimin e Plan-Propozimit sipas perspektivës metabolike. Ky hap, mungon dukshëm si në propozimet e planit kombëtar në vendin tonë ashtu edhe të planeve lokale. Në të dy rastet nuk kemi një vlerësim të propozimit të planeve nga pikëpamja e përmbushjes së një profili metabolik të qëndrueshëm për territorin në studim. Për shembull deri më tani nuk është evidentuar shkalla e ndikimit të Përdorimit të përpoqur të tokës apo të parametrave të rinj të zhvillimit (si ksht, intensiteti, apo dendësia urbane) në profilin e ri metabolik të një bashkie. Një përshkrim i inputeve, prurjeve dhe rezultateve të mundshme që lidhen me propozimin e planit, për sa i përket psh.fluksit dhe rezervave të energjisë, materialeve dhe tokës duhet të vlerësohen në lidhje me performancën metabolike. Ky përshkrim duhet të jetë në gjendje të përputhet, të paktën pjesërisht, me çështjet kryesore metabolike të zbuluara nga karakterizimi i sistemit në studim në fazën e mësipërme. Në çdo rast, pasojat e mundshme metabolike të propozimit të planit mund të tejkalojnë grupin fillestar të çështjeve metabolike që prekin territorin, duke gjeneruar një grup të ri problemesh dhe shqetësimesh të cilat duhen trajtuar.

Në këtë fazë, Indikatorët e profilit metabolik të shprehura në kapitullin 5.4.2, si dhe matricat skematike të organizimit të informacionit dhe pyetjet drejtuese, do të ndihmojnë planifikuesin të projektojë profilin metabolik të plan propozimit. Sa më e balancuar të jetë raporti midis Burimit të prodhuar ndaj atij të importuar aq më i qëndrueshëm është sistemi.

Krahasimi i vlerave të konsumit të burimit midis sektorëve na japin të dhëna për impaktin e zhvillimit të sektorit në ekonomi dhe ndikon në formulimin e politikave për ta kthyer atë më të qëndrueshëm, në këtë rast nga pikëpamja energjitike.

Matrica e Energjisë

INPUTET	SHNDËRRIME dhe OUTPUTE
<i>Energjia</i>	<i>Sektorët</i>

Uji Diellore Era Gjeotermale <i>Të klasifikuara:</i> të jashtme (si vlere e importuar jasht sistemit në studim); <i>të brendshme</i> , e prodhuar brenda sistemit në studim (prodhim i brendshëm)	Përdorimet sipas sektorëve: Familjar, Shërbime, Turizmi*, Ndërtimi , Transporti , Industria, Bujqësia Humbjet Eksporte Humbje
---	---

Tabela 5.6-1 Matrica e Energjisë për t'u përdorur në Fazën 2 dhe 4

Zërat në tabelën e mësipërme janë të përshtatshme për analizat në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Ndërkohë në nivel lagjeje të planifikuar përmes PDV, koona e Output-eve mund të jetë më e reduktuar pasi psh. sektori i bujqësisë në zona urbane nuk është i përhapur (me përjashtim këtu të bujqësisë urbane që po njih zhvillim në vendet perëndimore). Në këtë rast konsumi duhet detajuar sipas zërave të përdorimit të tokës dhe të funksioneve të propozuara nga PDV, si psh : banimi, shërbimi+tregëtimi, sipërfaqet publike (psh. energjia per ndricimin e tyre).

Pyetjet sasiore për plotësimin e matricës së Energjisë:

- *Sasia e energjisë e prodhuar brenda territorit në studim sipas burimit të prodhimit (hidro, tec, erë, diell etj)*
- *Sasia e Energjisë e përdorur brenda territorit në studim sipas sektorit të konsumit (konsum familjar, shërbime, industri, ndertime, transport etj) Psh. Turizmi, për rastin e Shqipërisë, edhe pse klasifikohet tek shërbimet mund të identifikohet më vete për të kapur shkallën e ndikimit të të tij në profilin metabolik të territorit në studim. Ky zë gjithashtu është i rëndësishëm për zonat turistike dhe planifikimin e tyre deri në nivel PDV-je.*
- *Sasia e konsumuar e energjisë sipas Outputit dhe sasia e humbur.*

Matrica e Materialeve

	INPUTET	SHNDËRRIMET	OUTPUTET
	<i>Materialet</i>	<i>Sektorët</i>	
Nenkategor i e inputeve	Hekur, Çelik Tulla Çimento, Dru, Rërë, Qelq	Ndërtimi sipas tipit (residenca, tregëti, turizëm) Industria Hapësira publike Infrastruktura	Ndërtimi Mirëmbajtje/ Shërbim Tjetër Mbetjet

Tabela 5.6-2 Matrica e Materialeve për t'u përdorur në Fazën 2 dhe 3

Fluksi i Materialeve nuk është studiuar në rastin e Shqipërisë as nga *Metabolism of Albania* dhe as nga PPK 'Shqipëria 2030', megjithatë paraqet një fluks me rëndësi për analizat e nivelit kombëtar dhe rajonal të planifikimit. Sektori i ndërtimit, duke qenë një nga sektorët kryesor të ekonomisë së vendit ka nevojë për një monitorim më të vëmendshëm të flukseve të materialeve. Katastrofat mjedisore të shkaktuara nga shfrytëzimi pa kriter i gurorëve mund të shmangen nëse te dhënat e këtij niveli bëhen të dukshme të matshme dhe përfshihen në instrumentat e planifikimit të territorit.

Pyetjet sasiore për plotësimin e matricës së Materialeve:

- *Sasia e materialeve të prodhuara sipas tipit*
- *Sasia e materialeve të përdorura sipas sektorëve*
- *Sasia e materialeve të transformuara*
- *Sasia e mbetjeve të materialeve siaps tipit*

- *Sasia e materialeve të ricikluara sipas tipit*

Matrica e Ujit

	INPUTET	SHNDËRRIMET	OUTPUTET
	Burimet sipas LLojit	Përdorimet sipas Sektorëve	
Nenkategoritë	Uji nëntokësor Uji sipërfaqësor Uji i burimeve Uji i rezervuarëve të pijshëm Uji i rezervuarëve të bujqësisë	Urban Industrial Bujqësor Shërbimit dhe tregëtisë Energji Tjetër	Uji i Ndotur Uji i konsumuar Humbjet Uji i Trajtuar Uji i Ripërdorur Tjetër

Tabela 5.6-3 Matrica e Ujit për t'u përdorur në Fazën 2 dhe 3

Pyetjet sasiore për plotësimin e matricës së Ujit

Sasia e ujit të prodhuar sipas destinacionit të përdorimit

Sasia e Ujit rezervë/Stok

Sasia e ujit të konsumuar sipas sektorëve kryesorë.

Sasia e Ujit të ndotur të prodhuar sipas sektorëve.

Sasia e Ujit të ndotur të trajtuar (sipas kapacitetit të impianteve të trajtimit).

Matrica e Tokës

INPUTET	SHNDËRRIMET	OUTPUTET
Toka	Transformimi	Konsumi
Përdorimi ekzistues i tokës Sipas 5 Sistemeve: Ujor, Natyror, Infrastrukturor, Bujqësor, Urban	Përdorimi i tokës i propozuar Indekset e përdorimit sipas 5 sistemeve	Produktiviteti sipas kategorive të përdorimit Disponueshmëria sipas përdorimit të propozuar Konvertime/humbje e tokës sipas kategorive sensitive (natyrore, bujqësore, pyjore..etj)
Sipas 14 kategorive bazë të përdorimit të tokës	Intensiteti i zhvillimit Koeficienti i shfrytëzimit të territorit	

Të dhënat për përdorimin e tokës janë të rëndësishme pasi lidhet drejtpërdrejt me dy instrumentat kryesorë për zbatimin e planeve territoriale, hartën e përdorimit të tokës dhe hartën e treguesve të zhvillimit. Matrica e mësipërme është një përpjekje për ta konsideruar edhe territorin si një burim dhe të karakterizohet përmes disa treguesve kryesisht urbanë. Bilanci i përdorimit të territorit që mund të rezultojë nga plotësimi i matricës së mësipërme mund të na informon për disponueshmërinë e tokës dhe përdorimeve të mundshme të saj.

Faza 5. Identifikimi dhe karakterizimi i Impaktit Metabolik

Për të identifikuar ndikimet metabolike të plan propozimit, dy modelet e zhvilluara në fazën 3 dhe 4 dhe plan propozimi (për zonën e ndërhyrjes) duhet të bashkohen, duke përfshirë propozimet në një territori më të gjerë, në kontekstin e rajonit ku bën pjesë qyteti, bashkia apo territori në studim.

Ky ushtrim pritet të zbulojë inputet dhe outputet që lidhen me zbatimin e planit dhe propozimet e tij, jo vetëm në zonën e ndërhyrjes, por më e rëndësishmja, në tërësi në metabolizmin urban të rajonit ose zonës metropolitane ku bën pjesë zona e studimit. Ai do të nxjerrë në pah kontributin e mundshëm neto të planit dhe vlerën e shtuar të propozimit për performancën metabolike urbane të territorit në studim në kontekstin rajonal kombëtar e më gjerë. Vetëm kështu mund të sigurohet integrimi i propozimeve të instrumentave të planifikimit të hierarkive të ndryshme dhe përputhshmëria e objektivave të planeve në çdo nivel.

Faza 6. Vlerësimi i propozimit dhe hartimi i skenarëve të mundshëm

Në këtë fazë merr rëndësi procesi i vlerësimit. Në asnjë nga rastet e trajtuara më lart, si në planet e nivelit kombëtar edhe të atyre në nivel vendor, nuk kemi një proces që të vlerësojë impaktin e propozimeve. Në rastin tonë ky vlerësim do të lidhet me ndikimin e propozime të profilit metabolik në territorin në studim. Nëse në fazën e 5 kemi përfshirjen e propozimeve në profilin metabolik të dhënë sipas planeve të hierarkive më të larta këtu vlerësimi do të konsiderohet në përputhje me skenarët e ndryshëm, nën një perspektivë më të gjerë si për shembull: në përputhje me qëllimet dhe vizionin e përgjithshëm për zhvillimin e qytetit. Në këtë fazë vlerësimi i propozimit pritet të ndikojë drejtpërdrejtë në vendimmarrjen politike dhe administrative - duke përfshirë edhe ndikimin e aktorëve të ndryshëm si edhe të proceseve të tilla si dëgjuesat publike apo procesi i pjesëmarrjes.

Tabela e mëposhtme ilustron lidhjet e elementëve të përmbajtjes të një plani me fazat e hartimit të analizës metabolike.

Analiza		Propozimi		Vlerësimi
Vizioni	Profili urban ekzistues	Perdorimi i tokës	Profili urban propozuar	Karakterizimi i Impaktit Metabolik
Objektiva strategjike	Profili metabolik ekzistues	Ndarja në njësi strukturore & treguesit e zhvillimit	Profili metabolik propozuar	Vlerësimi i skenarëve të mundshëm
Gjetjet e analizës		Rrjetet e infrastruktures teknike		A përputhet profili i propozuar me vizionin dhe objektivat e planit të përcaktuar në Fazën 1. Si përfshihen gjetjet e analizës në skenarët e mundshëm të
Faza 1 - Faza 2		Faza 3 - Faza 4		Faza 5 - Faza 6

Figura 5-11 Lidhja e elementëve të përmbajtjes të një plani me fazat e hartimit të analizës metabolike.

6 KAPITULLI VI_ PËRFUNDIME

Rritja e vullshme ekonomike e përjetuar gjatë këtyre dy shekujve është përkthyer në një rritje të shpejtë të përdorimit të burimeve materiale dhe energjitike si në shkallë lokale ashtu edhe në atë globale. Ky ekstraktim, përdorim i burimeve natyrore si dhe emetimet e ndotjes shoqëruese të tyre, me origjinë në teknologjitë e zhvilluara në shekujt e 18-të dhe 19-të të cilat formuan bazën për historinë e suksesshme të zhvillimit të qyteteve (Brunner, 2007, p. 11), janë përgjegjëse për presione ekstreme mjedisore. Nga ky përdorim gjithmonë në rritje i kërkesës për materiale dhe energji sipas Paul Dijst (2007) lindin tre probleme të mëdha: (1) disponueshmëria e burimeve; (2) ndarja e burimeve në mënyrë të drejtë; (3) (menaxhimi) mbetjet mjedisore' (Brunner, 2007, p. 11). Këto problematika padyshim kanë në zemër shkallën e urbanizimit si një trend global icili 'sëbashku më rritjen e popullsisë globale, mplakjen dhe emigracionin ndërkombëtar është një nga trendet demografike të shek XX-XI,' (UN, World Urbanization Prospects: The 2018 Revision, 2018).

Këto fenomene globale përshkallëzohen në mënyra të ndryshme dhe kanë impakt në zhvillimin hapësinor edhe brenda kufijve territorialë të një vendi si Shqipëria ku të dhënat nga Census 2011, treguan se për herë të parë, popullsia që jeton në zonën urbane e tejkaloi numrin e popullsisë që jeton në zonën rurale përkatësisht me vlerat 53,5% : 46,5% (INSTAT, Censusi i Popullsisë dhe i Banesave, 2012, p. 10) . Nën dritën e këtij kompleksiteti, që ofron fenomeni në rritje i urbanizimit dhe pasojat e tij në cilësinë e jetës së individit dhe shoqërive ku ai jeton, lind nevoja të rimendojmë mënyrën se si ne projektojmë qytetet tona. Shkenca e planifikimit hapësinor kërkon t'i japë zgjidhje disa prej këtyre problemeve me impakt mjedisor duke risjellë në vëmendje një qasje më organike në leximin e territorit dhe efekteve të urbanizimit në të. Thirrja për teorinë e planifikimit për të zgjeruar informacionin në kuptimin dhe funksionimin e botës - duke kombinuar shkencat biologjike dhe ekologjike me ato shoqërore dhe ekonomike, në një perspektivë evolucionare, gjurmohet që nga Geddes, më shumë se 100 vjet më parë. Ai shprehet se 'një qytet është më shumë sesa një hapësirë në një vend, është një dramë e vendosur në kohë'. Madje në ekspozitën e tij në Ghent ai pohon se 'nuk paraqesim thjesht plane qytetesh, por qëllimi ynë është të përparojmë për ndërtimin e një 'shkence' për qytetet' (Geddes, 1913). Në këtë kuptim, roli i planifikuesit urban dhe planifikimit të territorit si shkencë vazhdon edhe sot të mbartë të njëjtin mision në udhëheqjen e zhvillimit urban.

Gjithashtu vërehet një 'rilindje e interesit për formën fizike të planifikimit dhe për të kuptuar se si mund të lidhet me proceset e zhvillimit dhe vendimmarrjes nuk ka ardhur nga vetë planifikimi, por nga një interes më i përgjithshëm për kompleksitetin që kohët e fundit ka përfshirë edhe shkencat shoqërore' (Geddes, 1913). Ndërsa kemi mësuar se si dendësia, përdorimi i energjisë, aksesueshmëria dhe lëvizshmëria kombinohen në mënyra të ndërlikuara për të prodhuar forma të ndryshme të qytetit, kërkimi për të lidhur fiziken me hapësinoren me jo-hapësinoren është bërë një sfidë gjithnjë e më e madhe. Në të vërtetë, zhvillimi i shoqërive urbane të qëndrueshme, të cilat kombinojnë këto elemente në mënyra të ndryshme i kanë dhënë shkas lindjes së "New Urbanism" që kërkon të përdorë njohuri nga morfologjia, planifikimi i transportit dhe ekuilibri ekologjik për të planifikuar komunitete të reja që janë të qëndrueshme dhe të rinovueshme së brendshmi (Talen, 2005). Sfida është të ndërtojmë një teori të re për qytetet dhe planifikimin e tyre si një e tërë.

Zhvillimi i konceptit të urbanistikës drejt planifikimit hapësinor si edhe qasjeve drejt koncepteve sistematike dhe organike të territorit janë përfshirë vitet e fundit edhe në instrumentat e planifikimit në Shqipëri. Përparimet e shënuara në transformimin e sistemit ligjor mbi planifikimin në vend, mbeten premtuese. Pasi kanë kaluar 10 vjet nga hapat e parë për modernizim, dhe europianizim të metodave të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, vihet re një përvetësim më i thelluar i tipareve të reja të planifikimit të integruar si nga ana e autoriteteve shtetërore ashtu edhe nga profesionistët. Hartimi i planeve kombëtare dhe lokale brenda një periudhe të ngushtë kohore (2014-2020), shënoi një moment të rrallë në prodhimtarinë e dokumenteve të planifikimit në vendin tonë.

Teza tregon se reformimi dhe zbatimi i instrumentave të reja të planifikimit në Shqipëri në dekadën e fundit, u arrit përmes faktorit të njëkohshmërisë së aplikimit të disa reformave të rëndësishme që ndikuan dhe u ndikuan nga njëra tjetra si:

- 1.Reforma administrative territoriale, e cila solli ndryshimin e kufijve territorialë të bashkive, duke rritur kompleksitetin e territorit për planifikimi dhe administrim nga ana e pushtetit vendor;
- 2.Reforma ligjore, që ndryshoi sistemin e planifikimit nga racional në hapësinor, duke prezantuar një seri instrumentash të reja për planifikimin dhe drejtimin e zhvillimit të territorit, si edhe
- 3.Hartimi i instrumentave të planifikimit në nivel qendror dhe vendore në të njëjeten kohë, duke zbatuar hierarkinë ligjore.

Fusha e planifikimit të territorit në Shqipëri në këtë mënyrë, shënoi hapa të rëndësishëm progresivë drejt zbatimit të metodave të reja, nën shembullin e politikave evropiane të planifikimit hapësinor. Planifikimi përmes qasjes së metabolizmit urban është një tipar novator në këtë drejtim, i prezantuar për herë të parë nga kuadri ligjor i planifikimit i rishikuar në 2014 dhe u zbatua nga planet kombëtare dhe lokale të hartuara në vitet në vijim.

Për të vendosur në kontekst ndryshimet e mësipërme, teza përshkruan në kapitullin III kontekstin historik të zhvillimit të konceptit të planifikimit të territorit Shqipëtar, përmes kuadrit të ri ligjor, reformave dhe instrumentave të reja të planifikimit të hartuar.

Dy janë dokumentet kryesore në fushën e planifikimit që erdhën si risi nën dritën e reformave të mësipërme: Hartimi i studimit ‘*The Metabolism of Albania*,’ dhe hartimi i Planit të Përgjithshëm Kombëtar ‘Shqipëria 2030’ si plani i parë kombëtar për zhvillimin e territorit. Edhe pse teza dëshmon se planifikimi kombëtar në vendin tonë mund të gurmohet që me formimin e Shtetit të parë modern Shqiptar, lindja e urbanistikës moderne dhe më pas e planifikimit hapësinor në Shqipëri, nuk është trajtuar ende gjerësisht si nga pikëpamja historike e formimit dhe as e ndikimeve dhe influencave përmbajtëse. Shtetformimi i vonë dhe ndryshueshmëria e modeleve qeverisëse politike, dhe për pasojë institucionalizimi jo i konsoliduar për një kohë të gjatë i vendit reflektuar në një zhvillim të dobët ekonomik dhe kaotik urban, janë nga motivet kryesore që kanë ndikuar në një qasje të vakët të planifikimit urban. Kapitulli 3, argumenton gjithashtu rëndësinë dhe tiparet kryesore të metabolizmit urban të Shqipërisë dhe ndikimit që ky studim pati në hartimin e planit kombëtar, duke treguar që në fillim një përpjekje për të lidhur aspektet e një profili urban kombëtar me një profil kombëtar metabolik, kriteri i cili do të frymëzojë edhe propozimin e kësaj teze për zhvillimin e një kornize më të detajuar për zbatimin e Metabolizmit Urban (shih kapitullin V).

6.1 Mbi Metabolizmin Urban

Që kur urbanistët filluan të përshkruanin dhe projektin qytetin, gjuha e trupit të njeriut u përdor gjerësisht për të përshkruar formën urbane dhe për të ndikuar metodat për planifikimin e qyteteve. Ndikime të tilla mund të shihen, që në vizatimet dhe shkrimet e Leonardo da Vinci-t, i cili bënte thirrje për ruajtjen e të njëjtave raporte si ato të trupit të njeriut në projektet e tij. Kevin Lynch propozon tre metafora kryesore të cilat mund të shpjegojnë formën e qytetit. Metafora e parë e lidhur me qendrat e qyteteve antike kërkon të vendosë një lidhje midis qytetit, kozmosit dhe mjedisit. Metafora e dytë përdor makinerinë si një analogji për qytetin. Ndërsa, metafora e tretë dhe më e rëndësishmja për qytetin e qëndrueshëm, është analogjia me një organizëm. Duke përdorur këtë metaforë qyteti shihet si i përbërë nga qeliza të cilat mund të rriten, të bien dhe të vdesin (Lynch, 1981). Në një deklaratë tipike të kësaj fryme, arkitekti Jose Luis Sert, një nga zëdhënësit kryesorë të Congrès Internationaux d'Architecture Moderne (CIAM) në 1942, shprehet se: 'Qytetet [janë] organizma të gjallë; [ata] kanë lindur dhe [...] zhvillohen, shpërbëhen dhe vdesin [...]. Në kuptimin e tij akademik dhe tradicional, planifikimi i qytetit është i vjetëruar. Atë duhet ta zëvendësojë biologjia urbane' (Batty, M. & Marshall, S., 2009). Në këtë drejtim, teza paraqet një kornizë teorike të detajuar mbi konceptin e Metabolizmit Urban duke u nisur nga perspektiva e vendeve perëndimore, duke ndjekur kronologjinë historike të lindjes dhe zhvillimit të konceptit. Megjithë zhvillimin e hershëm në kohë dhe aplikimin e gjerë, zbatimi praktik i konceptit të metabolizmit urban në zhvillimin hapësinor dëshmon se mbetet i kufizuar.

Teza vendos një barazim midis zbatimit të Metabolizmit Urban në planifikim dhe objektivit për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke e argumentuar si nga ana teorike e origjinës të koncepteve dhe deri tek instrumentat për zbatimin e tyre. Edhe pse studimet komplekse që janë kryer deri më sot janë të kufizuara dhe eksperimentale ato vërtetojnë se qasja metabolike përbën një mjet me vlerë në analizën hapësinore dhe planifikimit të territorit.

Teza analizon në detaje zbatimin e metabolizmit në Shqipëri, në planet e nivelit kombëtar si Shqipëria 2030 dhe disa plane të përgjithshme vendore për bashkitë e vendit. (shih Kapitulli IV) Vëzhgimi dëshmon se dokumentat e planeve vendore të hartuara në vitet 2014-2020 në Shqipëri qëndrojnë realiste në panoramën e kufizuar që mund të paraqesin për zbatimin e analizës metabolike brenda territorit të një bashkie në studim. Teza identifikon disa mangësi kryesore të këtyre dokumentave si më poshtë:

- Mungesën e të dhënave të detajuara në nivel vendor për kryerjen e analizës;
- Mungesën e studimeve komplementare mbi strukturën urbane të qytetit, si edhe të shumë parametrave vendimtare bashkeveprues, që e bëjnë akoma më të vështirë zbatimin.
- Kufizim i rëndësishëm në cilësinë e analizës metabolike lind edhe nga paqartësia e definimit të sistemit urban në territor dhe i strukturës së tij. Përcaktimi cilësor dhe sasior i marrdhënieve të shkëmbimit midis sistemit urban dhe sistemeve të tjera brenda territorit administrative si ai ujor, natyror, infrastrukturor dhe bujqësor.
- Shembujt e zbatimit të metabolizmit urban në rastin e planeve vendore në Shqipëri, lidhen pak ose aspak me aspektet e shakllës së urbanizimit gjë që ka penalizuar efikasitetin e kësaj përjasjeje në aplikimin praktik duke e lënë të përgjithshme dhe teorike. Kërkimi propozon se për identifikuar metabolizmin e territorit që studjojmë, njohja e formës urbane dhe identifikimi i karakteristikave të saj që ndikojnë në

metabolizmin e territorit është shumë e rëndësishme për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

- Në pjesën më të madhe të bashkive evidentohet lineariteti i flukseve metabolike dhe jo cirkular duke dëshmuar se jemi akoma larg zbatimit të metodave të planifikimit që sigurojnë zhvillimin e qëndrueshëm;
- Meqenëse pjesa më e madhe e të dhënave statistikore, të nevojshme për matjen e flukseve të materialeve janë në nivel qarku ose rrethi, vlerësohet se reduktimi i madhësive nga nivele të afërta me bashkinë e marrë në studim çon në konkluzione të dobëta dhe/ose të gabuara.
- Një nga përfundimet më të rëndësishme, lidhet me gjetjen se edhe pse disa nga dokumentat e planeve vendore hartojnë Analizën metabolike, nuk konkludojnë me gjetje të cilat të influencojnë instrumentat e zbatimit të planeve si : harta e përdorimit të propozuar të tokës dhe treguesit e zhvillimit të propozuar. Me gjithë përparimet konceptuale të ligjit për përmbajtjen e dokumentave të planifikimit dhe detyrimit për hartimin e AM, zbatimi i planeve territoriale vendore reduktohet vetëm në këto dy instrumenta të ngurtë zhvillimi.
- Vlerësimi i planeve lokale tregon nevojën për të hartuar një metodë të strukturuar për përgatitjen e Analizës Metabolike në mënyrë që zbatimi i saj të jetë i vërtetë ndaj kontekstit, t'i shërbejë qëllimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të prodhojë rezultate të matshme, të krahasueshme me procesin e planifikimit të progresit.

Teza argumenton se tre janë drejtime kryesore ku duhet punuar më tepër për të përmirësuar rezultatet e mësipërme:

- Së pari, puna e vazhdueshme për të detajuar metodologjinë e analizës metabolike nga pikëpamja ligjore përmes përparimeve të ndryshme si në praktikën profesionale ashtu edhe në ato akademike. Qasja ndaj planifikimit përmes Metabolizmit Urban, krijon mundësi të reja për një zgjidhje të integruar të problematikave sociale, ekonomike dhe mjedisore që lidhen me zhvillimet në territor.
- Së dyti, nevoja për mbledhjen e të dhënave statistikore në funksion të procesit të planifikimit. Në këtë drejtim, puna e bërë nga institutet statistikore dhe autoritetet e planifikimit të territorit, në nivelin kombëtar dhe lokal duhet të koordinohet. Unifikimi i njësive statistikore me njësinë më të vogël të hapësirës së planifikuar, me qëllim mbledhjen dhe përlllogaritjen e të dhënave statistikore është një mundësi e mirë në këtë drejtim.
- Së treti, nevojiten procese vlerësimi për cilësinë e hartimit dhe zbatimit të instrumentave të planifikimit përmes indikatorëve të monitorimit, si një proces thelbësor për përparimin e planifikimit si shkencë e territorit.

Zbatimi i metabolizmit urban në rastin e Shqipërisë, si në Planin e Përgjithshëm Kombëtar edhe në Planet e Përgjithshme Vendore, demonstroi nivelin e paplotësisë që lidhet me zbatimin aktual të analizës metabolike dhe të përfshirjes së saj në propozimet dhe instrumentat për zbatimin e këtyre planeve . Në fakt, metodologjia aktuale nuk arrin të sigurojë një pamje të plotë të profilit metabolik për territoret në studim duke rezultuar formale në zbatimin e saj dhe e shkëputur nga ndikimi i profilit urban. Për të kapërcyer këtë kufizim, zbatimi i kornizës së propozuar kërkon disponimin e shumë të dhënave, të marra përmes një procesi kërkimi që kërkon kohë. Sidoqoftë, është një proces që duhet ndërmarrë nëse duam të rrisim besueshmërinë e instrumentave të planifikimit të territorit dhe zbatimin e tyre në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Për të kapërcyer boshllëqet e ndeshura në zbatimin e qasjes metabolike në instrumentat e planifikimit në Shqipëri, kjo tezë zhvillon një kornizë gjithëpërfshirëse të aplikimit të metabolizmit urban duke marrë parasysh metodologjitë e ndryshme të llogaritjeve kombëtare të burimeve të materialeve dhe energjisë, flukset metabolike, shkallën hapësinore dhe instrumentat e planifikimit sipas kuadrit ligjor në fuqi . Objektivi kryesor i kësaj kornize ishte të zhvillonte një qasje për të kuptuar më mirë marrëdhëniet komplekse midis profileve urbane dhe metabolike. Për ta bërë këtë, kjo kornizë propozon disa indikatorë të nevojshëm për ndërtimin e profileve urbane dhe metabolike të territoreve në studim dhe hapat për realizimin e saj. Gjithashtu, argumentohet se ka një lidhje të drejtpërdrejt midis karakteristikave që përcaktojnë profilin urban me metabolizmin e territorit që studiohet. Impakti i konfigurimit urban përcaktuar nga dendësia e strukturave, stokut të ndërtesave të përcaktuar sipas cilësive hapësinore dhe cilësore si dhe diversitetit urban sipas modeleve :monocentrik, policentrik fashat urban dhe i përbërë ndikon në performancën metabolike të qytetit.

Vështirësia për të zbatuar plotësisht kornizën e propozuara në raste të ndryshme studimi, çon në pikëpyetje nëse e ardhmja e planifikimit urban qëndron në zhvillimin e mjeteve më të standardizuara, që janë më të lehta për t'u përdorur dhe që sigurojnë përgjigje të drejtpërdrejta për palët e interesit, apo do të vazhdojë t'i qaset funksionimit kompleks të qyteteve në mënyrë asimptomatike? Ndërsa, përgjigja për këtë pyetje duhet t'u lihet të gjitha palëve të përfshira në procesin e zhvillimeve urbane, metodologjitë e ardhshme të planifikimit të territorit duhet të përpiqen të kapërcejnë këto dilemma në mënyrë që të formulojnë mësimet holistike nga marrëdhëniet midis profileve urbane dhe metabolike. Njohuritë nga këto gjetje mund të drejtojnë tranzicionin ekzistues të qyteteve Shqipëtare drejt një të ardhmeje më të sukseshme dhe të qëndrueshme, që përdor burimet në mënyrë eficiente, i mbron nga ezaurimi dhe siguron ripërtëritjen e tyre.

6.2 Kërkime të mëtejshme

Ndonëse ky punim paraqet një kornizë gjithëpërfshirëse që investigon dhe ndërlikohet marrëdhëniet komplekse midis instrumentave të planifikimit hapësinor, profilit urban të një sistemi në studim dhe analizës metabolike të tij, në mënyrë sa më sistematike dhe shkencore, mbetet ende një numër i gjerë metodash për ta pasuruar këtë kornizë.

Në fakt, një pjesë e madhe e profilizimit urban dhe metabolik, sipas niveleve të ndryshme territoriale ende mungon dhe pasurimi i setit të indikatorëve që njihojnë në ndërtimin e këtyre profileve mund të jetë i larmishëm dhe investigimi i tyre mund të sjellë njohuri të vlefshme për planifikimin e territorit.

Një përdorim i vlefshëm i kornizës aktuale mund të jetë matja e flukseve metabolike në nivelin e rajoneve të zhvillimit në mënyrë që të lidhen karakteristikat urbane me efektet mjedisore por gjithashtu për të ndihmuar në politikën e zhvillimit rajonal.

Ky kërkim mund të zbatohet në pasurimin e planeve territoriale kombëtar, sektoriale dhe vendore. Zgjerimi i rasteve të aplikuara do të kontribuonte në një kuptim më të gjerë se cilët janë nxitësit metabolikë për qytete dhe rajonet e vendit tonë dhe se si qëndrojmë në raport me treguesit e zhvillimit afatgjatë. Për të arritur këtë sidoqoftë, nevojiten më shumë të dhëna të hapura, në shkallë të ndryshme hapësinore dhe intervale kohore, që do të thotë se administratat urbane duhet të rrisin cilësinë e bazës së të dhënave dhe ti bëjnë ato më transparente dhe të arritshme për publikun e studiuesit.

Së fundmi, për të avancuar më tej në fushën e planifikimit hapësinor dhe kornizën e

metabolizmit urban, institucionet lokale dhe kombëtarë në fushën e planifikimit urban, të statistikave dhe institucionet akademike, si edhe bashkëpunimet ndërkombëtarë, janë të domosdoshme për të siguruar që kjo kornizë të pajiset me të dhënat e nevojshme, të strukturohet në përputhje me instrumentat e planifikimit që sigurojnë zbatimin e saj si edhe të integrohet në procesin e informimit që paraprin vendimarrjet politike e zhvillimeve strategjike. Në nivel kombëtar, këto institucione mund të nxisin hartimin e standarteve kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm duke ndihmuar në krijimin e një databaze me të dhëna të krahasueshme urbane dhe metabolike në shkallë të ndryshme hapësinore, që marrin parasysh rëndësinë e kontekstit të shprehur përmes profileve metabolike dhe urbane.

Procesi i vlerësimit për flukset metabolike kombëtare dhe studimi i marrdhënies dhe ndërveprimit të tyre me profilin metabolik të rajonit Ballkanik, por edhe dhe më gjerë, do të ishte hapi tjetër për formulimin e politikave të zhvillimit hapësinor të integruara me rajonin.

Përmbledhje

Gjatë dekadës së fundit, në Shqipëri janë realizuar disa reforma me ndikim në fushën e rregullimit të territorit, që shndërroan mënyrën e planifikimit të qyteteve nga një qasje tradicionale e urbanistikës, në një përafrim më kompleks, përmes planifikimit hapësinor. Megjithatë, ende nuk ka një studim i cili analizon dhe evidenton elementët novatorë që solli kjo panoramë në planet e reja. Fokusi i temës është Metabolizmi urban si një përafrim që mundëson një zgjidhje të integruar midis makro temave të rëndësishme si: urbanizimi – zhvillimi i qëndrueshëm dhe planifikimi hapësinor. ‘Metabolizmi Urban’ përdoret për të eksploruar lidhjen midis flukseve të burimeve natyrore, morfologjisë urbane dhe karakteristikave socio-ekonomike të qyteteve bazuar në analogjinë me metabolizmin e organizmave të gjallë. Si ka ndikuar kjo qasje në cilësinë e planeve të reja territoriale të hartuara në vendin tonë dekadën e fundit dhe si është zbatuar? Ky kërkim, ofron kontekstin teorik për kuptimin e konceptit të metabolizmit në planifikim, tregon ndikimin e tij në instrumentat e planifikimit të hartuar në Shqipëtri dekadën e fundit dhe propozon një metodologji për strukturimin e tij në përputhje me kontekstin.

Premtimi që na shtron përpara Metabolizmi Urban është reduktimi i shkëputjes mes natyrës dhe njeriut përmes një kuptimi të ri, më organik të marrëdhënieve midis tyre, zbatimi i tij mund të sjellë rritjen e cilësisë së planeve dhe të performancës së vetë qyteteve të planifikuara nën këtë qasje.

Gjatë dekadës së fundit, në Shqipëri janë realizuar disa reforma me ndikim në fushën e rregullimit të territorit, që shndërroan mënyrën e planifikimit të qyteteve nga një qasje tradicionale e urbanistikës, në një përafrim më kompleks, përmes planifikimit hapësinor. Megjithatë, ende nuk ka një studim i cili analizon dhe evidenton elementët novatorë që solli kjo panoramë në planet e reja që u hartuan në këto vite. Hartimi i planeve të reja kombëtare dhe vendore trajtohen kryesisht nën prizmin e lejeve të ndërtimit që mundësojnë apo mohojnë, përmes hartave të përdorimit të tokës dhe treguesve të zhvillimit, mundësinë për ndërtim, duke anashkaluar një këndvështrim më të gjerë, të modelit të zhvillimit që ofrojnë për jetën urbane dhe raportin e saj me natyrën përreth dhe zhvillimin shoqëror.

‘Metabolizmi Urban’ është një kornizë e re përmes së cilës mund të kuptojmë urbanizimin dhe pasojat e tij. Përdoret për të eksploruar lidhjen midis flukseve të burimeve natyrore, morfologjisë urbane dhe karakteristikave socio-ekonomike të qyteteve bazuar në analogjinë me metabolizmin e organizmave të gjallë. Si ka ndikuar kjo qasje në cilësinë e planeve të reja territoriale të hartuara në vendin tonë dekadën e fundit dhe si është zbatuar? Meqenëse Metabolizmi Urban ofron baza të reja për zhvillimin e mëtejshëm të planifikimit të territorit në vendin tonë dhe nxit hartimin e politikave për zhvillim të qëndrueshëm pritet që zbatimi i tij mund të sjellë rritjen e cilësisë së planeve dhe të performancës së vetë qyteteve të planifikuara nën këtë qasje. Kjo qasje, synon të konkretizojë përpjekjet për një zgjidhje holistike dhe ideale në fushën e urbanistikës, të shfaqura që në fillimet e saj si shkencë dhe art i projektimit të qyteteve. Rreziqet e ndikimit të rritjes së shpejtë të urbanizimit mbi ndryshimet klimatike dhe efekti i tyre në jetën e njerëzve dhe ekosistemit ku jetojmë, ka rritur presionin për ngritjen e agjendave më agresive për zhvillim të qëndrueshëm dhe ka risjellë atraksionin për përdorimin gjithmonë e më të madh të një përqsajeje më holistike. Premtimi që na shtron përpara Metabolizmi Urban është reduktimi i shkëputjes mes natyrës dhe njeriut përmes një kuptimi të ri, më organik të marrëdhënieve midis tyre.

Deri më tani duket se shkenca të ndryshme janë zhvilluar brenda këtij koncepti, pa eksploruar potencialin për integrimin ndërmjet tyre. Roli i planifikuesit urban është themelor për përfshirjen e mëtejshme dhe të qenësishme të metabolizmit në zhvillimin e qëndrueshëm të qyteteve dhe për këtë arsye është vendimtare njohja e konceptit të metabolizmit dhe zbrërthimi i tij në kontekstin e zhvillimit hapësinor. Theksi vendoset në jetën urbane cirkulare, natyrën sistemike të qyteteve dhe kombinimi dinamik të flukseve të materialeve në të kuptuarin dhe adresimin e problemeve urgjente (Savini, F., Verschuuren, S., Salet, W., & Raats, K., 2015). Në këtë kontekst, ky studim tenton të avancojë në ndërtimin e trupit teorik që do të ndihmojë disiplinën e planifikimit të territorit, në avancimin nga një praktikë administrative, në një shkencë komplekse për zhvillimin e territorit. Punimi bazohet në kërkimin teorik të literaturës bashkëkohore vendase dhe të huaj, në vëzhgimin analitik dhe metodën krahasuese të aplikimeve praktike. Autori duke qenë kontribues dhe pjesëmarrës në proceset e reformimit të kuadrit të ri ligjor të planifikimit në Shqipëri, nga viti 2009 e në vazhdim si edhe kontribuese e drejtpërdrejtë në disa praktika të implementimit të tij si: në hartimin e dokumentit “Metabolizmi i Shqipërisë”, Plani i Përgjithshëm Kombëtar “Shqipëria 2030”, koordinimi dhe monitorimi i procesit për hartimin e planeve të përgjithshme vendore në nivel bashkie, si dhe në zhvillimin e praktikave administrative që pasuan si: monitorimi dhe zbatimi i planeve territoriale përmes ‘Platforma e Monitorimit’¹⁴ dhe kërkimet mbi përcaktimin e një metode për unifikimin e përcaktimeve të ‘Urban Rurales’¹⁵, reflekton dhe argumenton nga pikëpamja akademike këtë eksperiencë. Një ndër makro temat e tezës është Planifikimit Hapësinor, si stad i ri i evolimit të shkencës urbane në vendin tonë, sfidat dhe mundësitë që paraqiten në implementimin e suksesshëm të tij. Fokusi i kërkimit është ndikimi i zbatimit të Analizës Metabolike të Territorit në dokumentat e planifikimit në nivel kombëtar dhe vendor të cilat hartohen, në zbatim të kuadrit të ri ligjor në Shqipëri 2009-2020. Arritja e objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm si paradigmë e planifikimit cilësor territorial/hapësinor është nëntema e dytë, e cila përbën dhe sfondin ku zhvillohet qasja e Metabolizmit Urban. Në këtë kontekst, teza eksperimenton dhe propozon një marrëdhënie të re që vizualizon lidhjen më komplekse që ekziston midis territorit, planifikimit dhe qeverisjes për një zhvillim të qëndrueshëm.

Edhe pse hartimi i njëkohshëm i planeve kombëtare dhe lokale, zbatimi i disa reformave të tilla si reformat administrative dhe institucionale për planifikimin e territorit, shënuan një moment të rrallë në prodhimin e planeve hapësinore në një kohë kaq të shkurtër në Shqipëri, kërkimi shkencor i metodave të reja dhe vlerësimi teknik i zbatimit të tyre ka munguar deri tani. Teza evidenton risitë e aplikimit të Analizës Metabolike (AM) në planet e hartuara rishtazi, por njëkohësisht edhe mangësitë dhe limitet e tyre. Pas

¹⁴ Shënim i autorit: Platforma e Monitorimit, bazohet në kapitullin e fundit të PPK ‘Shqipëria 2030’, si hapi tjetër i nevojshëm që duhet përbushur me qëllim zbatimin dhe monitorimin e PPK por jo vetëm. Ky kërkim është një produkt ende i papublikuar i hartuar nga grupi i punës së Drejtorinë e Planifikimit Kombëtar AKPT, ku autori ka kontribuar duke konceptuar dhe udhëhequr procesin. Platforma konsiston në selektimin e një seti Indikatorësh, mbledhja e të dhënave dhe matja e të cilëve në mënyrë periodike do të mund të tregojë shkallën e zbatimit të planeve territoriale.

¹⁵ Shënim i autorit: Përkufizimi Urban-Rurale në vendin tonë, aktualisht realizohet nga INSTAT duke ndjekur metodologjinë statistikore të miratuar nga OECD. Në këtë studim, ende i papublikuar, i hartuar nga grupi i punës së Drejtorinë e Planifikimit Kombëtar AKPT, ku autori ka kontribuar duke dizenuar dhe udhëhequr procesin argumentohet se metoda statistikore paraqet mungesa të theksuara në identifikimin real të Urban-Rurales në vendin tonë, dhe se një përqasje me karakter hapësinor, që të reflektojë shkallën dhe ndarjen dhe marrëdhëniet reale të këtij fenomeni, duhet ndërmarrë.

diskutimit të elementëve përbërës kryesorë të zbatimit, e gjithë teza ofron një propozim për rishikim e metodës së Analizës Metabolike të integruar në dokumentat e planifikimit në nivel kombëtar dhe vendor të vendit tonë. Bazuar në këtë pasqyrë mbi kërkimin dhe praktikën, përshkruhen një numër parimesh për vlerësimin e metabolizmit urban. Rekomandime për përfshirjen e metodave të reja të bazuara në kërkime komplekse për ngritjen e planifikimit nga një praktikë administrative në një shkencë komplekse të territorit.

Abstract

During the last decade, in Albania, several influential reforms have been implemented in the field of territorial regulation, which transformed the way of planning cities from a traditional approach of urbanism to spatial planning. However, there is still no study which analyzes and identifies the innovative elements that this panorama brought to the new plans. The focus of the thesis is Urban Metabolism as an approach that enables an integrated solution between important macro topics such as: urbanization - sustainable development and spatial planning. 'Urban Metabolism' is used to explore the relationship between natural resource flows, urban morphology and socio-economic characteristics of cities based on the analogy with the metabolism of living organisms. How has this approach affected the quality of the new territorial plans drafted in our country in the last decade and how has it been implemented? This research provides the theoretical context for understanding the urban metabolism concept, demonstrates its impact on planning instruments developed in Albania over the last decade, and proposes a methodology for structuring it in accordance with the planning context.

The promise that Urban Metabolism gives us is to reduce the disconnection between nature and man through a new, more organic understanding of the relationship between them, its implementation can increase the quality of the plans and the performance of the cities planned under this approach.

Aneksi 1 – Lista e Bashkive në Studim

	Bashkia	Miratimi i planit	Rishikimi	Burimi, materiali i plotë
1.	Gjirokastrë	Vendim nr.1 KKT dt 08.02.2017	-	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=737
2.	Skrapar	Vendim nr.2 KKT dt 08.02.2017	-	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=754
3.	Ura Vajgurore	Vendim nr.3 KKT dt 08.02.2017	-	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=756
4.	Poliçan	Vendim nr.4 KKT dt 08.02.2017	-	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=748
5.	Lezhë	Vendim nr.6 KKT dt 16.10.2017	Vendim nr.8 KKT dt 14.10.2020	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=745
6.	Kurbin	Vendim nr.6 KKT dt 08.02.2017	-	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=744
7.	Krujë	Vendim nr.5 KKT dt 08.02.2017	-	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=742
8.	Elbasan	Vendim nr.1 KKT dt 29.12.2016	Në proces	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=760
9.	Berat	Vendim nr.3 KKT dt 29.12.2016		http://planifikimi.gov.al/index.php?id=759
10.	Fier	Vendim nr.5 KKT dt 29.12.2016	Vendimi nr.1 KKT dt.26.01.2021	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=761
11.	Lushnje	Vendim nr.4 KKT dt 29.12.2016	Vendim nr.2 KKT dt 13.01.2020	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=763
12.	Kuçovë	Vendim nr.2 KKT dt 29.12.2016	-	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=762
13.	Vlorë	Vendim nr.1 KKT dt 16.10.2017	Vendim nr.4 KKT dt 17.05.2019	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=757
14.	Himarë	Vendim nr.2 KKT dt 16.10.2017	Vendim nr.5 KKT dt 10.06.2020	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=738
15.	Sarandë	Vendim nr.3 KKT dt 16.10.2017	-	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=751
16.	Konispol	Vendim nr.4 KKT dt 16.10.2017	-	http://planifikimi.gov.al/index.php?id=740

Aneksi 2 – Të dhënat për diagramën Chord

Tabelat e Burim, Përdorimeve në Shqipëri, 2015, Burimi: (INSTAT, Metodologjia, të dhënat Ekonomike Mjedisore, 2020)

Tabela e përshkrimeve të kodeve, Burimi: INSTAT (Instat, 2011)

Përshkrimi	KODI
Produkte bujqësore, pyjore dhe të peshkimit	A01-03
Produkte të industrisë nxjerrëse	B
Produkte ushqimore, pije dhe produkte duhani	C10-C12
Tekstile, veshje dhe produkte prej lëkure	C13-C15
Produkte prej druri dhe letre dhe shërbime printimi	C16-C18
Produkte koksi dhe të rafinimit të naftës	C19
Produkte kimike, produkte farmaceutike dhe preparate farmaceutike	C20-C21
Produkte prej gome dhe plastike, dhe produkte të tjera minerale jo metalike	C22-C23
Produkte me bazë metalike, përveç makinerive dhe pajisjeve	C24-C25
Produkte elektronike dhe optike, pajisje elektrike dhe makineri dhe pajisje të paklasifikuara diku tjetër dhe mjete transporti	C26-C30
Mobilie, produkte të tjera, shërbime riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	C31-C33
Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar	D35
Shërbime të prodhimit dhe furnizimit me ujë	E36
Shërbime të kanalizimeve, trajtimit dhe menaxhimit të mbetjeve	E37-E39
Shërbime të ndërtimit dhe punëve në ndërtim	F
Shërbime të tregtisë me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	G45
Shërbime të tregëtisë me shumicë, përveç shërbimeve të tregëtisë të automjeteve dhe motoçikletave	G46
Shërbime të tregëtisë me pakicë, përveç shërbimeve të tregëtisë së automjeteve dhe motoçikletave	G47
Shërbime të transportit tokësor dhe me tubacione	H49
Shërbime të transportit ujor, ajror dhe magazinimit	H50-H52
Shërbime postare	H53
Shërbime të akomodimit dhe ushqimit	I
Shërbime publikimi, audovizive dhe transmetimi	J58-J60
Shërbime telekomunikacioni	J61
Shërbime të teknologjisë së informacionit , konsulencë informatike dhe shërbime informacioni	J62_J63
Shërbime financiare dhe të sigurimit	K64-K66
Shërbime të pasurive të paluajtshme	L68
Shërbime ligjore dhe kontabiliteti, shërbime konsulence në fushën e menaxhimit; shërbime në fushën e arkitekturës dhe Inxh.	M69_M71
Shërbime kërkim-zhvillimi shkencor dhe shërbime të tjera profesionale dhe teknike	M72-M75
Shërbime administrative dhe mbështetëse	N77-N82
Shërbime të administrimit publik dhe mbrojtja, shërbime të sigurimit shoqëror të detyrueshëm	O84
Shërbime arsimit	P85
Shërbime shëndetësore	Q86-Q88
Shërbime artistike, argëtuese dhe çlodhëse	R90-R93
Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale	94-98

7 BIBLIOGRAFIA

8

- ADB, A. D. (2014). *Urban Metabolism of Six Asian Cities*. Filippine: ASIAN DEVELOPMENT BANK.
- Aiken, Michael., Newton, Kenneth., Friedland, Roger & Martinotti, Guido. (1987). Urban Systems Theory and Urban Policy: A Four-Nation Comparison . *British Journal of Political Science*, 17(3), 341-358.
- Aliaj, B. (2003). Albania, a short history of housing and urban development Models during 1945-1999. *International Conference of ENHR the European Housing network research, Making Cities Work!* (f. 25). Tirana: ENHR.
- Allmendinger, P. (2009). *Planning theory*. Londër: Palgrave Macmillan.
- Alterman, R. (2001). *National-Level Planning in Democratic Countries*. Liverpool: Liverpool University.
- AZHT. (2014, 12 29). Shpjeguese për Vendimin, Nr.5, Datë 29.12.2014. Tirane, Albania. Gjetur në http://www.azht.gov.al/files/news_files/SHPJEGUESE_Vendimi_nr.5_29.12.2014.pdf
- Barles, S. (2009). Urban Metabolism of Paris and Its Region. *Journal of Industrial Ecology*, 13 (6), 898- 913.
- Batty, M. & Marshall, S. (2009). The evolution of cities: Geddes, Abercrombie and the new physicalism. 80(6).
- Bertalanffy, L. (1972). The History and status of general systems theory. *Academy of Management Journal*, 407-426.
- Bertalanffy, L. v. (1951). General system theory; a new approach to unity of science. *Hum Biol.*, 23(4), 302-312.
- Bertalanffy, L. v. (1968). *General System theory, Foundation, Development, Applications*. New York: GEORGE BRAZILLER.
- Böhme, K., Zillmer, S., Toptsidou, M. & Holstein, F. (2015). *Territorial governance and cohesion policy*. DIRECTORATE-GENERAL FOR INTERNAL POLICIES, POLICY DEPARTMENT B: STRUCTURAL AND COHESION POLICIES. Bruksel: European Union. Gjetur në <http://www.europarl.europa.eu/studies>
- Brugmans G., Francke M., Persyn F. (ed). (2015). *Metabolism of Albania*. Rotterdam: iabr/UP.
- Brugmans,G., Strein J., (ed). (2014). *Urban by Nature*. Rotterdam: IABR.
- Brunner, P. H. (2007). Reshaping Urban Metabolism. *Journal of Industrial Ecology, Vëll. 11(2)*, 11-13 fq. 11-13. fq.11.
- Byrne, D. (2003). Complexity Theory and Planning Theory: A necessary encounter . *Planning Theory*, 171-178.
- Caputo, Paola., Pasetti, Giulia. & Bonomi, Marco. (2016). Urban metabolism analysis as support to drive metropolitan development. *Procedia Engineering*(161), 1588 – 1595.
- Castan Broto, V., Allen, A., Rapoport, E. (2012). Interdisciplinary Perspectives on Urban Metabolism. *Journal of Industrial Ecology*, 16(6), 851-861. doi:10.1111/j.1530-9290.2012.00556.x
- Caves, R. W. (2004). *Encyclopedia of the City*. Londër: Routledge.

- Civici, A. (2012). 100 vjet: Ekonomia shqiptare gjatë regjimit komunist (1945-1990). *Monitor*. Gjetur në <https://www.monitor.al/100-vjet-ekonomia-shqiptare-gjate-regjimit-komunist-1945-1990/>
- Commission, E. (1997). *The EU compendium of spatial planning systems*. Italy: European Communities.
- Davoudi, S. & Cowie, P. (2016). Guiding principles of 'good' territorial governance. Në P. & Schmitt, *Territorial governance across Europe – pathways, practices and prospects*. Londër: Routledge.
- Decker, E. H., Elliott, S., Smith, F. A., Blake, D. R., & Rowland, F. S. (2000). Energy and material flow through the urban ecosystem. *Annual Review of Energy and the Environment*, 25, 685-740.
- Dijst, M. et al. (2018). Exploring urban metabolism—Towards an interdisciplinary perspective. *Resources, Conservation and Recycling*, 132, 190-203.
- Dinares, M. (2014). Urban Metabolism: A review of recent literature on the subject. *Documents d'Anàlisi Geogràfica*, 60(3), 551-571.
- Dincer, I. & Bicer, Y. (2019). *Enhanced dimensions of integrated energy systems for environment and sustainability, Integrated Energy Systems for Multigeneration*. Elsevier Science. doi:<https://doi.org/10.1016/C2015-0-06233-5>
- Dougall, G. (1973). The systems approach to planning: A critique. *Socio-Economic Planning Science*, 79-90.
- EC, Committee on Spatial Development. (1999). *European Spatial Development Perspective*. Potsdam: European Commission.
- Ecores sprl, I. B. (2015). *Metabolisme urbain de la region Bruxelles –Capitale*. Bruxelles.
- EEA. (2009). *Ensuring quality of life in Europe's cities and towns*. Luxembourg: European Communities.
- Elezi, I. (2017). Trashëgimia kulturore juridike e shtetit të pavarur kombëtar shqiptar . *Analizë e botuar në kuadrin e 100 -vjetorit të Pavarësisë Kombëtare*.
- Elezi, M. (2006). *Fjalor i Gjuhës Shqipe*. Tiranë: Enti Botues Poligrafik "Gjergj Fishta".
- Faludi, A. (1973). The "systems view" and planning theory. *Soci-Economic, Planning Sciences*, 7(1), 67-77.
- Faraud, C. (2017). *Urban metabolism in practice - The difficult implementation of closing the loop approaches, through the water and food cycles in cities*. Londër: Development Planning Unit, The Bartlett | University College.
- Farooqui, T.A., Renouf, M.A., Kenway, S.J. . (2016). A metabolism perspective on alternative urban water servicing options using water mass balance. *Water Research*.
- Ferrao, P. & Nhambiu, J. (2009). A comparison between conventional LCA and hybrid EIO-LCA: analysing crystal giftware contribution to global warming potential. Në S. (. Suh, *Handbook of input-output economics in industrial ecology*. Londër, New York: Springer.
- Ferrero, G. (1923). L'opera degli soldati Italiani in Albani, durante la guerra. Në K. Miho, *Shqipëria vështrim urbanistik* (f. 21). Napoli.
- Foster, J. B. (2000). *Marx's Ecology Materialism and Nature*. New York: Monthly Review Press.

- Foster, J. B. (2013). Marx and the Rift in the Universal Metabolism of Nature. *Monthly Review*, 65(7). Gjetur në <https://monthlyreview.org/2013/12/01/marx-rift-universal-metabolism-nature/>
- Gallard, D. (2012). Understanding the Reorientations and Roles of Spatial Planning: The Case of National Planning Policy in Denmark. *European Planning Studies*, 20(8), 1364.
- Geddes, P. (1913). Two steps in civics: cities and town planning exhibition and the international congress of cities. *Town Planning Review*, 4, 78–94.
- Giezen, M., & Roemers, G. (2015). The metabolic planner: reflection on urban planning from the perspective of urban metabolism. Në S. Savini, S. Verschuuren, W. Salet, & K. Raats, *Urban Metabolism* (fv. 14-27). Amsterdam: University - Giezen.
- Gjirokastër, B. (PPV Bashkia Gjirokastër). *Plani i Përgjithshëm Vendor*. Tiranë: AKPT, Bashkia Gjirokastër.
- Graham, H., Allmendinger, P. & Vigar, G. (2010). *The new spatial planning – territorial management with soft spaces and fuzzy boundaries*. Londër: Routledge.
- Hall, E. T. (1982). *The Hidden Dimension (orig. The Garden City)*. New York: Random House Inc.
- Haughton, G., Allmendinger, P, Counsell, D. & Vigar, G. (2010). *The new spatial planning – territorial management with soft spaces and fuzzy boundaries*. Londër: Routledge.
- Herrschel, T. & P. Newman. (2002). *Governance of Europe`s City Regions: planning, Policy and Politics*. New York: Routledge.
- Heynen, N., Kaika, M. & Swyngedouw, E. (2006). *In the Nature of Cities Urban political ecology and the politics of urban metabolism*. Londër: Routledge.
- Holmes, T. & Pincetl, S. (2012). *Urban Metabolism Literature Review*. Center for Sustainable Urban Systems: UCLA. fq. 2. . UCLA.
- IABR, FABRIC, JCFO,TNO. (2014). *Urban metabolism, sustainable development of Rotterdam*. Rotterdam: IABR.
- INSTAT. (2011). *Instat*. Gjetur në [.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al): http://www.instat.gov.al/media/1786/tbp_2009-2011.pdf
- INSTAT. (2012). *Censusi i Popullsisë dhe i Banesave*. Tiranë: INSTAT. Gjetur në http://www.instat.gov.al/media/3058/main_results__population_and_housing_census_2011.pdf
- INSTAT. (2014). *Lëvizjet vajtje-ardhje për qëllime punësimi*. Tiranë: Instat.
- INSTAT. (2014). *Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare*. Tiranë: Instat.
- INSTAT. (2014). *Tipologjia e komunave dhe bashkive*. Tiranë: Instat.
- INSTAT. (2020). *Metodologjia, të dhënat Ekonomike Mjedisore*. Tiranë: Instat. Gjetur në <http://www.instat.gov.al/al/temat/mjedisi-dhe-energji/llogarit%C3%AB-ekonomike-t%C3%AB-mjedisit/#tab4>
- Ioppolo, G., Heijungs, R., Cucurachi, S., Salomone, R., & Kleijn, R. (2014). Urban Metabolism: Many Open Questions for Future Answers. Në R. & Salomone, *Pathways to Environmental Sustainability* (fv. 23-32). Londër: Springer.
- Japan, M. o. (2020, Nëntor 20). *env.go.jp*. Gjetur në 3R Initiative: <http://www.env.go.jp/recycle/3r/initiative/en/index.html>
- Karakiewicz, J. (2011). Urban Metabolism of Low Carbon Cities. *47th ISOCARP Congress: Urban Metabolism* (f. 1). ISOCARP. Gjetur December 10, 2019, nga http://www.isocarp.net/Data/case_studies/1874.pdf

- KE. (2008). *Green Paper on Territorial Cohesion, Turning territorial diversity into strength*.
Bruksel: COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES.
- Kennedy, Alex B. W.; Sankey, H. Riall . (1898). The Thermal Efficiency Of Steam Engines.
Minutes of the Proceedings of the Institution of Civil Engineers. 134, 278-312.
- Kennedy, C., Cuddihy, J., & Engel-Yan, J. (2007). The changing metabolism of cities. *Journal of Industrial Ecology*, 11(2), 43-59.
- Kennedy, C., Pincetl, S. & Bunje, P. . (2010). The study of urban metabolism and its applications to urban planning and design. *Journal of Environmental Pollution*, 159(8-9), 1965- 1973.
- Koumparou, D. (2017). Circular economy and social sustainability. *Proceedings of Solid Waste Management & its Contribution to Circular Economy*. Athens, Greece.
- L. 9482, 'Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje' , 9482 (Prill 03, 2006). Gjetur në <https://www.infrastruktura.gov.al/legalizimet/>, akses 17/12/2020
- L.10119, Për Planifikimin e Territorit, 10119 (Ligj 04 23, 2009).
- L.107/2014, Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, 107 (2014).
- L. 102/2020, Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin, 102 (2020).
- Laszlo, E. (1996). *The system view of the world. A Holistic vision for our time* (bot. i 3d). (A. Montouri, Re.) USA: Hampton Press.
- Lin, Z. (2010). *Kenzo Tange and the Metabolist Movement - Urban Utopias of Modern Japan*. Londër: Routledge.
- Lynch, K. (1981). *A Theory of Good City Form*, . Cambridge, MA.: MIT Press.
- Magoni, M. (2017). Resilience thinking and urban metabolism in spatial planning: which possible integrations. *City, Territory and Architecture*, 4.
doi:<https://doi.org/10.1186/s40410-017-0074-0>
- Marcotullio P. J. & Boyle G. eds. (2003). *Defining an ecosystem approach for urban environmental management* . Tokyo: UNU/IAS .
- Mc Loughlin, B. (1985). *The systems approach to planning: a critique*. Hong Kong: Centre of Urban Studies and Urban Planning.
- McLoughlin, J. (1969). *Urban and Regional Planning: A Systems Approach*. Londër: Faber and Faber.
- Michael Batty, Stephen Marshall. (2009). The evolution of cities: Geddes, Abercrombie and the new physicalism. *Centenary paperTPR*, 12.
- Miho, K. (2003). *Shqipëria - vështrim urbanistik*. Tiranë.
- Misha, A. (2005). *Njohuri Statistikore*. Tiranë: UNDP Albania. Gjetur në <http://www.instat.gov.al/media/6056/4-njohuri-statistikore.pdf>
- Musango, J. C. (2017). *Urban metabolism for resource efficient cities: from theory to implementation*. Paris: UN Environment.
- Musango, J.K., Currie, P. & Robinson, B. . (2017). *Urban metabolism for resource efficient cities: from theory to implementation*. Paris: UN Environment.
- MZHU&AKPT. (2016). *Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Shqipëria 2030*. Tiranë: Pegi.
- MZHU&AKPT. (2016). *Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Shqipëria 2030*. Tiranë: Pegi.
- MZHU, A. (2014). Kriteret për organizimin e sistemit urban. Në A. MZHU, *Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Shqipëria 2030* (f. 64). Tiranë.
- MZHU,AKPT,USAID,CoPlan. (2015). *Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit në Shqipëri, Manual Teknik*. Tiranë: Pegi.

- Nadin, V., & Stead, D. (2008). European Spatial Planning Systems, Social Models and Learning. *The Planning Review*, 44(172), 35-47.
doi:10.1080/02513625.2008.10557001
- Noboru, K. (1960). *Metabolism 1960: Proposals for a New Urbanism*. Tokyo: Bijutsu shuppansha.
- Odum, E. (1963). *Ecology*. New York: Holt, Rinehart & Winston, Inc.
- OECD. (2001). *Towards a New Role for Spatial Planning*. Paris: OECD.
- OECD. (2008). *Measuring material flows and resource productivity, Synthesis report*. OECD.
- OECD. (2008). *Measuring material flows and resource productivity, Volume 1, Guide*. Paris, Francë: OECD.
- Oliveira, F. L. (2011). Of Metabolism: future cities for our contemporary world. *RISCO*, 14(2), 77-81.
- Owens, S. (1986). *Energy, Planning and Urban Form*. Londër: Pion.
- Parlamenti European. (2015). *Territorial governance and cohesion policy*. European Parliament. Gjetur në
https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2015/563382/IPOL_STU%282015%29563382_EN.pdf
- Pincetl, S. (2012). Nature, urban development and sustainability - What new elements are needed for a more comprehensive understanding? *Science Direct, Cities*, 29(2), S32-S37.
- Pincetl, S., Bunjeb, P. Holmes, T. (2012). An expanded urban metabolism method: Toward a systems approach for assessing urban energy processes and causes. *Landscape and Urban Planning*, 107(3), 193-202.
- Pinho, P., Santos, S., Oliveira, V., Barbosa, M., Silva, M. (2010). *Manual of evaluation methodologies, SUME-Working Paper 3.1*. Oporto: SUME. Gjetur në
www.sume.at/project_downloads
- Pinho, P., Santos, S., Oliveira, V., Barbosa, M., Silva, M., Galera Lindblom, P., Weber, R., Reardon, M., Schmitt, P. (2011). *Report on approaches and strategies for a metabolically sustainable city, SUME-Working Paper 3.3*. Oporto: SUME. Gjetur në
www.sume.at/project_down
- Pumain, D. (2004). *Central places theory*. Hypergéó. Gjetur në
<https://www.hypergeo.eu/spip.php?article188#>
- Purvis, B., Mao, Y. & Robinson, D. (2019). Three pillars of sustainability: in search of conceptual origins. *Journal of Sustainable Science*, 14, 681–695.
- Rapoport, E. (2011). *Interdisciplinary Perspectives on Urban Metabolism, An review of the literature*. UCL Environmental Institute Working Paper, Development Planning Unit, Londër. Gjetur në
<https://www.alnap.org/system/files/content/resource/files/main/um-lit-review-final.pdf>
- Robert E. Park & Ernest W. Burgess . (1925). *The City* . United States: University of Chicago Press.
- Roggema, R. & Alshboul, A. (2014). Advanced use of the urban metabolism model in rapidly changing cities. Energy Production and Management in the 21st Century. *Energy Production and Management in the 21st Century*, 190(2), 735-747. Gjetur në

- <https://www.witpress.com/elibrary/wit-transactions-on-ecology-and-the-environment/190/25725>
- Savini, F., Verschuuren, S., Salet, W., & Raats, K. (2015). *Master studio urban planning 2014-2015: urban metabolism*. Amsterdam: Department of Human Geography, Urban Planning and International Development Studies, University of Amsterdam. Gjetur në <https://www.uva.nl/binaries>
- Schalk, M. (2014). The Architecture of Metabolism. Inventing a Culture of Resilience. *Journal of Arts*, 3, 279-297.
- Schmitt, P. & Van Well, L. (2017). *Territorial Governance across Europe – Pathways practices and prospects*. Londër: Routledge.
- Schremmer, C., Mollay, U., Neugebauer, W., Novak, S., Beiglböck, S., Bory, B, Panwinkler, T., Schmitt, P., Dubois, A., Galera-Lindblom, P. (October 2009). *Urban development and urban metabolism – A spatial approach, SUME Working Paper 1.1*. Vienna: SUME. Gjetur në www.sume.at/project_downloads
- Schütz, H., Wuppertal Institute & Mr A. Steurer, A., Eurostat B1. (2001). *Economy-wide material flow accounts and derived indicators, A methodological guide*. Luksemburg, Belgjikë: European Communities.
- Sette, A. (2014). Politica, diplomazia e petrolio: la rivalità italo-britannica per i giacimenti petroliferi albanesi (1920-1925). *Eunomia, Rivista semestrale di Storia e Politica Internazionali, Anno III(2)*, fv. 99-134. Gjetur në <http://siba-ese.unisalento.it>. Università del Salento ALESSANDRO
- Shutina, D. & Toto, R. et al. (2012). *Politikë ndjekës po Politikbërës 2*. Tiranë: Co-Plan.
- Talen, E. (2005). *New Urbanism and American Planning: The Conflict of Cultures*. New York: Routledge.
- Thomson, G., & Newman, P. (2018). Urban fabrics and urban metabolism - from sustainable to regenerative cities. *Resources, Conservation and Recycling*, 218-229.
- Toto, R. (2008). *Rajonalizimi Shqipërisë përkundrejt Reformës Territoriale*. Tiranë: Co-PLAN.
- UN. (2008). *Spatial Planning, Key Instrument for Development and Effective Governance with Special Reference to Countries in Transition*. New York, Geneva: UN.
- UN. (2018). *World Urbanization Prospects: The 2018 Revision*. New York: Department of Economic and Social Affairs Population Dynamics, UN. Gjetur në <https://population.un.org/wup/Publications/Files/WUP2018-Report.pdf>
- UN-Habitat. (2009). *Annual Report 2008*. United Nations Human Settlements Programme. UN-HABITAT.
- Van Der Meer, Jan. & Braun, Erik. (2008). Challenges to national urban policies in the Netherlands. *Journal of Raumforschung und Raumordnung*, 66(2), 178-190.
- Vendimi Nr.5, Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit, 5 (Dhjetor 29, 2014).
- Vitor Oliveira & Rita Vaz. (2021). Is the concept of urban metabolism useful for planning practice? *European Planning Studies*, 29(3), 411-424. doi:10.1080/09654313.2020.1740173
- VKM 686 Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit, pika 17, 686 (11 22, 2017).

- VKM. 320, Për miratimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të Revizionuara (Rev.2), 320 (VKM Maj 28, 2014). Gjetur në <http://www.instat.gov.al/media/1838/nve.pdf>
- VKM. 433, Për miratimin e zbatimit të nomenklaturës së produkteve, 433 (VKM Qershor 17, 1996). Gjetur në http://www.instat.gov.al/media/1841/nomenklatura_e_produkteve_sipas_aktiviteteve.pdf
- Voskamp, Ilse.& Stremke. (2014). *The pulse of the city: exploring urban metabolism in Amsterdam*. Amsterdam: Sven.
- Wassenhoven, L. C. (2018). *The ancestry of Regional Spatial Planning*. Londer: Springer.
- Weinstock, M. (2011). The metabolism of the city – the mathematics of networks and urban surfaces. *Journal of Architectural Design*, 102.
- Wolman, A. (1965). The metabolism of cities. *Scientific American*, 213(3), 179-190.

BURIME ONLINE:

- <http://countrystudies.us/albania/index.htm>
- https://marxists.architecturez.net/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/dokumentet_kryesore/05/vellimi5.2.pdf
- <https://marxists.architecturez.net/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/index.htm>
- <https://www.monitor.al/100-vjet-ekonomia-shqiptare-gjate-regjimit-komunist-1945-1990/>
- https://en.wikipedia.org/wiki/Economy_of_Albania
- <https://www.gutenberg.org/files/32129/32129-h/32129-h.htm>
- <http://www.instat.gov.al/media/6056/4-njohuri-statistikore.pdf>
- https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2015/563382/IPOL_STU%282015%29563382_EN.pdf